

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË

INSTITUTIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE

Tiranë, 2025



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të Përputhshmërisë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“Mbi Auditimin e Përputhshmërisë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Tiranë, Tetor 2025

Nr.	Përmbajtja	
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-3
1.	Përshkrim i shkurtër i rezultateve të auditimit	4-5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-7
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	7-7
II	HYRJA	7-7
1.	Objektivat dhe qëllimi	7-8
2.	Identifikimi i çështjes	8-8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-8
4.	Përgjegjësitë e audituesve	8-8
5.	Kriteret e vlerësimit	9-9
6.	Standartet e auditimit	9-9
7.	Metodat e auditimit	10-10
8.	Dokumentimi i auditimit	10-10
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	10-10
1	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	10-10
2	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit.	11-139
2.1	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.	11-16
2.2	Auditimi i administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore.	16-26
2.3	Auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, për vitin 2024.	26-61
2.4	Auditimi i funksionimit të strukturave të kontrollit, në drejtim të inspektimit të pensioneve.	61-83
2.5	Auditimi i hedhjes së kartelave të pensioneve dhe llogaritjes online të pensioneve në sistemin CMIS.	83-87
2.6	Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore.	87-111
2.7	Mbi procedurat e prokurimit me fonde publike dhe zbatimin e kontratave.	111-117
2.8	Auditimi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin e brendshëm.	117-131
IV	REKOMANDIME	132-147
V	ANKESE	147-155

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i institucionit.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është një institucion publik i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Bazuar në nenin 71, të këtij ligji misioni i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) i cili administron sigurimet shoqërore në përgjithësi dhe politikat e pensioneve në veçanti, konsiston tek vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij institucioni, mbulimi i popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore në çdo vend dhe kohë kur lind kjo e drejtë, rritja e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetar, përmirësimi i eficientësh në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë, mbulimi i të gjithë popullsisë me element të sigurimeve shoqërore dhe akordimi i përfitimeve për pension, paaftësi të përkohshme në punë, barre lindje, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale e përfitime suplementare në momentin e lindjes të së drejtës dhe nevojës për to.

Objektivat: Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elementë të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme. Zbatimit të një sistemi sigurimesh shoqërore që i përgjigjet më mirë stadi të arritur në zhvillimin ekonomik e social të vendit ;Përsosjes së menaxhimit të skemës së sigurimeve shoqërore, sidomos të mbledhjes të ardhurave kontributeve dhe shpërndarjes sa më të drejtë të tyre në formën e përfitimeve, aty dhe atëherë kur lind e drejta. Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore, duke synuar rritjen graduale më të shpejtë të kontributeve në krahasim me rritjen e përfitimeve si dhe duke minimizuar subvencionet buxhetore.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni ka rëndësi, duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit të saj, si administrimin e sigurimeve shoqërore në përgjithësi, politikave të pensioneve në veçanti, vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre. Gjithashtu në qendër, të vëmendjës është rritja e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetarë, përmirësimi i eficientë të menaxhimit të fondeve për administrimin e sistemit të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

-Ligjshmëria e hartimit dhe zbatimit të buxhetit,

-Auditimi i administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore.

-Auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, për vitin 2024.

-Auditimi i funksionimit të strukturave të kontrollit, në drejtim të inspektimit të pensioneve.

- Mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2024

-Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore.

-Mbi procedurat e prokurimit me fonde publike dhe zbatimin e kontratave.

-Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin e brendshëm.

- Auditimi i funksionimit të strukturave të kontrollit, në drejtim të inspektimit të pensioneve.

- Mbi përputhshmërinë e procedurave të kryera në përlllogaritjen dhe pagesat e pensioneve.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është në varësi të çështjeve të auditimit, ku janë përdorur veçmas metodat dhe teknikat e mëposhtme: verifikimi i buxhetit, prokurimeve publike, llogaritjen e pensioneve etj.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 27 gjetje dhe ka dhënë 31 rekomandime, nga të cilat 24 masa organizative dhe 3 masa efekt finansiare; përfitime të padrejta në vlerën 321,415. Lekë, tarifa përmbartimore në shumën 97,873 lekë, si dhe fonde të dëmtuara të pa arkëtuara në shumën 36,304,350 lekë.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Nga auditimi në ISSH, u konstatuan disa nga gjetjet kryesore janë:

-Nga analiza e planifikimit dhe realizimit të treguesve për vitin 2024, rezulton se ISSH nuk ka kryer një ndarje të drejtë të planit të të ardhurave, duke përfshirë në realizimin faktik edhe të ardhurat jo tatimore në shumën 1,852,974 mijë lekë. Të ardhurat tatimore të realizuara janë 137,584,157 mijë lekë, krahasuar me planin prej 137,367,563 mijë lekësh. Mungesa e këtij detajimi ka ndikuar në saktësinë e analizës së realizimit.

-Raportimi i realizimit të të ardhurave sipas Ministrisë së Financave dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore është në vlerën 134,295,143,017 lekë, e raportuar në sistemin Oracle, si dhe të rakorduar me Akt rakordimin nr. 1273/1, datë 27.01.2025.

-Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka raportuar në Ministrinë e Financave vlerën 134,295,636,937 lekë, si realizim të të ardhurave, nga krahasimi midis këtyre dy burimeve ka dalë diferenca negative në vlerën **493,920 lekë**, që janë rimbursime të skemës së sigurimeve shoqërore.

-Nga auditimi rezulton se të ardhurat tatimore të realizuara, janë **137,584,157 mijë lekë**. ISSH nuk ka kryer një ndarje të drejtë të planit të të ardhurave duke përfshirë në realizimin faktik edhe të ardhurat jo tatimore.

-Gjendja e debitorëve që ndiqen nga DPT në vitin 2024 e krahasuar me vitin 2023, ka pasur ndryshime të dukshme në sektorët publik dhe privat. Nga auditimi konstatohet rritje e numrit total të subjekteve debitorë me 10,705 (sektori publik dhe privat), si dhe e vlerës së debisë me 1,769,534 mijë lekë.

-Nga ISSH vijojnë të evidentohen problematika në transmetimin e liste pagesave të formatit elektronik si: Raste të vendosjes së gabuar të Numrit Personal; Problematika e subjektit Drejtorja Arsimore Rajonale Elbasan, Ës e Fier. Drejtoritë arsimore të këtyre rajoneve kanë një problematikë të mbartur të viteve 2013 e 2014; Në sistemin CMIS nuk shfaqen akoma liste pagesat e periudhave të personave gjyq fitues, pasi DPT nuk lejon që për personat gjyq fitues të bëhet liste pagese individuale, për t'u përcjellë më pas në bazën elektronike të ISSH; Në rastet kur subjektet kryejnë pagesa pjesore për punëmarrës të veçantë, të dhënat e kontributeve të paguara nuk shfaqen në sistemin CMIS.

-Nga dosjet të përgjedbura për auditim për 9 raste është konstatuar se përfituesit në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe kanë vazhduar aktiv duke përfituar pension edhe pse ishin të punësuar, çka do të thotë se përfituesi kanë vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar,

-Nga auditimi rezulton se Drejtorja e Inspektimit të Përfitimeve (DIP) nuk ka inspektuar të gjitha dosjet e paraqitura për kontroll, duke devijuar nga plani i miratuar vjetor si dhe nga detyrimet ligjore në fuqi. Ky veprim bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 62, pika 3 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Nga auditimi rezultoi se ka akoma dosje përfitimi, DRSSH/DSSH nuk kanë zbatuar afatet e përcaktuara sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, neni 62, pika 2.

Nga auditimi u konstatua se ka dosje të pa shqyrtuara nga ana e Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve, sipas të përcaktimeve ligjore.

-Nga auditimi i kryer mbi hedhjen e kartelave në sistemin PAMC dhe CMIS si dhe krahasimi ndërmjet dy sistemeve informatike në përdorim, u konstatua se ekziston një numër i

konsiderueshëm rastesh që kërkojnë sistemim, të cilat kanë ardhur si shkak të mospërputhjeve të krijuara nga hedhja manuale e të dhënave në sistem, si dhe nga mosidentifikimi në kohë i rasteve të dy punësimit, pas certifikimi të pensioneve.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Strukturat drejtuese dhe Drejtoria e Financës në ISSH-së në detajimin e planit të ardhurave nga kontributet dhe të realizimit të tyre, të mos përfshijnë të ardhurat jo tatimore (Të tjera DPT dhe ISSH), në zbatim të klasifikimit të të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, sipas Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, pjesë e ligjit dhe akteve normative.

Titullari i ISSH dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të shqyrtojnë mospërputhjet me Treguesit e Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, për sa i përket fondeve për ISSH,

-ISSH të kërkojë reagimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes tyre, si dhe nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në lidhje me rritjen e detyrimeve të prapambetura të kontributeve të sigurimeve shoqërore, ku për shkak të këtyre detyrimeve, ISSH nuk mund të administrojë listëpagesat mujore përkatëse dhe për rrjedhojë një numër i konsiderueshëm individësh të punësuar në këto subjekte, nuk mund të përfitojnë shërbime nga skema e sigurimeve shoqërore.

-Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masa në përditësimin e të dhënave për listëpagesat e munguara për kontributet e sigurimeve shoqërore, me qëllim plotësimin e fondit të arkivës dhe përfitimin e qytetarëve nga skema e sigurimeve shoqërore.

-ISSH-së, DRSSH të marrin masa që të ndryshohet masa e ndalesës së pensioneve për rastet e shpallura debitor në 50% duke aplikuar në përpjestim të drejtë me indeksimin (rritjen) e pensionit, përjashtimisht këstit të fundit.

-Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve të zbatojë me përpikëri planin vjetor të inspektimeve dhe detyrimet ligjore në fuqi, duke garantuar kontrollin e plotë të dosjeve dhe ndërmarrjen e masave në kohë për rikuperimin e përfitimeve të padrejta brenda afateve ligjore.

-ISSH për të minimizuar riskun dhe për të rritur efikasitetin në menaxhimin e sistemeve duhet të mërren masa për ndërtimi e një sistemi të integruar të përbashkët ndërmjet ISSH dhe Drejtorisë së Tatimeve, me qëllim sinjalizime automatike në rastet kur një individ rezulton me dy punësime, cili e bën të mundur verifikim në kohë reale të statusit të punësimit për çdo aplikant, si dhe të sigurojë përputhshmëri të të dhënave midis dy palëve.

- Drejtori i Përgjithshëm, të hartojë plan masash me afate, për të mundësuar certifikimin e dosjeve të pa certifikuar, brenda afatit 3-vjeçar.

-Titullarët e DRSSH/DSSH-ve, të marrin masa dhe të sigurohen që dosjet e konstatuara me problematikë nga Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve, të rishqyrtohen brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren e DIP dhe të përcaktimeve ligjore.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Baza për opinionin e përputhshmërisë:

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit Instituti i Sigurimeve Shoqëror për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, "Deklarata e Limës"; INTOSAI P-10, "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", ISSAI-n 4000 "*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Opinion i kualifikuar¹

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të cilësuar në paragrafin e “Baza për opinionin e kualifikuar” subjekti i audituar, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit Ligji 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH” VKM nr.77, datë 28.01.2015, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar:

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinionit. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shkeljet e evidentuara në disa çështje të audituara, janë materiale por jo të përhapura, referuar popullatave, nënpopullatave të kampionuara dhe kampioneve të testuara, sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Nga analiza e planifikimit dhe realizimit të treguesve për vitin 2024, rezultoi se ISSH nuk ka kryer një ndarje të drejtë të planit të të ardhurave, duke përfshirë në realizimin faktik edhe të ardhurat jo tatimore. Nga auditimi rezultoi se transferimi në Buxhetin e Shtetit i rezultateve financiare të ISSH nuk është kryer sipas Ligjit nr. 97/23 “Për buxhetin e vitit 2024”, duke përdorur pjesën e mbartur nga vitet e mëparshme dhe jo rezultatin e vitit, çka ka mbivlerësuar treguesit e të ardhurave dhe nuk ka rritur fondin rezervë të skemës.

Nga auditimi mbi saktësinë e të ardhurave të rakorduara dhe raportuara në Ministrinë e Financave rezultoi një diferencë negative prej 493,920 lekësh midis të dhënave të ISSH dhe DPT-së, si dhe një mospërputhje prej 5 milionë lekësh me të dhënat e sistemit të Fondit Special të Sigurimeve Shoqërore, duke treguar mangësi në raportimin dhe rakordimin e të ardhurave.

Auditimi mbi debitorët për kontributet e sigurimeve shoqërore evidentoi një rritje të numrit dhe vlerës së borxheve, veçanërisht nga sektori privat, me rritje të borxhit të papaguar mbi 9,763 milionë lekë, duke reflektuar vështirësi në mbledhjen e detyrimeve dhe rrezik për qëndrueshmërinë e skemës.

Nga shqyrtimi i listëpagesave të sigurimeve shoqërore rezultoi mungesë bashkëpunimi midis ISSH dhe DPT, probleme në transmetimin e të dhënave elektronike dhe mangësi të vazhdueshme në mbledhjen e listëpagesave të periudhave të mëparshme.

Nuk janë planifikuar inspektime në disa DRSSH me numër të konsiderueshëm përfituesish, nuk janë inspektuar të gjitha dosjet përkatëse, dhe nuk janë zbatuar rekomandimet për ndalimin e pagesës së përfitimeve në përputhje me ligjin, duke krijuar vonesa në rikuperimin e shpenzimeve të paguara padrejtësisht. Auditimi i dosjeve të përzgjedhura tregoi raste përfituesish ekonomikisht aktivë që kanë vazhduar të marrin pensione, si dhe shkelje të afateve për caktimin e pensioneve dhe mospërputhje të të dhënave midis sistemeve informatike PAMC dhe CMIS.

Nga auditimi i mbledhjeve të Këshillit Administrativ u konstatua se njoftimet dhe dokumentimi i mbledhjeve nuk janë respektuar sipas Statutit të ISSH-së, duke cënuar transparencën dhe llogaridhënien.

Nga auditimi i VKA-ve të ISSH u konstatua, mospërputhje ndërmjet ligjit dhe statutit të ISSH-së mbi nivelin e fondit rezervë.

Gjithashtu, u konstatua se përzgjedhja e muajit gusht 2024 si bazë për përlogaritjen e indeksit ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e përqindjes së indeksimit për përfituesit e skemës

¹ Opinioni i modifikuar, i cilësuar/kualifikuar: Audituesi duhet të shprehë një opinion të cilësuar, kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr.429/1 prot., datë 14.04.2024, me objekt "*Mbi auditimin e përputhshmërisë*", nga data 14.04.2025-18.07.2025, në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, për periudhën nga 01.01.2024 deri në 31.12.2024, u krye auditimi nga grupi i guditimit me përbërje:

1.Valdete Berisha	Përgjegjëse Grupi
2.Isidor Frashni	Audituese
3.Florian Duraj	Auditues
4.Alketa Çobo	Auditues
5.Ervina Basha	Audituese

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objektivat dhe qëllimi i auditimit. Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor në fuqi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Berat, lidhur me vlerësimin e nivelit të zbatimit të kriterëve referuar kuadrin ligjor në fuqi si, Ligji 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në RSH", me ndryshime, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë fushën e sigurimeve shoqërore në RSH. Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Berat, dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur mbi shkallën e zbatimit nga subjektet e audituara ligjeve dhe akteve nënligjore, gjatë veprimtarisë së tij.

Mbi bazën e akt-konstatimeve, diskutimeve me zyrtarët e subjektit të audituar vërejtjeve dhe sugjerimeve në takimin përmbyllës në terren, si dhe observacioneve të sjella mbi akt-konstatimet dhe mbi Projekt Raportin e Auditimit.

Identifikimi i çështjes

Nëpërmjet këtij auditimi kërkojmë të identifikojmë dhe të analizojmë riskun, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, ku u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit

Sa më sipër, fushat me risk të lartë u përcaktuan si drejtimet e auditimit të miratuara me Programin e Auditimit nr.429/1 prot., datë 14.04.2025 deri në datë 18.07.202 si më poshtë:

-Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

-Auditimi i administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore.

-Auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, për vitin 2023.

-Auditimi i funksionimit të strukturave të kontrollit, në drejtim të inspektimit të pensioneve.

-Mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023.

-Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore.

-Mbi procedurat e prokurimit me fonde publike dhe zbatimin e kontratave;

-Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin e brendshëm.

-Mbi përputhshmërinë e procedurave të kryera në përlllogaritjen dhe pagesat e pensioneve, në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Berat.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Strukturat drejtuese të ISSH, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë së ISSH në drejtim të administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, përcaktimit të masës së pensioneve për përfituesit dhe inspektimin e tyre.

Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia jonë është që nëpërmjet auditimit të realizuar:

-Të vlerësojmë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4100), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese;

-Të vlerësojmë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300);

-Të kryejmë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të objektivit.

Ne jemi të pavarur e theksuar kjo në ISSAI-n 10 "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI 30 "Kodi Etik", apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i përmbushim përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë së procesit të legalizimit dhe rregullshmërisë së veprimtarisë.

Kriteret e vlerësimit:

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikat e trajtuara, janë marrë në konsideratë si kriter vlerësues,

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

-Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";

- Rregullore e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit Administrativ të KLSH-së, miratuar me Vendimin të Kryetarit të KLSH nr. 58, datë 08.04.2022;

- Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"

-Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore";

- Ligji nr.10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë";

- Ligji nr.8097, datë 21.3.1996, i ndryshuar "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit";

-Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";

-Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik",

-Ligji nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë";

-Ligji nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore";

-Ligji nr.10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve";

-Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë";

-Ligji nr.97/23 "Për buxhetin e vitit 2024", me ndryshimet përkatëse, etj..

-VKM nr.77, datë 28.01.2015, "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", ndryshuar me VKM 653 dt. 22.07.2015, VKM 551 dt. 27.07.2016, VKM Nr. 660 dt.10.10.2019, VKM Nr. 720 dt. 16.09.2020, VKM nr. 604, datë 14.09.2022 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" VKM nr. 187 datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës" VKM nr.396, datë 28.06.2007 "Për përcaktimin e sëmundjeve profesionale"; VKM nr. 604, datë 14.9.2022 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"; VKM nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet përkatëse etj.,

Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre; Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.07, datë 17.01.2024, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

Metodat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut.

Në këtë auditim janë përzgjedhur metoda, metodologji apo teknika auditimi dhe shtrirje të procedurave të auditimit, për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

-*Intervistimi* - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

-*Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

-*Verifikimi në sistemet IT të ministrisë* - me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

-*Teknikat me ndihmën e kompjuterit* - për procedura të programuara, për të bërë testimet ose për nxjerrjen të dhënave për testim të mëtejshëm;

-*Verifikim transaksionesh* – me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

-*Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

Dokumentimi i auditimit

Auditimi është mbështetur në kërkesat e Manualit të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është një institucion publik i pavarur, organizimi dhe funksionimi

i të cilit rregullohet me dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 25/2017, datë 09.03.2017. Bazuar në nenin 71, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Misioni i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) është administrimi i sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe i politikave të pensioneve në veçanti; vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij institucioni; mbulimi i popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore në çdo vend dhe kohë kur lind kjo e drejtë; rritja e numrit të kontribuuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetarë; përmirësimi i efikasitetit të menaxhimit të fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.

Objektivat e përgjithshme të ISSH-së:

- Vazhdimi të punës për implementimin e skemës së reformuar të pensioneve;
- Zbatimit të politikave të Qeverisë për rritjen e të ardhurave të pensionistëve nëpërmjet rritjes së masës së pensioneve, nëpërmjet indeksimit të tyre;
- Përmirësimi të administrimit të buxhetit të ISSH-së dhe cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve;
- Vazhdimi të punës për krijimin e një baze të plotë, të informatizuar të të dhënave, siç janë periudhat kontributive të personave, zbatimi i plotë i një sistemi të informatizuar të autorizimit dhe pagesave të pensioneve në mënyrë online, si për pagesat në zonat urbane ashtu dhe ato rurale;
- Përmirësimi rrënjësor të praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, fokusimin e tij në luftën kundër informalitetit, duke zbatuar standardet e përcaktuara.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore drejtohet nga:

- Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore është organi më i lartë ekzekutiv dhe përbëhet nga 12 anëtarë,

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Kriteret e vlerësimit:

- Ligji 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 67, datë 23.06.2020.

Dokumentacioni i shqyrtuar:

- Shkresa përcjellëse e Raportit dhe Vendimit të Kryetarit të KLSH-së;
- Plani i masave 20 ditore të dërguar në KLSH;
- Raportimi 6 mujor mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dërguar në KLSH;
- Dokumentacioni i subjektit mbi zbatimin e rekomandimeve.

Auditimi mbi “Përputhshmërinë” është zhvilluar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2023, me Programin e Auditimit nr. 476/1 prot., datë 15.04.2024, i ndryshuar, “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore” për të cilin Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes i janë dërguar subjektit të audituar me shkresën nr. 476/10 prot., datë 03.10.2024, protokolluar në subjektin ISSH me shkresën nr. 4263/6 prot., datë 07.10.2024.

Nga auditimi ka rezultuar:

Në lidhje me hartimin e “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, bazuar në nenin 15, gërma (j) dhe neni 30, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, konstatohet se Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka kthyer përgjigje në Kontrollin e Lartë të Shtetit brenda afatit 20 ditore nga marrja e RPA, nëpërmjet shkresës nr. 4263/7 prot., datë 25.10.2024 “Dërgohet programi i masave në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, dërguar me shkresën nr. 476/10 prot., datë 03.10.2024 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet të

auditimit të ushtruar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrëss”. Me shkresën nr. 4263/9 prot., 02.04.2025, ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e RPA.

Nga grupi i auditimit u verifikua realizimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm dhe nga shqyrtimi i plan veprimit, përgjigjeve të subjektit në lidhje me masat e marra, dokumentacionit përkatës, ka rezultuar se niveli i pranimit është në masën 95.5% dhe i realizimit në masën 52.4%.

Tabela nr. 1.1 “Statusi i zbatimit të rekomandimeve”

Lloji i masave	Masa të dhëna (numër)	Statusi i zbatimit të rekomandimeve				Pranuar	Pranuar pjesërisht
		Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar		
Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi	1				1	1	
Masa organizative	19	10	3	4	2	18	1
Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në admin. e fondeve publike dhe menaxh. me ekonomicitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike.	1		1			1	
Masa disiplinore	1	1				1	
Totali	22	11	4	4	3	21	1

Burimi: ISSH, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH-së

Konkluzion: Nga KLSH, në auditimin e mëparshëm janë dhënë 22 rekomandime, nga të cilët janë pranuar plotësisht 21 dhe 1 është pranuar pjesërisht. Janë zbatuar plotësisht 11 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 4 rekomandime, janë në proces zbatimi 4 rekomandime, si dhe rezultojnë të pa zbatuar 3 prej tyre.

- 1 “Masë për propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi” e dhënë me Rekomandimin nr. 1.1, rezulton e pa zbatuar;

- Nga 19 “Masa organizative” janë zbatuar pjesërisht 3 Rekomandime: nr. 1.1, 11.1, 14.1; janë në proces zbatimi 4 Rekomandime: nr. 3.1, 4.1, 6.1, 13.1; si dhe nuk janë zbatuar 2 Rekomandime: nr. 2.1, 18.1;

- 1 “Masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhura të munguara” e dhënë me Rekomandimin nr. 1.1, rezulton i zbatuar pjesërisht.

Në mënyrë të detajuar rekomandimet e zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi, si dhe të pa zbatuara, paraqiten si më poshtë:

A. Masa për propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi.

1.1 Rekomandimi: Këshilli Administrativ, të propozojë në strukturat përkatëse përmirësimin e nenit 62, pika 2 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, ku minimalisht të përmbajë një klasifikim të masës së penaltetit në varësi të shkeljes, duke parashikuar ose kufij maksimalë dhe minimalë të vlerës së gjorbës ose aplikimin e penaltetit të kategorizuar me fasha.

Përgjigja e subjektit:

Këshillit Administrativ të ISSH, i është paraqitur informacioni me lëndë: “Informacion në lidhje me problematikat e konstatuara për zbatimin e nenit 62, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar, për klasifikim të masës së penaltetit në varësi të shkeljes. Nga Këshilli Administrativ u vendos që, për këtë përmirësim do diskutohet dhe vendoset në mbledhjet që do zhvillojnë në vijim.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga evidencat e vëna në dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se Këshilli Administrativ i ISSH, ka kryer dy mbledhje (përkatësisht më datë 19.11.2024 dhe 30.12.2024) pas lënies së Raportit Përfundimtar të Auditimit, por nuk ka marrë ende një Vendim.

Statusi: I pa zbatuar

1.1. Rekomandimi: Titullari i Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të shqyrtojnë mospërputhjet me Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, përsa i përket fondeve për ISSH, të raportuara në Kapitullin II “Të ardhurave tatimore”; II.3.1 “Të ardhura nga Fondet Speciale” (ISSH) dhe në Kapitullin I “Shpenzimet korrente”, pika 5 “Shpenzimet për

fondet speciale” (ISSH). Instituti i Sigurimeve Shoqërore në vijimësi të mundësojë rritjen e të ardhurave dhe numrin e kontribuuesve, të cilat do të sjellin uljen e deficitit të skemës së pensione, zvogëlimin e subvencionet nga buxheti i shtetit dhe përmirësimin e raportit kontribute me prodhimin e brendshëm bruto (PBB).

Përgjigja e subjektit:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet Drejtorisë së Financës rakordon çdo muaj dhe fundviti, të dhënat fiskale me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë, Postën Shqiptare, Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve para raportimit fiskal dhe mbylljes së Pasqyrave Financiare të vitit. Zhvillon punë sistematike për realizimin dhe rritjen e të ardhurave nga skema e të vetëpunësuar vë në bujqësi dhe realizimit të numrit të kontribuuesve fermerë. Ndjek realizimin dhe rritjen e të ardhurave nga skema e sigurimit vullnetar dhe realizimin e numrit të kontribuuesve vullnetarë. Komunikon në vazhdimësi me të gjitha Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për rritjen e të ardhurave për të vete punësuarit në bujqësi dhe kontribuuesit vullnetar, si dhe rritjen e numrit të kontribuuesve fermerë dhe vullnetarë.

Drejtoria e Kontributeve ka monitoruar dhe vlerësuar procesin e mbledhjes së kontributeve në vazhdimësi me qëllim koordinimin dhe ecurinë e punës pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Vijon bashkëpunimi i përvitshëm me AZHBR-në, për rritjen e numrit të të vetëpunësuar vë në bujqësi, që përfitojnë nga grantet e qeverisë për zhvillimin rural.

Me shkresat nr. 2206 prot., datë 28.02.2024 dhe nr. 10389 prot., datë 11.10.2024, janë përgatitur Programe pune “Për ecurinë e realizimit të ardhurave për të vete punësuarit në bujqësi për vitin 2024”, si dhe me shkresën nr. 2205 prot., datë 28.02.2024 Program pune “Për ecurinë e realizimit të të ardhurave për sigurimin vullnetar”. Realizimi i planit të të ardhurave kontributeve dhe realizimi i numrit të kontribuuesve është proces pune në vazhdimësi dhe në fokus të Drejtorisë së Kontributeve.

Komenti i grupit të auditimit:

Për zbatimin e këtij rekomandimi janë paraqitur evidenca bazuar në gjetjen e auditimit, por nga auditimi për veprimtarinë e ISSH për vitin 2024, rezultoi se ka mospërputhje, midis të dhënave të raportuara nga ISSH dhe atyre të Tabelës së Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit në faktin e të ardhurave; Gjatë vitin 2024 deficitin financiar i sistemit u përmirësua lehtë, duke zbritur në -17,724 milionë lekë ose -0.71% i PBB, krahasuar me -18,358 miliardë lekë në vitin 2023, me një përmirësim prej 634.1 milionë lekë ose 0,03% të PBB. Përmirësimi i deficitit për vitin 2024, ka qenë kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave për shkak të rritjes së pagave mesatare dhe i rritjes së numrit të kontribuuesve. Rekomandim rezulton i zbatuar pjesërisht.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

2.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ISSH-së, në vijim, në detajimin e planit të të ardhurave nga kontributet dhe të realizimit të tyre të kenë parasysh klasifikimin e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, sipas Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, pjesë e ligjit dhe akteve normative pa përfshirë të ardhurat jo tatimore (Të tjera DPT dhe ISSH).

Përgjigja e subjektit:

Në raportimin e Pasqyrave Financiare dërguar në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministrinë e Financave, janë ndarë të ardhurat e realizuara në zëra të veçantë, sipas llogarive kontabile që i përkasin. Si dhe është evidentuar veprimtaria ekonomiko-financiare e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në përputhje të plotë me standartet e kontabilitetit publik dhe me qëllim pasqyrimin e detajuar të veçorive e specifikave të aktivitetit financiar të sistemit të sigurimeve shoqërore.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga evidecat e paraqitura, rezulton se ISSH edhe për vitin 2024, nuk ka kryer detajimin e planit të të ardhurave nga kontributet dhe të realizimit të tyre sipas Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, pasi në fakt ka përfshirë si realizim i të ardhurave edhe të ardhura jo tatimore (nga gjokat, kamatat, interesat),

Statusi: I pa zbatuar

3.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrë masat për zgjidhjen e problematikave të mbartura midis tyre në lidhje me arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për kontributet e sigurimeve shoqërore nga 110,129 subjektet publike dhe private, në vlerën 18,4 miliardë lekë.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 9189 prot., datë 03.09.2024, ISSH i është drejtuar DPT-së dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me objekt problematikat që lindin nga detyrimet e prapambetura për kontributet e sigurimeve shoqërore. Ky proces është ndjekur dhe ndiqet me përparësi në vijimësi, duke bashkëpunuar me këto institucione.

Komenti i grupit të auditimit:

Për zbatimin e tij, ISSH paraqiti evidencë bazuar në gjetjen e auditimit dhe duke qenë se është proces pune e cila ndiqet në vijimësi, rekomandimi rezulton në proces zbatimi.

Statusi: Në proces zbatimi

4.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Arkivit Qendror dhe Sektori i Arkivës në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, të marrin masa për përditësimin e të dhënave për listëpagesat e munguara për kontributet e sigurimeve shoqërore, për subjektet buxhetore, jo buxhetore, biznes i madh, biznes i vogël, me qëllim plotësimin e fondit të arkivës dhe përfitimin e qytetarëve nga skema e sigurimeve shoqërore. ISSH për personat “Të vetëpunësuar që kanë edhe të punësuar të tjerë”, që rezultojnë të kenë derdhur kontribute, të vijnë me njoftime dhe sensibilizime, me qëllim maksimizimin e grumbullimit të listë pagesave të kësaj kategorie.

Përgjigja e subjektit:

Mungesa e listëpagesave të subjekteve publike, biznes i madh privat dhe biznes i vogël deri më 31.12.2023, kanë qenë 1,483,347, gjatë vitit 2024 janë mbledhur 7,574 listëpagesa. Nga strukturat përgjegjëse në ISSH kryhet komunikim i vazhdueshëm me Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për të vijuar grumbullimin e listëpagesave të munguara. Ky proces është ndjekur dhe ndiqet me përparësi në vijimësi, duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale të Tatimeve, si dhe institucionet respektive.

Komenti i grupit të auditimit:

Për zbatimin e tij, ISSH paraqiti evidencë bazuar në gjetjen e auditimit. Rekomandimi rezulton në proces zbatimi.

Statusi: Në proces zbatimi

6.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, të hartojë plan masash me afate, për të mundësuar certifikimin e dosjeve të pa certifikuar, duke vlerësuar të angazhojë edhe Drejtorinë e Përfitimeve në ISSH, e cila ka në përbërje të saj specialistë të fushës së lidhjes së pensioneve. Gjithashtu, të marrë masa për inspektimin dhe certifikimin e të gjitha dosjeve të përfituesve brenda afatit 3-vjeçar.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 651 prot., datë 18.01.2024, Drejtori i Përgjithshëm ka miratuar “Planifikimin vjetor të punës së Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve, për vitin 2024” me qëllim kryerja e inspektimit dhe certifikimit të përfitimeve të caktuara, brenda afatit 3-vjeçar. Me shkresën nr. 12360 prot., datë 11.12.2024, është bërë një ndryshim i planifikimit vjetor të punës në këtë drejtori, për shkak të reduktimit të kapaciteteve inspektuese.

Me shkresën nr. 3575 prot., datë 01.04.2025, Drejtori i Përgjithshëm i ISSH ka nxjerrë urdhrin nr. 4, datë 01.04.2025 “Për ngarkimin e dy specialistëve të Drejtorisë së Përfitimit, në procesin e certifikimit të dosjeve të pacertifikuara”.

Komenti i grupit të auditimit:

Me shkresën nr. 12360 prot., datë 11.12.2024 të titullarit të ISSH, është ndryshuar planifikimi vjetor, duke u hequr nga kontrolli, DRSSH Elbasan për shkak të reduktimit të stafit inspektues. Rekomandimi konsiderohet në proces deri në inspektimin dhe certifikimin e të gjitha dosjeve të përfituesve brenda afatit 3-vjeçar.

Statusi: Në proces zbatim

11.1. Rekomandimi: Titullari i Institutit të Sigurimeve Shoqërore të zbatojë menjëherë masat korrigjuese për të rregulluar shkeljen e procedurave të blerjeve me vlerë të vogël nëpërmjet shqyrtimit të detajuar të proceseve të blerjes për rastet e mëparshme, një rivlerësim të dokumentacionit dhe procedurave të përdorura për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, për të siguruar përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret në fuqi të sektorit publik.

Përgjigja e subjektit:

Drejtori i Përgjithshëm i ISSH ka nxjerrë urdhërat për ngritjen e komisioneve të veçanta në përputhshmëri me ligjin dhe rregulloret në fuqi, si dhe janë marrë masat për rivlerësimin e dokumentacionit të procedurave të kryera më parë. Sektori i Administratës dhe Prokurimeve ka kryer trajnime tek ASPA.

Komenti i grupit të auditimit:

Për zbatimin e këtij rekomandimi u paraqitën observacionet e dërguara nga Sektori i Administratës dhe Prokurimeve grupit të auditimit të KLSH-së, si dhe evidenca mbi trajnimet e kryera. Për sa më sipër, rekomandimi është pranuar pjesërisht dhe zbatuar pjesërisht.

Statusi: I pranuar pjesërisht dhe zbatuar pjesërisht.

13.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave/shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo aplikim për kriteret e veçanta të jetë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Vendosija dhe vlerësimi i çdo kriteri duhet të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar.

Përgjigja e subjektit:

Njësia e prokurimit ka marrë masa që kriteret e veçanta të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa argumenton Njësia e Prokurimit dhe nga dokumentet që ka vënë në dispozicion grupit të auditimit, ky është një proces që duhet të kihet në konsideratë dhe të zbatohet për çdo aplikim për kriteret e veçanta, prandaj rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Statusi: Në proces zbatim

14.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ISSH dhe Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm të marrin masa për plotësimin e pozicioneve vakante në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm. Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, të marrë masa për planifikimin e auditimit të sistemeve IT.

Përgjigja e subjektit:

Gjatë vitit 2024, janë plotësuar 3 vendet vakante në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, por gjatë këtij viti është larguar 1 (një) punonjës (dalje në pension). Me shkresën nr. 6167/1 prot., datë 28.05.2024, Drejtori i Përgjithshëm ka miratuar Program Angazhimi të Auditimit të IT në Drejtorinë e Burimeve të Informacionit në ISSH.

Komenti i grupit të auditimit:

Sipas evidencave të vëna në dispozicion, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm rezultojnë përsëri 2 vende vakante.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

18.1. Rekomandimi: Këshilli Administrativ të shqyrtojë dhe të analizojë në veçanti zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi.

Përgjigja e subjektit:

U shqyrtua në bordin e drejtorëve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, si dhe në mbledhjen e ardhshme do i paraqitet një informacion i detajuar, Këshillit Administrativ.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, nuk u paraqitën evidenca mbi shqyrtimin dhe analizimin nga KA, e rekomandimeve të zbatuara pjesërisht dhe si përsheptimin e atyre në proces zbatimi të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Statusi: I pa zbatuar

C. Masa për eliminimin e efekteve negative

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit të marrë masa që të rikontrollojë dhe të evidentojë, përfitimet e llogaritjes së gabuar nga Njësiti e Përfitimeve, më qëllim arkëtimin e tyre.

Përgjigja e subjektit:

Drejtoria e Inspektimit të përfitimeve ka kryer kontrole për secilën dosje dhe në varësi të problematikës i'u dërgon orientimet respektive rajoneve, të cilët kanë marrë masa për zbatimin e tyre.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa konstatohet nga shkresat e vëna në dispozicion grupit të auditimit, Drejtoria e Inspektimit për vitin 2024 ka marrë masa me kontrollin e dosjeve të konstatuara me parregullsi, por nuk është kryer ende arkëtimi i shumës prej 322,379 lekë. Rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 4089/2 prot., datë 25.07.2025, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 429/2 prot., datë 28.07.2025.

Pretendimet e subjektit:

1. Për Rekomandimin nr. 7.1, në përgjigje të shkresës nr. 3566/1 prot., datë 28.03.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, DRSSH-të përkatëse kanë kthyer përgjigje mbi masat e marra në zbatim të rekomandimit të lënë nga KLSH, në auditimin e mëparshëm.

Me shkresën nr. 8811/2 prot., datë 07.05.2025 Drejtoria e Financës së DRSSH Tiranë ka kthyer përgjigje në ISSH mbi identifikimin e saktë të masave debitorë për secilin rast, si dhe janë bërë sistemimet nga masa 20% në 50%. Me shkresën nr. 5369/1 prot., datë 08.04.2025, Dega e Përfitimeve e DRSSHs ka kthyer përgjigje në ISSH, pasi ka kryer sistemimet e debisë së mbetur nga masa 20% në 50%. Me shkresën nr. 7396 prot., datë 15.04.2025, Dega e Përfitimeve në DRSSH Elbasan ka kthyer përgjigje pas identifikimit të 5 rasteve dhe sistemit të masës së ndalesës nga 20% në 50%. Me shkresën nr. 3566/1 prot., datë 28.05.2025 Drejtoria Rajonale Shkodër ka njoftuar ISSH mbi masat e marra në sistemin e ndalesës nga 20% në 50%. Me shkresën nr. 3652/2 prot., datë 10.04.2025, Dega e Përfitimeve në DRSSH Berat ka kthyer përgjigje pas identifikimit të 3 rasteve dhe sistemit të masës së ndalesës nga 20% në 50%.

2. Për Rekomandimin nr. 8.1, në përgjigje të shkresës nr. 11721 prot., datë 19.11.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, Dega e Përfitimeve në DRSSH Durrës- ka marrë masat dhe ka kthyer përgjigje në ISSH, me shkresën nr.21640 prot., datë 10.12.2024.

3. Për Rekomandimin nr. 9.1, në përgjigje të shkresës nr. 245 prot., datë 13.01.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, DRSSH kanë paraqitur njoftimet mbi zbatimin e rekomandimeve të paraqitura në Raportet përfundimtare, në përfundim të inspektimeve të kryera gjatë vitit 2024, nga Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve.

4. Për Rekomandimin nr. 10.1, në përgjigje të shkresave nr. 10809 – 10809/13 prot., datë 23.10.2024, si dhe nr. 11205 prot., datë 04.11.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, DRSSH/DSSH kanë kthyer përgjigje me shkresat përkatëse 4332 prot., datë 06.12.2024, 2161/1 prot., datë 20.12.2024, 6850 prot., datë 13.03.2025 mbi masat që kanë marrë dhe dërgimin e informacionit në ISSH.

5. Për Rekomandimin nr. 13.1, Njësia e prokurimet argumenton se, gjatë vitit 2024 është zhvilluar vetëm një procedurë prokurimi "E hapur e thjeshtuar", ku njësia e prokurimit ka zbatuar me përpikmëri Ligjin për Prokurimi Publik dhe ka vendosur kritere në përputhje me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, e cila është e dokumentuar dhe me proces verbalin e argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim.

Gjithashtu edhe në procedurat e tjera që janë kontrolluar nga grupi i auditimit, proceduara me vlerë të vogël, janë zbatuar rregullat dhe ligjshmëria sipas përcaktimeve të Prokurimit Publik.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

1. Në lidhje me Rekomandimin 7.1, ISSH ka përcjellë në KLSH, shkresat mbi masat e marra nga DRSSH-të përkatëse, në zbatim të rekomandimit të lënë nga KLSH, në auditimin e mëparshëm. Observacioni merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Projekt Raportin e Auditimit.
2. Në lidhje me Rekomandimin 8.1, ISSH ka përcjellë në KLSH, shkresën mbi masat e marra nga DRSSH. Observacioni merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Projekt Raportin e Auditimit.
3. Në lidhje me Rekomandimin 9.1, ISSH ka përcjellë në KLSH, shkresat e DRSSH mbi masat e marra në zbatim të rekomandimeve të paraqitura në Raportet përfundimtare, në përfundim të inspektimeve të kryera gjatë vitit 2024, nga Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve. Observacioni merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Projekt Raportin e Auditimit.
4. Në lidhje me Rekomandimin 10.1, ISSH ka përcjellë në KLSH, shkresat e DRSSH mbi masat e marra, në zbatim të rekomandimit të lënë nga KLSH. Observacioni merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Projekt Raportin e Auditimit.
5. Për sa ka argumentuar Njësia e Prokurimit në ISSH, observacioni merret pjesërisht në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.2. Auditimi i administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore.

Për auditimin e këtij drejtimi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Shpenzimet totale të ISSH;
- Financimi nga Buxheti i Shtetit;
- Marrëveshjet e bashkëpunimit të ISSH me institucionet homologe përgjatë vitit 2024;
- Shpenzimet për programe të veçanta shtetërore;
- Investim i i Fondit Rezervë përgjatë 2024.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 71 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar drejtohen dhe administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH, këtu e në vijim).

Misioni i ISSH, është përcaktuar në Rregulloren e miratuar më 15.03.2018, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” ndryshuar me rregulloren nr.556/2 datë 07.10.2024 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, detyrat për realizimin e këtij objekti janë: “*Administrimi i sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe i politikave të pensioneve në veçanti, vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij institucioni, mbulimi i popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore në çdo vend dhe kohë kur lind kjo drejtë, rritja e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetar, përmirësimi i evidencës në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë*”.

Elementet e sigurimeve shoqërore;

Shtyllat kryesore të mbulimit të sigurimeve shoqërore, dhe ato administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) në Shqipëri, paraqiten si më poshtë;

1. Sigurimi për pleqëri;
2. Sigurimi për invaliditet;
3. Sigurimi për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
5. Sigurimi për papunësinë;
6. Sigurimi për barrëlindje dhe mëmësi.


Skemat e sigurimeve;

- *Një skemë sigurimesh shoqërore e detyrueshme* që administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe mbulon të punësuarit në shtet dhe në sektorin privat dhe të vete punësuarit në zonat urbane dhe rurale, me kusht që ata të kenë kontribuar për një kohë të përcaktuar në skemë.
- *Një skemë vullnetare* që përfshin ata që nuk janë më të siguruar, që kanë qenë dhe duan të

vazhdojnë të jenë si edhe ata që nuk janë të mbuluar nga ligji përfshirë dhe studentët e universitetit.

- *Një skemë suplementare* për funksionet e larta kushtetuese, shërbimin civil dhe ushtarakët e punësuar në ushtri, në polici dhe në shërbimin informativ. Pensionet suplementare financohen drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit.
- *Pensione të veçanta* për ata që kanë marrë pjesë në luftë, që kanë tituj në fushën e kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës si edhe të përndjekurit nga regjimi totalitar. Pensionet e veçanta financohen gjithashtu drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit.

SISTEMI I SIGURIMEVE SHOQËRORE



Në kuadër të strategjive kombëtare në fushën e mbulimit social ISSH duhet në mënyrë të vazhdueshme të sigurojë ruajtjen dhe përmirësimin e standardeve të jetesës për pensionistët dhe të moshuarit nëpërmjet:

-Zbatimit të kuadrit rregullator për fondet e pensioneve, sipas indeksit të çmimeve të konsumit; Ka rezultuar se gjatë vitit 2024, mbulimi me pensione sociale të personave mbi 70 vjeç, që nuk kanë mundur të kontribuojnë në skemën e pensioneve;

-Mbrotjes së shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, ish -shtetas shqiptarë, që janë jashtë shtetit, në përputhje me konventat, marrëveshjet dy paleshe dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

-Zbatimit të kuadrit rregullator për zhvillimin e kompensimeve në varësi të ndryshimeve të çmimit të energjisë elektrike për pensionistët dhe kompensime të tjera të rregulluara me anë të VKM-ve. Në lidhje me veprimtarinë e ISSH, në drejtim të zbatimit të pikave të mësipërme, në kuadër të realizmit të strategjisë Kombëtare në fushën e mbulimit social, përgjatë vitit 2024 ka rezultuar si më poshtë ;

Me vendim nr.582 datë 18.09.2024 “Për indeksimin e pensioneve” Këshilli i Ministrave ka miratuar rritjen në masën 4.1% të pensioneve të kategorive sipas përcaktimeve në këtë vendim. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi janë përlllogaritur në shumën 1,693,000,000 (një miliard e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre milionë) lekë, të cilat janë përcaktuar të përballohen nga fondi për politikën e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të vitit, dhe janë ndarë:

-1 657 000 000 (një miliard e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë) lekë, për mbulimin e pagesave të përfitimeve;

-36 000 000 (tridhjetë e gjashtë milionë) lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a., dhe bankat e nivelit të dytë.

Në vitin 2024 me Vendimin nr.736 date 27.11.2024 “Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2024”, Këshilli i Ministrave miratoi dhënien e një shpërblimi, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë ose në masën 10 000 (dhjetë mijë) për kategoritë e përfituesve të përcaktuar në VKM.

Vendimin nr.736 date 27.11.2024 gjithashtu ka parashikuar: Efektet financiare, prej 9 873 862 000 (nëntë miliardë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekësh, përballohen, si më poshtë vijon:

- a) në masën 3 650 000 000 (tre miliardë e gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë, nga fondi “Kontingjencë për bonusin e pensionistëve”, i miratuar në buxhetin e vitit 2024;
- b) në masën 2 444 000 000 (dy miliardë e katërqind e dyzet e katër milionë) lekë, nga fondi “Për indeksimin e pensioneve”, i miratuar në buxhetin e vitit 2024;
- c) në masën 3 779 862 000 (tre miliardë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, nga buxheti i shtetit dhe buxheti i planifikuar për sigurimet shoqërore, për vitin 2024”.

Sipas Aktit Normativ nr. 3, datë 29.08.2024, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, shuma e të ardhurave dhe shpenzimeve në vlerën 185,825 milion lekë janë reflektuar si ;

- Për skemën e detyrueshme shuma e të ardhurave dhe shpenzimeve është 169,838 milion lekë, i cili në total krahasuar me planin fillestar ka sjell efekt financiar duke shtuar kontributet në vlerën 1,000 milion lekë, dha pakësuar transferues nga buxhetit i shtetit në shumën 1,000.5 milion lekë.
- Për Skemën Suplementare janë në vlerën 8,200 milion lekë, i cili në total krahasuar me planin fillestar ka sjell efekt financiar duke shtuar kontributet në vlerën 128 milion lekë, dhe pakësuar transfertën nga buxhetit i shtetit në shumën 128.5 milion lekë.
- Në total këto ndryshime kanë sjellë pakësim të Transfertës së buxhetit në vlerën 1,128 milion lekë dhe shtim të Kontributeve në vlerën 1,129 milion lekë.


VKM nr.736 datë 27.11.2024 “Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fund vitit 2024”, me efekt financiar + 9,874 milion lekë, i cili do të mbulohet nga fondi “Kontingjente për bonusin e pensionistëve”, i miratuar në buxhetin e vitit 2024;

në masën 2,444,000, 000 lekë, nga fondi “Për indeksimin e pensioneve”, i miratuar në buxhetin e vitit 2024;në masën 3 779 862 000 lekë, nga buxheti i shtetit dhe buxheti i planifikuar për sigurimet shoqërore, për vitin 2024”, duke filluar nga data 1 dhjetor e në vazhdim .

Sipas Aktit Normativ nr. 5, datë 19.12.2024, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, shuma e të ardhurave dhe shpenzimeve në vlerën 188,825 milion lekë janë reflektuar si më poshtë:


- Për skemën e detyrueshme janë 169,658 milion lekë, i cili në total krahasuar me planin fillestar ka sjell efekt financiar duke u pakësuar më vlerën 180 milion lekë. Këto ndryshime kanë sjellë pakësim të transferuese së buxhetit në vlerën 1,180 milion lekë dhe shtim të Kontributeve në vlerë 1,000 milion lekë.
- Për Skemën Suplementare janë në vlerën 7,600 milion lekë, i cili në total krahasuar me planin fillestar ka sjell efekt financiar duke u pakësuar më vlerën 600 milion lekë.
- Në total këto ndryshime kanë sjellë pakësim të Transfertës së buxhetit në vlerën 728 milion lekë dhe shtim të Kontributeve në vlerën 128 milion lekë.

PËRQINDJA E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE SIPAS DEGËVE



Burimi: ISSH, punuar nga grupi i KLSH

ISSH ADMINISTRON SKEMËN E DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËROR



Burimi ISSH. Punuar nga Grupi i KLSH –së.

ISSH bazuar në objektivin kombëtar të integrimit në BE, në nenin 70 të MSA-së që përcakton përafrimin e gjithë legjislacionit të brendshëm me atë të Bashkimit Evropian, në Planin Kombëtar të Integrimit Evropian, legjislacioni për sigurimet shoqërore në tërësi përfshirë edhe menaxhimin dhe administrimin e gjithë sistemit të sigurimeve shoqërore që ka synuar në përafrimin me legjislacionin e BE-së, Lidhur “Marrëveshjet e bashkëpunimit të ISSH me institucionet homologe përgjatë vitit 2024” si më poshtë;

- Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë ka nisur zbatimin që nga viti 2005 ku; *Gjatë vitit 2024, në total janë ndjekur 25 praktika në zbatim të marrëveshjes.*
- Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës e hyrë në fuqi prej datë 01.01.2016. *Gjatë vitit 2024, janë ndjekur në total 158 praktika.*
- Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë hyri në fuqi prej datës 01.07.2016. *Gjatë vitit 2024, janë ndjekur në total 13 praktika.*
- Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut, hyrë në fuqi që prej datës 01.07.2016. *Gjatë vitit 2024, janë ndjekur në total 25 praktika.*
- Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, hyrë në fuqi prej datës 01.06.2016. *Konkretisht, për vitin 2024 janë ndjekur në total 42 praktika.*
- Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke, hyrë në fuqi prej datës 01.02.2017. *Konkretisht për 2024 janë ndjekur në total 5 praktika.*
- Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, ka hyrë në fuqi prej datës 01.12.2017, *gjatë vitit 2024 janë ndjekur në*

total 872 praktika.

- Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë, hyri në fuqi më 01.12.2018 dhe gjatë vitit Janë ndjekur 284 praktika, në zbatim të marrëveshjes.

- Marrëveshja dypalëshe për sigurimet shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, hyri në fuqi më 01.07.2022. Gjatë vitit 2024 janë ndjekur 16 praktika.

- Marrëveshja dypalëshe për mbrojtjen shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë, hyri në fuqi më 01.08.2022. Gjatë vitit 2024 janë ndjekur në total 79 praktika, në zbatim të marrëveshjes.

- Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për Mbrojtjen Shoqërore ka hyrë në fuqi më datë 01.10.2023. Gjatë vitit 2024 janë ndjekur në total 16 praktika, në zbatim të saj.


- Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikën e Kroacisë për Mbrojtjen Shoqërore ka hyrë në fuqi më datë 01.05.2024. Nga hyrja në fuqi deri në fund të vitit është ndjekur vetëm 1 praktikë, kërkesë për vërtetim periudhash sigurimi.

ISSH, gjatë vitit 2024 u ka siguruar mbrojtje shtresave në nevojë, duke kryer kompensime sipas VKM-ve përkatëse në lidhje me kompensimet për energjinë elektrike, për pensionet sociale, invalidët e luftës, etj., në shumën totale 18,371 lekë, ose 99.7% kundrejt atyre të planifikuara. Shpenzimet për programe të veçanta për vitin 2024 në mënyrë të detajuar paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.1“Shpenzimet për kompensime të pensionistëve përgjatë vitit 2024”

Ref. E llogarisë	Përshkrimi					
		Plan 2024	Fakt 2024	Fakt 2023	% real. Fakt/plan 24	% e 24-23
	Shpenzime për programe të veçanta shtetërore	18,446.73	18,371.00	16,107.20	100%	114%
60.060.008	Kompensim suplementar për çmimin për pensionistet	4,496.51	4,488.70	4,588.00	100%	98%
60.600.081	Kompensim te ardhura për pensionet e shtetit	12,933.59	12,874.15	10,680.70	100%	121%
60.600.081	Kompensim te ardhura për pensionet e fshatit	406.98	405.23	384.2	100%	105%
6.060.009	Pensione te veçanta shtetërore (Pensione te posaçme)	308.28	305.37	179.8	99%	170%
6.060.010	Pensionet sociale	218.89	217.08	187.6	99%	116%
6.060.011	Kompensim për veteranët dhe invalidët e luftës	36.39	35.81	40.5	98%	88%
60.600.122	Rimbursim i shpenz të invalidëve për karburant	46.09	44.68	46.4	97%	96%

Paraqitur dhe sipas Grafikut



Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga tabela si dhe grafikun më sipër rezulton se, për vitin 2024 zërat e shpenzimeve nuk kanë tejkalim të planit kjo si rezultat i planifikimit të mirë të shpenzimeve. Po të krahasojmë periudhën 2024 me 2023 kemi një rritje të shpenzimeve kjo për shkak të rritjes së numrit të përfituesve, të rritjes së përfitimeve gjatë vitit 2024 sipas VKM-ve përkatëse. Kontributet Veprimtaria e ISSH-së ka si qëllim, drejtimin e mbledhjes së të ardhurave nga kontributet e të vet punësuarve në bujqësi dhe nga të siguruarit vullnetarë.

Misioni i ISSH-së, gjithashtu përfshin dhe; “*rritjen e numrit të kontribuuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetar*”.

Në lidhje me këto tregues, gjatë vitit 2024 ka rezultuar:

Grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetar:

Të ardhurat kontributeve mbledhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

ISSH mbledh të ardhura nga kontributet e fermerëve (vetëpunësuar në bujqësi) dhe të të siguruarve vullnetar.

Për vitin 2024, kontributet e mbledhura nga ISSH, të planifikuar dhe faktik paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.2 “Të ardhurat sipas llojeve të kontributit, të mbledhura nga ISSH”

Në mijë /lekë,

Përshkrimi	2024			2023			%Δ 24-23
	Plan	Fakt	realiz	Plan	Fakt	realiz	Fakt
Të vete punësuarit në Bujqësi							
Të ardhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore	3,490	3,464	99.26%	2,393	2,901	121%	19.4%
Numri fizik i kontribuuesve	97,051	40,507	41.74	66,516	37,877	56.94	6.9
Numri i kontribuuesve	97,051	88,866	91.57%	66,516	75,451	113%	17.8%
Sigurimi Vullnetar							
Të ardhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore	750	718	96%	600	712	119%	0.8%
Numri fizik i kontribuuesve	7,234	5,254	72.63	6,211	5,221	84.06	0.60
Numri i kontribuuesve	7,234	6,931	95.81	6,211	7,362	119%	-5.9%

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Gjatë vitit 2024 ka rezultuar se kontributet e sigurimeve shoqërore të mbledhura nga ISSH janë 99.26% në raport me planin për të vete punësuarit në bujqësi dhe 96% për kontributet e sigurimeve vullnetare, ndërsa në krahasim me një vit më parë kontributet e sigurimeve shoqërore

për të vete punësuarit në bujqësi janë rritur me 19.4%, ndërsa për të siguruarit vullnetarë me 0.8%. Numri i kontribuuesve për secilën kategori paraqitet në rritje në krahasim me një vit më parë, konkretisht për vitin 2024 rezulton se, për të vetë punësuarit në bujqësi ka pasur një rritje me 6.9 % krahasuar me vitin 2023 për numrin fizik dhe me 17.8% për numrin mesatar muaj/njerëz/kontribute.

Për kategorinë “të siguruar vullnetarë” rritja e numrit të kontribuuesve krahasuar me një vit më parë është 0.6%.

Rritja e kontributeve të mbledhura nga këto kategori ka ardhur edhe si rezultat i rritjes së pagës minimale, e cila shërben si bazë për llogaritjen e masës së këtyre kontributeve dhe numrit të kontribuuesve.

Në analizat e bëra nga grupi i auditimit të dhënat e marra nga ISSH në lidhje me këta dy tregues rezulton se, pavarësisht rritjes në numrin dhe shumën e kontributeve për të vetë punësuarit në bujqësi, situata nuk paraqitet pozitive, pasi vihet re mos interesim nga grup moshat e reja për të punuar pranë ekonomive të tyre fermerë dhe punësimi i përhershëm apo se zonal i tyre në sektorë të tjerë, po ashtu moshat mesatare e lartë e fermerëve dhe mungesa e pasardhësve të gatshëm për të vazhduar punën në bujqësi paraqet një kërcënim për fuqinë punëtore në të ardhmen e afërt.

Niveli i ulët ekonomik në zonat rurale, kryesisht ato të thella malore, ose larg zonave urbane, nuk mundëson kapacitet financiar të kësaj kategorie nga kryerja e aktivitetit bujqësor ose blegtoral, për të paguar kontributet e sigurimeve shoqërore.

Në lidhje me skemën e të vete punësuarve në bujqësi, është krijuar mentaliteti, i “skemës vullnetare” dhe jo si “skemë e detyrueshme”, çfarë ka bërë që trendi i rritjes së treguesve në lidhje me të vete punësuarit në bujqësi të ulët.

Nga grupi i auditimit, për kontributet e mësipërme, që mbledhen nga ISSH, është analizuar si ka ndikuar në shumën e kontributeve të mbledhura, niveli i pagës minimale dhe rritja e numrit të kontribuuesve, konkretisht gjatë vitit 2024, niveli i pagës minimale nuk ka ndryshuar, - për periudhën Prill 2023 e në vazhdim paga minimale është 40,000 lekë.

Gjatë vitit 2024 numri fizik i kontribuuesve “të vetëpunësuar në bujqësi”, ka pësuar një rritje me 6.9% krahasuar me vitin 2023, dhe numri mesatar (muaj/njerëz/kontribute) për këtë kategori kontribuueses ka një rritje prej 17.8% krahasuar me vitin 2023.


Rritja e numrit të kontribuuesve ka ndikuar ndjeshëm në masën e të ardhurave të mbledhura nga ISSH, nga kontributet e drejtpërdrejta të cilat krahasuar me një vit më parë janë rritur me 19.4%.

Në mënyrë të detajuar treguesit e mësipërm paraqiten si në tabelën në vijim:

Tabela nr. 3 “Treguesit e pagës minimale, numër kontribuueses dhe të ardhura të drejtpërdrejta nga kontributet e drejtpërdrejta në ISSH për periudhën 2023-2024”

Përshkrimi	2024	2023	%Δ 24-23
Paga minimale mesatare (lekë)	40,000	40,000	
Nr. Kontribuuesve ISSH + DPT	805,416	783,252	2.8%
Të ardhurat nga kontributet shoqërore të drejtpërdrejta (mil. lekë)	137,437	124,618	10.3%
Masa mujore e kontributit për të vete punësuarit (person fizik)	9,200	9,200	
Masa e kontributit për sigurimin vullnetar	8,640	8,640	

*Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimi KLSH
Shprehur edhe sipas grafikut.*



Nga tabela më sipër rezulton, se rritja e numrit të kontribuuesve prej 22,164 kontribuues ka reflektuar në rritjet e të ardhurave prej 10.3% krahasuar me vitin 2023.

Administrimi i skemës së pensioneve përgjatë vitit 2024, është analizuar bazuar në një set treguesish, të cilat paraqesin situatën e sigurimeve shoqërore përgjatë vitit 2024, të cilët paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 4 "Treguesit e situatës së sigurimeve shoqërore për vitin 2024"

Përshkrimi	2024	2023	%Δ 24-23
Nr. Pensionistëve(raste)	721,398	704,999	2.30%
Pensione te reja gjatë vitit(raste)	29,232	30,352	-3.7%
Pensione te mbyllura përgjatë vitit (raste)	14558	13727	6%
Masa mesatare e pensioneve të reja (lekë)	17,022	15,569	9.3%
Shpenzimet për përfitime	159,332	144,061	10.6%
Koha mesatare e përpunim të kërkesës për pension(ditë)	24	25.2	
% e pensioneve të lidhura para afatit ndaj totalit	99,1	98.5	0.6%
Mosha mesatare e daljes në pension(vjeç)	63.9	63.6	0.30%
Koha mesatare e gëzimit të pension (vite)	22.8	22.9	0.4%
Norma e varësisë së sistemit	1.17	1.17	

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH
Shprehur edhe sipas grafikut.

	704,999	30,352	13,727	15,569	144,061	25	98.5	64	23	1.17
	721,398	29,232	14,558	17,022	159,332	24	99.1	64	23	1.17
	Nr. Pensionistë ve(raste)	Pensione të reja gjatë vitit(raste)	Pensione të mbyllura përgjatë vitit(raste)	Masa mesatare e pensione të reja (lekë)	Shpenzimet për përfitime	Koha mesatare e përpunimit të kërkesës për pension(ditë)	% e pensione të lidhura para afatit ndaj totalit	Mosha mesatare e daljes në pension(vjeç)	Koha mesatare e gëzimit të pension(vite)	Norma e varësisë së sistemit
2023	704,999	30,352	13,727	15,569	144,061	25	98.5	64	23	1.17
2024	721,398	29,232	14,558	17,022	159,332	24	99.1	64	23	1.17

■ 2024 ■ 2023

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Referuar të dhënave të tabelës së sipërme rezulton se:

- Numri i pensione përgjatë vitit 2024 ka pësuar një rritje me 2.3% krahasuar me një vit më parë, Masa mesatare e pensione të reja është rritur me 9.3% krahasuar me 2023 kjo si rezultat i rritjes së periudhës kontributeve në lidhje me këtë kategori dhe kontributeve të derdhura që sjellin një bazë të vlerësuar më të lartë, por dhe pensionet ekzistuese janë rritur si rezultat i indeksimit ç' ka sjellë shpenzime totale për përfitime më të larta në masën 10.6%, krahasuar me një vit më parë.

- ISSH përgjatë vitit 2024, ka përpunuar më shpejt kërkesat për pension, koha mesatare e përpunimit të kërkesës për pension nga 25.2 ditë që ishte në vitin 2023 ka rezultuar në 24 ditë, gjithashtu përqindja e pensione të lidhura para afatit, ndaj totalit të pensione të lidhura përgjatë vitit është rritur me 0.6%, ç' ka treguar se kërkesat për pension janë administruar më mirë përgjatë vitit 2024.

- Mosha mesatare e daljes nuk ka ndryshuar krahasuar me një vit më parë, koha mesatare e gëzimit të pensionit është rritur me 0.4%, kjo për shkak të rritjes së jetëgjatësisë mesatare (sipas INSTAT, mosha mesatare:74,4 vjeç për meshkujt dhe 78,7 vjeç për femrat) ç' ka nënkupton më shumë shpenzime për përfitime.

- Norma e varësisë së sistemit (numër mesatar i kontribuuesve/numër mesatar i pensione) nuk ka ndryshuar krahasuar me vitin 2023. Në 2024 për një pension nevojiten 1.17 kontribuues për pensionist.


- Në nivel sistemi ISSH përgjatë vitit 2024, ka realizuar të ardhura nga kontributet në masën 137,437 milionë lekë ose 10.3% më shumë se një vit më parë, të ardhurat nga transferuar nga buxhetit të shtetit ka qenë 51.457 milionë lekë ose 26 % më pak se viti 2023, shpenzimet totale të ISSH, që përfshijnë shpenzime për përfitime, për paga dhe të tjera administrative të ISSH-së kanë rezultuar në masën 181,080 milionë lekë ose 6.3% më shumë se një vit më parë, ndërsa rezultati fiskal i vitit 2024 ka rezultuar 2.268 milionë lekë ose 104.9% më pak se një vit më parë, në terma të treguesve financiarë situata e sigurimeve shoqërore paraqitet pozitive dhe me treguesve financiarë në rritje. Në mënyrë të detajuar treguesit financiarë të performances së ISSH-së paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 5 "Treguesit e situatës së sigurimeve shoqërore për vitin 2024"

Përshkrimi	2024	2023	%Δ 24-23
Të ardhurat nga kontributet e drejtpërdrejta (milionë lekë)	139,437	124,618	11.9%
Të ardhurat nga transferata e buxhetit të shtetit (milionë lekë)	51,457	46,727	10.1%
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore (milionë lekë)	188,626	170,238	10.8%
Rezultati fiskal (milionë lekë)	2,268	1,107	104.9%

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

E paraqitur dhe në grafik



Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Konkretisht:

Duke u bazuar në analizën e auditimit, disa aspekte të rëndësishme të zhvillimeve të vitit 2024 në sistemin e sigurimeve shoqërore, janë sfida që janë të lidhura me rritjen e shpenzimeve dhe efekteve për periudhat e ardhshme.

Shpenzimet për pensione janë vazhdimisht në rritje, për shkak të dy faktorëve kryesorë: rritja e numrit të pensionistëve dhe periudha më e gjatë e përfitimit të pensione.

Treguesi i varësisë (raporti midis kontribuuesve dhe përfituesve) është gjithashtu një indikator kyç që tregon sa efikas është një sistem i sigurimeve shoqërore. Një tregues i ulët i varësisë do të thotë se ka shumë më shumë kontribuues sesa përfitues dhe anasjelltas.

Pavarësisht përmirësimeve të mundshme në administrimin e kërkesave për pension, rritja e numrit të pensionistëve dhe ulja e numrit të kontribuuesve ka rritur ndjeshëm varësinë e sistemit nga buxheti shtetëror dhe kjo do të bëjë që shpenzimet të rriten ndjeshëm.

Faktorët demografikë, si plakja e popullsisë dhe ulja e lindshmërisë, janë dukshëm të lidhura me trendet që po shihen në sistemin e sigurimeve shoqërore. Me një popullsi të plakuar, numri i pensionistëve është në rritje dhe po ndikon negativisht në stabilitetin e sistemit.

Gjithashtu rritja e kontributeve nga sektorët e tjerë, ndërkohë që sektori publik ka një rritje të ngadaltë të kontribuuesve, fokusi mbetet në rritjen e numrit të të siguruarve në sektorë të tjerë, përfshirë ata që janë të vetëpunësuar.

Marrëdhëniet me bizneset e vogla, Mekanizma për bizneset e vogla për të kontribuar në sistemin e sigurimeve shoqërore, duke i mbështetur për t'u integruar në sistem..

Në përfundim, pavarësisht përpjekjeve pozitive që janë bërë në administrimin e kërkesave për pension dhe treguesve financiarë, sfidat demografike dhe financiare që paraqiten kërkojnë një qasje më të thellë dhe të planifikuar mirë për të ruajtur qëndrueshmërinë e sistemit të sigurimeve shoqërore për të ardhmen.

2.3. Auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, për vitin 2024.

Për auditimin e këtij drejtimi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rakordimet me institucionet MF dhe DPT;
- Pasqyrat financiare të ISSH të vitit 2024;
- Raporte vjetore të ISSH të vitit 2024;
- Raporte statistikore të ISSH dhe analiza statistikore të vitit 2024, etj.

2.3.1. Planifikimi i të ardhurave dhe ndryshimet me Aktet Normative, për vitin 2024.

Plani fillestar i të ardhurave nga kontributet për skemën e sigurimeve shoqërore dhe financimi nga buxheti i shtetit për ISSH, është miratuar me Ligjin nr. 97/2023 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2024", në shumën totale **185,825 milionë lekë**. Kjo shumë përbëhet nga 136,239 milionë lekë të ardhura nga kontributet (133,059 mijë lekë nga skema e sigurimit të detyrueshëm + 3,180 milionë lekë nga skema suplementare), me vlerën 41,799 milionë lekë transferimet nga buxheti i shtetit, vlerën 4,137 milionë lekë transferta për indeksimin e pensione, si dhe vlerën 3,650 milionë

lekë, bonusi i pensionistëve.

Gjatë vitit 2024, janë bërë disa ndryshime me Aktin Normativ nr. 3, datë 29.08.2024 dhe Aktin Normativ nr. 5, datë 19.12.2024 (AN) të Këshillit të Ministrave, të cilat në raport me planin fillestar kanë efekt në rritjen e planit të të ardhurave nga kontributet me 1,128 milionë lekë dhe nga bonusi i pensionistëve me 6,224 milionë lekë, si dhe uljes së Transfertës për indeksimin e pensioneve me 2,444 milionë lekë dhe së Transfertës nga buxheti i shtetit me 1,908 milionë lekë. I përmbledhur plani i ISSH-së me ndryshimet e buxhetit në Skemën e Sigurimeve Shoqërore, sipas ligjit vjetor të buxhetit dhe akteve normative, si dhe realizimi faktit 2023, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 3.1 "Plani i të ardhurave me ndryshime, për viti 2024 dhe realizimi faktit 2023" Në milionë lekë

Buxheti i Sigurimeve Shoqërore (Në milion lekë)	Fakt 2023	Ligji nr. 97/2023 "Për huxhetin e vitit 2024" Nen 4	AN nr. 3, datë 29.08.2024	AN nr. 5, datë 19.12.2024	Ndryshimet në vlerë, Plan fillestar/përfund.
I. Të ardhura (Skema e sigurimit të detyrueshëm)	164,454	169,838	169,838	169,658	(180)
Kontributet	122,650	133,059	134,059	134,059	1,000
Transferimet nga buxheti i shtetit	34,700	36,779	35,779	35,599	(1,180)
Transferta për indeksimin e pensioneve	3,083.5				-
Bonusi i pensionistëve	4,020.5				-
Shpenzimet gjithsej	163,810	169,838	169,838	169,658	(180)
II. Të ardhura (Skema e sigurimit suplementar)	6,890.5	8,200	8,200.00	7,600	(600)
Kontributet	1,967.50	3,180	3,308.00	3,308	128
Transferimet nga buxheti i shtetit	4,823	5,020	4,892.00	4,292	(728)
Transferta për indeksimin e pensioneve	100				-
Bonusi i pensionistëve					-
Shpenzime gjithsej	6,428	8,200	8,200	7,600	(600)
III. Totali i të ardhurave (I+II)	171,345	178,038	178,038	177,258	(780)
Kontributet	124,617.5	136,239	137,367	137,367	1,128
Transferimet nga buxheti i shtetit	39,523	41,799	40,671	39,891	(1,908)
Transferta për indeksimin e pensioneve (VKM nr. 582 datë 18.09.2024)	3,183.5	4,137	4,137	1,693	(2,444)
Bonusi i pensionistëve (VKM nr. 736 datë 27.11.2024)	4,020.5	3,650	3,650	9,874	6,224
Totali sipas MF	171,345	185,825	185,825	188,825	3,000
Të Ardhura dhe Shpenzime gjithsej sipas ISSH	170,238			188,825	
Diferenca ISSH-MF (ndryshime të buxhetit sipas VKM)	-1107				

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Në analizë të të ardhurave për Skemën e Sigurimit të Detyrueshëm fakt 2023 me planin fillestar 2024, konstatohet se,

Në vitin 2024, sipas planifikimit të miratuar me Ligjin nr. 97/2023, ka një rritje të përgjithshme e të ardhurave dhe shpenzimeve të skemës së sigurimit të detyrueshëm krahasuar me faktin e vitit 2023.

-Të ardhurat gjithsej për këtë skemë në planin fillestar janë parashikuar të arrijnë në 169,838 milionë lekë, nga 164,454 milionë lekë të realizuara në vitin 2023, duke shënuar një rritje prej 5,384 milionë lekë. Kjo rritje vjen kryesisht si rezultat i rritjes së kontributeve;

-Kontributet që përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave, janë planifikuar të rriten me 10,409 milion lekë ose rreth 8.5% më shumë se në vitin 2023, e cila tregon pritshmëri për:

- Formalizim më të lartë të tregut të punës;
- Rritje të pagave;
- Rritje të numrit të të punësuarve që paguajnë sigurime;

-Transferimet nga buxheti i shtetit janë parashikuar të jenë 36,779 milionë lekë, që përbën një rritje prej 2,079 milionë lekë. Kjo gjë tregon, se shteti vijon të ketë një rol subvencionues për të garantuar që skema të jetë e qëndrueshme financiarisht, por rritja e barrës financiare është më shumë te kontribuesit;

-Shpenzimet gjithsej janë parashikuar të jenë në të njëjtin nivel me të ardhurat, 169,838 milionë lekë, që është 6,028 milionë lekë më shumë se në vitin 2023. Kjo rritje përfshin indeksim të pensioneve dhe pagesa të tjera sociale që i përkasin kësaj skeme.

-Për Skemën e Sigurimit Suplementar paraqitet një rritje nga realizimi faktik 2023 me planin fillestar 2024, me një shtim prej mbi 60%, e cila tregon zgjerim të kësaj skeme nga 1,967.5 në 3,180 milionë lekë, duke treguar një rritje të vlerës së kontributeve.

Konkluzion: Rritja në planifikim të të ardhurave në Skemën e Sigurimit të Detyrueshëm për vitin 2024, pasqyron përmirësim të pritshëm ekonomik, rritje të nivelit të formalitetit në tregun e punës dhe përgjegjësi më e lartë nga ana e punëdhënësve dhe punëmarrësve për të kontribuar në sistemin e sigurimeve shoqërore.

Ndërsa rritja e shpenzimeve tregon se ka nevojë për fonde shtesë për të përballuar detyrimet ndaj pensionistëve dhe përfituesve të tjerë të sistemit.

Vlera totale e financimeve me Vendim të Këshillit të Ministrave për programe të veçanta, është detajuar si më poshtë:

Tabela nr. 3.2 “Financimet me VKM, gjatë vitit 2024”:

Në

mijë lekë

Nr.	VKM	Përfshirë në AN nr. 5, datë 19.12.2024	Shuma e financuar sipas (VKM)	Shuma sipas (AN)	Ndryshimet në Buxhetin e ISSH
1	VKM nr. 582, datë 18.09.2024	VKM nr. 582, datë 18.09.2024	1,693,000	1,693,000	-
2	VKM nr. 736, datë 27.11.2024 e ndarë:	VKM nr. 736, datë 27.11.2024	9,873,862	9,873,862	-
a	Financim buxheti i shtetit			3,000,000	-
b	Buxheti i planifikuar për sig.shoqërore			779,862	-
c	Buxheti i planifikuar për sig.shoqërore (indeksim pensione)			2,444,000	-
d	Buxheti i planifikuar për sig.shoqërore (bonus i pensionistëve)			3,650,000	-
	Totali		11,566,862	11,566,862	-

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Gjatë vitit 2024 janë miratuar dy VKM, të cilat kanë sjellë financime në ISSH, në vlerën totale prej 11,566,862 mijë lekë. Konkretisht:

-VKM nr. 582, datë 18.09.2024 “Për indeksimin e pensioneve” efektet financiare në shumën 1,693,000 mijë lekë, do të mbulohen nga fondi për politikën e indeksimit të pensioneve të parashikuara në buxhetin e ISSH të vitit 2024.

-VKM nr. 736, datë 27.11.2024 “Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2024”, efektet financiare në shumën 9,873,862 mijë lekë, do të mbulohen:

a) në masën 3,650,000 mijë lekë nga fondi “Kontigjencë për bonusin e pensionistëve”, i miratuar në buxhetin e vitit 2024;

b) në masën 2,444,000 mijë lekë nga fondi “Për indeksimin e pensioneve” i miratuar në buxhetin e vitit 2024;

c) në masën 3,779,862 mijë lekë, (3,000,000 mijë lekë nga buxheti i shtetit dhe 779,862 mijë lekë nga buxheti i planifikuar për sigurimet shoqërore) për vitin 2024.

Këto VKM janë reflektuar në AN nr. 5, datë 19.12.2024 dhe janë zbatuar plotësisht, duke mos sjellë nevojën për ndryshime shtesë në buxhetin e ISSH, si dhe brenda kuadrit të parashikuar në AN përkatës.

Rezultati fiskal vjetor për vitin 2024, sipas ISSH,

Për vitin 2024, ISSH ka planifikuar të ardhura në total në shumën 188,825,385 mijë lekë;

Të ardhura nga kontributet, ka planifikuar në shumën 400,000 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën **959,692 mijë lekë**. Pra **559,692 mijë lekë më shumë** se plani, ose në masën **240% nga plani i parashikuar**. Ky zë është planifikuar nga ISSH në këtë nivel duke pasur parasysh që politikën e qeverisë për likuiditetin e lirë (bankat e nivelit të dytë), në momente të caktuara të ishin në nivele minimale. Tejkasimi i “të ardhurave të tjera jo tatimore” në masën 240%, ka ardhur si pasojë e të ardhurave nga interesat e depozitave dhe investimet e letrave me vlerë për vitin 2024, nga të cilat janë arkëtuar në shumën 707,112 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2023, ka pakësim të tyre në shumën 66,148 mijë lekë;

Shuma 51,457,822 mijë lekë, përfaqëson vlerën e transfertës nga buxheti i shtetit, për mbulimin e disa skemave të pensioneve. Nga auditimi konstatohet se ISSH nuk ka kërkuar ulje të financimit, pavarësisht se projeksionet kanë qenë më të ulëta. Kjo është argumentuar me faktin se transfertat nga buxheti i shtetit, e cila përfaqëson një subvencion, për vitin 2024 është 4,730,587 mijë lekë më e lartë krahasuar me vitin 2023. Gjithashtu, bonusi i vitit 2024 është 5,854 milionë lekë më i lartë se ai i vitit 2023. Kjo nënkupton se transfertat nga buxheti duhet të ishte rritur edhe më shumë, për të mbuluar këtë diferencë. Megjithatë, në të kundërt, transfertat është ulur me 1,100 milionë lekë.

Tabela nr. 3.3 "Të ardhura dhe shpenzime plan/fakt 2024, krahasuar me fakt 2023"

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Gjithsej			Diferenca F/P 2024	Realizim i në %
		Fakt 2023	Plan 2024	Fakt 2024		
I	Të ardhurat	124,618,101	137,367,563	139,437,131	2,069,568	102
1	DPT të ardhura	119,979,210	132,727,563	134,295,143	1,567,580	101
2	ISSH kontribute të tjera	1,025,840	400,000	959,692	559,692	240
3	ISSH të ardhura	3,613,051	4,240,000	4,182,296	(57,704)	99
II	Financime nga buxheti	46,727,235	51,457,822	51,457,822	-	100
III	Totali të ardhurave (I+II)	171,345,336	188,825,385	190,894,953	2,069,568	101
	Shpenzimet					
I	Transferta për buxhetet familjare e individët	166,940,791	185,020,748	185,248,710	227,962	100
1	Shpenzime për përfitime	144,059,900	159,027,824	159,331,590	303,766	100
2	Shpenzime për programe të veçanta shtetërore	16,107,171	18,446,729	18,371,004	(75,725)	100
3	Shpenzime për programe e skema suplementare	6,773,720	7,546,195	7,546,116	(79)	100
II	Shpenzime administrative	3,297,383	3,804,637	3,377,770	(426,867)	89
III	Totali i shpenzimeve (I+II)	170,238,174	188,825,385	188,626,480	(198,905)	100
	Rezultati fiskal			2,268,473		

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa më sipër, rezulton se ky vit është mbyllur me rezultat fiskal pozitiv, me tepriçë të të hyrave mbi shpenzimet, në shumën 2,268,473 mijë lekë.

3.2. Të ardhurat për vitin 2024

Me Vendimin nr. 12, datë 28.12.2023, të Këshillit Administrativ janë miratuar të ardhurat dhe shpenzimet e ISSH, plan dhe fakt për vitin 2024. Skema e të ardhurave, për mbulimin e shpenzimeve të skemës së sigurimeve shoqërore përbëhet nga dy grupe kryesore: *Të ardhura nga kontributet dhe Financimi nga buxheti i shtetit*. Realizimi i të ardhurave nga kontributet sipas ISSH, bazuar në rakordimin me DPT, MF-ve dhe llogarinë e të ardhurave të ISSH-së, për kontributet e derdhura në ISSH (të vetëpunësuar në bujqësi dhe sigurim vullnetar), paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3.4 Realizimi i të ardhurave nga kontributet viti 2024/2023, si dhe plan/fakt 2024

Në mijë lekë

Nr.	Të ardhurat	Fakti 2023	VITI 2024			
			Plan	Fakt	Realizimi në %	
					2024/2023	F/P 2024
I	Sektori Publik	45,410,885	50,027,739	50,777,615	11.8	102
	Buxhetore	38,678,142	42,235,271	42,868,344	10.8	102
	Jo Buxhetore	6,732,743	7,792,468	7,909,271	17.4	102
II	Sektori privat	72,038,841	79,391,823	80,581,843	11.8	102
	Biznesi i madh	68,165,264	75,472,433	76,603,704	12.3	102
	Biznesi i Vogël	3,873,577	3,919,390	3,978,139	2.7	102
III	Sigurim Suplementar	1,968,328	3,308,000	2,296,035	16.6	69
IV	Të tjera DPT	561,156	-	639,650	14	-
	DPT (I-II+III+IV)	119,979,210	132,727,563	134,295,143	11.9	101
IV	Vullnetar	711,898	750,000	718,480	0.9	96
V	Të vetëpunësuar në bujqësi	2,901,153	3,490,000	3,463,816	19	99
1	Kontribute	2,715,504	3,490,000	3,209,290	18.2	92
2	Nga e cila penalitete sipas TSA	185,649	0	254,525	37.1	
VI	Të ardhura tjera ISSH (jo tatimore)	994,121	400,000	958,799	(3.6)	240
VII	Derdh në llog e sig (tatimore)	1,025,840	0	893	(97.2)	
	ISSH (IV+V+VI)	3,613,051	4,640,000	5,141,095	11.6	111
A	Gjithsej sigurime	124,618,101	137,367,563	139,437,131	11.9	102
B	Financime nga buxheti	46,727,235	51,457,822	51,457,822	-	100
	Totali të Ardhura (A+B)	171,345,336	188,825,385	190,894,953	11.4	101
	Fakt/Plan 2024			2,069,568		

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

- Të ardhura nga kontributet

Nga auditimi i të dhënave mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2024, rezultoi se, ISSH nuk ka detyrim ligjor të përfshihet në programimin dhe planifikimin e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore për subjektet në përgjegjësi të organeve tatimore. Planifikimi i të ardhurave kryhet në total nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i cili nuk është i detajuar sipas kategorive të biznesit (buxhetor, jo buxhetor, biznes i madh, biznes i vogël, sigurime suplementare), sepse të dhënat për programimin buxhetor përgatiten dhe dërgohen në këtë format nga Ministria e Financave.

Kontributet e sigurimeve shoqërore, të derdhura nga subjektet fizike dhe juridike, publike e private, kontribuesit në sektorin e bujqësisë dhe ata vullnetarë, së bashku me të ardhura të tjera jo tatimore, si dhe derdhur në llogari të sigurimeve, kanë arritur në shumën **139,437,131 mijë lekë** për vitin 2024. Kjo përfaqëson një **rritje prej 14,819,030 mijë lekë ose 11.9% më shumë**, krahasuar me realizimin faktik të vitit 2023. Ndërsa realizimi faktik për vitin 2024, është realizuar për 2,069,568 mijë lekë ose në masën 1% më shumë, në krahasim me planifikimin përfundimtar. Nga shuma totale **139,437,131 mijë lekë**:

- **134,295,143 mijë lekë** (ose **96%** e totalit) janë mbledhur nga **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)**, të cilat përbëhen nga të ardhura nga derdhja e kontributeve (të ardhura tatimore) në shumën 133,655,493 mijë lekë dhe të ardhura të tjera (jo për kontribute për sigurime shoqërore), nga gjoba dhe kamatëvonesa në shumën 639,650 mijë lekë, sipas rakordimit të ISSH me MF;
- **50,777,615 mijë lekë kontribute nga sektori publik janë realizuar për 5,366,730 mijë lekë ose në masën 11.8% më shumë** në krahasim me realizimin faktik të vitit 2023; rezultojnë edhe me realizim në shumën 749,876 mijë lekë ose **në masën 2% më shumë** në krahasim me planifikimin e bërë;
- **80,581,843 mijë lekë kontribute nga sektori publik janë realizuar për 8,543,002 mijë lekë ose në masën 11.8% më shumë** në krahasim me realizimin faktik të vitit 2023; rezultojnë edhe me realizim në shumën 1,190,020 mijë lekë ose **në masën 2% më shumë** në krahasim me planifikimin e bërë;
- **2,296,035 mijë lekë kontribute sigurime suplimentare janë realizuar për 327,707 mijë lekë ose në masën 16.6% më shumë** në krahasim me realizimin faktik të vitit 2023; ndërsa në krahasim me planifikimin, rezulton me mosrealizim në shumën 1,011,965 mijë lekë ose në masën 31%, më pak;
- **5,141,988 mijë lekë** (ose **4%** e totalit) janë mbledhur nga **Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)**, të cilat përbëhen nga kontribute vullnetarë, të vetëpunësuar në bujqësi, të ardhura të tjera (jo tatimore), si dhe derdhur në llogari të sigurimeve (tatimore). Për vitin 2024 janë mbledhur **534,816 mijë lekë më shumë** në kontribute, krahasuar me vitin e mëparshëm, që përfaqëson një **rritje prej 11.6%**;
- **718,480 mijë lekë kontribute vullnetare janë realizuar për 6,582 mijë lekë ose 1% më shumë** në krahasim me realizimin faktik të vitit 2023; por rezultojnë me mosrealizim në vlerën 31,520 mijë lekë ose 4% më pak në krahasim me planifikimin e bërë në 2024;
- **3,463,816 mijë lekë janë kontribute nga të vetëpunësuar në bujqësi, ku janë përfshirë kontribute në shumën 3,209,290 mijë lekë dhe të ardhura të tjera (jo nga kontributet) nga kamatëvonesa/penalitetet në shumën 254,525 mijë lekë.** Kontributet nga të vetëpunësuar në bujqësi janë realizuar për 493,786 mijë lekë ose 18% më shumë në krahasim me realizimin faktik të vitit 2023, por rezultojnë me mosrealizim në vlerën 280,710 mijë lekë (duke përfshirë të ardhura të tjera jo nga kontributet) ose 8% më pak në krahasim me planifikimin e bërë;
- të ardhura të tjera (jo tatimore) në shumën 958,799 mijë lekë, sipas llogarive përkatëse në Pasqyrat Financiare të ISSH për vitin 2024 janë përfshirë:

Llog. 765 "Të ardhura nga interesat e depozitave" në shumën 707,112 mijë lekë;

Llog. 711 "Të ardhura nga komisionet për shërbime ndaj të tretëve" në shumën 869.4 mijë lekë;

Llog. 710 “Të ardhura nga qeraja e ndërtesës” në shumën 21.6 mijë lekë si dhe të ardhura nga qira e pajisjeve në shumën 25.5 mijë lekë;

Llog. 719 “Arkëtimet nga debitorët e përfitimeve” në shumën 250,683 mijë lekë;

Llog. 711 “Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme në shumën 87.9 mijë lekë, të realizuar në masën 240 % më shumë se sa planifikimi vjetor dhe në masën 3.6% më pak se viti 2023.

Nga ISSH, llogaria “Të ardhura të tjera (jo tatimore)” është planifikuar në total dhe jo në zëra të veçanta, si dhe në këtë nivel, duke pasur parasysh që politikat e qeverisë për likuiditetin e lirë (bankat e nivelit të dytë), në momente të caktuara të ishin në nivele minimale.

- Kontributet e tjera, në shumën 893 mijë lekë përfaqësojnë kontribute për gratë e diplomatëve.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e ISSH-së, në realizimin faktik të të ardhurave janë përfshirë edhe “të ardhura të tjera”, të cilat sipas klasifikimi buxhetor, janë të ardhura jo nga kontributet ose “Të tjera DPT dhe ISSH” gjithsej në shumën 1,852,974 mijë lekë, nga të cilat DPT 639,650 mijë lekë dhe ISSH 1,213,324 mijë lekë, e përbërë nga (penalite 254,525 mijë lekë + të ardhura të tjera jo tatimore 958,799 mijë lekë).

Konkluzion: Nga analiza e planifikimit dhe realizimit të treguesve për vitin 2024, rezulton se ISSH nuk ka kryer një ndarje të drejtë të planit të të ardhurave, duke përfshirë në realizimin faktik edhe të ardhurat jo tatimore në shumën 1,852,974 mijë lekë. Të ardhurat tatimore të realizuara janë 137,584,157 mijë lekë, krahasuar me planin prej 137,367,563 mijë lekësh. Mungesa e këtij detajimi ka ndikuar në saktësinë e analizës së realizimit.

- Financimi nga buxheti i shtetit

Financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2024, për mbulimin e disa skemave të pensioneve, rezultoi në shumën **51,458 milionë lekë**. Ky financim përfshin grantet për mbulimin e shpenzimeve të këtyre skemave, si dhe fondet për mbulimin e deficitit të skemës së pensioneve. Plani nga transfertat e buxhetit sipas Ligjit nr. 97/2023, ka qenë në shumën 49,586 milion lekë. Si pasojë e ndryshimeve ligjore me AN nr. 3, datë 29.08.2024 dhe nr. 5, datë 19.12.2024, totali i tyre shkoi në shumën 51,458 milion lekë, pra rezulton me rritje në shumën 1,872 milion lekë ose në masën 3.8% kundrejt planit fillestar.

Në lidhje me financimin nga buxheti i shtetit, ISSH ka rakorduar me Degën e Thesarit Tiranë për shumën 51,457,822 mijë lekë, sipas Akt rakordimit, nr. 101, datë 07.01.2025, referuar Ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2024” dhe në vijim të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, për periudhën 12 mujore të vitit 2024. Nga verifikimi i të dhënave rezulton se plani i të ardhurave dhe plani i shpenzimeve të ISSH-së është i rakorduar me Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit për vitin 2024, të raportuar nga Ministria e Financave. Konkretisht:

- Plani përfundimtar i të ardhurave nga kontributet/të ardhurat tatimore është i përputhur me shumën prej 137,367 milion lekë, siç pasqyrohet në Kapitullin II.3/1 “Të ardhurat nga fondet speciale”;
- Plani i shpenzimeve është në përputhje me shumën 177,258 milion lekë, të raportuar në Kapitullin I.5 “Totali i shpenzimeve”.

Tabela nr. 3.5 “Të dhëna analitike mbi financimin nga buxheti i shtetit, fakt 2023 & viti 2024”

Në lekë

Llog.	Përshkrimi	Fakti Viti 2023	Plani Fillestar 2024	Plani Përfundimtar 2024	Fakti Viti 2024	Diferenca fakt 2024/2023	Diferenca në plan fill/përf 2024
755	Kontribute te buxhetit per	4,771,702,486	5,449,293,009	5,449,293,009	5,449,293,009	677,590,523	-
	Sig.shoq. Per ushtaret	-	-	-	-	-	-
	Sig.shoq.per te papunet	919,632,000	1,081,919,999	1,081,919,999	1,081,919,999	162,287,999	-
	Sig.shoq.per ushtarake ne reforme e pension te parakohshem	201,607,954	204,649,892	204,649,892	204,649,892	3,041,938	-
	Sig.shoq.per police ne ref dhe pension te parakohshem	122,062,464	123,904,192	123,904,192	123,904,192	1,841,728	-
	Sig.shoq.per ish-funksionaret	27,118,058	26,838,562	26,838,562	26,838,562	(279,496)	-

	Sig.shoq.per ushtarake ne reforme e pension te parakohshem	2,682,101,000	3,048,238,000	3,048,238,000	3,048,238,000	366,137,000	-
	Sig. Shoq. Per gra te pensionuara	794,945,810	935,230,365	935,230,365	935,230,365	140,284,555	-
	Sig.shoq.per punonj e industrise ushtarake+ minierave	24,235,200	28,511,999	28,511,999	28,511,999	4,276,799	-
720	Grant nga buxheti per pagesa te posacme	16,055,514,000	8,558,508,000	17,656,588,000	17,656,588,000	1,601,074,000	9,098,080,000
	Grande per koms e tiritjes se pens + cmimit energi elek	4,793,871,000	4,665,235,000	4,665,235,000	4,665,235,000	(128,636,000)	-
	Shperblimi i pensionistev Prill 2023	3,536,735,000				(3,536,735,000)	-
	Rezistenca sociale dhjetor	-			-	-	-
	Bonusi pensionistev	3,530,000,000		9,094,362,000	9,094,362,000	5,564,362,000	9,094,362,000
	Bonusi invalideve	490,500,000				(490,500,000)	-
	Kompensim cinimesh dhe te ardhurash	3,523,912,000	3,534,260,000	3,534,260,000	3,534,260,000	10,348,000	-
	Grande per pensione shtetore te posacme	96,503,000	297,844,580	300,796,580	300,796,580	204,293,580	2,952,000
	Grande per shtesa te parashikuara per veteranet	49,113,000	14,927,420	15,223,420	15,223,420	(33,889,580)	296,000
	Grande per shtesa te parashikuara per invalidet e punes	34,880,000	46,241,000	46,711,000	46,711,000	11,831,000	470,000
720	Grant nga buxheti per trajtime te vecanta	5,728,950,000	4,876,412,000	4,956,105,000	4,956,105,000	(772,845,000)	79,693,000
	Grande per shtesa te parashikuara per ushtarakeve te tjere	2,407,944,000	1,983,634,000	2,025,035,000	2,025,035,000	(382,909,000)	41,401,000
	Sigurim suplementar per ish-ushtaraket	-			-	-	-
	Perfitime per policine e shtetit	249,404,000	260,378,000	260,378,000	260,378,000	10,974,000	-
	Perfitime per ushtaraket e nendetseve ne pension.	12,890,000	11,951,000	12,065,000	12,065,000	(825,000)	114,000
	Grande per pagesa kalimtare e pensione te ish funks.	530,254,259	293,267,000	305,954,000	305,954,000	(224,300,259)	12,687,000
	Grande per pagesa per shtesa te parashikuara per deshmoret	28,449,000	27,185,000	27,437,000	27,437,000	(1,012,000)	252,000
	Grande per pagesa per shtesa te parashikuara per minatoret	1,701,263,000	1,601,321,000	1,620,195,000	1,620,195,000	(81,068,000)	18,874,000
	Grande per pagesa per shtesa te parashikuara per pilotet	100,591,000	85,060,000	85,868,000	85,868,000	(14,723,000)	808,000
	Grande per pagesa per shtesa te parashikuara per ind. Usht.	76,782,000	71,117,000	71,794,000	71,794,000	(4,988,000)	677,000
	Per shpenzime varrimi	219,495,741	168,019,000	168,019,000	168,019,000	(51,476,741)	-
	Perfitime per statusin e profesorit	169,298,000	131,148,000	133,500,000	133,500,000	(35,798,000)	2,352,000
	Pensione sociale	232,579,000	243,332,000	245,860,000	245,860,000	13,281,000	2,528,000
720	Grant nga buxheti per mbulimin e deficitit	20,171,068,514	22,915,246,991	23,395,835,991	23,395,835,991	3,224,767,477	480,589,000
	Diference kontributi per fermeret	5,298,965,880	6,019,865,128	6,146,116,482	6,146,116,482	847,150,602	126,251,354
	Grant per mbulim deficiti	14,872,102,634	16,895,381,863	17,249,719,509	17,249,719,509	2,377,616,875	354,337,646
	Totali	46,727,235,000	41,799,460,000	51,457,822,000	51,457,822,000	4,730,587,000	9,658,362,000

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa më sipër, financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2024, është rritur në planin fillestar në shumën 4,730,587 mijë lekë ose në masën 10% më shumë, krahasuar me realizimin faktit të viti të kaluar.

Zëri 755 “Kontributet në buxhet” financime nga buxheti i shtetit, përfshin kontributet për grupe të caktuara si të papunët, ushtarakët në reformë, ish-funksionarët, gra të pensionuara, etj; i cili në realizimin e vitit 2024 paraqitet në shumën 5,449,293 mijë lekë dhe ka një rritje prej rreth 14.2%, në krahasim me shumën 4,771,702 mijë lekë të vitit 2023.

Zëri 720 “Grant nga buxheti për pagesa të posaçme” paraqitet në realizimin faktin e vitit 2024, për 17,656,588 mijë lekë, me një rritje prej 1,601,074 mijë lekë ose në masën 10% më shumë, në krahasim me faktin 2023. Rritja lidhet kryesisht me **shtimin e bonusit të pensionistëve dhe kompensimeve të reja**, por sidomos rritja më e dukshme, bonusi për pensionistët në 2024 (nga 3,650 milionë lekë në mbi 9,800 milionë lekë). Kjo vjen në dukje si një **angazhim më i madh social i shtetit** për të përballuar efektet e inflacionit dhe për të mbështetur kategoritë në nevojë.

Por gjatë vitit 2024, transferta nga buxheti i shtetit për indeksimin e pensioneve u ul nga 4,137 milionë lekë, në 1,693 lekë (me -2.444 milionë lekë diferencë). Pra, rritja e bonusit të pensioneve ka kompesuar uljen e vlerës së indeksimit të pensioneve.

Zëri 720 “Grant nga buxheti për mbulimin e deficitit” paraqitet me një rritje prej rreth 3,224,767 mijë lekë ose në masën 16% më shumë nga realizimi faktik 2023. Kjo tregon se shteti është dashur të shtojë ndjeshëm mbështetjen për balancimin financiar të skemës së sigurimeve shoqërore, për shkak të rritjes së përfitimeve dhe nevojave të sistemit.

ISSH ka rakorduar me Degën e Thesarit Tiranë për fondet e alokuara nga buxheti i shtetit në shumën 51,457,822 mijë lekë, sipas akt rakordimit, ku në shkresën përcjellëse nr. 101 prot., datë 07.01.2025 të akt rakordimit është cilësuar: “Mbështetur në Ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2024” dhe në vijim të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, bashkëlidhur shkresës dërgojmë akt rakordimin për financimin e Buxhetit të Shtetit sipas grupit, titullit, artikullit dhe llogarisë ekonomike për periudhën 12 mujore të vitit 2024”.

Tabela nr. 3.6 “Financim i nevojshëm nga buxheti i shtetit”

Në mijë lekë

	Emërtimi	Fakt 2023	Plan 2024	Fakt 2024	Fakt 2024/2023	P/F në %
1	Totali të ardhura	171,345,336	188,825,385	190,894,953	19,549,617	99
2	Totali i shpenzimeve	170,238,174	188,825,385	188,626,480	18,388,306	100
3	Rezultati fiskal (1-2)	1,107,162		2,268,473	1,161,311	
4	Financimi i planifikuar dhe tërhequr	46,727,235	51,457,822	51,457,822	4,730,587	100
5	Financimi i nevojshëm (4-3)	45,620,073		49,189,349		

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Konkluzion: Nga analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se, në vitin 2024 financimi nga buxheti i shtetit është rritur për shumën 4,730,587 mijë lekë ose në masën 10% më shumë, në krahasim me vitin 2023. Por, nevoja për përdorimin e këtij financimi ka qenë në shumën 49,189,349 mijë lekë, për shkak të rezultatit fiskal pozitiv ose 2,268,473 mijë lekë më pak, se financimi i tërhequr.

Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara

Të ardhurat e realizuara janë konfirmuar nga dy institucionet, Ministria e Financave me Akt rakordimin nr. 1273/1 prot., datë 27.01.2025 dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore me Akt rakordimin nr. 855 prot., datë 27.01.2025 “Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara nga kontributet për sigurimet shoqërore nga DPT për vitin 2024”.

Tabela nr. 3.7 “Rakordimi i të ardhurave të realizuara me MF”

Në mijë lekë

Përshkrimi	ISSH	MF
Gjendja në 01.01.2024	1,652,101	1,652,101
Tatimore (Klasa 7, llog 75)	133,655,493	133,655,493
Jo tatimore (Klasa 7, llog 711), gjoba	402,169	402,169
Jo tatimore (Klasa 7, llog 709), kamatëvonesa sig shoq	237,481	237,481
Total të ardhura	134,295,143	134,295,143
Transferuar nga TSA ² progresive	133,862,000	133,862,000
Gjendja më datë 31.12.2024	2,085,244	2,085,244

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Sipas Akt rakordimit, gjendja e të ardhurave cash më 01.01.2024, është 1,652,101 lekë. Të ardhurat e realizuara nga DPT rezultojnë në total 134,295,143 mijë lekë nga e cila:

- Në skemën e sigurimit të detyrueshëm + të ardhurat në skemën suplementare rezultojnë 133,655,493 mijë lekë, të cilat zënë 99,5% të realizimit gjithsej të të ardhurave nga DPT;
- Të ardhurat jo tatimore (gjoba & kamatë vonesa) rezultojnë në total 639,650 mijë lekë (402,169 mijë lekë + 237,481 mijë lekë), të cilat zënë 0,5% të realizimit gjithsej të të ardhurave nga DPT;

² Llogaria e unifikuar e thesarit “Depozitë qeverie” llogari e personalizuar në BSH që menaxhohet nga MF për Fondin e Sigurimeve Shoqërore.

- Sipas MF të ardhurat e transferuara në llogarinë e unifikuar të thesarit "Depozitë qeverie" pranë Bankës së Shqipërisë janë në vlerën 133,862,000 mijë lekë;
- Gjendja e të ardhurave cash në fund të vitit më 31.12.2024, është 2,085,244 mijë lekë, e cila mbartet dhe transferohet në vitin 2025, si dhe paraqitet në Aktiv të Pasqyrave Financiare vjetore në llog. 44 "Institucione të tjera publike".

Mbi rakordimin me Treguesit Fiskal të Konsoliduar të Buxhetit

Tabela nr. 3.8 "Raportimi i realizimit të të ardhurave dhe diferencat në raportim"

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Vlerat e DPT-së raportuar në MF	Vlerat e ISSH-së rakorduar me MF, Akt Rakordimi 1273/1 datë 27.01.2025	Diferenca (rimbursime)
1	Llog. 75 ORACLE MF	133,655,885,457	133,655,492,996	(392,461)
2	Llog. 711 ORACLE MF	402,259,023	402,169,023	(90,000)
3	Llog. 709 ORACLE MF	237,492,4570	237,480,998	(11,459)
	Totali	134,295,636,937	134,295,143,017	(493,920)

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Në tabelën e mësipërme paraqitet raportimi i realizimit të të ardhurave sipas Ministrisë së Financave (MF) dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), në vlerën 134,295,143,017 lekë, të raportuara në sistemin Oracle, si dhe të rakorduara sipas Akt rakordimit nr. 1273/1, datë 27.01.2025. Si dhe vlera 134,295,636,937 lekë e cila është raportuar nga DPT në MF.

- **Llogaria 75** "Të ardhurat nga kontributet" ka një diferencë prej 392,461 lekësh më pak në raportimin Accrual të ISSH-së me atë të DPT-së në MF;
- **Llogaria 711** "Gjoha nga sigurimet shëndetësore" ka një diferencë prej 90,000 lekësh;
- **Llogaria 709** "Kamatëvonesat" ka një diferencë më të vogël, prej 11,459 lekësh.

Krahasimi midis këtyre dy burimeve ka nxjerrë diferencë negative në vlerën 493,920 lekë, që janë rimbursime të skemës së sigurimeve shoqërore. Këto rimbursime, sistemohen në sistemin Oracle nga MF. Kjo diferencë shkaktohet kryesisht nga vonesa kohore në pasqyrim.

Në llogaritë përkatëse (75,711 dhe 709) ka lëvizje në vlera për shkak të rimbursimeve, korrigjimeve të deklarimeve apo riklasifikimeve të pagesave.

Konkluzion: Nga krahasimi i të ardhurave të realizuara nga ISSH (kontributet/të ardhura tatimore) dhe të dhënave të Tabelës së Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit (Kapitulli II.3 "Të ardhurat nga fondet speciale") dhe të dhënave të sistemit Oracle, rezulton se fakti i të ardhurave nuk përputhet. Sipas të dhënave të MF, fakti nga fondet speciale "Sigurimet Shoqërore", paraqitet në vlerën prej **139,404 milionë lekë**, ndërsa ISSH raporton **134,295 milionë lekë**, duke krijuar një **diferencë prej rreth 5 milionë lekësh**.

Të ardhurat e realizuara e të deklaruara nga ISSH janë në shumën 134,295 milionë lekë ku përfshihen të ardhurat tatimore në shumën 133,655 milionë lekë dhe të ardhura jo tatimore (jo për kontribute për sigurime shoqërore), në shumën 640 milionë lekë. Kjo diferencë është krijuar nga trajtimi i ndryshëm i të ardhurave ndërmjet institucioneve, si dhe nga vonesat kohore në pasqyrimin e arkëtimeve të pranuar në sistemin e Thesarit dhe atij të ISSH, i cili shpjegohet si më poshtë:

- **Momenti i regjistrimit të të ardhurave**, ku MF evidenton të ardhurat sipas arkëtimeve faktike të raportuara nga Thesari, ndërsa ISSH mbështetet në deklaratimet dhe evidencat e kontributeve të administruara nga organet tatimore;
- **Klasifikimi i ndryshëm i të ardhurave**, pasi ISSH, përveç të ardhurave nga kontributet (133,655 milionë lekë), përfshin edhe të ardhura jo tatimore në shumën 640 milionë lekë; Efektet e riklasifikimeve dhe penaliteteve.
- **Rritja e të ardhurave dhe e numrit të kontribuesve në vitin 2024 në krahasim me 2023**

Tabela nr. 3.9 "Të ardhura dhe numri i kontribuesve nga DPT 2024/2023"

Në mijë lekë

Përshkrimi	Të ardhura		Kontribues		Diferenca 2024/2023		Ndryshimi në % 2024/2023	
	2023	2024	2023	2024	Të ardhura	Kontribues	Të ardhura	Kontribues
Institucione buxhetore	38,678,142	42,868,344	143,958	144,553	4,190,202	595	10.8	0.4
Institucione jo	6,732,743	7,909,271	21,616	22,257	1,176,528	641	17.4	2.9

buxhetore									
Firma private	68,165,264	76,603,704	394,746	407,729	8,438,440	12,983	12.3	3.2	
Të vetëpunësuar	3,873,577	3,978,139	140,119	135,080	104,562	(5,939)	2.6	(3.6)	
Totali	117,449,726	131,359,458	700,439	709,619	13,909,732	9,180	11.8	1.310	

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Në krahasim me vitin 2023, numri i kontribuesve është rritur me 9,180 raste dhe të ardhurat me 13,909,732 mijë lekë. Duke u nisur nga kontributi mesatar vjetor për një kontribues në vitin 2023 dhe kontributi mesatar për një kontribues të vitit 2024, (Të ardhura/numër kontribues), kemi një rritje të këtij treguesi në masën 11.8 %, ndërsa numri i kontribuesve është rritur me 1.3 %.

Nga auditimi u konstatua se, faktorët që kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2024 në krahasim me vitin 2023, kanë qenë deklarimi i pagave reale dhe pagesa e rregullt e kontributeve të sigurimeve shoqërore, formalizimi i tregut të punës, si dhe përfshirja e kontribuesve të rinj në skemën e sigurimit të personave të vetëpunësuar në bujqësi.

Mbi rakordimin e të ardhurave të mbledhura nga DPT

Procedurat e detyrimit të pagesës, mbledhjes, verifikimit, transferimit dhe administrimit të kontributeve të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, shëndetësor dhe sigurimit suplementar shtetëror, kryhen në përputhje me Ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në zbatim të këtij ligji, në nenin nr.3, përcaktohet se: “Kontributet mbledhen nga organet tatimore për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore”.

Në lidhje me realizimin e të ardhurave nga kontributet me shkresën nr. 1409 prot., datë 29.01.2025 të DPT, protokolluar në ISSH me nr. 1118 prot., datë 31.01.2025, janë dërguar treguesit e sigurimeve shoqërore për periudhën janar-dhjetor 2024, të cilët përputhen me Treguesit e Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit dhe që paraqiten si më poshtë:

- Kontribute ISSH, 133,655,885 mijë lekë (të ardhura tatimore);
- Gjoha dhe kamatëvonesa ISSH në shumën 639,751 mijë lekë (të ardhura jo tatimore)
- **Totali: 134,295,636 mijë lekë.**

Tabela nr. 3.10 “Të ardhura të realizuara për ISSH sipas DPT”

Në mijë lekë

Nr.	Përshkrimi	Treguesit sipas DPT 2023	Treguesit sipas DPT 2024	Në %
I	Kontribute sigurime shoqërore	119,419,349	133,655,885	12
1	Sektori buxhetor	38,679,436	42,868,344	11
2	Sektori jo buxhetor	6,732,743	7,909,271	17
3	Sektori Privat	68,165,264	76,603,704	12
4	Të vetëpunësuarit	3,873,577	3,978,531	10
5	Kontributi suplementar	1,968,328	2,296,035	17
	Totali (1+2+3+4+5)	119,419,349	133,655,885	12
II	Kontribute kujdesi shëndetësor	18,787,612	21,065,360	12
III	Totali kontribute (I+II)	138,206,961	154,721,245	12
IV	Të ardhura jo tatimore (shoqërore)	561,156	639,751	14
1	Gjoha sigurime shoqërore	385,458	402,259	10
2	Kamatëvonesa sigurime shoqërore	175,697	237,492	35
V	Totali kontribute sigurime shoqërore (I+IV)	119,980,505	134,295,636	12
	Total kontribute (I+II)	138,206,961	154,721,245	12

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën janar - dhjetor 2024, sipas raportimit nga DPT, të ardhurat e realizuara në skemën e detyrueshme të sigurime shoqërore rezultojnë në total 133,655,885 mijë lekë ose krahasuar me vitin 2023, janë realizuar më shumë në vlerën 14,236,536 mijë lekë ose në masën 12% më shumë.

Tabela nr. 3.11 “Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas rakordimeve”

Në mijë lekë

Nr.	Përshkrimi	Treguesit sipas DPT	Treguesit sipas ISSH	Treguesit e Buxhetit të Shtetit në Llogarinë e Unifikuar (TSA)	Diferenca
1	Kontribute shoqërore				
1	Sektori Buxhetor	42,868,344	42,868,344		-
2	Sektori jo buxhetor	7,909,271	7,909,271		-
3	Sektori Privat	76,603,704	76,603,704		-
4	Të vetëpunësuarit	3,978,531	3,978,139		392

5	Kontributi suplementar	2,296,035	2,296,035		-
I	Totali	133,655,885	133,655,493	133,655,493	392
II	Të ardhura jo tatimore (shoqërore)	639,751	639,650	639,650	101
1	Gjaba sigurime shoqërore	402,259	402,169	402,169	90
2	Kamatëvonesa sigurime shoqërore	237,492	237,481	237,481	11
	Totali (I+II)	134,295,636	134,295,143	134,295,143	493.5

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Nga analiza e tabelës së mësipërme u evidentua një diferencë prej 493.5 mijë lekë, e cila është krijuar nga disa mospërputhje midis treguesve të DPT dhe ISSH:

1. Te kontributet e sigurimeve shoqërore

Diferenca shfaqet vetëm te “Të vetëpunësuarit”, ku ISSH raporton 3,978,139 mijë lekë, ndërsa DPT 3,978,531 mijë lekë, duke krijuar një diferencë prej 392 mijë lekësh. Kjo diferencë lidhet me vonesë kohore ose korrigjime në pasqyrimin e pagesave të këtij sektori.

2. Te të ardhurat jo tatimore (shoqërore)

Totali i këtij zëri ka një diferencë prej 101 mijë lekësh ku:

- Gjaba sigurime shoqërore kanë diferencë 90 mijë lekë;
- Kamatëvonesa sigurime shoqërore kanë diferencë 11 mijë lekë.

Këto diferenca lidhen me afrime teknike në regjistrimin e gjobave e kamatëvonesave ndërmjet sistemeve.

Konkluzion: Referuar shkresës së MF nr. 1273/1, datë 27.01.2025 “Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara nga kontributet për Sigurimet Shoqërore nga DPT për vitin 2024”, midis të dhënave të DPT, si dhe të dhënave të rakorduara midis ISSH me Ministrinë e Financave mbi të ardhurat nga kontributet për sigurimet, rezulton një diferencë në shumën 493,920 lekë, i cili është pakësim i të ardhurave në debi të llog.75. Ky sistemim i rakorduar midis ISSH dhe MF, nuk është reflektuar në të dhënat e DPT-së.

Sa më sipër, rezulton se të ardhurat të mbledhura nga DPT janë në shumën 133,655,493 mijë lekë dhe të ardhura të tjera jo tatimore (gjaba, kamatë vonesa) në shumën 639,650 mijë lekë.

Listëpagesat e formatit elektronik nga periudha 2012 e në vijim

Marrëdhëniet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë të mbështetura në Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 11422, datë 19.05.2017 dhe nr. 4473/1, datë 23.05.2017.

Tabela nr. 3.12 “Ecuria e transmetimit të Listëpagesave sipas formatit elektronik në vitet 2012 – 2024”

Nr.	Viti	Listëpagesat elektronike deri më 31.12.2023	Listëpagesat elektronike deri më 31.12.2024	Diferenca e Listëpagesave të plotësuarra gjatë vitit 2024
1	2012	859,701	863,948	4,247
2	2013	1,040,491	1,044,508	4,017
3	2014	962,745	975,151	12,406
4	2015	1,196,744	1,198,955	2,211
5	2016	1,390,510	1,392,745	2,235
6	2017	1,343,531	1,346,641	3,110
7	2018	1,358,772	1,363,341	4,569
8	2019	1,365,552	1,373,723	8,171
9	2020	1,395,807	1,407,410	11,603
10	2021	1,432,806	1,450,037	17,231
11	2022	1,452,291	1,490,246	37,955
12	2023	1,374,078	1,475,583	101,505
13	2024	0	1,323,015	0
Gjithsej		15,173,028	16,705,303	209,260

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa më sipër, rezulton se për periudhën 2012 – 2024, DPT ka dërguar në ISSH gjithsej 16,705,303 listë pagesa të formatit elektronik. Gjatë vitit 2024 janë plotësuar gjithsej 209,260 liste pagesa më shumë e krahasuar me vitin 2023.

DPT dërgon në ISSH listë pagesat për çdo NIPT, me të dhënat e detajuara sipas rubrikave për çdo subjekt tatimpagues dhe individ, duke përfshirë numrin e identifikimit dhe shumat e derdhura plotësisht. Pas marrjes zyrtare të këtyre të dhënave në mënyrë koherente dhe online, ato

transferohen në regjistrin elektronik të historikut individual kontributi dhe pozicionohen në kartelën individuale të secilit kontribuues.

Edhe pse është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet ISSH dhe DPT me nr. 11422, datë 19.05.2017 dhe 4473/1, datë 23.05.2017, referuar Kreut II të saj, ISSH raporton se vijnë të evidentohen problematika në transmetimin e listë pagesave, si:

* Raste të vendosjes së gabuar të Numrit Personal (NID), çka ka sjellë problematika, pasi edhe pse gabimi është korrigjuar pas konstatimit, si dhe është reflektuar për periudhat pasuese, mbetet i pazgjidhur reflektimi për periudhat para konstatimit. Si pasojë, nuk verifikohet identiteti i personit për ato periudha dhe rrjedhimisht, as shumat përkatëse të kontributeve sipas viteve dhe periudhave përkatëse;

* Problematika e subjektit Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë, Elbasan, Ës, Fier. Drejtoritë arsimore të këtyre rajoneve kanë një problematikë të mbartur të viteve 2013 e 2014, të mungesës së listëpagesave elektronike në bazën e të dhënave CMIS që ISSH, administron.

Kjo problematikë po **ndiqet** nga Drejtoria e Kontributeve, degët përkatëse të kontributeve pranë DRSSH-ve dhe drejtoritë arsimore me qëllim **sistemimin e listëpagesave** për periudhën e munguar. Në muaji qershor 2025, DAR Tiranë ka përfunduar sistemimin e listëpagesave me problematikë, të periudhës;

* Ndryshimet në CMIS për E-SIG 25. Në sistemin CMIS nuk shfaqen akoma listëpagesat e periudhave të personave gjyqfitues. DPT nuk lejon që për personat gjyqfitues të bëhet listëpagesë individuale, për t'u përcjellë më pas në bazën elektronike të ISSH;

*Në rastet kur subjektet kryejnë pagesa pjesore për punëmarrës të veçantë, të dhënat e kontributeve të paguara nuk shfaqen në sistemin CMIS. Kur pagesa e kryer (e cila mund të bëhet pjesore) do të likujdojë të gjithë shumën e listëpagesës që është deklaruar në organet tatimore, në këtë moment bëhet i mundur transferimi i listëpagesës në sistemin elektronik që ISSH administron; Në sistemin elektronik CMIS të administruar nga ISSH, në periudha të mëparshme, mungonte informacioni mbi datën e ndryshimeve në listëpagesën E-SIG 25, duke e bërë të vështirë interpretimin e saktë të kushteve të përfitimit për qytetarët. Që nga muaji maji 2025, është bërë e mundur shfaqja e datës së ndryshimit të një listëpagese në CMIS, një element i domosdoshëm për të interpretuar kushtet e përfitimit afatshkurtër apo afatgjatë për qytetarët që u ka lindur e drejta për përfitim.

Listëpagesat e munguara të formatit letër 2006-2012

Spektori i Marrëdhënieve me Tatimet dhe Administrimit të të Dhënave në ISSH, i cili merret me administrimin e listëpagesave të subjekteve paguese, ka trajtuar problemin e mungesave të listëpagesave në formatin letër, për periudhat kohore 2006 – 2012. Të ndara sipas drejtorive rajonale të Sigurimeve Shoqërore, situata e mungesave të listëpagesave, format letër të periudhës 2006-2012, si dhe listë pagesat e munguara të marra gjatë vitit 2024, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Për rajonin e Tiranës, procesi i sistemimit të të dhënave të ardhura nga DPT, lidhur me pagesat e të vetëpunësuar vë të vetëm, vijon ende. Si rrjedhojë, të dhënat mbi mungesat në listë pagesat e subjekteve fizike në këtë rajon nuk janë ende përfundimtare dhe mund të ndryshojnë në vazhdimësi.

Tabelë nr. 3.13 "Listëpagesa të munguara deri më 31.12.2023, Listëpagesa të munguara e marra në dorëzim deri 31.12.2024"

DRSSH	Listëpagesa të munguara gjithsej deri më 31.12.2023				Listëpagesa të marra në dorëzim Janar - Dhjetor 2024				Listëpagesa të munguara gjithsej deri më 31.12.2024			
	Gjithsej	Subjekte Publike	Biznes i Madh Privat	Biznes i Vogël	Gjithsej	Subjekt e Publike	Biznes i Madh Privat	Biznes i Vogël	Gjithsej	Subjekt e Publike	Biznes i Madh Privat	Biznes i Vogël
Berat	543	-	41	502	44	-	-	44	499	-	41	458
Dibër	58,308	317	2,797	55,194	228	-	20	208	58,080	317	2,777	54,986
Ës	17,753	367	2,499	14,887	1,473	63	-	1,410	16,280	304	2,499	13,477
Elbasan	9,645	365	2,203	7,077	217	3	8	206	9,428	362	2,195	6,871

Fier	13,862	102	3,137	10,623	295	6	25	264	13,567	96	3,112	10,359
Gjirokastrë	24,372	817	3,496	20,059	39	-	7	32	24,333	817	3,489	20,027
Korçë	6,761	237	1,408	5,116	822	116	259	447	5,939	121	1,149	4,669
Kukës	9,615	426	1,792	7,397	71	6	-	65	9,544	420	1,792	7,332
Lezhë	3,529	53	873	2,603	16	1	-	15	3,513	52	873	2,588
Shkodër	3,869	214	1,460	2,195	28	20	8	-	3,841	194	1,452	2,195
Tiranë	1,275,223	2,605	41,931	1,230,687	4,278	1,040	1,385	1,853	1,270,945	1,565	40,546	1,228,834
Vlorë	59,867	474	11,192	48,201	63	-	63	-	59,804	474	11,129	48,201
Total	1,483,347	5,977	72,829	1,404,541	7,574	1,255	1,775	4,544	1,475,773	4,722	71,054	1,399,997

Burimi: Sektori i Marrëdhënieve me Tatimet dhe Administrimit të të dhënave në ISSH, përpunuar nga KLS

*Në vitin 2024, u konstatua një ulje e lehtë e numrit të listëpagesave të munguara të formatit letër për periudhën 2006-2012. Numri i listëpagesave të munguara u reduktua nga **1,483,347** në fund të vitit 2023, në **1,475,773** në fund të vitit 2024, duke shënuar një ulje prej **7,574 listëpagesash** në total.

Në disa DRSSH ka pasur përmirësime si:

- Tirana: ulje me rreth 4,278 listëpagesa;
- Ësi: ulje me 1,473 listëpagesa;
- Korça: ulje me 822 listëpagesa;
- Fieri: ulje me 295 listëpagesa;
- Dibër: ulje me 228 listëpagesa. Ndërsa në DRSSH Berat, Gjirokastrë, Lezhë dhe Shkodër ndryshimet janë minimale, duke treguar nevojën për ndjekje të mëtejshme administrative.

*Gjatë vitit 2024, rezultojnë se janë marrë në dorëzim 7,574 listëpagesa të mungura:

- 1,255 nga subjekte publike (buxhetorë dhe jo buxhetorë);
- 1,775 nga biznesi i madh;
- 4,544 nga biznesi i vogël.

*Nga 1,475,773 listëpagesa të munguara gjithsej deri më 31.12.2024:

- 4,722 janë nga subjekte publike (buxhetorë dhe jo buxhetorë) ose në masën 0.4% të listëpagesave totale;
- 71,054 janë nga biznesi i madh ose në masën 4.8% të listëpagesave totale;
- 1,399,997 janë nga biznesi i vogël ose në masën 94.8% të listëpagesave totale.

Në zbatim të shkresës nr. 2835 prot., datë 13.04.2018, "Për grumbullimin e listëpagesave të munguara të formatit letër të subjekteve aktive buxhetore dhe jo buxhetore për periudhën tatimore Janar 1994-Dhjetor 2012", është hartuar një plan veprimi nga Drejtoria e Kontributeve dhe degët pranë DRSSH-ve për evidentimin dhe njoftimin e subjekteve buxhetore lidhur me dorëzimin e listëpagesave të munguara për këtë periudhë. Megjithatë mungesa e koordinimit në kohë, me degët rajonale të arkivit për sigurimin e listës së subjekteve dhe periudhave përkatëse problematike, ka vijuar të mbetet një sfidë edhe gjatë vitit 2024.

Konkluzion: Në vitin 2024, ka pasur një ulje të përgjithshme të listëpagesave të munguara të formatit letër për periudhën 2006-2012, me 0.5%, por për një numër të konsiderueshëm DRSSH-sh, problematika mbetet pothuajse e pandryshuar, duke kërkuar ndërhyrje më të fortë institucionale.

Mbi rakordinin e të ardhurave të mbledhura nga ISSH

Për mbledhjen, evidentimin dhe kontabilizimin e të ardhurave që janë në përgjegjësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), menaxhimi dhe përpunimi i tyre bëhet në ndarje sipas këtyre kategorive:

- Kontributet e personave të vetëpunësuar në sektorin e bujqësisë;
- Kontributet e personave të siguruar në mënyrë vullnetare;
- Të ardhura dhe kontribute të tjera të ndryshme.

Tabela nr. 3.14 "Realizimi i të ardhurave nga ISSH të vitit 2024"

Në mijë lekë

Nr.	Burimi	Plan	Fakt	Diferenca (F/P)	Realizimi në %
-----	--------	------	------	-----------------	----------------

I	Kontribute të vetëpunësuarve në bujqësi	3,490,000	3,463,816	(26,184)	99
II	Kontribute të siguruarve vullnetarë	750,000	718,480	(31,520)	96
III	Të ardhura dhe kontribute të tjera (Të Tjera + Derdhur në llogari të ISSH)	400,000	959,692	559,692	240
	Totali (ISSH)	4,640,000	5,141,988	501,988	111

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Të ardhurat e realizuara nga strukturat e Sigurimeve Shoqërore kanë arritur vlerën prej 5,141,988 mijë lekë, krahasuar me 4,640,000 mijë lekë të planifikuara, duke shënuar një tejkalim prej 501,988 mijë lekë ose në masën 111% të planit. Kjo shumë është e shpërndarë sipas kategorive të mëposhtme:

- Të ardhurat nga “Të vetëpunësuarit në bujqësi” janë realizuar në shumën 3,463,816 mijë lekë, kundrejt planit prej 3,490,000 mijë lekë ose në masën 99%, duke rezultuar në një mosrealizim prej 26,184 mijë lekësh;
- Të ardhurat nga “Sigurimi shoqëror vullnetar” janë realizuar në shumën 718,480 mijë lekë, kundrejt planit prej 750,000 mijë lekë ose në masën 96%, duke rezultuar në një mosrealizim prej 31,520 mijë lekësh;
- Të ardhurat nga “Kontribute të tjera” janë realizuar në shumën 959,692 mijë lekë, nga të cilat:

958,799 mijë lekë përfaqësojnë të ardhurat nga interesat e depozitave, pagesa shërbimesh ndaj të tretëve, arkëtimet nga debitorët e përfitimeve, të ardhura nga qira ndërtesë;

893 mijë lekë përfaqësojnë kontribute për gratë e diplomatëve.

Kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi

Në rritjen e të ardhurave kontributive të vetëpunësuarve në bujqësi dhe të numrit të kontribuesve për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023, kanë ndikuar disa faktorë:

Sipas përcaktimeve ligjore të VKM nr. 77, datë 28.01.2015, e ndryshuar, kreu IV, pika 12, “Personat e vetëpunësuar në bujqësi, të cilët nuk i kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat e kaluara, mund t’i paguajnë kontributet për këto periudha. Në këtë mënyrë përveç periudhës koherente, individët paguajnë edhe për vitet pararendëse me kuotën e vitit kur kryhet pagesa (aktuale);

-Veprime avantazhuese nëpërmjet përfshirjes në skemat mbështetëse të qeverisë për zhvillimin e bujqësisë përgjatë vitit 2024, dhanë impaktin e tyre në derdhjen e kontributeve shoqërore nga fermerët e vetëpunësuar në bujqësi;

-Përfshirja e grave të vetëpunësuarve në bujqësi për të përfituar nga grantet IPARD III dhe mundësi të barabarta për akses në pagesat e drejtpërdrejta;

-Numri i hyrësve të rinj në skemën e buikut, veçanërisht në rritjen e numrit të grave dhe nënave të reja të vetëpunësuarve në bujqësi që paguajnë rregullisht detyrimet kontributive, për t’u futur në kushte për përfitimin e të ardhurës për barrë lindje, periudhë e cila llogaritet si vjetërsi pune;

-Ndërgjegjësimi i fermerëve për avantazhet e skemës në lidhje me kuotat më të ulëta të sigurimit shoqëror kundrejt të vetëpunësuarve në qytet. Në kontekstin e kontributeve të paguara dhe përfitimeve nga legjislacioni i sigurimeve shoqërore për të vetëpunësuarit në bujqësi, janë kategori e avantazhuar, në krahasim me të vetëpunësuarit në qytet;

-Ratifikimi i marrëveshjes me shtetin Italian për skemën e sigurimeve shoqërore, ndikoi pozitivisht gjatë vitit 2024, për sigurimin e individëve për periudhat e mëparshme për të cilat i kanë pasur kushtet e sigurimit me qëllim shtrirjen dhe rritjen e periudhës kontributive totale në të dy shtetet për efekt përfitimi pensioni.

Disa nga vështirësitë që hasen në rritjen e numrit të kontribuesve në skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi janë:

- Ekonomia rurale, bujqësore dhe blegtorale vijon të mbetet kryesisht informale, çka vështirëson identifikimin dhe përfshirjen e fermave të vogla në skemën e sigurimeve shoqërore;
- Mungesa e të dhënave zyrtare për aktivitetin ekonomik bujqësor krijon hapësirë për evazion kontributiv;

- Në skemën e personave të vetëpunësuar në bujqësi, sipas përcaktimeve ligjore, nuk futet e gjithë popullsia rurale aktive në forcat e punës;
- Tranzicioni demografik, migrimi i brendshëm dhe emigracioni i lartë po ndikojnë ndjeshëm në tkurrjen e popullsisë rurale, duke rrezikuar seriozisht fuqinë punëtore në bujqësi;
- Rënia e numrit të kontribuesve në skemën e të vetëpunësuarve lidhet me lëvizjet e shpeshta të fermerëve, mosinteresimin e të rinjve për të punuar në bujqësi, veçanërisht të meshkujve, dhe moshën e lartë mesatare të fermerëve;
- Moshë mesatare e lartë e fermerëve dhe mungesa e pasardhësve të gatshëm për të vazhduar punën në bujqësi, paraqet një kërcënim për fuqinë punëtore në të ardhmen e afërt;
- Niveli i ulët ekonomik në zonat rurale, kryesisht ato të thella malore, ose larg zonave urbane, nuk mundëson kapacitetin financiar të kësaj kategorie nga kryerja e aktivitetit bujqësor ose blegtoral, për të paguar sigurimet shoqërore.

Tabela nr. 3.15 "Realizimi i të ardhurave (sig shoq + kamata) nga të vetëpunësuarit" Në mijë lekë

Nr.	Rajonet	VITI 2024			
		Plan	Fakt	Në %	Diferenca
1	Totali	3,490,000	3,463,816	99	(26,184)

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr. 3.16 "Realizimi i të ardhurave (sig shoq + kamata) nga të vetëpunësuarit" Në mijë lekë

Nr	Rajoni	I Vetëpunësuarit në Bujqësi				
		Plan	Gjithsej	Sig shoq	Kamatë	%
1	Berat	248,724	238,520	222,541	15,979	96
2	Dibër	213,332	195,000	178,736	16,264	91
3	Ës	170,076	162,669	149,114	13,555	96
4	Elbasan	456,159	449,547	417,712	31,835	99
5	Fier	605,588	606,243	562,425	43,818	100
6	Gjirokastrë	176,958	171,165	160,493	10,672	97
7	Korçë	351,949	341,090	320,685	20,405	97
8	Kukës	92,411	90,204	82,797	7,407	98
9	Lezhë	207,433	221,037	202,677	18,360	107
10	Shkodër	271,335	271,944	250,681	21,263	100
11	Tiranë	316,558	308,376	284,412	23,964	97
12	Vlorë	379,477	408,021	377,018	31,003	108
	Totali	3,490,000	3,463,816	3,209,291	254,525	99

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Sipas rakordimit të të ardhurave të realizuara dhe rakorduara me DRSSH ka rezultuar se, për vitin 2024, të ardhurat nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi janë realizuar gjithsej në shumën 3,463,816 mijë lekë (3,209,291 mijë lekë të ardhura + 254,525 mijë lekë kamatë vonesa), kundrejt shumës 3,490,000 mijë lekë të planifikuara ose në masën 99%, me mosrealizim të planit në shumën 26,184 mijë lekë.

Tabelat nr. 3.17 dhe 3.17/1 "Realizimi i të ardhurave dhe nr. të kontribuesve i të vetëpunësuarve në bujqësi sipas rajoneve të ISSH", ku janë pasqyruar treguesit për numrin fizik dhe numrin mesatar të kontribuesve të vetëpunësuar në bujqësi dhe të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesa, ndodhen në *Aneksin nr. 1*, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Siç evidentohet nga të dhënat krahasuese në të dy tabelat (3.17 dhe 3.17/1), për vitet 2023 - 2024 ka rritje në të ardhurat kontributive 19.3%, si dhe për numrin e kontribuesve 6.9 %, në total. Për të ardhurat kontributive për vitin 2024, çdo rajon ka rritje pozitive me një normë përqindje nga 9.8% - 29.6%. Për numrin e kontribuesve rritja në përqindje për çdo rajon, varion nga 0.5% - 17.4%, përveç se rajoni i Kukësit, ku numri i kontribuesve paraqitet në përqindje negative (5.8%) në vitin 2024, krahasim me 2023.

Kjo tendencë në rritjen e të ardhurave në përqindje më shumë se në numër fizik (19.3% me 6.9%) për vitin 2024, tregon se individët nuk derdhin kontribut vetëm për periudhën koherente, por edhe për vitet e mëparshme.

Kontributi mesatar për vitin 2023, në kuotën 35,990 lekë, u përftua nga raporti i të ardhurave vetëm në sigurimin shoqëror, 2,715,504,000 lekë/numrin mesatar të kontribuesve 12 muaj/njerëz kontribute 75,451 kontribues.

Kontributi mesatar për vitin 2024, në kuotën 36,114 lekë, u përftua nga raporti i të ardhurave vetëm në sigurimin shoqëror 3,209,290,000 lekë/numrin mesatar të kontribuesve 12 muaj/njerëz kontribute 88,866 kontribues.

Të ardhurat e kontributeve nga sigurimi vullnetar

Nga auditimi i realizimit të të ardhurave nga sigurimi vullnetar për vitin 2024, rezultoi se të ardhurat të programuara janë realizuar në shumën 718,480 mijë lekë ose në masën 96 %. Pra, ka mosrealizim të planit, në shumën 31,520 mijë lekë.

Të dhënat për skemën e sigurimit vullnetar, janë regjistruar në programin informatik CMIS për të gjithë periudhën 2024. Procedurat janë informatizuar dhe kryhen në kohë reale si pritja e dokumentacionit, përpunimi i të dhënave dhe pajisja e kontribuesve me dokumentet e parashikuara e të kërkuara prej tyre dhe shfaqen në portalin unik qeveritar e-Albania, në llogarinë individuale të historikut kontributiv. Në tabelat nr. 3.18 dhe 3.19 paraqiten realizimi i të ardhurave nga sigurimi vullnetar, sipas DRSSH, si dhe duke e krahasuar me vitin 2023.

Tabela nr. 3.18 “Realizimi i të ardhurave nga kontributet vullnetare sipas rajoneve plan/fakt” Në mijë lekë

Nr.	Rajoni	Viti 2024			
		Plan	Fakt	Në %	Diferenca në vlerë
1	Berat	35,000	36,714	105	1,714
2	Dibër	3,000	2,782	93	-218
3	Es	81,000	80,067	99	-933
4	Elbasan	49,000	36,901	75	-12,099
5	Fier	57,000	53,578	94	-3,422
6	Gjirokastrë	22,000	20,382	93	-1,618
7	Korçë	50,000	48,137	96	-1,863
8	Kukës	3,000	2,134	71	-866
9	Lezhë	17,000	19,874	117	2,874
10	Shkodër	33,000	35,390	107	2,390
11	Tiranë	328,000	305,388	93	-22,612
12	Vlorë	72,000	77,133	107	5,133
	Totali	750,000	718,480	96	-31,520

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr. 3.19 “Realizimi i të ardhurave nga kontributet vullnetare 2024/2023”

Në mijë lekë

Nr.	Rajonet	2023		2024		Diferenca	
		Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
1	Berat	246	32,532	298	36,714	52	4,182
2	Dibër	16	2,481	22	2,782	6	301
3	Es	531	76,929	468	80,067	(63)	3,138
4	Elbasan	294	45,434	290	36,901	(4)	-8,533
5	Fier	335	54,057	353	53,578	18	-479
6	Gjirokastrë	152	19,443	148	20,382	(4)	939
7	Korçë	342	46,811	343	48,137	1	1,326
8	Kukës	23	2,304	21	2,134	(2)	-170
9	Lezhë	115	14,984	119	19,874	4	4,890
10	Shkodër	244	30,510	293	35,390	49	4,880
11	Tiranë	2,445	317,192	2,399	305,388	(46)	-11,804
12	Vlorë	478	69,221	501	77,133	23	7,912
	Totali	5,221	711,898	5,255	718,480	34	6,582

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Gjatë vitit 2024, në krahasim me 2023, është shënuar një rritje e lehtë si në numër kontributesh ashtu edhe në vlerë totale. Numri i kontributdhënësve u rrit me 34 persona, nga 5,221 në 2023, në 5,255 në 2024. Vlera totale e të ardhurave nga kontributet vullnetare është rritur me 6,582 mijë lekë, nga 711,898 mijë lekë në vitin 2023, në 718,480 mijë lekë në vitin 2024. Rajonet me rënie në vlerë janë:

- **Tirana:** -11,804 mijë lekë me rënien më të madhe;
- **Elbasani:** -8,533 mijë lekë;
- **Fieri dhe Kukësi** shënuan gjithashtu rënie të vogla, me nga 479 dhe 170 mijë lekë.

Konkluzion: Edhe pse rritja është e moderuar, ajo tregon një qëndrueshmëri në skemën e kontributeve vullnetare, me përmirësim në disa rajone, ndërsa nevojitet vëmendje e shtuar në

rajonet ku ka rënie, sidomos në Tiranë dhe Elbasan.

Të ardhura të tjera

Këto të ardhura për vitin 2024, janë realizuar në shumën 958,799 mijë lekë, nga 400,000 mijë lekë të planifikuara dhe përbëhen nga:

Tabela nr. 3.20 "Të ardhura të tjera"

Në mijë lekë

Nr.	Përshkrimi	Shuma
1	Të ardhura nga interesat e depozitave	707,112
2	Të ardhura nga arkëtimet nga debitorët e përfitimeve	250,683
3	Të ardhura nga komisione për shërbime	869.4
4	Të ardhura nga qira pajisjeje	25.5
5	Të ardhura nga qiraja	21.6
6	Të tjera të ardhura nga shitja e aktiveve	87.9
7	Të tjera	893
	Totali	959,692

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër, konstatohet që peshën më të madhe të të ardhurave e zënë të ardhurat nga interesat në masën 73.7% dhe të ardhurat e tjera në masën 26.3%.

Kontributet nga interesat dhe nga ankandet e titujve

Politikat e investimit të Fondit Rezervë të Sigurimeve Shoqërore mbështeten në parimin e sigurisë dhe kujdesit në menaxhimin e aseteve. Investimet janë orientuar drejt instrumenteve financiare publike, të cilat ofrojnë siguri të lartë dhe një nivel të përshtatshëm kthimi, duke mbajtur një balancë optimale ndërmjet riskut të marrë dhe përfitimit të mundshëm. Strategjia e investimit synon diversifikimin e aseteve përmes krijimit të një portofoli të përqendruar në tituj shtetërorë, të emetuar ose të garantuar nga Banka e Shqipërisë.

Portofoli i investimit të fondit Rezervë përbën asetin më të rëndësishëm financiar në pasqyrat financiare të ISSH-së. Kjo edhe për shkak të rëndësisë që ky portofol investimi përfaqëson, konkretisht rezerva apo kursimi i të ardhurave të ISSH-së për të bërë të mundur shlyerjen e pagesave për pensione për një muaj, i cili është detyrim që buron nga neni 70, i ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar me ligjin 104/2014, datë 31.07.2014, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Ky portofol përbëhet nga:

-Bono thesari me afat maturimi 3-12 mujor;

-Obligacione me maturim 2 vjeçar.

Portofoli i investuar i fondit rezervë në ISSH, ka pësuar ndryshime dhe rritje nga vitit 2015 e deri në fund të vitit 2024. Këto ndryshime kanë ardhur si pasojë e ndryshimeve të ligjit të Sigurimeve Shoqërore dhe rritjes së shpenzimeve të ISSH-së si rezultat i indeksimit të pensioneve çdo vit, gjë e cila ka sjellë rritjen e përvitshme të fondit rezervë dhe të portofolit të investuar të saj. Më konkretisht portofolin e investimeve të fondit rezerve të ISSH-së për periudhën 2015-2024, paraqitet në tabelën nr. 3.21 "Portofoli i investimit të fondit rezerve të ISSH-së ndër vite", në Aneksin nr. 1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit)..

Për sa më sipër rezultojnë se, portofoli i investuar i fondit rezervë ka pësuar rritje, por edhe diversifikim në përbërjen e tij, pra shuma e investuar në Obligacione ka ardhur duke u rritur si në njësi investimi ashtu edhe në vlerë.

Tabela nr. 3.22 Portofoli i investimit të fondit rezerve vitet 2023-2024

Në lekë

Portofoli i investimit			
Periudha	Bono Thesari	Obligacion	Totali
2023	8,593,780,000	6,652,900,000	15,246,680,000
2024	9,196,230,000	4,900,000,000	14,096,230,000

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Për vitet 2023-2024 vendimet e Këshillit Administrativ dhe shtesat e fondit rezervë paraqiten më poshtë:

Tabela nr. 3.23 Fondit rezerve sipas VKA vitet 2023-2024

Në lekë

Vitet	2023	2024
Fondi Rezervë	14,059,078,373	14,765,704,759
Shtesa me Vendim KA	757,214,912	706,626,386

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Me Vendimin nr. 4, datë 09.07.2024 të Këshillit Administrativ të ISSH-së, është bërë miratimi i normativës së fondit rezervë në fund të vitit 2023, në shumën 14,059,078,373.43 lekë, për mbulimin e pagesave të përfitimeve të paktën për një muaj. Si dhe miratimi i plotësimit të normativës së fondit rezervë nga rezultati financiar i vitit 2023, në shumën prej 757,214,912.34 lekë.

Me Vendimin nr. 5, datë 12.06.2025 të Këshillit Administrativ është bërë miratimi i fondit rezervë në fund të vitit 2024, në shumën 14,765,704,759 lekë, për mbulimin e pagesave të përfitimeve të paktën për një muaj, si dhe miratimi i plotësimit të fondit rezervë nga rezultati financiar i vitit 2024, në shumën prej 706,626,386 lekë. Pas miratimit të rezultatit financiar dhe shpërndarjes së tij, në bilancin financiar fondi rezervë evidentohet në shumën 14,765,704,759 lekë.

Nga auditimi konstatohet se me ligjin nr. 97/2023 *“Për buxhetin e vitit 2024”* të ndryshuar, në nenin 4, pika 3, është përcaktuar se *“Rezultati pozitiv në fund të vitit buxhetor derdhet në të ardhurat e buxhetit të shtetit të vitit pasardhës, pas miratimit të pasqyrave financiare, por jo më vonë se muaji prill 2024”* dhe kjo është reflektuar në zërin *“Rezultati financiar i ISSH”* në grupin e të ardhurave tatimore në shumën 7,900 milionë lekë në tabelën 4 të ligjit, Treguesit Fiskalë sipas Buxhetit të Konsoliduar. Referuar rezultateve faktike të kësaj tablele, konstatohet se është realizuar në shumën 7,916 milionë lekë. Realizimi i këtij treguesi buxhetor është kryer në vijim të shkresës nr. 4776/1 prot. datë 25.04.2024 të ISSH *“Kërkesë për transferim të likuiditeteve të krijuara nga rezultati financiar pozitiv i ISSH”*, ku është kërkuar transferimi më datë 25.04.2024 të shumës 7,916,259,945 lekë të gjendjes së likuiditetit të krijuar në Llogarinë Speciale të ISSH, në llogarinë me përfitues Ministria e Financave. Nga auditimi konstatohet se referuar Kapitullit V *“Fondi i Sigurimit Shoqëror”* të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, nuk është përcaktuar në asnjë nen transferimi i rezultatit të vitit në Buxhetin e Shtetit pas krijimit të gjendjes së fondit rezervë në nivelin e një muaj të shpenzimeve të skemës.

Konstatohet se nuk përmbush kushtet për t’u klasifikuar si e ardhur buxhetore, referuar përcaktimeve të bëra në pikën 18, të nenit 3, të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 *“Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”* ku përcaktohet që *“E ardhur” është rritja e pasurisë neto, e cila realizohet në formën e arkëtimeve, qofshin ato kapitale apo korrente dhe mund të jenë me ose pa detyrim për t’u kthyer në të ardhmen*”. Gjithashtu, nuk plotësohen kushtet për njohjen si të ardhur, pasi nuk kemi një rritje të pasurisë neto nga veprimet e mësipërme të parashikuar, por vetëm një lëvizje nga llogaria në llogari. Për më tepër, ISSH nuk hyn në kategorinë e mjeteve të përcaktuara në nenin 9, të ligjit të buxhetit për derdhjen e mjeteve në buxhet. Sipas parashikimit të ligjit nr. 97/2023 *“Për buxhetin e vitit 2024”*, të ndryshuar, në nenin 4 të tij është përcaktuar që *“Rezultati pozitiv në fund të vitit buxhetor derdhet në të ardhurat e buxhetit të shtetit të vitit pasardhës, pas miratimit të pasqyrave financiare, por jo më vonë se muaji prill 2024”*.

Sipas relacionit shoqërues të Aktit Normativ 1, datë 21.02.2024 është përcaktuar që *“Shuma prej 7.9 miliardë lekësh përbën rezultatin financiar të akumuluar të ISSH-së, të krijuar si rrjedhojë e tejkalimit të të ardhurave kontributive dhe transfertës buxhetore të miratuar në ligjin e buxhetit përkatës. Mbështetur në nenin 2, të ligjit të buxhetit 2024, rezultati financiar i akumuluar i ISSH-së do të transferohet në buxhetin e shtetit, pasi është plotësuar rezerva ligjore e skemës”*, ndërkohë që neni 2, i ligjit të buxhetit të vitit 2024 nuk ka asnjë përcaktim për rezultatin financiar të ISSH. Nga auditimi konstatohet se megjithëse është kërkuar përdorimi i rezultatit të akumuluar financiar, me ligj është miratuar vetëm rezultati financiar pozitiv në fund të vitit buxhetor, dhe jo rezultati i akumuluar ndër vite.

Nga MF me shkresën nr. 5158 prot., datë 17.04.2024 i është kërkuar ISSH-së **derdhja e rezultatit financiar të vitit 2023**, duke përcaktuar derdhjen në buxhetin e shtetit të fitimit të rezultuar nga viti 2023. Në përgjigje të kësaj shkrese, ISSH ka bërë kërkesë për transferim të likuiditeteve të krijuara nga rezultati financiar pozitiv i ISSH. Sipas VKA të ISSH nr. 4, datë 09.07.2024 *“Për miratimin e rezultatit financiar të sigurimeve shoqërore për vitin 2023”* është miratuar rezultati financiar pozitiv për vitin 2023 në shumën 1,107,162,055 lekë, duke destinuar 757,214,912 lekë

për shtesën e fondit rezervë (nga 13,301,863,461 lekë në 14,059,078,373 lekë) dhe pjesën tjetër prej 349,947,142 lekë për kalim në rezultat të mbartur.

Përsa më sipër, konstatohet se nuk është transferuar pjesa e rezultatit të vitit të ISSH, por rezultati i mbartur dhe nga llogaritjet e paraqitura nga ISSH konstatohet se gjatë vitit 2024, është transferuar në buxhetin e shtetit pjesa e rezultatit të mbartur nga vitet 2021 (3,502,042,169 lekë) dhe 2022 (4,414,217,785 lekë).

Gjithashtu konstatohet se këto të ardhura nuk kanë shkuar për rritjen e fondit rezervë të ISSH apo financimin e shpenzimeve të skemës, në kushtet kur skema e sigurimeve shoqërore paraqitet me deficit dhe mbështetet me transferta nga buxheti i shtetit. Kjo nuk është shoqëruar së paku me pakësimin e transfertave buxhetore për mbulimin e skemave të sigurimit shoqëror, duke mbivlerësuar treguesit e të ardhurave dhe në të njëjtën kohë ka shkuar për t'u përdorur për financimin e shpenzimeve të tjera buxhetore.

3.3. Shpenzimet për vitin 2024

- *Programimi dhe realizimi i shpenzimeve, në nivel ISSH dhe struktura rajonale*

Për vitin 2024, ISSH kishte planifikuar që shpenzimet e buxhetit të sigurimeve shoqërore të arrinin në shumën totale prej **188,825,385 mijë lekë**, e cila përfaqëson një rritje prej **18,587,211 mijë lekësh**, ose **10.9%**, më shumë krahasuar me faktin e vitit 2023.

Tabela nr. 3.24 "Plani dhe fakti i shpenzimeve për vitin 2024"

Në mijë lekë

Nr.	Shpenzimet	Fakt 2023	Plan 2024	Fakt 2024	Diferenca Fakt 2024/2023	Diferenca F/P 2024	Realizimi në %
I	Transferta për buxhetet familjare e individët	166,940,791	185,020,748	185,248,710	18,307,919	227,962	100
1	Shpenzime për përfitime	144,059,900	159,027,824	159,331,590	15,271,690	303,766	100
2	Shpenzime për programe te veçanta shtetërore	16,107,171	18,446,729	18,371,004	2,263,833	-75,725	99.5
3	Shpenzime për programe e skema suplementare	6,773,720	7,546,195	7,546,116	772,396	-79	100
II	Shpenzime administrative	3,297,383	3,804,637	3,377,770	80,387	-426,867	89
	Totali (I+II)	170,238,174	188,825,385	188,626,480	18,388,306	-198,905	99.9

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se, totali i shpenzimeve për vitin 2024 paraqitet 188,626,480 mijë lekë dhe është rritur ndjeshëm, në vlerën 18,388,306 mijë lekë ose në masën 10.8%, në krahasim me vitin 2023. Kjo tregon për një zgjerim të anagazhimeve buxhetore, mundësisht për rritjen e përfitimeve dhe zgjerimin e skemave sociale.

Tabela nr. 3.25 "Realizimi i shpenzimeve analitikisht viti 2024"

Në mijë lekë

	SHPENZIMET	Fakt 2023	Plan 2024	Fakt 2024	Diferenca F/P	Në%
A	Transferta per buxhetet familjare e individet (I+II+III)	166,940,791	185,020,747	185,248,710	227,962	100%
I	Shpenzime per perfitime	144,059,900	159,027,824	159,331,590	303,765	100%
1	Kompensim per paaftesi te perkohshme per shkak te semundjes	684,730	763,706	764,538	833	100%
2	Kompensim per leje lindje	299,655	313,387	318,188	4,801	102%
	Barre lindje qytet	4,161,843	4,719,201	5,029,005	309,804	107%
	Barre lindje fshat	426,491	281,074	279,714	-1,360	100%
3	Totali shpenzimeve per pensione	138,464,123	152,917,786	152,907,541	-10,245	100%
	Pensione qyteti	125,889,280	139,975,080	139,964,662	-10,418	100%
	Pensione fshati	12,574,844	12,942,707	12,942,879	172	100%
4	Kompensim per paaftesi i. Per shkak te demtimit ne pune	23,058	32,671	32,603	-68	100%
II	Shpenzime per programe te veçanta shtetërore	16,107,171	18,446,729	18,371,004	-75,725	100%
1	Kompensim supl. Per çmimet per pensionistet	15,652,834	17,837,080	17,768,070	-69,011	100%
	Kompensim supl. Per çmimet per pensionistet qytet	14,889,267	17,072,821	17,009,033	-63,788	100%
	Kompensim supl. Per çmimet per pensionistet fshat	763,567	764,260	759,037	-5,223	99%
2	Pensione te veçanta shtetërore	179,839	308,284	305,370	-2,913	99%
3	Pensione sociale (ishte-kompensim per ish te persekutuuarit)	187,633	218,889	217,078	-1,811	99%
4	Kompensim per veteranet e luftes	40,458	36,385	35,806	-579	98%
5	Kompensim suplementar per cimin e karburantit	46,407	46,090	44,679	-1,411	97%

III	Shpenzime per programe e skema suplementare	6,773,720	7,546,195	7,546,116	-78	100%
1	Sigurim suplementar per ish-ushtaraket	4,006,898	4,490,470	4,489,121	-1,349	100%
2	Perfitime per policine e shtetit	18,910	11,813	11,809	-4	100%
3	Trajtime te vecanta per pilotet	78,151	86,155	81,657	-4,498	95%
4	Perfitime per ushtaraket e nendetseve ne pension.	12,492	12,229	13,131	902	107%
5	Shpenzime per statusin e deshmor i atdheut	34,986	33,343	28,851	-4,492	87%
6	Trajtime te vecanta per punonjesit e industrise ushtarake	69,814	70,580	70,271	-309	100%
7	Transferta te tjera tek individet (shpenzime per statusin e profesorit)	215,155	257,963	267,122	9,159	104%
8	Sigurim suplementar shtetëror per ish funksionaret	1,001,051	1,147,897	1,146,278	-1,619	100%
9	Pagesa te parakohshme per minatoret	600,043	637,727	635,342	-2,385	100%
10	Pagesa te parakohshme per naftetarin	510,612	578,202	578,113	-89	100%
11	Pagesa te parakohshme per metalurgun	75,337	60,094	57,730	-2,364	96%
12	Transferta te tjera tek individet (shpenzime funerali)	150,272	159,722	166,691	6,969	104%
B	Shpenzime administrative	3,297,383	3,804,637	3,377,770	-426,867	89%
1	Paga,shperblime, dhe shpenz.tjera personeli	1,427,645	1,650,523	1,540,708	-109,814	93%
2	Kontribute per sigurime shoqerore e shendetesore	226,880	256,049	245,719	-10,330	96%
3	Mallra dhe sherbime te tjera	1,307,216	1,525,887	1,455,560	-70,327	95%
4	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrushme te trupezuara	335,642	372,178	135,783	-236,396	36%
	Totali (A+B)		188,825,384	188,626,479	-198,905	100%
C	Rezultati fiskal (Fakt-Plan)			2,268,473		
D	Financimi i planifikuar dhe terhequr		51,457,822	51,457,822	-	100
E	Financimi i nevojshem (D-C)			49,199,349		

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Vlerësim i realizimit të shpenzimeve buxhetore

Rezulton se gjatë vitit 2024, janë tejkaluar shpenzimet në krahasim me ato të planifikuara për dy programe dhe nuk janë realizuar dy programe të tjera:

- Programi “Transferta për buxhetet familjare e individët” është tejkaluar mbi planin në vlerën 227,962 mijë lekë ose në masën 12%, çka tregon rritje të presionit mbi buxhetin social dhe nevojë për përmirësim në parashikimin e nevojave sociale;

- Programi “Shpenzime për përfitime” është tejkaluar mbi planin në vlerën 303,766 mijë lekë ose në masën 19%. Ky tejkalim kryesisht është në zërin “Shpenzime për barrë lindje qytet”, i cili ka një tejkalim të planit në masën 309,804 mijë lekë, i cili mund të jetë rritur për disa arsye:

1. Rritja e pagës minimale në vitin 2023, pasi për përllogaritjen e përfitimit të barrë lindjes merret si bazë paga e një viti më parë, e cila ndikon në rritjen e shpenzimeve;

2. Indeksimi dhe rritja e pagave. Përfitimet e barrë lindjes llogariten si një përqindje e pagës mujore të personit të siguruar, pra nëse rriten pagat, shpenzimet për barrë lindje rriten në përpjestim;

3. Rritja e numrit të përfitueseve, më shumë gra të punësuar që kanë përfutuar nga skema e sigurimeve shoqërore;

4. Deklarimi i pagës reale rrit bazën e kontributeve, më shumë punonjës janë deklaruar me pagën e tyre reale (dhe jo minimale);

5. Përveç kësaj, ndikim ka patur edhe zbatimi i politikave të qeverisë për uljen e informalitetit në deklarin e pagave, më shumë të rinj të deklaruar;

6. Rritja e pagës mesatare në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat, rritja e bazës së vlerësuar etj.

- Programi “Shpenzime për programe te veçanta shtetërore” paraqitet me mos realizim nga plani për vlerën 75,725 mijë lekë, ose në masën 0.5%, i cili mund të konsiderohet brenda kufijve të pranueshëm;

- Programi “Shpenzime për programe e skema suplementare” është realizuar në vlerën 7,546,116 mijë lekë, në masën 100%, duke reflektuar një menaxhim të mirë të këtij segmenti buxhetor;

- Programi “Shpenzime administrative” paraqetitet me mos realizim në vlerën 426,867 mijë lekë ose në masën 11% të planit. Krahasuar me faktin e vitit 2023, që është në vlerën 3,297,383 mijë lekë, ka një parashikim në vlerë në shumën 80,387 mijë lekë më shumë për vitin 2024.
- Programi “Shpenzime administrative” ka shënuar një mosrealizim më të ndjeshëm, 426,867 mijë lekë ose 11%, gjë që kërkon analizë më të thelluar për të identifikuar arsyet konkrete të mosshfrytëzimit të fondeve të planifikuara, pavarësisht një parashikimi më të lartë se viti 2023.

Konkluzion: Të dhënat për vitin 2024, tregojnë për një tendencë në rritje të kërkesave dhe shpenzimeve sociale, të nxitura nga zhvillimet ekonomike pozitive (ritja e pagave, formalizimi i punësimit), por edhe nga politikat qeveritare për uljen e informalitetit. Megjithatë, këto zhvillime duhet të shoqërohen me një rishikim më të kujdesshëm të parashikimeve buxhetore dhe një analizë të thelluar të shpenzimeve administrative, për të shmangur tejkalimet apo mosrealizimet në të ardhmen dhe për të garantuar një përdorim sa më efikas të fondeve publik.

Kontrolli i pagesave të kryera nga ISSH

Një ndër detyrat kryesore që lidhet me administrimin e shpenzimeve është kontrolli i plotë i të gjithë pagesave që kryhen, për çdo muaj dhe në mënyrë të veçantë gjendja e pagesave të kryera në momentin e mbylljes së një përfundimi, kryesisht për shkak të vdekjeve. Ky është një kontroll i plotë i përmuajshëm dhe si proces, krahas zbulimit të menjëhershëm, duhet edhe marrja e masave për evadimin e dëmit.

Spektori i Kontrollit të Pagesave në ISSH gjatë kontrolleve të kryera kanë konstatuar shkelje të natyrave të ndryshme si: dublim pagesash, pagesa pas vdekjes, pagesa marrë tepër ose jashtë afatit, të cilat sipas natyrës për vitin 2024 janë:

- 5 raste dublim pagese, në shumën 88,449 lekë;
- 780 raste pagesa pas vdekjes, në shumën 35,994,428 lekë, këto raste kanë të bëjnë vetëm me shkeljet që kanë ndodhur kur tërheqja e pensionit është bërë pas datës së vdekjes, e cila pasqyrohet në momentin kur familjarët kanë bërë ç’regjistrimin në gjendjen civile;
- 36 raste pagesë tepër dhe jashtë afatit në shumën 836,463 lekë.

Për të gjitha rajonet janë konstatuar fonde të dëmtuara, të cilat janë shuma të përfituara në mënyrë të gabuar, të pajustificuar ose të paligjshme nga fondet e sigurimeve shoqërore, në 821 raste për shumën 36,919,340 lekë. Nga këto janë arkëtuar deri më datë 31.12.2024 në shumën 29,059,735 lekë. Kjo shumë është arkëtuar në: 4,479,368 lekë nga komisionet e postës; 19,119,020 lekë me mandate arkëtimin në bankë; si dhe 5,461,347 lekë me urdhër - xhirim nga posta. Rezultojnë ende fonde të dëmtuara të pa arkëtuar në shumën **7,859,605 lekë**. Tabela e detajuar mbi arkëtimin e fondeve të dëmtuara, sipas rajoneve përkatëse, ndodhet në *Aneksin nr. 1*, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Raste të tjera shkeljeje janë zbuluar në rajonin e Shkodrës, kur pagesa nuk është e rregullt (mandate pa firmën e pensionistit) gjithsej 46 raste. Nga këto, 33 raste janë nga sistemi TIMS në shumën **13,299,538 lekë** dhe 13 raste janë pagesa të pa rregullta në shumën **418,447 lekë**.

Mbi pagesat e kryera pas vdekjes për vitin 2024

Nga kontrolli i kryer nga Spektori i Kontrollit për rastet që kanë përfutuar të ardhura pas vdekjes progresivisht, për periudhën Janar - Dhjetor 2024, është konstatuar një dëm financiar prej **11,030 raste** me vlerë **114,885,368 lekë**, (ku përfshihen të gjitha rastet e tërheqjes pas datës së vdekjes, gjithashtu edhe rastet kur përfutuesi i pensionit e ka tërhequr vetë pensionin, por ka ndërruar jetë në po atë muaj. Meqënëse pensioni është një pagesë që merret paradhënie, pjesa pas datës së vdekjes duhet mbajtur nga granti), të raportuar për të gjitha rajonet nga Gjendja Civile, ku krahasuar me vitin 2023, ka pësuar një ulje prej 1,171 rastesh me vlerë 157,697 lekë.

✓ Nga 11,030 raste në total:

- 232 raste, janë pa efekte financiare;
- 10,798 raste, janë me efekte financiare;

✓ 10,151 raste, janë arkëtuar deri më datë 31.12.2024, në shumën **100,158,608 lekë**.

Nga këto:

- 108 raste, janë arkëtuar me postë në shumën 3,673,277 lekë;
- 592 raste, janë arkëtuar me bankë në shumën 23,846,892 lekë;
- 9,451 raste, janë arkëtuar nga shpenzime granti në shumën 72,638,439 lekë;
- 647 raste, janë në proces arkëtimi në shumën **14,726,760 lekë**.

Konkluzion: Nga Sektori i Kontrollit të Pagesave në ISSH, vazhdon kontrolli për rikthimin e fondeve të dëmtuara, por ende mbeten fonde të pa arkëtuara në vlerën **36,304,350 lekë** të cilat kërkojnë vëmendje të shtuar, për t'u shlyer plotësisht.

3.4 Rezultati fiskal vjetor, deficitit buxhetor dhe mbulimi tij

-Rezultati fiskal vjetor

Politikat buxhetore të sistemit të sigurimit shoqëror zbatohen nëpërmjet 3 programeve kryesore: “Sigurimi i detyrueshëm” që zë 84.4 % të fondit të përgjithshëm, “Sigurimi suplementar” zë 4 % dhe “Programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta” zënë 9.7 % të fondit të përgjithshëm të sigurimit shoqëror, i cili për vitin 2024, ishte 188,626 milion lekë.

Për vitin 2024, teprica e të ardhurave mbi shpenzimet, sipas degëve të sigurimeve shoqërore dhe programeve të veçanta dhe suplementare, është përdorur për të mbuluar deficitin të degës së pensioneve.

Rezultati fiskal vjetor përllëgaritet si diferencë midis të ardhurave faktike dhe shpenzimeve faktike. Për vitin 2024 rezulton në shumën 2,268,473 mijë lekë, i cili paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 3.26 “Të ardhura dhe shpenzime plan/fakt 2024, krahasuar me fakt 2023”

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Gjithsej			Diferenca F/P 2024	Realizim i në %
		Fakt 2023	Plan 2024	Fakt 2024		
I	Të ardhurat	124,618,101	137,367,563	139,437,131	2,069,568	102
1	DPT të ardhura	119,979,210	132,727,563	134,295,143	1,567,580	101
2	ISSH kontribute të tjera	1,025,840	400,000	959,692	559,692	240
3	ISSH të ardhura	3,613,051	4,240,000	4,182,296	(57,704)	99
II	Financime nga buxheti	46,727,235	51,457,822	51,457,822	-	100
III	Totali të ardhurave (I+II)	171,345,336	188,825,385	190,894,953	2,069,568	101
	Shpenzimet					
1	Transferta për buxhetet familjare e individët	166,940,791	185,020,748	185,248,710	227,962	100
1	Shpenzime për përfitime	144,059,900	159,027,824	159,331,590	303,766	100
2	Shpenzime për programe të veçanta shtetërore	16,107,171	18,446,729	18,371,004	(75,725)	100
3	Shpenzime për programe e skema suplementare	6,773,720	7,546,195	7,546,116	(79)	100
II	Shpenzime administrative	3,297,383	3,804,637	3,377,770	(426,867)	89
III	Totali i shpenzimeve (I+II)	170,238,174	188,825,385	188,626,480	(198,905)	100
	Rezultati fiskal			2,268,473		
	Financimi i nevojshëm (II-IV)			49,189,349		

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa më sipër konstatohet se, nevojat për financimin e shpenzimeve të vitit, janë ulur në vlerën 198,905 mijë lekë. Gjatë vitit 2024, nuk ka rezultuar tejkalim i shpenzimeve, por paraqiten me realizim në masën 100%.

Gjithashtu, konstatohet tejkalim i realizimit të të ardhurave nga kontributet, të cilat ishin planifikuar në shumën 137,367,563 mijë lekë dhe u realizuan në shumën 139,437,131 mijë lekë, me një tejkalim në shumën 2,069,568 mijë lekë më shumë.

Konkluzion: Teprica e të ardhurave prej 2,069,568 mijë lekë dhe e shpenzimeve të pakryera prej 198,905 mijë lekë, rezultuan në një rezultat fiskal pozitiv për vitin 2024, në shumën 2,268,473 mijë lekë.

- Deficiti buxhetor dhe mbulimi tij për vitin 2024

Bazuar në normën e kontributeve sipas degëve të sigurimit, kontributi për degën e pensioneve dhe degët e tjera, për vitin 2024, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 3.27 “Kontributet sipas skemave, viti 2024”

Në mijë lekë

Emërtimi	NORMA %						
		Shtundje	Barërlindje	Pensione	Aksidente	Papunësi	Pension Supl
A		0.3	1.4	21.6	0.3	0.9	
Sigurimi Shoqëror	137,141,095	1,559,771	7,716,428	121,625,811	1,559,771	4,679,314	
buxhetorë	42,868,344	524,918	2,449,620	37,794,132	524,918	1,574,755	
jobuxhetorë	7,909,271	96,848	451,958	6,973,072	96,848	290,545	
firma	76,603,704	938,005	4,377,355	67,536,327	938,005	2,814,014	

	individë	3,978,139		242,148	3,735,991			
	të ardhura të tjera	1,853,867			1,853,867			
	të siguruar vullnetarisht	718,480			718,480			
	të vetëpunësuar në bujqësi	3,209,290		195,348	3,013,942			
B	Kontribute të Buxhetit të Shtetit	5,449,293	0	273,135	5,176,158	0	0	
	për të papunët	1,081,920		65,856	1,016,064			
	për ushtarakët në reformë	204,650		12,457	192,193			
	për policët në reformë	123,904		7,542	116,362			
	për ish funksionarët	26,839			26,839			
	për ushtarakët në reformë të pensioneve të parakoshme	3,048,238		185,545	2,862,693			
	gra të pensionuara në vitin planifikues	935,230			935,230			
	punonjësit e industrisë ushtarake dhe minierave	28,512		1,736	26,776			
C	Diferencë kontributi për të vetëpunësuarit në bujqësi	6,601,626		401,838	6,199,788			
	Totali i të Ardhurave për Sigurimin e Detyrueshëm	149,192,014	1,559,771	8,391,402	133,001,757	1,559,771	4,679,314	
E	Kontribute për Sigurimin Suplementar	2,296,035						2,296,035
	TOTALI	151,488,049	1,559,771	8,391,402	133,001,757	1,559,771	4,679,314	2,296,035

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Sipas përcaktimeve të nenit 8, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, periudha kur individi përfiton pagesa nga sigurimet shoqërore për shkak të sëmundjes, barrë lindjes, aksidentit në punë, sëmundjeve profesionale apo papunësisë konsiderohet si **periudhë sigurimi** për efekt pensioni. Skema e detyrueshme e sigurimit shoqëror jep përfitime për **5 degë kryesore**: sëmundje, barrë lindje, pensione (pleqëri, invaliditet, familjar), aksidente e sëmundje profesionale, dhe papunësinë, e cila menaxhohet nga **Shërbimi Kombëtar i Punës**.

Për arsye se buxheti i sigurimeve shoqërore subvencionohet nga buxheti i shtetit, për deficitin e planifikuar të degës së pensioneve, kontributi i mbledhur për sigurimin e papunësisë mbetet në buxhetin e ISSH, ndërkohë shpenzimet për përfitimet e papunësisë financohen nga buxheti dhe disbursohen për shërbimin kombëtar të punës. Kontributet me destinacion transferohen në buxhetin e sigurimeve shoqërore nga buxheti i shtetit, si program i Ministrisë së Financave dhe disbursohen çdo muaj nga dega e thesarit Tiranë. Ato evidentohen në raportin mujor dhe progresiv të ISSH dhe në bilancin financiar. Të dhënat për numrin e kontribuesve nxirren nga evidenca e përfituesve nga këto programe dhe janë të evidentuara në raportin statistikor përmbledhës sipas raporteve dhe përfituesve të evidentuar në çdo njësi rajonale.

Rezultati financiar i skemës së sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Shpenzimet klasifikohen sipas degëve të sigurimit dhe aktiviteteve të skemës së detyrueshme, si një skemë e cila principalisht duhet të mbulohet me kontribute.

1. Skema e qytetit

Kontributet në total, kontributet sipas degëve të sigurimit dhe shpenzimet për skemën e sigurimit të detyrueshëm të qytetit paraqiten në tre tabelat në vijim:

Tabela nr. 3.28 “Kontributet në total”

Në mijë lekë

Emërtimi	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023
I. Kontribute të personave juridikë dhe fizikë	98,228,246	115,760,918	129,252,491	13,491,573
II. Kontribute me destinacion nga buxheti i shtetit	4,411,815	4,771,702	5,449,293	677,591
Gjithsej	102,640,062	120,532,620	134,701,784	14,169,164

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa më sipër, të ardhurat nga **kontributet e personave juridikë dhe fizikë** kanë shënuar një rritje të vazhdueshme gjatë periudhës 2022-2024. Nga 98,228,246 mijë lekë në vitin 2022, ato u rritën në 115,760,918 mijë lekë në vitin 2023, që përbën një rritje prej rreth **17.8%**. Në vitin 2024, kontributet arritën në 129,252,491 mijë lekë, duke shënuar një rritje prej **11.7%** krahasuar me vitin 2023. Në total, rritja midis viteve 2022 dhe 2024 është **31.6%**.

Kontributet me destinacion nga buxheti i shtetit gjithashtu kanë regjistruar rritje gjatë kësaj periudhe. Vlera e tyre u rrit nga 4,411,815 mijë lekë në vitin 2022, në 4,771,702 mijë lekë në vitin 2023,

duke shënuar një rritje prej 8%. Në vitin 2024, këto kontribute arritën në 5,449,293 mijë lekë, një rritje prej 14 % krahasuar me vitin 2023. Për periudhën 2022-2024, rritja totale ishte 23.5%. Në përmbledhje, të dyja kategoritë e kontributeve kanë treguar tendencë rritëse, me kontributet e personave juridikë dhe fizikë me rritjen më të dukshme, si në vlerë absolute ashtu edhe në përqindje, gjatë kësaj periudhe.

Tabela nr. 3.29 "Kontributet në total, sipas degëve të sigurimit"

Në mijë lekë

Emërtimi	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023	Në % 2024-2023
Kontribute sipas degëve	106,188,573	124,705,971	139,381,098	14,675,127	11.8
sëmundje	1,182,837	1,391,117	1,559,771	168,655	12
barrë lindje qytet	5,948,819	6,968,074	7,794,215	826,142	11.9
pensione qytet	94,325,569	110,782,313	123,788,026	13,005,713	11.7
aksidente	1,182,837	1,391,117	1,559,771	168,655	12
papunësi	3,548,511	4,173,350	4,679,314	505,964	12

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Gjatë periudhës 2022-2024, kontributet sipas degëve kanë shënuar rritje, ku skema e qytetit rezultoi me 139,381,098 mijë lekë në vitin 2024, që përbën një rritje prej 11.8%, krahasuar me vitin 2023. Ndërsa të destinuara për mbulimin e shpenzimeve sipas degëve, janë 134,701,784 mijë lekë ose 14,054 milion lekë më shumë, pasi përjashtohen kontributet e degës së papunësisë për të cilat nuk programohen kontributet, por vetëm realizohen pagesa.

Në nivel degësh:

- Kontributet për sëmundje janë rritur nga 1,182,837 mijë lekë në 2022, në 1,559,771 mijë lekë në 2024, duke shënuar një rritje prej 12% në vitin 2024, në krahasim me 2023;
- Kontributet barrë lindje qytet ka pësuar rritje prej 11.9%, me vlerë që është rritur nga 5,948,819 mijë lekë në 2022, në 7,794,215 mijë lekë në 2024;
- Kontributet pensione qytet mbeten degë me kontributet më të mëdha, të cilat janë rritur nga 94,325,569 mijë lekë në 2022, në 123,788,026 mijë lekë në 2024, me një rritje prej 11.7% në vitin 2024, krahasuar me 2023;
- Kontributet për aksidente janë rritur gjithashtu me 12%, duke shkuar nga 1,182,837 mijë lekë në 2022, në 1,559,771 mijë lekë në 2024;
- Kontributet papunësi ka shënuar një rritje prej 12%, me kontribute që u rritën nga 3,548,511 mijë lekë në 2022, në 4,679,314 mijë lekë në 2024.

Në përgjithësi, të gjitha degët kanë regjistruar rritje të qëndrueshme, me përqindje të rritjes që luhet midis 11.7% dhe 12% në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023.

Tabela nr. 3.30 "Shpenzimet në total, sipas degëve të sigurimit"

Në mijë lekë

Emërtimi	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023	Në % 2024-2023
Shpenzime sipas degëve	120,901,769	133,618,806	148,756,034	15,137,228	11
sëmundje	599,829	698,255	778,479	80,224	11.5
barrë lindje qytet	3,922,930	4,521,217	5,427,621	906,405	20
pensione qytet	116,355,362	128,375,821	142,516,736	14,140,915	11
aksidente	23,649	23,513	33,197	9,684	41

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Gjatë periudhës 2022-2024, shpenzimet sipas degëve kanë shënuar rritje, duke arritur në 148,756,034 mijë lekë në vitin 2024, që përbën një rritje prej 11% krahasuar me vitin 2023.

Në nivel degësh:

- Shpenzimet për sëmundje janë rritur nga 599,829 mijë lekë në 2022, në 778,479 mijë lekë në 2024, duke shënuar një rritje prej 11.5% në vitin 2024, krahasuar me 2023;
- Barrë lindje qytet ka pësuar rritje, me një shtim prej 20%, duke u rritur nga 4,521,217 mijë lekë në 2023, në 5,427,621 mijë lekë në 2024;
- Shpenzimet për pensione qytet kanë shënuar një rritje prej 11%, nga 128,375,821 mijë lekë në 2023, në 142,516,736 mijë lekë në 2024;
- Shpenzimet për aksidente kanë pësuar rritjen më të madhe në përqindjeje, prej rreth 41%, nga 23,513 mijë lekë në 2023, në 33,197 mijë lekë në 2024, edhe pse në vlerë absolute mbeten relativisht të ulëta.

Shpenzimet janë rritur në të gjitha degët, me barrë lindjen dhe aksidentet që shfaqin rritjet më të

larta përqindjeje, ndërsa shpenzimet për pensionet mbeten me volum më të madh në vlerë, por me rritje më modeste.

Tabela nr. 3.31 "Deficiti i Degës së pensioneve qytet"

Në mijë lekë				
Vitet/Degët	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023
Rezultati financiar sipas degëve	-18,261,708	-13,086,185	-14,054,249	-968,064
semundje	0	0	0	-
barrëindje	0	0	0	-
pensione qytet	-18,261,708	-13,086,185	-14,054,249	-968,064
aksidente	0	0	0	0
Deficiti qytet / GDP	-0.85	-0.55	-0.56	-0.04

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Në lidhje me skemën e qytetit, sa më sipër rezulton se:

Deficiti i skemës së qytetit për vitin 2024, paraqitet në shumën 14,054 milionë lekë nga 13,086 milionë lekë që ishte në vitin 2023, pra është rritur me 0.04% ndaj PBB.

Nëse do të krahasonim ritmet e rritjes së të ardhurave me ato të shpenzimeve me vitin 2023, do të shikojmë që të ardhurat janë rritur më pak se shpenzimet, për rrjedhojë kemi një rritje të deficitit të qytetit në shumën 968,064 mijë lekë.

2. Skema e fshatit

Tabela nr. 3.32 "Kontributet në total, sipas degëve të sigurimit"

Në mijë lekë					
Emërtimi	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023	Në % 2024-2023
Kontribute për fshatin	5,510,392	8,014,470	9,810,916	1,796,446	22
Barrëindje fshat	335,415	487,837	597,186	109,349	22
Pensione fshat	5,174,977	7,526,633	9,213,730	1,687,097	22

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Gjatë vitit 2024, kontributet për skemën e fshatit u rritën me 22% krahasuar me 2023, duke arritur në 9,810,916 mijë lekë. Të dyja degët përkatëse: barrëindja në fshat dhe pensionet shënuan gjithashtu një rritje të njëjtë prej 22%, çka tregon një tendencë të qëndrueshme rritjeje në mbledhjen e kontributeve nga zonat rurale.

Tabela nr. 3.33 "Shpenzimet sipas degëve të sigurimit"

Në mijë lekë					
Emërtimi	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024-2023	Në % 2024-2023
Shpenzime për fshatin	13,287,475	13,286,538	13,480,761	194,223	1.5
Barrëindje fshat	600,237	463,319	301,885	-161,433	-35
Pensione fshat	12,687,237	12,823,220	13,178,876	355,656	2.8

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Gjatë vitit 2024, shpenzimet për fshatin u rritën lehtë me 1.5% krahasuar me vitin 2023, duke arritur në 13,480,761 mijë lekë. Kjo rritje modeste reflekton ndryshime të kundërta brenda dy degëve kryesore:

- Shpenzimet për pensione në fshat u rritën me 2.8%, nga 12,823,220 mijë lekë në 2023, në 13,178,876 mijë lekë në 2024, duke ruajtur trendin e rritjes së qëndrueshme të kësaj kategorie;
- Në të kundërt, shpenzimet për barrëindje në fshat ranë ndjeshëm me 35%, nga 463,319 mijë lekë në 2023, në 301,885 mijë lekë në 2024, e cila lidhet kryesisht me rënien e numrit të përfituesve, e cila është pasojë e disa faktorëve: rënia e lindshmërisë në zonat rurale, emigrimi i vazhdueshëm i popullsisë në moshë riprodhuese, si dhe zhvendosja e popullsisë drejt zonave urbane.

Tabelë nr. 3.34 "Bilanci i Skemës së fshatit"

Në mijë lekë				
Bilanci i skemës së fshatit	2022	2023	2024	ndryshimi 2024-2023
Barrëindje fshat	-264,822	24,519	295,301	270,782
Pension fshat	-7,512,260	-5,296,587	-3,965,145	1,331,441
Deficiti i fshatit	-7,777,082	-5,272,068	-3,669,844	1,602,224
Deficiti si % ndaj PBB	-0.36	-0.22	-0.15	0.06

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Në lidhje me skemën e fshatit, sa më sipër rezulton se:

Deficiti i skemës së fshatit për vitin 2024, paraqitet në shumën 3,670 milionë lekë nga 5,272 milionë lekë që ishte në vitin 2023, pra është ulur në shumën 1,602 milionë lekë.

Ndër vite deficiti i skemës së pensioneve të fshatit ka ardhur duke u ulur dhe se për vitin 2024,

kjo ulje rezulton me 0.06% ndaj PBB.

Tabela nr. 3.35 "Deficiti në total për të dy skemat, qytet dhe fshat"

Në mijë lekë

Deficiti sipas skemave	2022	2023	2024	ndryshimi 2024-2023
PBB (VKM 83, dt.05.02.2025) në mln lekë	2,149,700	2,369,900	2,494,200	124,300
Deficiti i PENSIONEVE në qytet në mijë lekë	-18,261,708	-13,086,185	-14,054,249	-968,064
Në % ndaj PBB	-0.85	-0.55	-0.56	-0.04
Deficiti i PENSIONEVE në fshat në mijë lekë	-7,777,082	-5,272,068	-3,669,844	1,602,224
Në % ndaj PBB	-0.36	-0.22	-0.15	0.06
Deficiti gjithsej i SKEMËS SË DETYRUESHME	-26,038,790	-18,358,253	-17,724,094	634,160
Në % ndaj PBB	-1.21	-0.77	-0.71	-0.03

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa më sipër, rezulton se të ardhurat nga kontributet nuk kanë qenë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të skemës së pensioneve qytet dhe fshat, duke pasur deficit të vazhdueshëm në vijim.

Gjatë vitit 2024, deficiti financiar i sistemit ka zbritur në -17,724 milionë lekë ose -0.71% i PBB, krahasuar me -18,358 miliardë lekë në vitin 2023, me një përmirësim prej 634.1 milionë lekë ose 0.03% të PBB. Përmirësimi i deficitit për vitin 2024, ka qenë kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave për shkak të rritjes së pagave mesatare dhe i rritjes së numrit të kontribuesve. Me gjithë përmirësimet në rezultatin e vitit 2024, skema rezulton me deficit.

3.5 Detyrimet e papaguara

Detyrimet e papaguara për subjektet në përgjegjësi të DPT

Një subjekt identifikohet si debitor nga mospagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore në momentin kur pagesa e kryer është më e vogël në vlerë, se vlera e përcaktuar në Deklaratën e Listëpagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të ardhurave nga TAP, ku afati ligjor i pagesës së tyre është data 20 e muajit pasardhës.

ISSH ka trajtuar në mënyrë analitike situatën lidhur me detyrimet e prapambetura të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shifër e konsiderueshme në numër subjektsh debitorë, por dhe në vlerë debie, në total për të katër kategoritë e biznesit.

Me anë të shkresës nr. 9189 prot., datë 03.09.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe për dijeni Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me objekt për problematikën në vazhdimësi në lidhje me rritjen e numrit të subjekteve me detyrime të prapambetura të kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Në këtë shkresë është bërë një pasqyrim i situatës së subjekteve debitorë me status aktive, pasive si dhe "kërkesë për çregjistrim" deri në 6-mujorin e parë të vitit 2024. Në të cilën është theksuar se "për shkak të këtyre detyrimeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore nuk mund të administrojë listëpagesat mujore përkatëse dhe për rrjedhojë një numër i konsiderueshëm individësh të punësuar në këto subjekte, nuk mund të përfitojnë shërbime nga skema e sigurimeve shoqërore". Në fund të shkresës kërkohet bashkëpunim më i gjerë ndërmjet dy institucioneve, për përmirësimin e gjendjes në mbledhjen e detyrimeve të prapambetura për të gjithë kategoritë e biznesit.

Gjendja e debitorëve që ndiqen nga DPT, sipas sektorëve (publik dhe privat), për vitin 2024 duke e krahasuar me 2023, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 3.36 "Gjendja e debitorëve që ndiqen nga DPT, sipas sektorëve për vitin 2024/2023"

Në lekë

Nr	Përshkrimi	Viti 2023		Viti 2024		Diferenca 2024/2023	
		Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
I	Spektori publik	823	794,665,260	724	1,263,704,416	-99	469,039,156
1	Buxhetorë	511	410,906,855	439	480,885,240	-72	69,978,385
2	Jo buxhetorë	312	383,758,405	285	782,819,176	-27	399,060,771
II	Spektori privat	109,306	17,661,585,774	119,912	18,962,080,124	10,606	1,300,494,350
1	Biznes i madh	26,854	10,680,249,131	29,731	11,103,129,136	2,877	422,880,005
2	Biznes i vogël	82,452	6,981,336,643	90,181	7,858,950,988	7,729	877,614,345
III	Totali (I+II)	110,129	18,456,251,034	120,636	20,225,784,540	10,705	1,769,533,506

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa më sipër, duke krahasuar gjendjen e debitorëve të vitit 2024 me 2023 rezulton se, numri i subjekteve debitorë të sektorit publik ka pësuar rënie nga 823 në 724 (-99 subjekte). Por vlera totale e debisë është rritur ndjeshëm, nga 794,665 mijë lekë, në 1,263,704 mijë lekë me një ndryshim prej rreth 469,039 mijë lekë.

- Në sektorin publik, numri i debitorëve buxhetorë është reduktuar me (-72), por vlera e tyre është rritur me 69,978 mijë lekë në vitin 2024;
- Jo buxhetorët gjithashtu kanë rënë në numër (-27), por vlera e tyre është pothuajse dyfishuar, me një rritje prej rreth 399,061 mijë lekë;

Numri i subjekteve debitorë në sektorin privat është rritur me 10,606 (nga 109,306 në 119,912). Vlera totale e debisë është rritur me rreth 1,300,494 mijë lekë. Nga 17,661,586 mijë lekë në 2023, në 18,962,080 mijë lekë në 2024;

- Biznesi i madh për vitin 2024, ka rritje të numrit të debitorëve me 2,877 subjekte dhe vlera është rritur me 422,880 mijë lekë;
- Biznesi i vogël ka rritje të numrit të debitorëve me 7,729 subjekte dhe vlera është rritur me 877,614 mijë lekë.

Konkluzion: Gjendja e debitorëve në vitin 2024 e krahasuar me vitin 2023, ka pasur ndryshime të dukshme në sektorët publik dhe privat. Është rritur numri total i subjekteve debitorë me 10,705 (sektori publik dhe privat). Si dhe vlera totale e debisë është rritur me 1,769,534 mijë lekë. Në sektorin publik, numri i subjekteve debitorë ka rënë, por vlera e debisë është rritur ndjeshëm, sidomos për debitorët jo buxhetorë, ku vlera është dyfishuar. Kjo tregon një rritje të detyrimeve financiare të sektorit publik, që mund të pasqyrojë një problem më të madh në menaxhimin e borxheve. Në sektorin privat, ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të debitorëve, sidomos në bizneset e vogla, ku vlera e borxhit është rritur më shumë. Ky trend tregon një rritje të ndjeshme të detyrimeve i cili është një indikator i vështirësive financiare që ata po hasin.

Në tabelën 3.37, paraqiten detyrimet e papaguara për sigurimet shoqërore sipas llojit të detyrimit. Pjesën më të madhe të borxhit e përbëjnë subjektet juridike (54.9%) dhe biznesi i vogël (38.9%), ndërsa subjektet buxhetore dhe jo buxhetore përbëjnë një pjesë shumë më të vogël. Totali i detyrimeve arrin në mbi 20,226 milionë lekë, duke përfshirë detyrimin, gjrobat dhe interesat.

Tabela nr. 3.37 "Detyrimet e sigurimeve shoqërore të papaguara, sipas llojit të detyrimit" Në lekë

Nr.	Subjektet	Numri i subjekteve sipas NIPT-it	Detyrimi	Gjoba	Interesa	Debia	Në %
1	Buxhetoret	439	221,159,504	93,568,053	166,157,683	480,885,240	2.4
2	Jo buxhetorët	285	653,533,344	79,544,466	49,741,366	782,819,176	3.9
3	Subjekte juridike	29,731	9,380,197,766	1,148,460,595	574,470,775	11,103,129,136	54.9
4	Biznes i Vogël	90,181	6,923,040,418	758,152,282	177,758,288	7,858,950,988	38.9
	TOTAL	120,636	17,177,931,032	2,079,725,396	968,128,112	20,225,784,540	

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Detyrimet e papaguara nga subjektet nën përgjegjësi të DPT-së, janë progresive dhe dërgohen në ISSH çdo 3 muaj, sipas akt marrëveshjes midis dy institucioneve. Të dhënat 3-mujore për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për subjektet buxhetore, jobuxhetore, biznes i madh privat dhe subjekte biznes i vogël për subjektet aktive, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 3.38 "Detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për subjektet aktive" Në lekë

Nr.	SUBJEKTET	Nr. i subjekteve Aktive sipas NIPTI-it	DETYRIMI	GJOBA	INTERESA	DEBIA	Në %
1	Buxhetorë	201	143,046,362	47,281,319	90,438,494	280,766,175	3.0
2	Jobuxhetorë	150	224,748,783	52,108,789	31,743,961	308,601,533	3.3
3	Biznes i Madh	13,482	4,561,505,964	352,806,592	149,249,410	5,063,561,966	54.1
4	Biznes i Vogël	37,820	3,441,500,278	212,747,184	44,536,600	3,698,784,062	39.6
	TOTAL	51,653	8,370,801,387	664,943,884	315,968,465	9,351,713,736	
	SHPK	12,277	4,172,236,524	302,306,173	128,768,430	4,603,311,127	

Burimi: Sek. i Marrëdhënieve me Tatimet dhe Admin. të të Dhënave, në ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të mësipërme, subjektet **aktive** debitore rezultojnë në numër 51,653 ose rreth 42.8% të numrit gjithsej të subjekteve debitore dhe në vlerë 9,351,714 mijë lekë ose 46% të të gjithë shumës të detyrimit (detyrim+gjobë+interesa = 20,225,785 mijë lekë).

Vetëm për nga vlera e detyrimit (pa gjoba dhe interesa) subjektet aktive debitore zënë 48.7% të shumës totale të detyrimit.

Detyrimet e papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore nga **subjektet aktive**, të ndara sipas kategorive: **biznesi i madh** ka borxhin më të lartë, me **54.1%** të totalit, ndjekur nga **biznesi i vogël** me **39.6%**. **Subjektet buxhetore dhe jobuxhetore** kanë detyrime më të vogla, përkatësisht **3.0% dhe 3.3%**. Në total, borxhi i papaguar është mbi **9,352 milionë lekë**. Subjekte debitorë me formë ligjore **SHPK (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar)** përbëjnë një pjesë të madhe të borxhit, të cilët rezultojnë në numër 12,277 dhe në vlerën mbi **4,603 milionë lekë**.

Detyrimet e papaguara nga subjektet biznesi i madh SHPK, me status aktiv për vitin 2024, rezultojnë në vlerën 656,514,568 lekë dhe përbëjnë 14.3% të vlerës totale të detyrimit të kësaj kategorie tatimpaguesish.

Të dhënat 3-mujore për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për subjektet buxhetore, jobuxhetore, biznes i madh privat dhe subjekte biznesi i vogël për subjektet **pasive**, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 3.40 “Detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për subjektet pasive”

Nëlekë

Nr.	SUBJEKTET	Nr. i subjekteve sipas NIPTI-it	DETYRIMI	GJOBA	INTERESA	DEBIA	Në %
1	Buxhetorë	118	62,382,395	42,947,251	72,300,822	177,630,468	1.8
2	Jobuxhetorë	91	61,205,557	15,069,518	14,688,350	90,963,425	0.9
3	Biznesi i Madh	16,156	5,332,978,116	817,779,275	439,365,202	6,590,122,593	67.6
4	Biznesi i Vogël	36,016	2,432,890,551	369,635,926	92,447,976	2,894,974,453	29.7
	TOTAL	52,381	7,889,456,619	1,245,431,970	618,802,350	9,753,690,939	
	SHPK	14,570	4,520,841,610	707,554,684	381,880,703	5,610,276,997	

Burimi: Sek. i Marrëdhënieve me Tatimet dhe Admin. të të Dhënave, në ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Detyrimet e papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore nga **subjektet pasive**, të ndara sipas kategorive: **biznesi i madh privat** ka borxhin më të lartë, me **67.6%** të totalit, ndjekur nga **biznesi i vogël** me **29.7%**. **Subjektet buxhetore dhe jobuxhetore** kanë detyrime më të vogla, përkatësisht **1.8% dhe 0.9%**. Në total, borxhi i papaguar është mbi **9,763 milionë lekë**. Subjekte debitorë me formë ligjore **SHPK** përbëjnë një pjesë të madhe të borxhit, të cilët rezultojnë në numër 14,570 dhe në vlerën mbi **5,610 milionë lekë**. Detyrimet e papaguara nga subjektet biznesi i madh SHPK, me status pasiv për vitin 2024, rezultojnë në vlerën 887,379,457 lekë dhe përbëjnë 15.8% të vlerës totale të detyrimit të kësaj kategorie tatimpaguesish.

Tabela nr. 3.39 “Me 20 subjekte aktive biznesi i madh SHPK, duke filluar me detyrimin më të lartë se 18,000 mijë lekë, të kontributeve të sigurimit shoqërore për vitin 2024”;

Tabela nr. 3.41 “Me 20 subjekte pasive biznesi i madh SHPK, duke filluar me detyrimin më të lartë se 14,000 mijë lekë, të kontributeve të sigurimit shoqërore për vitin 2024”; si dhe Tabela “Të dhënat për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për subjektet aktive, pasive, kërkesë për çregjistrim, të çregjistruar, falimentuar për vitin 2024”, paraqiten në *Aneksin nr. 1*, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Debitorët e mbetura në organet e sigurimeve shoqërore të ISSH-së

Nga të dhënat e ISSH gjendja e detyrimeve në 31.12.2024, rezulton në shumën totale 6,125,218,329 lekë e cila zë 35.6% të totalit të detyrimit (pa gjobë dhe interesa) të të gjithë subjekteve debitore në përgjegjësi të DPT-së, vlerë e cila rezulton e kuadruar me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara në llog. ekonomike 470 “Të tjera kërkesa debitore”.

Tabela nr.3.42 “Debitorët për kontribute për të vetëpunësuar në bujqësi në ISSH, 2023 dhe 2024” Në mijë lekë

Përshkrimi	2023	2024
Gjendje në fillim të periudhës	767,186	889,863
Shtesa	280,052	270,515
Pakësimi	157,374	145,645
Gjendja në fund të vitit	889,864	1,014,733
Pakësimi	122,678	145,645

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa më sipër, konstatohet se totali i borxhit për të vetëpunësuar në bujqësi është rritur nga 889,864 mijë lekë në 2023 në 1,014,734 mijë lekë në 2024, që do të thotë një rritje prej 124,870 mijë lekësh.

Debitorët ndaj ISSH-së janë rritur nga viti në vit, sepse shtesat e borxhit janë më të mëdha se pakësimet. Kjo tregon një tendencë negative në mbledhjen e detyrimeve për sigurimet shoqërore.

Tabela nr. 3.43 “Debitorët për kontribute për të vetëpunësuar në bujqësi (bujku) sipas DRSSH-ve” Në lekë

Nr.	Rajoni	Gjendja progresive deri në 31.12.2023			Gjendja progresive deri në 31.12.2024		
		Shuma	Shuma e k/vonesës	Total	Shuma	Shuma e k/vonesës	Total
1	Berat	49,835,945	435,123	50,271,068	60,926,931	512,840	61,439,771
2	Dibër	10,564,815	822,176	11,386,991	7,722,854	789,865	8,512,719
3	Ës	3,419,680	19,988	3,439,668	3,419,745	20,529	3,440,274
4	Elbasan	153,044,713	1,549,557	154,594,270	181,605,133	1,780,071	183,385,204
5	Fier	446,738,108	4,731,931	451,470,039	486,725,428	5,601,138	492,326,566
6	Gjirokastrë	201,283	32,215	233,498	128,370	17,211	145,581
7	Korçë	16,322,620	163,758	16,486,378	18,374,320	194,560	18,568,880
8	Kukës	3,001,572	83,038	3,084,610	4,079,066	155,928	4,234,994
9	Lezhë	23,611,800	263,500	23,875,300	25,545,950	152,050	25,698,000
10	Shkodër	19,347,000	128,574	19,475,574	20,054,330	131,073	20,185,403
11	Tiranë	13,452,146	529,728	13,981,874	14,032,000	700,730	14,732,730
12	Vlorë	140,521,147	1,043,504	141,564,651	180,704,387	1,359,012	182,063,399
	Totali	880,060,829	9,803,092	889,863,921	1,003,318,514	11,415,007	1,014,733,521

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Njëkohësisht konstatohet se janë rritur edhe **kamatëvonesat** me mbi 1,612 mijë lekë.

Vlerësime sipas rajoneve:

- **Fier, Elbasan dhe Vlorë** janë tre qarqet me detyrimet më të larta si dhe janë rritur dukshëm në 2024;
- Rajonet si **Berati, Tirana, Lezha, Shkodra dhe Kukësi** kanë pësuar gjithashtu rritje të borxhit, por në përmasa më të moderuara;
- **Dibra dhe Gjirokastra** janë të vetmet rajone ku borxhi total është ulur nga 2023 në 2024 (situatë e cila vjen nga lëvizjet demografike të popullsisë).

Faktorët që ndikojnë në vështirësinë e të vetëpunësuar në bujqësi (bujkun) për të shlyer detyrimet e papaguara për kontributet e sigurimit të detyrueshëm shoqëror:

* Niveli i ulët ekonomik në zonat rurale, kryesisht ato të thella malore, ose larg zonave urbane, nuk mundëson kapacitet financiar të kësaj kategorie nga kryerja e aktivitetit bujqësor ose blegtoral, për të paguar sigurimet shoqërore;

*Mosha mesatare e lartë e fermerëve dhe mungesa e pasardhësve të gatshëm për të vazhduar punën në bujqësi, paraqet një kërcënim për fuqinë punëtore në të ardhmen e afërt dhe si pasojë pamundësinë për të paguar detyrimet e prapambetura;

*Bujqësia po humbet gradualisht fuqinë punëtore, norma vjetore e rritjes së punësimit në bujqësi është më e ulët në krahasim me sektorët e tjerë ekonomikë, veçanërisht të rinjtë, duke kërcënuar të ardhmen e tregut të punës dhe rritur boshllëkun në numrin e kontribuesve të vetëpunësuar në bujqësi, çfarë ka sjellë dhe rritjen e detyrimeve të papaguara për kontributet e sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

Tabela nr. 3.44 “Mbi gjendjen debitore në 31.12.2023, sipas llojit të përfitimeve”

Në lekë

Nr.	Lloji i Përfitimit	Gjendja në fillim të vitit		Shtuar gjatë vitit		Pakësuar gjatë vitit		Gjendja në fund të vitit	
		Nr.	Shuma	Nr.	Shuma	Nr.	Shuma	Nr.	Shuma
1	Pensione Pleqërie	6,551	3,862,446,661	1,056	128,144,810	1,231	250,546,807	6,376	3,740,044,664
2	Pensione Invaliditeti	932	160,682,395	279	13,203,603	323	24,746,179	888	149,139,819

3	Pensione familjare	1,054	321,354,848	409	24,473,563	359	22,816,683	1,104	323,011,728
4	Trajtime te veçanta	2,800	778,950,255	904	55,887,512	956	98,540,925	2,748	736,296,843
5	Kompensime	96	24,633,760	49	2,682,544	38	5,163,150	107	22,153,154
6	Te tjera	744	22,224,854	22	622,874	31	665,693	735	22,182,035
	Shuma	12,177	5,170,292,773	2,719	225,014,906	2,938	402,479,437	11,958	4,992,828,242

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr. 3.44/1 "Mbi gjendjen debitore në 31.12.2024, sipas llojit të përfitimeve"

Në lekë

Nr.	Lloji i Përfitimit	Gjendja në fillim të vitit		Shtuar gjatë vitit		Pakësuar gjatë vitit		Gjendja në fund të vitit	
		Nr.	Shuma	Nr.	Shuma	Nr.	Shuma	Nr.	Shuma
1	Pensione Pleqërie	6,382	3,743,022,638	1,132	222,562,371	1,492	391,548,037	6,022	3,574,036,972
2	Pensione Invaliditeti	897	148,503,463	274	43,188,859	233	26,440,234	938	165,252,088
3	Pensione familjare	1,106	322,921,945	990	129,657,641	303	35,205,461	1,793	417,374,125
4	Trajtime te veçanta	2,736	739,854,657	995	264,118,470	627	105,283,564	3,104	898,689,563
5	Kompensime	102	16,343,505	46	6,192,336	8	960,544	140	21,575,297
6	Te tjera	735	22,182,035	119	13,988,639	50	2,613,913	804	33,556,761
	Shuma	11,958	4,992,828,242	3,556	679,708,316	2,713	562,051,753	12,801	5,110,484,805

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr. 3.45 "Mbi gjendjen debitorë për përfitime sipas DRSSH-ve"

Në lekë

Nr.	Rajoni	Gjendja progresive deri në 31.12.2023		Gjendja progresive deri në 31.12.2024	
		Nr.	Shuma	Nr.	Shuma
1	Berat	157	47,549,205	186	53,178,522
2	Dibër	533	260,251,522	673	282,591,411
3	Ës	477	240,529,203	670	267,091,272
4	Elbasan	354	78,550,953	427	81,979,262
5	Fier	632	119,412,333	559	114,086,228
6	Gjirokastrë	157	27,696,164	249	38,538,739
7	Korçë	379	126,053,041	423	123,608,580
8	Kukës	947	617,041,351	969	592,137,530
9	Lezhë	331	109,555,240	386	122,795,192
10	Shkodër	798	387,330,054	846	386,977,812
11	Tiranë	213	61,402,056	374	84,076,501
12	Vlorë	6980	2,917,457,120	7039	2,963,423,756
	Totali	11958	4,992,828,242	12801	5,110,484,805

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH-së

Nga informacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit rezulton se, **shtesat e debitorëve** për kontributet të vitit 2024 krahasuar me vitin 2023, janë në vlerën **454,693,410 lekë**. Këto shtesa kanë ardhur për shkak:

1. të punësimit në vlerën 309,990,872 lekë;
2. të rishqyrtimeve të Kontrollit Audit dhe Certifikimi në vlerën 60,527,590 lekë;
3. të përlllogaritjes së kompesimeve në kundërshtim me ligjin në vlerën 3,217,574 lekë të ardhjes së dosjeve me debi nga rajonet e tjera në vlerën (5,374,170 lekë);
4. rillogaritje nga Dega e Përfitimeve DRSSH në vlerën 86,331,544 lekë.

Pakësimet e debitorëve të vitit 2024 krahasuar me vitin 2023 janë në vlerën **159,572,316 lekë**.

Këto pakësime kanë ardhur për shkak të:

1. mbajtur debia nga sistemi në vlerën (17,172,365 lekë);
2. me Vendim Gjykatë në vlerën 27,651,191 lekë;
3. me Vendim të ISSH-së, Auditit dhe Kontrolleve në vlerën 30,946,256 lekë;
4. të transferimit të dosjeve në vlerën 17,991,956 lekë;
5. arkëtuar në Postë ose në Bankë në vlerën 3,033,420 lekë;
6. falje nga Ligji 72/2017-156/2020 në vlerën (329,447 lekë);
7. falje nga Ligji 46/16-167/2020 në vlerën (244,560 lekë);
8. sisteme nga financa (debitorë minatorë kalojnë në familjarë) në vlerën 88,065,999 lekë;

9. rishqyrtime nga dega e përfitimeve në vlerën 9,629,866 lekë.

Konkluzion: Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se në vitin 2024, ka një rritje neto të debitorëve për kontribute në vlerën **295,121,094 lekë** krahasuar me vitin 2023. Kjo rritje është kryesisht rezultat i punësimeve të reja dhe rilloaritjeve nga institucionet përkatëse, ndërsa pakësimet janë ndikuar kryesisht nga sistemet, vendimet gjyqësore dhe faljet ligjore. Nga strukturat përgjegjëse kërkohet forcimi i kontrollit dhe ndjekjes së debitorëve për të shmangur akumulimin e detyrimeve të reja.

Tabela nr. 1 dhe 1.1 “Detajimet për shtesat dhe pakësimet e debitorëve për kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2024, paraqiten në *Aneksin nr. 1*, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.6 Mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2024.

Në bazë të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” si dhe aktet nënligjore të dalë gjatë vitit mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit të shtetit, u shqyrtua dokumentacioni më poshtë:

1. Çelja e buxhetit të vitit 2024, si dhe detajimi i shpenzimeve administrative sipas programeve dhe produkteve;
2. Shkresat për rishikimet e buxhetit (rialokime, shtesa /pakësime) gjatë vitit 2024;
3. Urdhri i titullarit për hartimin e projektbuxhetit për periudhën 01.01.2024-31.12.2024;
4. Programi Buxhetor Afatmesëm i miratuar për periudhën 2024-2026, me ndryshimet përkatëse dhe shkresat përcjellëse për periudhën 01.01.2024-31.12.2024;
5. Raportet periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2024
6. Urdhrat për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Programeve buxhetore, etj.

Programimi PBA 2024-2026 (fazat), si dhe programimi i buxhetit të vitit 2024, nga ISSH.

Përgatitja e buxhetit të ISSH-së ka kaluar në tre faza:

1. Faza I- strategjike;
2. Faza II- teknike;
3. Faza III përfundimtare

Faza I – Strategjike

Sipas programit vjetor është planifikuar edhe inspektimi i përfitimeve afatgjata të caktuara nga DRSSH Elbasan dhe Durrës, inspektim i cili ka filluar në Shtator 2023 dhe është planifikuar të përfundojë në Shkurt 2024, rezultatet e të cilave do të paraqiten për vitin 2024, me përjashtim të rezultateve të DRSSH Elbasan, për pjesën e përfitimeve të invaliditetit, familjare dhe sociale.

Kontrollet e kryera për vitin 2024, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfitimeve afatgjata dhe të invaliditetit, familjare dhe sociale, janë pasqyruar si vijonë:

Tabela nr.5: rezultatet e gjetjeve të konstatuara;

000 mijë lekë

RAJONET	DRSSH Elbasan	DRSSH Durrës	DRSSH Gjirokastër	DRSSH Vlorë	DSSH Sarandë	DRSSH Korçë	DRSSH Dibër	DRSSH Kukës	DSSH Tropojë	DRSSH Shkodër (paraprake)	
Periudha e kontrolluar	01.01.2020 01.01.2021	01.01.2020 31.12.2021	01.01.2020 31.12.2022	01.01.2020 31.12.2022	01.01.2020 31.12.2022	01.01.2021 31.12.2022	01.01.2020 31.12.2022	01.01.2021 31.12.2022	01.01.2021 01.12.2022	01.01.2021 31.12.2022	
Afati i kontrollit	25.09.2023 09.02.2024 18.03.2024 03.04.2024	16.12.2023 05.02.2024 23.05.2024 31.05.2024	12.02.2024 13.03.2024	08.04.2024 20.05.2024	10.06.2024 25.06.2024	01.07.2024 27.08.2024	17.09.2024 15.10.2024	21.10.2024 30.10.2024	21.10.2024 30.10.2024	04.11.2024 31.12.2024	Totali
Dosje për kontroll	1,384	1,327	540	972	329	1,190	802	300	95	936	7,875
Dosje të paraqitura	1,363	1,320	528	941	318	1,170	679	293	94	927	7,633
Dosje të munguara	21	7	12	31	11	20	123	7	1	9	242
Nga keto (KMCAP Epror + KQA)	16										16
(transferuar, mbyllur, kal.pens.tje)		7	12	12	6	20	44	6		8	115
Aktive në sisteme/ pa arsye	5			19	5		79	1	1	1	111
Dosje të çertifikuara	1,301	1,281	509	860	285	1,092	620	254	82	883	7,167
Dosje me problematike	62	39	19	81	33	78	59	39	12	44	466
dosjet me problematike në %	4.55%	2.95%	3.60%	8.61%	10%	6.67%	8.69%	13.31%	12.77%	4.75%	6.11%
Konstatime t											0

ë kontrollit											
Pezullime			2					3		1	6
Rishqyrtime	39	30	16	52	18	32	44	23	3	31	288
Rishqyrtuar gjatë kontrollit	28	21	5	11	9	16	28	13	1	23	155
Plotësuar me dok. gjatë kontrollit	10	1	1	7	7	11	11	6	3	5	62
Mbeten detyrë për rishqyrtim	11	9	11	41	9	16	16	10	2	8	133
Mbeten detyrë për plotësim/KQA	8										8
Probleme mjekësore	5	8		22	8	32	4	7	6	7	99
GJITHSEJ / DETYRA	24	17	11	63	17	48	20	17	8	15	240
dosje të rezultuara debitorë/pezuilime (logaritur)										1	1
Ike										509	509
dosje të rezultuara debitorë/rishqyrtime	22	19	4	9	7	14	19	12	1	11	118
Ike	1,227	1,543	533	1,147	759	1,246	1,949	945	95	458	9,902
Debitorë (rishqyrtues)											0
Nr. dosje	22	19	4	9	7	14	19	12	1	12	119
Lekë	1,227	1,544	533	1,147	758	1,246	1,949	945	95	968	10,412
Kreditorë											0
Dosje të rezultuara kreditorë	6	2	1	2	2	5	9	1		12	40
Lekë	135	175	5	9	65	243	363	21		329	1,346
Nr. dosjeve të ertifikuara në përfundim të programit	1,339	1,303	515	878	301	1,122	659	273	86	911	7,387
dosje të ertifikuara në përfundim	98.24%	98.71%	97.34%	93.30%	94.63%	95.90%	97.05%	93.17%	91.49%	98.37%	96.78%
Nr. dosjeve me efektë	28	21	5	11	9	19	28	13	1	24	159

Burimi: të dhëna nga DIP në ISSH.

Sa më sipër, rezulton se gjatë vitit 2024 janë planifikuar për kontroll gjithsej 7,875 dosje. Nga këto, janë ertifikuar 7,160 dosje, që përbëjnë 90.92% të totalit të dosjeve të kontrolluara. Ndërkohë, janë evidentuar 465 dosje me problematika, ose 5.90% e totalit. Nga dosjet me probleme, 159 prej tyre kanë rezultuar me efekte financiare, që përfaqësojnë 34.1% të këtij grupi. Konkretisht, janë identifikuar 119 dosje debitorë me një efekt financiar prej 10,412 mijë lekësh, si dhe 40 dosje kreditorë me një efekt financiar prej 1,346 mijë lekësh. Në kuadër të programeve të inspektimit, një element i veçantë i tyre ka qenë edhe verifikimi i zbatimit të detyrave të lëna nga inspektimet e mëparshme. Rezultatet e këtyre kontrolleve tregojnë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të parashtruara në raportet përkatëse të inspektimit, në drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore (DRSSH) ku është realizuar inspektimi gjatë vitit 2024 të cilat paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 6: rezultatet e kontrollit të zbatimit të rekomandimeve;

Në mijë lekë

Kontrolli Detyrave	DRSS H Elbasan	DRSS H Durrës	DRSSH Gjrokastrë	DRSSH Vlorë	DRSSH Sarandë	DRSSH Korce	DRSSH Dibër	DRSSH Kukës	DRSSH Tropojë	DRSS H Shkodër	Totali
Dosje gjithsej	367	122	7	65	15	1	39	4	1	49	670
Paraqitur	367	120	7	62	15	1	18	2	1	49	642
Pa realizuar	43	2		17			1	0		3	66
Transferuar/ mbyllur				2			3				5
Aktive/ pa paraqitur		2		1			18	2			23
Pezullime											0
Rishq/pezuilime/debitorë											0
Nr. dosje	16	4	1	7	3		5			1	37
Debitorë lekë	1,770	828	27	267	622		791				4,306
Rishq/kreditorë											0
Nr. dosje	12	8	2	3	3					4	32
Kreditorë/ lekë	347	524	12	269	64					143	1,360
Plotësime dokumentacioni	296	106	4	35	9	1	12	1	1	41	506
Të rregullta në fund	324	118	7	45	15	1	17	1	1		529

Mbeten përsëri	43	4		18	0	0	19	3		3	90
Pezullime											0

Burimi: të dhëna nga DIP në ISSH.

Nga dosjet e kontrolluara për të cilat janë zbatuar rekomandimet përkatëse, në 69 raste, pas rishqyrtimit, janë konstatuar efekte financiare si në drejtim debitor, ashtu edhe kreditor. Më konkretisht, 37 dosje përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar debitor në shumën 4,306 mijë lekë, ndërsa 32 dosje kanë pasur efekt financiar kreditor në shumën 1,360 mijë lekë. Në anën tjetër, për 506 raste, zbatimi i rekomandimeve përmes plotësimit të dokumentacionit nuk ka sjellë efekte financiare.

▪ **Spektori i Inspektimit të Përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta.**

Spektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare dhe trajtimeve të veçanta, bazuar në planin vjetor me nr. 651 prot., datë 18.01.2024, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, ndryshuar me nr.12360 prot., datë 11.12.2024, gjatë vitit 2024 janë planifikuar për të kryer 5 inspektimet në DRSSH-të si më poshtë:

Tabela nr. 7: Planifikimi i programit vjetor SPS;

Nr.	DRSSH/DSSH	Periudha kohore	Afati kontrollit	Programi nr/Data
1	Dibër	01.01.2020-31.12.2022	08.01.2024-13.02.2024	nr. 87 prot., datë 04.01.2024
2	Tiranë	01.07.2020-31.12.2022	19.02.2024-06.09.2024	nr. 1711 prot., datë 16.02.2024
3	Berat	01.01.2021-31.12.2022	23.09.2024-22.10.2024	nr. 9196 prot., datë 04.09.2024
4	Sarandë	01.01.2021-31.12.2022	28.10.2024-11.11.2024	nr. 10863 prot., datë 25.10.2024
5	Vlorë	01.01.2021-31.12.2022	14.11.2024-13.12.2024	nr. 11443 prot., datë 08.11.2024

Burimi: të dhëna nga DIP në ISSH.

Nga auditimi rezulton se për DRSSH Elbasan, për të cilën inspektimi i përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta të caktuara në periudhën kohore 01.01.2021-31.12.2022, ishte planifikuar të kryhej brenda vitit 2024, pas ndryshimit të programit vjetor (për shkak të kapaciteteve inspektuese), programi i inspektimit ka filluar në dhjetor-2024 dhe do të është objekt i planifikimit për vitin 2025.

Inspektimet e kryera për vitin 2024, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta, janë pasqyruar si vijonë:

Tabela nr.8: rezultatet e gjetjeve nga sektori i inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta; 000 mijë Lekë

Rajonet	DRSSH Dibër	DRSSH Tiranë	DRSSH Berat	DSSH Sarandë	DRSSH Vlorë	
Periudha E Kontrolluar	01.01.2020 31.12.2022	01.07.2020 31.12.2022	01.01.2021 31.12.2022	01.01.2021 31.12.2022	01.01.2021 31.12.2022	
Afati I Kontrollit	08.01.2024 13.02.2024	19.02.2024 06.09.2024	23.09.2024 22.10.2024	28.10.2024 11.11.2024	14.11.2024 13.12.2024	
						Totali
Dosje per kontroll	967	5,899	515	275	679	8,335
Dosje te paraqitura	936	5,886	493	266	663	8,244
Dosje te mbyllura, transf. etj.	28	13	11	2	13	67
Paparaqitur Pa arsye	3		11	7	3	24
Dosje te rregullta	847	5,520	463	254	637	7,721
Dosje me problematike	89	366	30	12	26	523
% e dosjeve me prob	9.51%	6.22%	6.09%	4.51%	3.94%	6.3%
Te plotesuara dhe rishq. gjate kontrollit	53	302	14	5		374
Te pezulluara	16	46	1	4		67
Te rreg. ne fund	884	5,822	477	259	634	8,076
Mbeten detyra	36	18	15	3	26	98
Konstatime te kontrollit						
pezullime	16	46	1			63
plotesime/rishqyrtime	73	320	28			421
Plotesuar dhe certifikuar gjate kontrollit	37	302	14			353
rishqy. gjate kontrollit/ efekte (debi +kredi)	22	176	9			207
Plotesuar me dokumen.	15	126	5			146
Mbeten detyre per rishq./plot.	36	18	14			68
Dosje me probleme te tjera						
dosje te rezultuara debitor/ pezullime/ illogaritur debia	16	46	1			63
leke	6,155	15,639	107			21,900
dosje te rezultuara debitor/ rishqyrtime	17	136	5			158
leke	1,815	26,002	627			28,444
Dosje te Vle.Deb.Punesimi						
Vlera e Demit						
Debitor						
Nr.Dosje	33	182	6			221
Leke	7,969	41,641	733			50,344
dosje te rezultuara kreditor	5	40	4			49
Leke	112	2,107	136			2,355
Nr. dosjeve te certifikuara ne perfundim te programit	884	5,822	477	259	637	8,079
Dosje te certifikuara ne p. erfundim n e %	94.44%	98.91%	96.75%	97.37%	96.08%	97.99%
Dosje te mbyllura per plotesim, rishqyrtim /pezullim	36	18	14	4	26	98
Dosje te pezulluara	16	46	1			63

% e dosjeve të rishqyrtuara/pezuilluara me efekte	4.05%	3.77%	2.03%	2.6%		3.28%
---	-------	-------	-------	------	--	-------

Burimi: të dhëna nga DIP në ISSH, përpunuar nga grupi auditimit.

Nga auditimi ka rezultuar se Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve, nga 8,332 dosje të planifikuara për kontroll, janë paraqitur dhe inspektuar gjithsej 8,241 dosje, pasi 91 dosje janë transferuar ose mbyllur pa paraqitje të arsyes. Nga dosjet e inspektuara, janë çertifikuar 8,076 dosje, që përbëjnë 97.7% të totalit të dosjeve të shqyrtuara. Nga totali prej 8,241 dosjesh të inspektuara, vetëm 270 dosje kanë rezultuar me efekte financiare, që përfaqësojnë 3.27%. Prej tyre, 221 dosje kanë pasur efekt debitor në shumën 50,344 mijë lekë, ndërsa 49 dosje kanë rezultuar me efekt kreditor në shumën 2,355 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar se Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve, sipas planit të miratuar për vitin 2024, kishte parashikuar inspektimin e gjithsej 62,528 dosjeve, përfshirë edhe dy Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH), përkatësisht Elbasanin, të planifikuara fillimisht në vitin 2023. Gjatë vitit 2024, kjo drejtori ka realizuar inspektimin e 61,334 dosjeve. Nga këto, 60,392 dosje janë çertifikuar, 558 janë lënë me detyra për plotësim, ndërsa 942 dosje rezultojnë se nuk janë çertifikuar. Në total, nga inspektimi ka rezultuar një efekt financiar debitor në shumën 78,883 mijë lekë dhe një efekt financiar kreditor në shumën 31,826 mijë lekë. Dosje të cilat kanë qënë objekt i inspektimit për vitin 2024, që kanë mbetur për tu rishqyrtuar, për plotësim dhe të pa çertifikuara të vitit 2022 në total, janë 942 dosje.

Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve (DIP), gjatë vitit 2024 nuk ka kryer inspektime në 4 DRSSH-të, Tiranë, Lezhë, Fier dhe Berat, të cilët kanë një numër të konsiderueshëm përfitimesh, pensione afatgjata, invaliditetit, familjare dhe sociale nga skema e detyrueshme. Nga ana e Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve, rezulton se këto DRSSH-të janë inspektuar dhe çertifikuar gjatë vitit 2022-2023, për periudhat e pasqyruara si më poshtë:

Tabela nr.9, DRSSH-të, Tiranë, Lezhë, Fier dhe Berat inspektuar dhe çertifikuar gjatë vitit 2022-2023.

DRSSH	Programi i inspektimit	Periudha e inspektuar	Afati i inspektimit
Tiranë	Nr. 916 prot., datë 03.02.2023	01.01.2020-31.12.2021	08.02.2023-15.09.2023
Fier	Nr. 1978 prot., datë 16.03.2022	01.01.2019-31.12.2020	28.03.2022-10.06.2022
Lezhë	Nr. 4088 prot., datë 13.06.2022	01.01.2019-31.12.2020	22.06.2022-22.07.2022
Berat	Nr. 6952 prot., datë 18.10.2022	01.01.2020-31.12.2021	01.11.2022-03.02.2023

Burimi: të dhëna nga DIP në ISSH.

Nga ana e grupit të auditimit u kërkua informacion për arsyet e mos inspektimit, çertifikimit brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 62, pika 3 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet se: "*Pensionet e njohura, por të patërhequra do të paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet. Pensionet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për tre vjet. E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e kështit mujor të pensionit.*" Nga ana e subjektit të audituar në informacionin e dhënë sqaron se DRSSH-të Tiranë, Fier dhe Lezhë janë inspektuar gjatë vitit 2025, ndërsa DRSSH Berat do inspektohet në vazhdim.

Konkluzion:

- Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve (DIP) nuk ka inspektuar të gjitha dosjet e paraqitura për kontroll, duke devijuar nga plani i miratuar vjetor si dhe nga detyrimet ligjore në fuqi. Ky veprim bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 62, pika 3 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet qartë se: "*Pensionet e njohura, por të patërhequra do të paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet. Pensionet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për tre vjet. E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e kështit mujor të pensionit.*" Në përputhje me këtë dispozitë, DIP duhej të kishte ndërmarrë masa konkrete për të shmangur efekte financiare negative për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe për Buxhetin e Shtetit, të cilat rrjedhin nga tejkalimi i afatit ligjor 3-vjeçar për rikuperimin e shumave të përfituara

në mënyrë të padrejtë. Grupi i auditimit konstaton gjithashtu një mungesë angazhimi dhe vullneti të mjaftueshëm nga ana e strukturave përgjegjëse për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e ISSH-së, duke ndikuar negativisht në zbatimin e ligjshmërisë dhe mbrojtjen e fondeve publike.

- Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve (DIP), gjatë vitit 2024 nuk ka realizuar inspektime pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH): Tiranë, Fier, Lezhë dhe Berat, pavarësisht faktit se këto DRSSH-të, kanë një numër të konsiderueshëm përfituesish nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore, përfshirë pensionet afatgjata, përfitimet e invaliditetit, familjare dhe sociale, këto veprime kanë krijuar një boshllëk në kontrollin dhe mbikëqyrjen e rregullt të veprimtarisë së këtyre strukturave. Gjithashtu këto veprime bien në kundërshtim me parashikimet e nenit 62, pika 3 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", pasi mungesa e inspektimeve brenda afateve të përcaktuara mund të ndikojë negativisht në garantimin e rregullsisë dhe ligjshmërisë së përfitimeve të dhëna, si dhe në rikuperimin në kohë të shumave të marra në mënyrë të pa drejtë ose të paguara në mënyrë të pasaktë.

Nga ana e grupit të auditimit u kërkuar evidenca e debitorëve të nxjerrë për shkak të punësimit në institucione shtetërore, si dhe për përfitimet suplementare dhe trajtimeve të veçanta, e cila paraqitet sa më poshtë vijonë:

Sa më sipër, nga DIP janë konstatuar disa raste të tërheqjes së kësteve të përfitimit në kundërshtim me nenin 57 të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar, duke kërkuar shumat e përfituara padrejtësisht nëpërmjet ndalesës së pensionit në masën 50% të tij deri në shlyerjen e plotë të detyrimit.

Nga auditimi është konstatuar se masat e ndërmarra dhe rekomandimet e dhëna nga ana e Drejtorisë së Inspektimit (DIP) për Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH), nuk janë të plota si dhe nuk janë zbatuar plotësisht, ashtu siç parashikohet në nenin 62, pika 2, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Ky nen, ndër të tjera, përcakton se: *"Përsoni që ka përfituar pension ose të ardhura të tjera nga sigurimet shoqërore në mënyrë të paligjshme, detyrohet të kthejë të gjithë shumën e përfituar në mënyrë të padrejtë, e cila shlyhet me mbajtje mujore prej 50 për qind të kështit të përfitimit. Përveç kësaj, personi ndëshkohet me gjobë në masën katërfish të dëmit të shkaktuar."*

Nga auditimi konstatohet se nga ana e DIP dhe DRSSH, për asnjë nga rastet e tabelës së mësipërme nuk është vendosur masa penalitetit siç parashikohet në nenin 62, pika 2, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar.

Nga analiza e rasteve të tërheqjes së kësteve të përfitimeve në kundërshtim me nenin 57 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, rezulton se:

- Në 8 raste, Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) kanë zbatuar ndalimin e përfitimit në masën 100%.
- Në 47 raste, ndalimi është zbatuar në përputhje me parashikimet ligjore, pra në masën 50%.
- Ndërsa në 125 raste të tjera, ndalimi është vendosur në një masë më të ulët se 50%, duke qenë kështu në kundërshtim me përcaktimet e nenit 62 të po këtij ligji.

Ky mosrespektim i përqindjes së përcaktuar ligjërisht sjell pasoja të drejtpërdrejta në procesin e rikuperimit të dëmit të shkaktuar. Në disa raste, kjo sjellje mund të vonojë ndjeshëm kthimin e shumave të përfituara padrejtësisht, ose, në rastin më negativ, ato mund të mbeten të pambledhura. Si rrjedhojë, barra financiare bie në mënyrë të padrejtë mbi Buxhetin e Shtetit.

Gjithashtu, nga debitorët progresiv rezulton se ndalesa e masës së pensionit nuk përditësohet sipas indeksimit të pensionit. Grupi i auditimit ka konstatuar se për të gjithë debitorët ndër vite, në asnjë rast, ndalesa e pensionit nuk është aplikuar në përpjestim të drejtë me indeksimin (rritjen) e pensionit, në kundërshtim me nenin 62, pika 2, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi, për ndalesat me 20% të masës së pensionit (kur vjen si shkak i mosdeklarimit të përfituesit), Titullari sipas Drejtorive Rajonale si dhe drejtuesit e Degëve të Përfitimeve të atakuar më sipër.

Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për verifikim 20 dosje të debitore, më vlerë debitore në 2,613,423 lekë, pasqyruar në tabelat si më poshtë:

Tabela nr.11 Dosjet e debitoreve të përzgjedhur për auditim.

Nr.	Nr. Dosje	Përfitues			Lloji i Pensionit	Debia	ID	Masa e ndalesës së pensionit në %
		Emër	Atësi	Mbiemër				
1	P0000222	Meliha	Rasim	Tofciu	Pleqëri	41,468	G15310006J	20%
2	147796	Flamur	Etem	Rakipi	Pleqëri	269,397	F50110084N	50%
3	151612	Eleni	Mihal	Xharja	Pleqëri	104,231	F95529117A	50%
4	151010	Zejxhana	Haxhi	Nushi	Pleqëri	122,746	F96020223Q	20%
5	157620	Mustafa	Orhan	Malo	Pleqëri	100,551	F50128060L	18%
6	159109	Eshe	Ramazan	Musta	Pleqëri	720,892	F95321010H	49%
7	97421	Enver	Medi	Cani	Pleqëri	214,300	F41201194I	50%
8	98735	Ismail	Feta	Salju	Pleqëri	75,169	F60108010P	20%
9	P0000995	Servete	Agim	Myrte	Pleqëri	50,615	G06201217M	20%
10	179785	Pandi	Koli	Bello	Pleqëri	28,645	F51114073T	50%
11	90474	Sejdi	Hajdar	Kastrati	Pleqëri	35,959	F60922039L	100%
12	90615	Dashamir	Ferit	Palushi	Pleqëri	67,912	F61007107S	20%
13	P0000983	Ramis	Isuf	Mehmeti	Pleqëri	24,030	F70826086I	20%
14	P0001410	Lizë	Mark	Simoni	Pleqëri	28,708	G15604056A	20%
15	131539	Bedrije	Xhafiz	Marjani	Pleqëri	98,720	F86106038F	20%
16	131989	Misha	Sotir	Miho	Pleqëri	172,046	F60310167N	20%
17	151159	Durmish	Maliq	Tahiraj	Pleqëri	55,553	F41117030F	20%
18	156525	Vladimir	Ruba	Arapi	Pleqëri	160,918	F60322128I	15%
19	154170	Dhurata	Ali	Myrtaj	Pleqëri	101,120	G05102191K	20%
20	130922	Miltjadh	Kristofor	Marjani	Pleqëri	16,442	F60101161G	100%

Burimi: të dhëna nga DIP në ISSH.

Nga auditimi i dosjeve të debitorëve, grupi i auditimit ka konstatuar se:

Në dosjen nr. P0000222, e cila i përket përfituesit Meliha Rasim Tofciu, ka rezultuar debitor në vlerën 41,468 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën 10.07.2022-31.08.2022) pasi përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv duke përfitur pension edhe pse ishte i punësuar në administratë publike, ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Nga verifikimi i kryer, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore është saktë.

-Në dosjen nr. 130922, e cila i përket përfituesit Miltjadh Kristofor Marjani, nga DIP ka rezultuar debitor në vlerën 16,442 lekë, (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike deri me 20.05.2021) inspektuar nga specialisti Emiljano Shametaj si dhe Albert Kaculi. Nga verifikimet e kryera, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore nuk është 16,442 lekë por 26,017 lekë, me një diferencë në masën debitore prej 9,575 lekë. Nga grupi i auditimit u konstatua se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv i punësuar në administratë publike, ç'ka do të thotë se ka qenë në kundërshtim me pikat 2 dhe 3 të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Për këtë, inspektori përfitimeve Eliana Beqiri, nuk ka kryer verifikimet e duhura në sistemet përkatëse, duke krijuar një dëm ekonomik prej 9,575 lekë në buxhetin e shtetit.

-Në dosjen nr. 147796, e cila i përket përfituesit Flamur Etem Rakipi, ka rezultuar debitor në vlerën 269,397 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike deri me Maj-Shtator 2020) inspektuar nga specialisti Anisa Muceku. Nga verifikimet e kryera, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore nuk është e saktë 269,397 lekë, por kemi një diferencë të mbajtur tepër në vlerën 69,630 lekë e cila është mbajtur në mënyrë të padrejtë. Nga grupi i auditimit u konstatua se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv i punësuar në administratë publike, ç'ka do të thotë se ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, duke përfitur padrejtësisht vlerën 199,767 lekë e cila është mbajtur nga ISSH. Kjo dosje është certifikuar 11.10.2023. Për këtë, inspektorja e përfitimeve Ina Alushi, nuk ka kryer verifikimet e duhura në sistemet përkatëse, ky veprim ka krijuar një dëm të padrejtë ndaj përfituesit në vlerën 69,630 lekë.

-Në dosjen nr. 151612, e cila i përket përfituesit Eleni Mihal Xharja, ka rezultuar debitor në vlerën 104,231 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike deri me Maj-Dhjetor 2020) inspektuar nga specialisti Anisa Muceku. Nga verifikimet e kryera, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore nuk është e saktë 104,231 lekë, por kemi një diferencë të përlllogaritur në vlerën 22,432 lekë e cila është përfituar si shtesë kreditore dhe pension pleqërie Maj-Dhjetor 2020 në mënyrë të padrejtë. Nga grupi i auditimit u konstatua se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv, i punësuar në administratë publike, ç'ka do të thotë se ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Për këtë, inspektorja e përfitimeve Karolina Arra, nuk ka kryer verifikimet e duhura në sistemet përkatëse ky veprim ka krijuar një dëm ekonomik prej 22,432 lekë në buxhetin e shtetit.

-Në dosjen nr. 151010, e cila i përket përfituesit Zejxhana Haxhi Nushi, ka rezultuar debitor në vlerën 122,443 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën shtator 2022, nëntor 2022, qershor 2023 dhe korrik 2023) pasi përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv, i punësuar në administratë publike, ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Nga verifikimi i kryer, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore është saktë.

-Në dosjen nr. 157620, e cila i përket përfituesit Mustafa Orhan Malo, ka rezultuar debitor në vlerën 100,551 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën 07.02.2020-12.05.2020)) inspektuar nga specialisti Guri Mersinllari certifikuar me datë 22.12.2023. Nga verifikimet e kryera, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore nuk është e saktë 100,551 lekë, por kemi një përlllogaritje të gabuar pasi vlera totale përfituar si shtesë kreditore dhe pension pleqërie, në mënyrë të padrejtë nga përfituesi është 123,155 lekë. Për këtë grupi auditimit kërkoi shpjegime për diferencat e konstatuara: *Subjekti sqaroi se masës së debisë i është zbritur diferenca kreditore e përfituar sipas nenin 33, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në shumë 22,604 lekë.* Nga grupi i auditimit u konstatua se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv, i punësuar në administratë publike, ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Gjithashtu nga verifikimi raportit të kontrollit të mbajtur në subjektin e inspektuar vërehet se shtesa kreditore nuk pasqyrohet në materialin e kontrollit, veprim i cili është në kundërshtim me Vendimin nr. 5, datë 25.07.2022, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e parimeve dhe rregullave bazë për funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit". Nga verifikimi i kryer, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore është saktë.

-Në dosjen nr. 159109, e cila i përket përfituesit Eshe Ramazan Musta, ka rezultuar debitor në vlerën 720,892 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën 01.08.2020-31.07.2022), inspektuar nga specialisti Xhemal Disha certifikuar me datë 23.11.2023. Nga verifikimet e kryera, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore nuk është e saktë 720,892 lekë, por kemi një përlllogaritje të gabuar pasi vlera totale e përfituar si shtesë kreditore dhe pension pleqërie, në mënyrë të padrejtë nga përfituesi është 795,080 lekë. Për këtë grupi auditimit kërkoi shpjegime për diferencat e konstatuara: *Subjekti sqaroi se masa debitore e llogaritur nga ana e Inspektoreve të përfitimeve të DRSSH Elbasan është 720,892 lekë, ku ka dalë debitore për periudhën 01.08.2020-31.07.2022, pasi ka qenë e punësuar në institucion publik, ndërkohë është trajtuar me pension pleqërie. Nga llogaritja e diferencave debitore rezulton që masa debitore duhet të jetë në shumën 792,080 lekë. Me ndryshimin e vjetërsisë në punë duke i marrë në përlllogaritje periudhën 01.08.2020-31.07.2022 që ka qenë e punësuar në Institucion Publik i janë llogaritur diferencat kreditore të nenit 33 për periudhën 01.08.2022-31.12.2023 që kanë rezultuar në shumën 64,188 lekë. Kjo shumë nuk i është dhënë po i është ndaluar duke ju zbritur shumës debitore (792,080 lekë – 64,188 lekë), duke ngelur masa e debisë 727,892 lekë. Rezulton që nga DRSSH Elbasan i*

është llogaritur më pakë masa debitore në shumën 7,000 lekë, pasi në masën e debisë nuk i është llogaritur shpërblimi i fundvitit 2020 prej 5,000 lekë dhe shpërblimi i fundvitit 2021 prej 5,000 lekë, që bëjnë gjithsej 10,000 lekë. Ndërkohë në muajin Korrik 2022 masa debitore i është llogaritur 36,337 lekë kur ajo ka qenë 33,337 lekë, pra i është llogaritur 3,000 lekë më shumë (36,337-33,337=3,000). Si përfundim në total i është llogaritur më pakë masa debitore për 7,000 lekë (727.892 lekë – 720,892 lekë. Nga grupi i auditimit u konstatua se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv, i punësuar në administratë publike, ç’ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Gjithashtu nga verifikimi raportit të kontrollit të mbajtur në subjektin e inspektuar vërehet se shtesa kreditore nuk pasqyrohet në materialin e kontrollit, veprim i cili është në kundërshtim me Vendimin nr. 5, datë 25.07.2022, për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e parimeve dhe rregullave bazë për funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit”. Për këtë, inspektorja e përfitimeve Alije Xibraku, nuk ka kryer verifikimet e duhura në sistemet përkatëse, ky veprim ka krijuar një dëm ekonomik prej 7,000 lekë në buxhetin e shtetit).

-Në dosjen nr. 97421, e cila i përket përfituesit Enver Medi Cani, ka rezultuar debitor në vlerën 214,300 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën Shtator 2020- Prill 2023), inspektuar nga specialisti Emiljano Shametaj certifikuar me datë 14.02.2024. Nga verifikimet e kryera, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore nuk është e saktë 214,300 lekë por kemi një përlllogaritje të gabuar pasi vlera totale e përfituar si shtesë kreditore dhe pension pleqërie, në mënyrë të padrejtë nga përfituesi është 219,300 lekë deri në momentin e certifikimit, pasi nga verifikimi në sistemin CMIS dhe sitemit PCAMS, përfituesi vijon në punë përsëri në Prill dhe Maj të vitit 2025. Nga grupi i auditimit u konstatua se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv duke përfituar pension edhe pse ishte i punësuar pranë Zyra Vendore Arsimore Tepelenë-Memalia, ç’ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Për këtë, inspektorja e përfitimeve Entela Buka, nuk ka kryer verifikimet e duhura në sistemet përkatëse deri në periudhën e certifikimit, ky veprim ka krijuar një dëm ekonomik prej 5,000 lekë në buxhetin e shtetit dhe vijon duke krijuar dëm ekonomik në vazhdimësi, pasi përfituesi ka përfituar pension pleqërie edhe për periudhat që është i punësuar Prill-Maj 2025 vlera e përfitimit 50,498 lekë.

-Në dosjen nr. 98735, e cila i përket përfituesit Ismail Feta Saliu, ka rezultuar debitor në vlerën 75,169 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën 10.07.2022-31.08.2022) pasi përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv, i punësuar në administratë publike, ç’ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Nga verifikimi i kryer, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore është saktë.

-Në dosjen nr. P0000995, e cila i përket përfituesit Servete Agim Myrte, ka rezultuar debitor në vlerën 50,615 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën 01.04.2022-05.07.2022) pasi përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv, i punësuar në administratë publike, ç’ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Nga verifikimi i kryer, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore është saktë.

-Në dosjen nr. 179785, e cila i përket përfituesit Pandi Koli Bello, ka rezultuar debitor në vlerën 28,645 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën Gusht-Shtator 2021), inspektuar nga specialisti Mateo Meco certifikuar me datë 12.08.2024. Nga verifikimet e kryera, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore nuk është e saktë 28,645 lekë por kemi një përlllogaritje të gabuar pasi vlera totale e përfituar si shtesë kreditore dhe pension pleqërie, në mënyrë të padrejtë nga përfituesi është 13,207 lekë ndryshe nga sa është konstatuar nga specialisti Mateo dhe Edmond Bode. Nga grupi i auditimit u konstatua se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv, i

punësuar në administratë publike, ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, pro përlllogaritja e masës debitor është e pasaktë. Për këtë, inspektori i përfitimeve Edmond Bode, nuk ka kryer verifikimet e duhura në sistemet përkatëse, ky veprim ka krijuar një dëm të padrejtë ndaj përfituesit në vlerën **15,438** lekë--Në dosjen nr. 90474 e cila i përket përfituesit Sejdi Hajdar Kastrati, ka rezultuar debitor në vlerën 35,959 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën 30.09.2021-31.10.2021), inspektuar nga specialisti Guri Mersinllari certifikuar me datë 29.10.2024. Nga verifikimet e kryera, grupi i auditimit klla konstatuar që vlera debitore nuk është e saktë 35,959 lekë por kemi një përlllogaritje të gabuar pasi vlera totale e përfituar si shtesë kreditore dhe pension pleqërie, në mënyrë të padrejtë nga përfituesi është 53,265 lekë e ndarë në 43,660 lekë pension pleqërie dhe 9,065 lekë, pension suplementar referuar ligjit nr. 10142, datë 15.09.2009, i ndryshuar. Për këtë grupi auditimit kërkoi shpjegime për diferencat e konstatuara. *Subjekti sqaroi se masës së debisë i është zbritur diferenca kreditore e përfituar sipas nenin 33 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në shumë 7,401 lekë.* Nga grupi i auditimit u konstatua se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv, i punësuar në administratë publike", ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Gjithashtu nga verifikimi raportit të kontrollit të mbajtur në subjektin e inspektuar vërehet se shtesa kreditore nuk pasqyrohet në materialin e kontrollit, veprim i cili është në kundërshtim me Vendimin nr. 5, datë 25.07.2022, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e parimeve dhe rregullave bazë për funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit". Për këtë, inspektorja e përfitimeve Matilda Demaj, nuk ka kryer verifikimet e duhura në sistemet përkatëse, ky veprim ka krijuar një dëm ekonomik prej **9,905** lekë në buxhetin e shtetit.

-Në dosjen nr. 90615 e cila i përket përfituesit Dashamir Ferit Palushi, ka rezultuar debitor në vlerën 67,912 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën 01.02.2022-06.03.2022). Nga verifikimi i kryer, grupi i auditimit ka konstatuar se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv duke përfituar pension pleqërie dhe ka përfituar pension suplementar në vlerën 16,606 lekë referuar ligjit nr. 10142, datë 15.09.2009, i ndryshuar, edhe pse ishte i punësuar pranë "Bashkia Kukës", ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Për këtë, inspektori i përfitimeve Llosh Dashi, nuk ka kryer verifikimet e duhura në sistemet përkatëse, ky veprim ka krijuar një dëm ekonomik prej **16,606** lekë në buxhetin e shtetit.

-Në dosjen nr. P0000983 e cila i përket përfituesit Ramis Isuf Mehmeti, ka rezultuar debitor në vlerën 24,030 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën 26.08.2022-30.09.2022), inspektuar nga specialisti Guri Mersinllari certifikuar me datë 27.12.2024. Nga verifikimet e kryera, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore nuk është e saktë 24,030 lekë, por kemi një përlllogaritje të gabuar pasi vlera totale e përfituar si shtesë kreditore dhe pension pleqërie, në mënyrë të padrejtë nga përfituesi është 31,830 lekë. Për këtë grupi auditimit kërkoi shpjegime për diferencat e konstatuara: *Subjekti sqaroi se masës së debisë i është zbritur diferenca kreditore e përfituar sipas nenin 33, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në shumë 7,800 lekë.* Nga grupi i auditimit u konstatua se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv, i punësuar në administratë publike", ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Gjithashtu nga verifikimi raportit të kontrollit të mbajtur në subjektin e inspektuar vërehet se shtesa kreditore nuk pasqyrohet në materialin e kontrollit, veprim i cili është në kundërshtim me Vendimin nr. 5, datë 25.07.2022, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e parimeve dhe rregullave bazë për funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit". Nga verifikimi i kryer, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera

debitore është saktë.

Në dosjen nr. P0001410 e cila i përket përfituesit Lizë Mark Simoni, ka rezultuar debitor në vlerën 28,708 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën 05.10.2022-31.10.2022). Nga kontrollit ka rezultuar se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv, i punësuar në administratë publike, ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Nga verifikimi i kryer, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore është saktë

-Në dosjen nr. 131539 e cila i përket përfituesit Bedrije Xhafiz Marjani, ka rezultuar debitor në vlerën 98,720 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën Korrik 2022-Korrik 2023). Nga kontrollit ka rezultuar se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv duke përfituar pension edhe pse ishte i punësuar në sektorin publik, ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Nga verifikimi i kryer, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore në momentin e certifikimit është saktë. Nga grupi i auditimit u konstatua se përfituesi pas certifikimit edhe pse është shpallur debitor për vlerën e përfituar padrejtësisht, ka vijuar të kryej të njëjtin veprim, duke u punësuar për periudhën Tetor 2024 (verifikuar në sistemin CMIS dhe PCAMS), gjithashtu edhe duke përfituar pension pleqërie për të njëjten periudhë në vlerën 47,557 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Për këtë, inspektorja e përfitimeve Anisa Nelaj, nuk ka kryer verifikimet e duhura në sistemet përkatëse, ky veprim ka krijuar një dëm ekonomik prej **47,557** lekë në buxhetin e shtetit.

-Në dosjen nr. 131989 e cila i përket përfituesit Misha Sotir Miho, ka rezultuar debitor në vlerën 172,046 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën 10.03.2021-31.12.2021). Nga kontrollit ka rezultuar se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv, i punësuar në administratë publike, ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Nga verifikimi i kryer, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore është përlllogaritur saktë.

-Në dosjen nr. 151159 e cila i përket përfituesit Durmish Maliq Tahiraj, ka rezultuar debitor në vlerën 55,553 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën nëntor 2021 dhjetor 2021). Nga kontrollit ka rezultuar se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv, i punësuar në administratë publike, ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Nga verifikimi i kryer, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore është përlllogaritur saktë.

-Në dosjen nr. 156525 e cila i përket përfituesit Vladimir Ruba Arapi, ka rezultuar debitor në vlerën 160,918 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën 08.05.2021-31.12.2021) inspektuar nga specialisti Guri Mersinllari certifikuar me datë 27.12.2024. Nga verifikimet e kryera, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore nuk është e saktë 160,918 lekë, por kemi një përlllogaritje të gabuar pasi vlera totale e përfituar si shtesë kreditore dhe pension pleqërie, në mënyrë të padrejtë nga përfituesi është 165,918 lekë. Nga grupi i auditimit u konstatua se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv duke përfituar pension edhe pse ishte i punësuar pranë "Porti Detar Vlorë", ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Për këtë, inspektorja e përfitimeve Sonila Dalipaj, nuk ka kryer verifikimet e duhura në sistemet përkatëse, ky veprim ka krijuar një dëm ekonomik prej **5,000** lekë në buxhetin e shtetit.

-Në dosjen nr. 154170 e cila i përket përfituesit Dhurata Ali Myrtaj, ka rezultuar debitor në vlerën 101,120 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht punonjës në administratë publike për periudhën 01.06.2022-30.09.2022), inspektuar nga specialisti Xhemal Disha certifikuar me

datë 21.05.2024. Nga kontrollit ka rezultuar se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe ka vazhduar aktiv duke përfituar pension edhe pse ishte i punësuar në sektorin publik, ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Nga verifikimi i kryer, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitore në momentin e certifikimit është saktë. Nga grupi i auditimit u konstatua se përfituesi pas certifikimit edhe pse është shpallur debitor për vlerën e përfituar padrejtësisht, ka vijuar të kryej të njëjtin veprim, duke u punësuar për periudhën 01.06.2024-30.09.2024 (verifikuar në sistemin CMIS dhe PCAMS), gjithashtu duke përfituar pension pleqërie për të njëjten periudhë në vlerën 116,408 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Për këtë, inspektorja e përfitimeve Zamira Islamaj, nuk ka kryer verifikimet e duhura në sistemet përkatëse, ky veprim ka krijuar një dëm ekonomik prej 116,408 lekë në buxhetin e shtetit.

Konkluzion:

-Nga auditimi i dosjeve të përgjdhura për auditim ka rezultuar se Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve (DIP) si dhe inspektorët e përfitimeve në DRSSH-të Rajonale nuk kanë përlllogaritur saktë vlerën debitore. Nga grupi i auditimit është konstatuar se përfituesit në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe kanë vazhduar aktiv duke përfituar pension edhe pse ishin të punësuar, ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, këto veprime kanë krijuar një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

Konkluzion:

-Nga auditimi i dosjeve të përgjdhura për auditim ka rezultuar se Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve (DIP) si dhe inspektorët e përfitimeve në DRSSH-të Rajonale nuk kanë përlllogaritur saktë vlerën debitore. Nga grupi i auditimit është konstatuar se përfituesit në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv dhe kanë vazhduar aktiv duke përfituar pension edhe pse ishin të punësuar, ç'ka do të thotë se përfituesi ka vepruar në kundërshtim me pikat 2, dhe 3, të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, këto veprime kanë krijuar një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

Sa më sipër, për veprimet dhe mos veprimet, mbajnë përgjegjësi specialistët e DIP dhe inspektorët e përfitimeve sipas rajoneve përkatëse:

Zamira Islamaj me detyrë inspektore e përfitimeve, Sonila Dalipaj me detyrë inspektore e përfitimeve, Guri Mersinllari me detyrë specialist në DIP, Anisa Nelaj me detyrë inspektore e përfitimeve, Arta Mehmetaj me detyrë inspektore e përfitimeve, Llosh Dashi me detyrë inspektore e përfitimeve, Matilda Demaj me detyrë inspektore e përfitimeve, Edmond Bode, Mateo Meço me detyrë specialist në DIP, Emiljano Shametaj me detyrë specialist në DIP, Entela Buka, Xhemal Disha me detyrë specialist në DIP, Alije Xibraku, Elvina Gugu, Karolina Arra, Ina Alushi, Anisa Muceku me detyrë specialist në DIP, Eliana Beqiri, Albert Kaculi me detyrë specialist në DIP.

Grupi i auditimit ka shqyrtuar për vlerësim 8 dosje të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme nga gjithsej 25 programe inspektimi të përfunduara gjatë vitit 2024, që përbëjnë 32% të totalit. Nga këto, 4 praktika janë realizuar nga Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata (nga 8 gjithsej), dhe 4 të tjera nga Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare (nga 5 gjithsej).

Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve (DIP) ka funksionuar në bazë të vendimit nr. 5, datë 05.07.2022, me të cilin është miratuar Rregullorja "Për përcaktimin e parimeve dhe rregullave bazë për funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve". Në kreun VIII të kësaj rregulloreje përcaktohet dokumentacioni që duhet të administrohet në dosjen e inspektimit për secilin subjekt të inspektuar dhe që më pas arkivohet. Nga auditimi i kryer, rezulton se të gjitha dosjet janë të pajisura me dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve të rregullores në fuqi.

Një nga elementët kyç të programeve të inspektimit të realizuara nga DIP mbetet edhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të përfshira në raportet përfundimtare të inspektimeve të mëparshme. Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve (DIP), janë kontrolluar gjithsej 692 dosje përfitimi, të cilat ishin subjekt i rekomandimeve të mëparshme. Nga këto, 683 dosje (ose 98.7%) janë certifikuar si të realizuara pas zbatimit të rekomandimeve, ndërsa

9 dosje (ose 1.3%) kanë mbetur të perealizuara. Nga 683 dosjet e certifikuara, në të cilat rekomandimet janë zbatuar, 458 prej tyre (ose 45%) kanë rezultuar me efekte financiare, si debitoare ashtu edhe kreditore, si rezultat i rishqyrtimit, kanë rezultuar me efekte financiare debitoare dhe kreditore si më poshtë:

- 257 dosje (67%) përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar debitor në shumën 14,251 mijë lekë.
- 201 dosje (29.4%) përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar kreditor në shumën 6,736 mijë lekë.

Ndërkohë, nga zbatimi i rekomandimit për 225 dosje (55%) përfitime (plotësim me dokumentacion) ka rezultuar pa efekt financiar.

Rezultatet e kontrollit të zbatimit të rekomandimeve, në DRSSH-të sipas programeve respektive po i paraqesim në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 12: Rezultatet e kontrollit të zbatimit të rekomandimeve:

000 mijë lekë

Kontrolli Detyrave	DRSSH Elbasan	DRSSH Durrës	DRSSH Gjirokastrë	DRSSH Vlorë	Dssh Sarandë	DRSSH Dibër	DRSSH Kukës	Dssh Tropojë	DRSSH Shkodër	Totali
Dosje gjithsej	130	98	143	182	74	89	3	1	26	746
Paraqitur	124	94	137	178	73	57	3	1	25	692
Pa realizuar	0	1	1	3	2	2	0	0	0	9
Nr. Dosje	14	17	91	69	37	21	1	0	7	257
Debitore leke	1,052	619	3,887	1,726	771	5,499	332	0	367	14,252
Nr. Dosje	26	29	25	73	19	11	1	1	16	201
Kreditore/ leke	886	1,612	715	1,370	291	610	17	49	1,186	6,736

Burimi: DIP në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Sa më sipër, grupi i auditimit ka konstatuar se DRSSH/DSSH-të nuk kanë zbatuar afatet e përcaktuara sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, neni 62, pika 2, ku ndër të tjera citohet se: "E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20% e kështit mujor të pensionit". Nga tabela e mësipërme rezultojnë se të paktën 462 dosje përfitimi janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara. Nga verifikimet e mëtejshme, grupi i auditimit konstatoi se dhe nga rishqyrtimet e dosjeve të përfitimeve për të cilat ishin zbatuar rekomandimet e lëna, rezultuan të ishin në tejkalim të afatit 6 mujor.

Auditimi i zbatimit të afateve në procedurat e inspektimit, bazuar në rregulloren e funksionimit të Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve:

Sipas përcaktimeve të kreut VI të rregulloreve përcaktohet qartë se:

- pas përfundimit të inspektimit përgatitet projekt raporti jo më vonë se 45 ditë;
- kopja e konfirmuar e projektit dërgohet në ISSH brenda 15 ditëve nga subjekti inspektuar;
- zhvillohet takimi ballafaques brenda 15 ditëve nga konfirmimi i projektit;
- pas takimit brenda afatit 14 ditor dërgohet raporti përfundimtar në subjekt;

Tabela nr. 13: Të dhëna mbi programet dhe afatet:

Dosjet e auditimit sipas subjekteve	Programi nr/datë	Afati i Inspektimit	Projekt raporti nr/datë	Kthimi i observacioneve pas PRA	Takimi ballafaques	Raportit Përfundimtar nr/datë	Afati nga mbajtja e aktit në terren deri në dërgimin e Projektit	Afati nga takimi ballafaques në dërgimin e Rap.Përfundimtar
SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PËRFITIMEVE AFATGJATA								
DRSSH Dibër	Nr. 9197 Datë 04.09.2024	17.09.2024 - 15.10.2024	Nr. 9197/2 Datë 14.11.2024	Ska	ska	Nr. 9197/3 Datë 11.12.2024	29 dite kalendarike	Brenda afatit
DRSSH Kukës	Nr. 10484 Datë 15.10.2024	21.10.2024 - 30.10.2024	Nr. 10484/2 Datë 25.11.2024	Datë 20.12.2024	07.01.2025	Nr.10484/5 Datë 14.01.2025	25 dite kalendarike	Brenda afatit
DRSSH Shkodër	Nr. 11163 Datë 01.11.2024	04.11.2024 - 31.12.2024	Nr. 11163/2 Datë 27.01.2025	Datë 17.02.2025	27.02.2025	Nr 11163/4 Datë 18.03.2025	27 dite kalendarike	Brenda afatit
DRSSH Korçë	Nr. 7504 05.07.2024	10.07.2024 -	Nr. 7504/1 Datë 10.10.2024	Datë 10.10.2024	11.11.2024	Nr.7504/4 Datë	13 dite kalendarike	Brenda afatit

		13.09.2024	26.09.2024			15.11.2024		
SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PERFITIMEVE SUPLEMENTARE DHE TRAJTIMEVE TE VECANTA								
DRSSH Berat	Nr. 9196;	23.09.2024-22.10.2024	Nr. 9196/2	Datë	ska	Nr. 9196/4	23 ditë kalendarike	Breda afatit
	Datë 04.09.2024;		Datë 14.11.2024			Datë 11.12.2024		
DRSSH Dibër	Nr. 87	08.01.2024	Nr. 87/2	Ska	ska	Nr.87/4	36 ditë kalendarike	Brenda afatit
	Datë 04.01.2024	13.02.2024	Datë 21.03.2024			Datë 29.04.2024		
DRSSH Tiranë	Nr. 1711	19.02.2024 - 06.09.2024	Nr. 1711/2	Datë	04.12.2024	Nr.1711/5	60 ditë kalendarike	15 ditë pas afatit
	Datë 16.02.2024		Datë 06.11.2024			Datë 14.01.2025		
DRSSH Vlorë	Nr.11443	14.11.2024	Nr. 11443/1	Datë	ska	Nr. 11443/4	44 ditë kalendarike	Brenda afatit
	Datë 08.11.2024	13.12.2024	Datë 27.01.2025			Datë 28.02.2025		

Burimi: DIP në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Konstatim: sipas të dhënave në tabelën më sipër rezulton se afatet nga përfundimi i inspektimit në terren deri në mbajtjen e Raportit Paraprak dhe të Raportit Përfundimtar nuk janë janë të njëjta dhe variojnë deri në 60 ditë vonesë, ky veprim bie në kundërshtim me përcaktimet e Rregullores së miratuar të DIP në kreun VI të saj.

2.5. Mbi auditimin e hedhjes së kartelave të pensioneve dhe llogaritjes online të pensioneve në sistemin CMIS.

U audituan si më poshtë;

Të dhënat e marra nga Drejtora e përfitimve dhe kontributëve;

Shkresat e titullarit;

Rakordimet nëpërmes Drejtorinsë së Përfitimeve Drejtorisë së Sherbimeve dhe Informacionit IT.

Nga Drejtoria e përfitimieve janë marrë të dhënat mbi përfitimin e pensioneve për vitin 2024, krahasuar nme vitin 2023 .

Tabela nr. 1 përfitimeve sipas kategorive për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023.

	Pensione gjithsej		Pens/Pleqerie		%	Pens/ Invaliditë			Pens/Familjare		
	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2024		Viti 2023	Viti 2024	%	Viti 2023	Viti 2024	%
Berat	2196	2316	2047	2136	104	73	86	118	76	94	124
Dibër	1334	1379	1166	1194	102	91	99	109	77	86	112
Ës	3837	3762	3322	3264	98	238	276	116	277	222	80
Elbasan	3891	3733	3259	3099	95	443	442	100	189	192	102
Fier	5144	5037	4768	4666	98	194	177	91	182	194	107
Gjirokastrë	1657	1644	1521	1515	100	65	56	86	71	73	103
Korce	3787	3692	3342	3295	99	255	241	95	190	156	82
Kukës	730	682	573	552	96	104	84	81	53	46	87
Lezhë	1733	1736	1486	1502	101	133	125	94	114	109	96
Shkodër	3057	2841	2737	2540	93	154	146	95	166	155	93
Tiranë	9136	9903	7961	8701	109	578	552	96	597	650	109
Vlore	3768	3621	3484	3362	96	127	116	91	157	143	91
Totali	40270	40346	35666	35826	100	2455	2400	98	2149	2120	99

Burimi ISSH,

Nga tabela rezulton se numri i përfitueseve të pensioneve nga krahasimi i dy viteve, nuk kishte diferencë të mëdha në numër si dhe në %.

Nga auditimi i dokumentacionit si dhe verifikimi kartelave në sistem CMIS dhe PAMC, rezultoi se sistemet kishin diferencë në hedhjen e kartelave, midis sitemit CMIS dhe FMS.

Bazuar në informacionin e marrë nga DRSSH-të, në 31.12.2024 nga verifikimi i 3,487 dosjeve kanë rezultuar debitorë në sistem 1,627 dosje të cilat janë dërguar për vlerësim dhe janë në proces sakëtsimi. Tabela me rastet e debitorë konstatuara nga përplasja e sistemeve në datë 31.12.2024

DRSSH/DSSH	Total Gjithsej	Total Debitorenr
Berat	113	47
Diber	163	95
Durres	321	164
Elbasan	200	107
Fier	134	56
Gjirokaster	82	43
Korçe	160	84
Kukes	86	40
Lezhe	152	77
Shkoder	141	73
Tirane	1675	721
Vlore	165	74
Sarande	74	36
Tropoje	21	10
TOTALI	3487	1627

Burimi ISSH /Punuar Grupi I auditimit KLSH.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me qëllim saktësimin e debitorëve në sistem kishte realizuar ballafaqimin e bazës së të dhënave shtetërore, të kalkulimit dhe pagesës së përfitimeve (PCAMS) si dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore (CMIS) ku kishte kryer verifikime nga IT dhe Dega e financës mbi ndërveprimin e sistemeve informatike PCAMS dhe FMS dhe nga ky ballafaqim i dy sistemeve kishin rezultuar problematika të përfituesve të pensioneve, të cilat kanë ardhur si shkak;

-Debi që falen nga akte normative të ndryshme.

-Debi të ndryshme të cilat rishqyrtohen.

-Likuidime me vendime gjykatë.

-Debitorë të zhdukur të cilët nuk kanë ID (janë të falsifikuara), kjo ndodhur përpara periudhës së digjitalizimit të sistemit (kur certifikatat jepeshin me dorë) si dhe hedhja në mënyrë manuale e kartelave, debitorë të dy punësuar ose të nxjerrë nga rishqyrtimi i dosjeve nga ana e kontrollit të certifikimit, nga mungesa e pasqyrimin të saktë të dokumentacionit të vjetër në sistemin elektronik dhe nga ndërtimit i sistemeve në kohë të ndryshme dhe mungesës së një mekanizmi integruar automatik për transferimin e saktë të të dhënave.

-Nisur nga këto problematika, për adresimin dhe saktësimin e debitorëve me Urdhrin e Titullarit nr. 10878/1, datë 25.10.2024, janë ngritur grupe pune pranë DRSSH-ve, të cilat kanë nisur procesin e verifikimit manual dhe sistemit të rasteve të mosrakupordura, por ky proces është ende në vijim dhe nuk është përmbyllur në mënyrë të plotë, duke lënë hapësirë për pasaktësi në administrimin e debitorëve. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se sistemin e PAMCS dhe CMIS për të dhënat e hedhura nga përfituesit në rastet e debitorëve është akoma në proces dhe vazhdon sistemin sipas rasteve të konstatuara.

Nga analiza e të dhënave rezulton se janë identifikuar ende shumë raste që kërkojnë sistemin, për shkak të mospërputhjeve ndërmjet sistemit të institucionit dhe atij të Drejtorisë së Tatimeve. Këto mospërputhje po shkaktojnë:

- Vonesa në verifikimin e statusit të punësimit të përfituesve;
- Rrezik për dhënie të dyfishtë përfitimesh ose përfitime të padrejta;
- Ngarkesë shtesë për stafet rajonale, që aktualisht e bëjnë verifikimin manualisht.

Shkaku kryesor, i kësaj situate është mungesa e një mekanizmi të përbashkët për shkëmbimin automatik të të dhënave ndërmjet dy institucioneve.

Konkluzion; Nga auditimi i kryer mbi hedhjen e kartelave në sistemin PAMC dhe CMIS dhe krahasimi ndërmjet dy sistemeve informatike në përdorim, u konstatua se ekziston një numër i konsiderueshëm rastesh që kërkojnë sistemin, të cilat kanë ardhur si shkak të mospërputhjeve të krijuara nga hedhja manuale e të dhënave në sistem, si dhe nga mosidentifikimi në kohë të rasteve të dy punësimit pas certifikimit të pensioneve.

- Në zbatim të pikës 5.1. Në vijimësi të auditimit dhe hedhjes së kartelave në sistem CMIS, u

auditua me zgjedhje Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat, duke marrë parasysh një numër relativisht të lartë të përfitimit të pensioneve të pleqërisë. Në total numri i përfituesve gjithsej është 40,690, krahasuar me vitin 2023 është rritur me 924 përfitues. Peshën specifike më të lartë e zënë pensionet për pleqëri në masën 83% e më pas pensionet e invaliditetit në masën 6.4%, pensionet familjare zënë 3.9%, pensionet sociale zënë 0.15% dhe pensionet suplementare zënë 5.5 % të totalit të numrit të pensioneve.

- Nga 2,549 përfitime të lidhura gjithsej 11% ose 501 përfitime janë të ardhura/transferuara nga drejtori rajonale të tjera dhe 89% ose 4.082 janë përfitime të reja.
- Nga 1,625 përfitime të mbyllura gjithsej 8% ose 239 përfitime janë të transferuara në drejtori rajonale të tjera dhe 92% ose 2,771 përfitues janë mbyllur.
- Gjatë vitit 2023, kërkesat për lidhje pensionesh të cilat janë pranuar dhe refuzuar nga DRSSH Berat paraqiten sipas tabelës më poshtë;

mbi auditim e kartelave të pensioneve si dhe llogaritjes tyre deri në përfitim të pensionit, praktika sipas kategorive si më poshtë:

Tabela nr.2, Pensionet sipas llojit me ndryshimet gjatë vitit 2024;

Lloji i pensionit	Gjendja në fillim 01.01.2024	Lidhur gjatë vitit dhe transferuar	Mbyllur gjatë vitit dhe transferuar	Gjendja në 31.12.2024
Pension pleqërie	33,149	2,171	1,192	34,128
Pensione invaliditeti	2,694	100	176	2,618
Pensione Familjar	1,615	106	104	1,617
Pensione social	64	6	5	65
Pensione Suplementare	2,244	166	148	2,262
Totali	39,766	2,549	1,625	40,690

Burimi i të dhënave: DRSSH Berat përpunuar nga Grupi auditimit KLSH.

- Nga auditimi i kërkesave për lidhje pensionesh gjatë vitit 2024 grupi i auditimit mori me zgjedhje nga, DRSSH Berat sipas numrit të apalikimeve për përfitim pensionesh sipas kategorive u audituan në dosje fizike afatet e përlllogaritjes së përfitimit si dhe hedhjes në sistem CMIS dhe PCAMS sipas tabelës më poshtë;

DRSSH Berat.

Tabela nr.3. Pensionet e lidhura dhe të refuzuara gjatë vitit 2024

Lloji i pensionit	Kërkesa	Caktuar	Të Refuzuara
Pleqëri	2394	2136	258
Invalide	277	86	191
Familjare	108	94	14
Suplemtar	201	166	35
Total Pensione	2980	2482	498

Burimi i të dhënave: DRSSH Berat përpunuar nga Grupi auditimit KLSH

Nga platforma e Bashkëqeverisjes, janë trajtuar 15 raste ankesash, nga të cilat vetëm 2 raste kanë rezultuar me zgjidhje në favor të qytetarit dhe kanë qenë kryesisht nga mosnjohja e vjetësisë së punës, ndërsa rastet e tjera kanë rezultuar me problematika të ndryshme dokumentacionesh.

-Nga ana e grupit të auditimit u përzgjedhën për auditimi 41 dosjeve (fizike) pensionesh, të kategorive, pleqëri, invaliditet dhe familjar, rezultoi se 34 dosje janë caktuar brenda afatit ligjor pasqyruar si më poshtë :

Tabela nr.4. Dosjeve të audituara të cilat janë caktuar brenda afatit ligjore.

Nr.	Kategoria e Pensionit	Nr. Dosje	Data e Kërkesës për Caktim Pensioni	Nr. Vendimi	Data Vendimit për Caktim Pensioni	Afati lidhjes së pensionit	Komente
1	Pleqëri	188398	26/12/2023	2661	22/01/2024	27	Brenda afatit
2	Pleqëri	860000	04/01/2024	19	01/02/2024	28	Brenda afatit
3	Pleqëri	266000	21/02/2024	341	28/03/2024	36	Brenda afatit
4	Pleqëri	262780	21/02/2024	347	28/03/2024	36	Brenda afatit
5	Pleqëri	339300	08/03/2024	479	16/04/2024	39	Brenda afatit
6	Pleqëri	470800	04/04/2024	667	18/04/2024	14	Brenda afatit
7	Pleqëri	348000	11/03/2024	487	18/04/2024	38	Brenda afatit
8	Pleqëri	506080	11/04/2024	725	24/04/2024	13	Brenda afatit
9	Pleqëri	478640	06/04/2024	685	24/04/2024	18	Brenda afatit
10	Pleqëri	475520	05/04/2024	678	08/05/2024	33	Brenda afatit

11	Pleqëri	579760	25/04/2024	856	15/05/2024	20	Brenda afatit
12	Pleqëri	586020	26/04/2024	872	21/05/2024	25	Brenda afatit
13	Pleqëri	534040	17/04/2024	785	22/05/2024	5	Brenda afatit
14	Pleqëri	550100	20/04/2024	819	24/05/2024	34	Brenda afatit
15	Pleqëri	596660	29/04/2024	876	04/06/2024	36	Brenda afatit
16	Pleqëri	860440	21/06/2024	1311	10/07/2024	19	Brenda afatit
17	Pleqëri	950400	10/07/2024	1432	25/07/2024	15	Brenda afatit
18	Pleqëri	973840	16/07/2024	1474	08/08/2024	23	Brenda afatit
19	Pleqëri	924400	04/07/2024	1389	14/08/2024	41	Brenda afatit
20	Pleqëri	101058	25/07/2024	1530	19/08/2024	25	Brenda afatit
21	Pleqëri	106594	07/08/2024	1617	22/08/2024	15	Brenda afatit
22	Pleqëri	108056	11/08/2024	1639	04/09/2024	24	Brenda afatit
23	Pleqëri	126710	18/09/2024	1956	14/10/2024	26	Brenda afatit
24	Pleqëri	137806	09/10/2024	2149	23/10/2024	14	Brenda afatit
25	Pleqëri	137832	09/10/2024	2146	23/10/2024	14	Brenda afatit
26	Pleqëri	137096	08/10/2024	2125	29/10/2024	21	Brenda afatit
27	Pleqëri	141466	15/10/2024	2192	13/11/2024	29	Brenda afatit
28	Pleqëri	187108	16/12/2024	2706	29/12/2024	13	Brenda afatit
29	Social	3849	23/11/2023	2460	18/01/2024	26	Brenda afatit
30	Social	385900	19/03/2024	564	22/04/2024	34	Brenda afatit
31	Social	527300	16/04/2024	775	14/05/2024	28	Brenda afatit
32	Social	750900	29/05/2024	1122	04/06/2024	6	Brenda afatit
33	Social	147644	28/10/2024	2297	07/11/2024	10	Brenda afatit
34	Social	169686	29/11/2024	2564	23/12/2024	24	Brenda afatit

- Nga auditimi i afateve nga paraqitja e kërkesës nga përfituesi deri në caktimin e pensionit, rezultuan me parregullsi 7 dosje përfitimi, në kundërshtim me përcaktimet në Rregulloren Nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, në mosrespektim me kapitullin XI “Afatet për çdo hallkë të procesit të caktimit të pensionit”, të rregullores, paraqitur në tabelën si më poshtë:
Tabela nr.5, rastet e tejkalimit të afatit të caktimit të pensionit;

Nr.	Kategoria e Pensionit	Nr. Dosjë	Nr.Kërkese	Data e kërkeses për caktim pensioni	Nr. Vendimi	Data e vendimit për caktim pensioni	Afati i lidhjes së pensionit	Komente	Specialisti
1	Familjare	F0000136	7499600000	14.11.2023	2385	12.01.2024	59 ditë	jashtë afatit	Drinalda Dosti
2	Invaliditet	I0000149	6741800000	19.12.2023	2622	09.02.2024	52 ditë	jashtë afatit	Sharlota Ismailaj
3	Invaliditet	I0000229	4001200000	23.10.2024	2256	17.12.2024	55 ditë	jashtë afatit	Blerita Lame
4	Invaliditet	I0000225	3921800000	17.10.2024	2213	04.12.2024	48 ditë	jashtë afatit	Blerita Lame
5	Pleqëri	P0003457	1687000000	16.11.2023	2408	03.01.2024	48 ditë	jashtë afatit	Enkeleda Rustaj
6	Pleqëri	P0003479	1716240000	22.11.2023	2442	08.01.2024	47 ditë	jashtë afatit	Drinalda Dosti
7	Pleqëri	P0003650	1839120000	16.12.2023	2504	01.02.2024	47 ditë	jashtë afatit	Sharlota Ismailaj

Burimi i të dhënave: CMIS dhe PCMAS, përpunuar nga Grupi KLSH

Na auditimi i kryer në sistemin CMIS dhe PCMAS, në lidhje me inspektimin e pensioneve të pleqërisë të caktuara, të cilët gjatë vitit 2024 janë shpallur debitor, rezultoi se: për 3 rast, me vlerë debitorë 113,832 lekë, të pa çertifikuar, nuk është respektuar masa e ndalesës me 50% të kështit të përfitimit, por janë ndaluar në masën 20% - 44%, veprim i cili është në kundërshtim me nenin 62, pika 2, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar, ku ndër të tjera citohet se: “*Personi, që ka përfutur pension ose të ardhura të tjera nga sigurimet shoqërore, me mënyra e mjete në kundërshtim me ligjin, detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër, të cilën e shlyen duke iu mbajtur çdo muaj 50 për qind e kështit mujor të përfitimit*”. Të detajuara rastet janë si më poshtë:

Tabela nr. 6: Tabela me ndalesën më pak se 50% të kështit mujor të përfitimit;

DRSSH Berat							
Nr. Rend.	Nr. Dosje	Përfutues			Lloji i Pensionit	Debia (Lekë)	
		Emër	Atësi	Mbiemër			
1	PPP000048	Enver	Halim	Qajalliu	Pleqëri	49,562	
2	104939	Kleo	Xhevair	Velaj	Familjar	48,825	
3	103286	Amelio	Izet	Buzo	Familjar	15,445	
Totali						113,832	

Burimi i të dhënave: CMIS dhe PCMAS, përpunuar nga Grupi KLSH-së.

Nga verifikimet e kryera në sistemin CMIS dhe PCMAS të 41 dosjeve të audituara, në lidhje me të drejtën e përfitimit për pension si dhe shtesë pensioni pleqërie, është konstatuar 1 rast përfitimi të padrejtë, pasi përfutuesit për pension suplementar referuar ligjit 29/2019 ka rezultuar njëkohësisht edhe i punësuar: në 1 rast në vlerën 15,996 lekë, të ndara sipas kategorive, të pa certifikuar nga DIP, veprime në kundërshtim me pikën 2 dhe 3, të nenit 57, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar ku citohet: “*Tërheqja e kësteve të përfitimit 2. Përfutuesi nuk ka të drejtë për këste*

përfitimi për çfarëdo periudhe, kur merr pagë ose të ardhura nga veprimtaria ekonomike si i punësuar ose i vetëpunësuar; 3. Pagesat e të ardhurave ndalohen për çdo kohë që përfituesi është punësuar ose ka qenë ekonomikisht aktiv”.

Tabela nr.7. Rastet e konstatuara pa të drejtë përfitimi për pension suplementar referuar ligjit 29/2019, të pa certifikuar nga DIP.

Nr	Numër Dosje	Lloji i pensionit	NID	Emër	Atësi	Mbiemër	Vlera (Lekë)	Debi	Specialisti i përfitimeve
1	P0005413	Pleqeri	F90328177M	Aleksander	Trifon	Ziu	15,996		Lindita Bajraktari

Burimi i të dhënave: CMIS dhe PCMAS, përpunuar nga Grupi KLSH-së.

Në vijim të paraqitura dosja e konstatuara me parregullsi:

Në dosjen me nr.P0005413 e cila i përket përfituesit Aleksander Trifon Ziu, me vendimin e KMCAP nr. 2192, i ka lindur e drejta e përfitimit dhe data e fillimit të pensionit që prej 07.09.2024, si dhe ka përfituar pension suplementar referuar ligjit 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”. Nga verifikimet e kryera në sistemin CMIS, grupi i auditimit ka konstatuar se nga data e përfitimit dhe në vazhdim, përfituesi ka qenë ekonomikisht aktiv. Sa më sipër, rezulton se përfituesi është paguar me pension suplementar ndërkohë që ka qenë edhe i punësuar, ky veprim bie në kundërshtim me pikën 2 dhe 3, të nenit 57, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Nga përlogaritja e grupit të auditimit (KLSH) përfituesi, rezultonë të jetë debitor në vlerën 15,996 lekë. Sa më sipër mbajnë përgjegjësi, inspektorët e DRSSH BERAT, Lindita Bajraktari me detyre specialiste për përpunimin e përfitimeve, Enkeleda Rustaj me detyre specialiste për përpunimin e përfitimeve, Drinalda Dosti me detyre specialiste për përpunimin e përfitimeve, Sharlota Ismailaj me detyre specialiste për përpunimin e përfitimeve, Blerta Lame me detyre specialiste për përpunimin e përfitimeve.

2.6. Auditimi mbi strukturat organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës, dhe shpenzimet për paga në institucion.

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 17.01.2024, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, është përcaktuar se veprimtaria e Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) kalon nën përgjegjësinë e kësaj ministrie.

Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullon dhe përcakton mënyrën e drejtimit dhe të administrimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Sipas këtij Ligji, sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë drejtohen dhe administrohen nga ISSH, i cili është institucion publik i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me këtë Ligj. ISSH drejtohet nga:

- Këshilli Administrativ;
- Drejtori i Përgjithshëm.


Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore është organi më i lartë ekzekutiv. Ai përbëhet nga 12 anëtarë, nga të cilët:

- 6 anëtarë, përfaqësues të Qeverisë;
- 6 anëtarë, përfaqësues të Sindikatave dhe Punëdhënësve.

Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së zgjidhet nga Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve.

6/1. Funksionimi i Këshillit Administrativ të ISSH dhe veprimtaria e tij gjatë vitit 2024.

Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore është organi më i lartë ekzekutiv. Ai përbëhet nga 12 anëtarë, të paraqitur në skemën e mëposhtme:





Skema e strukturës së Këshillit Administrativ

Nga auditimi i dokumentacionit, është konstatuar se përbërja aktuale e Këshillit Administrativ të ISSH-së përfshin përfaqësuesit nga institucionet e mësipërme si më poshtë vijon:

Tabela nr.1 Anëtarët e Këshillit Administrativ

Nr.	Emër	Mbiemër	Pozicioni
1	Olta	Manjani	Zv. Ministër, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
2	Vasilika	Vjero	Zv. Ministër, Ministria e Financave
3	Elidjana	Çelaj	Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve
4	Spartak	Zekja	Drejtor i Përgjithshëm i FSDKSH
5	Elsonida	Rama	Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit
6	Elsa	Dhuli	Drejtor i Përgjithshëm, INSTAT
7	Luan	Bregasi	President, Biznes Albania
8	Naim	Hasa	Shoqata e Bizneseve të Ushqim-Pije
9	Latif	Miha	Shoqata e Ndërtuesve
10	Gezim	Kalaja	President, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë
11	Kol	Nikollaj	President, Konfederata e Sindikatave
12	Bilbil	Kasmi	President, Sindikata Autonome Ushqim, Tregtisë, Turizmit

Burimi: ISSH, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Mbi veprimtarinë e Këshillit Administrativ

a) Nga auditimi i aktivitetit të Këshilli Administrativ, u konstatua se janë zhvilluar 6 mbledhje gjithsej gjatë vitit 2024, në përputhje me nenin 15 dhe 16, të kreut V, të Statutit të ISSH-së, i miratuar me VKM nr. 161, datë 11.04.1994, “Për miratimin e statutit të ISSH”, i ndryshuar. Në këto mbledhje janë shqyrtuar çështje të përcaktuara në rendin e ditës bazuar në projektvendimet e paraqitura, si dhe të shoqëruara me relacionet përkatëse. Këshilli Administrativ ka miratuar gjithsej 15 vendime për vitin 2024.

Tabela nr. 2: Mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli Administrativ (viti 2024)

N r.	Data e Mbledhjeve	Nr. i anëtarëve në mbledhje	Procesverbalet mbajtur	Vendimet e Miratuara
1.	13.06.2024	10	13.06.2024 1 firmosur nga 9 anëtarë të KA-së	Vendim nr. 1 Për miratimin e projekt VKM “Për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar, për llogaritjen e pensioneve”. Vendim nr. 2 “Për miratimin e Komisionit të Kontrollit të Revizionit”. Vendim nr. 3 “Miratim të rendit të ditës, miratim të procesverbalit të datës 28.12.2023, miratim me të gjitha votat pro, të projektVKA e mësipërme.
2.	09.07.2024	10	09.07.2024 1 firmosur nga KA	Vendim nr. 4 “Për miratimin e Rezultatit Financiar të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023”. Vendim nr. 5 Për disa ndryshime në VKA nr. 2 datë 23.06.2023 “Për disa ndryshime në Rregulloren nr. 3/2 datë 26.02.2008 “Për personelin e ISSH-së” rritjen e pagave. caktimin e klasave, shkallëve të karrierës dhe koeficientet sipas klasave dhe shkallëve”. Vendim nr. 6 Miratim të rendit të ditës, miratim të procesverbalit të datës 13.06.2024, miratim me të gjitha votat pro, të projekt VKA të mësipërme.
3	30.07.2024	11	30.07.2024 1 firmosur nga KA	Vendim nr. 7 “Për miratimin e Projekt Ligjit Për njohjen e periudhave të punësimit në Institucionet shtetërore , në ish ndërmarrjet shtetërore, në ish ndërmarrjet bujqësore dhe në ish –kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”. Vendim nr. 8 “Miratim të rendit të ditës, miratim të procesverbalit të datës 30.07.2024, miratim me të gjitha votat pro, të projekt VKA të mësipërme.
4	12.09.2024	12	12.09.2024, i firmosur nga KA	Vendim nr. 9 “Për miratimin e projekt VKM “Për indeksimin e pensioneve”. Vendim nr. 10 “Miratim të rendit të ditës, miratim të procesverbalit të datës 30.07.2024, miratim me të gjitha votat pro, të projekt VKA të mësipërme”.
5	19.11.2024	12	19.11.2024, i firmosur nga KA	Vendim nr. 11 “Për miratimin e treguesve të Projekt Buxhetit të ISSH-së për vitet 2025-2027”.
6	30.12.2024	9	30.12.2024, i firmosur nga KA	Vendim nr. 12 “Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të ISSH-së”. Vendim nr. 13 “Për treguesit e buxhetit të ISSH-së për vitin 2025”. Vendim nr. 14 “Për miratimin e treguesve të Projekt Buxhetit të ISSH-së për vitet 2025- 2027”. Vendim nr. 15 “Miratim të rendit të ditës, miratim të procesverbalit të datës 19.11.2024, miratim me të gjitha votat pro, të projekt VKA të mësipërme”.

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela e mësipërme pasqyron mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli Administrativ gjatë vitit 2024, duke përfshirë datën e mbledhjeve, numrin e anëtarëve të pranishëm, procesverbalet dhe vendimet e miratuara.

1-Mbledhja e parë është zhvilluar më 13.06.2024, me pjesëmarrjen e 10 anëtarëve. Procesverbali është firmosur nga 9 anëtarë të Këshillit Administrativ. Janë miratuar tre vendime: Vendimi nr. 1 për miratimin e projekt-VKM-së për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar të vitit 2022; Vendimi nr. 2 për miratimin e Komisionit të Kontrollit të Revizionit; dhe Vendimi nr. 3 për miratimin e rendit të ditës dhe të procesverbalit të mbledhjes së mëparshme. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se njoftimi për mbledhjen e datës 13.06.2024 është bërë me shkresën nr. 6668 prot., datë 12.06.2024, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në nenin 17 të Statutit të ISSH-së. Në dosje administrohen Vendimi nr. 1 për miratimin e projekt-VKM-së për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar; Vendimi nr. 2 për miratimin e Komisionit të Kontrollit të Revizionit; dhe Vendimi nr. 3 për miratimin e rendit të ditës dhe të procesverbalit të mbledhjes së mëparshme”, procesverbali përkatës (pa nr. prot., datë 13.06.2024) dhe relacionet shpjeguese.

2-Mbledhja e dytë është zhvilluar më 09.07.2024, me po aq anëtarë të pranishëm, dhe procesverbali është firmosur nga Këshilli Administrativ. Janë miratuar tre vendime: Vendimi nr. 4 për miratimin e rezultatit financiar të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023; Vendimi nr. 5 për disa ndryshime në rregulloren për personelin e ISSH-së, përfshirë rritjen e pagave dhe përcaktimin e klasave e shkallëve të karrierës; dhe Vendimi nr. 6 për miratimin e rendit të ditës dhe procesverbalit të mbledhjes së datës 13.06.2024. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, njoftimi për mbledhjen e datës 09.07.2024 është bërë me shkresën nr. 7552 prot., datë 08.07.2024, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në nenin 17 të Statutit të ISSH-së. Në dosje administrohen Vendimi nr. 4 për miratimin e rezultatit financiar të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023; Vendimi nr. 5 për disa ndryshime në rregulloren për personelin e ISSH-së, përfshirë rritjen e pagave dhe përcaktimin e klasave e shkallëve të karrierës; dhe Vendimi nr. 6 për miratimin e rendit të ditës, procesverbali përkatës (pa nr. prot., datë 09.07.2024) dhe relacionet shpjeguese.

3-Mbledhja e tretë është zhvilluar më 30.07.2024, me pjesëmarrjen e 11 anëtarëve. Procesverbali është firmosur nga Këshilli Administrativ. U miratuan dy vendime: Vendimi nr. 7 për miratimin e projektligjit për njohjen e periudhave të punësimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore për efekt pensioni; dhe Vendimi nr. 8 për miratimin e rendit të ditës dhe procesverbalit të kësaj mbledhjeje. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, njoftimi për mbledhjen e datës 30.07.2024 është bërë me shkresën nr. 8222 prot., datë 26.07.2024, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në nenin 17 të Statutit të ISSH-së. Në dosje administrohen Vendimi nr. 7 për miratimin e projektligjit për njohjen e periudhave të punësimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore për efekt pensioni; dhe Vendimi nr. 8 për miratimin e rendit të ditës, procesverbali përkatës (pa nr. prot., datë 30.07.2024) dhe relacioni shpjegues.

4-Mbledhja e katërt është zhvilluar më 12.09.2024, me 12 anëtarë të pranishëm. Procesverbali është firmosur nga Këshilli Administrativ. U miratuan dy vendime: Vendimi nr. 9 për projekt-VKM-në për indeksimin e pensioneve; dhe Vendimi nr. 10 për miratimin e rendit të ditës dhe procesverbalit të datës 30.07.2024. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, njoftimi për mbledhjen e datës 12.09.2024 është bërë me shkresën nr. 9405 prot., datë 12.09.2024, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në Statutin e ISSH-së. Në dosje administrohen Vendimi nr. 9 për projekt-VKM-në për indeksimin e pensioneve; Vendimi nr. 10 për miratimin e rendit të ditës dhe procesverbalit të datës 30.07.2024, procesverbali përkatës (pa nr. prot., datë 12.09.2024) dhe relacioni shpjegues.

5-Mbledhja e pestë është zhvilluar më 19.11.2024, me pjesëmarrjen e 12 anëtarëve. U miratua vetëm një vendim, Vendimi nr. 11, që lidhet me miratimin e treguesve të projektbuxhetit të ISSH-së për vitet 2025-2027. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, njoftimi për mbledhjen e datës 19.11.2024 është bërë me shkresën nr. 11719 prot., datë 19.11.2024, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në Statutin e ISSH-së. Në dosje administrohen Vendimi nr. 11, që lidhet me miratimin e treguesve të projektbuxhetit të ISSH-së për vitet 2025-2027, procesverbali përkatës (pa nr.

prot., datë 19.11.2024) dhe relacioni shpjegues. Nga auditimi i dokumentacionit të mbledhjes së KA, datë 19.11.2024, u konstatua se mungonte vendimi për miratimin e rendit të ditës, të procesverbalit të mbledhjes së datës 19.11.2024 si dhe të vendimeve përkatëse (projekt-VKA).

Në të gjitha mbledhjet e tjera të Këshillit Administrativ, është ndjekur një praktikë e konsoliduar, ku miratimi i rendit të ditës dhe i procesverbalit është bërë përmes një vendimi të veçantë të Këshillit, i cili është përfshirë në dokumentacionin zyrtar dhe është i protokolluar. Kjo praktikë garanton formalitetin, transparencën dhe vlefshmërinë e procesit vendimmarrës.

Në rastin e mbledhjes së datës 19.11.2024, ky vendim i miratimit nuk figuron në dokumentacion, duke krijuar një mospërputhje me standardin e ndjekur në mbledhjet e tjera dhe me kërkesat e mirëadministrimit institucional.

6-Mbledhja e gjashtë është zhvilluar më 30.12.2024, me pjesëmarrjen e 9 anëtarëve. Procesverbali është firmosur nga Këshilli Administrativ. U miratuan katër vendime: Vendimi nr. 12 për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të ISSH-së; Vendimi nr. 13 për treguesit e buxhetit të ISSH-së për vitin 2025; Vendimi nr. 14 për miratimin e treguesve të projektbuxhetit për vitet 2025-2027; dhe Vendimi nr. 15 për miratimin e rendit të ditës dhe procesverbalit të mbledhjes së datës 19.11.2024. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, njoftimi për mbledhjen e datës 30.12.2024 është bërë me shkresën nr. 12991 prot., datë 27.12.2024, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në Statutin e ISSH-së.

Në dosje administrohen Vendimi nr. 12 për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të ISSH-së; Vendimi nr. 13 për treguesit e buxhetit të ISSH-së për vitin 2025; Vendimi nr. 14 për miratimin e treguesve të projektbuxhetit për vitet 2025-2027; dhe Vendimi nr. 15 për miratimin e rendit të ditës dhe procesverbalit të mbledhjes së datës 19.11.2024 si dhe të vendimeve përkatëse (projekt-VKA), procesverbali përkatës (pa nr. prot., datë 30.12.2024) dhe relacionet shpjeguese.

Si konkluzion:

Nga auditimi i dokumentacionit të mbledhjeve të Këshillit Administrativ të ISSH-së për vitin 2024, u konstatua se njoftimet për të gjitha mbledhjet janë bërë në kundërshtim me afatin e përcaktuar në Statutin e ISSH-së. Në të gjashta rastet, njoftimi është lëshuar një ditë deri në tre ditë para datës së mbledhjes, përkatësisht me shkresat përkatëse nr. 6668 prot., 7552 prot., 8222 prot., 9405 prot., 11719 prot., dhe 12991 prot. Gjithashtu, asnjë nga njoftimet nuk është firmosur nga Kryetarja e Këshillit Administrativ, znj. Olta Manjani. Në mbledhjen e datës 19.11.2024, nuk është miratuar rendi i ditës dhe procesverbali, në kundërshtim me praktikën e ndjekur në mbledhjet e tjera.

Sipas nenit 17 të Statutit të ISSH-së, miratuar me VKM nr. 161, datë 11.04.2006, i ndryshuar, “Mbledhja e Këshillit Administrativ njoftohet me shkrim, të paktën 10 ditë përpara, duke bërë të ditur rendin e ditës.” Gjithashtu, njoftimi duhet të firmoset nga Kryetari i Këshillit Administrativ. Mosrespektimi i afatit dhe mungesa e firmës së Kryetares në njoftimet për mbledhje përbëjnë shkelje të kërkesave statutores dhe cenojnë ligshmërinë dhe transparencën e procesit vendimmarrës të organit drejtues. Kjo situatë mund të ndikojë negativisht në përgatitjen e anëtarëve për shqyrtimin e rendit të ditës dhe në vlefshmërinë procedurale të vendimeve të marra. Për më tepër, mungesa e miratimit me vendim të rendit të ditës dhe procesverbalit në mbledhjen e datës 19.11.2024, çënon dokumentimin e plotë dhe zyrtar të procesit vendimmarrës të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se deri në mbledhjen e datës 12.09.2024, përbërja e anëtarëve ka qenë e pandryshuar. Në mbledhjet pasuese janë evidentuar ndryshime në përbërjen e anëtarëve. Konkretisht, në mbledhjen e datës 19.11.2024, znj. Elidjana Çelaj është zëvendësuar nga z. Ilir Binaj, i cili në muajin tetor 2024 është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve. Ndërkohë, në mbledhjen e datës 30.12.2024 nuk ka pasur përfaqësues nga Ministria e Financave, pas largimit të znj. Vjero. Në lidhje me këtë mungesë, më datë 10.12.2024 është dërguar një shkresë zyrtare Ministrisë të Financave për të përcaktuar përfaqësuesin përkatës nga kjo ministri.

b) Mbi miratimin e VKA-së nr. 4, datë 09.07.2024

Me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 4, datë 09.07.2024 "*Për miratimin e rezultatit financiar të sigurimeve shoqërore për vitin 2023*", Këshilli Administrativ ka miratuar:

1. Rezultatit financiar pozitiv të ISSH-së për vitin 2023 prej 1,107,162,054.67 Lekë;
2. Të ardhurat, shpenzimet e vitit 2023;
3. Miratimin e normativës së Fondit Rezervë në fund të vitit 2023 në shumën 14,059,078,373,43 Lekë;
4. Miratimin e plotësimit të normativës së Fondit Rezervë nga rezultati financiar i vitit 2023 në shumën prej 757, 214,912.34 Lekë. Fondi rezervë sipas bilancit të vitit 2022 është 13,301,863,461 lekë, normativa e llogaritur batuar në shpenzimet e vitit 2023 është në shumën prej 14,059,078,373.43 Lekë. Pas miratimit të rezultatit financiar, Fondi Rezervë evidentohet në shumën 14,059,078,373.43 Lekë;
5. Të miratojë kalimin e pjesës së mbetur nga rezultati pozitiv i vitit 2023, në shumën 349,947,142.33 Lekë në llogaritë e rezultatit të mbartur.

Destinacioni përfundimtar i kësaj shume, të përcaktohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave.

Nga auditimi u konstatua:

1-Nga auditimi konstatohet se VKA-së nr. 4, datë 09.07.2024, nuk përmban **bazën ligjore**, ku mbështetet vendimmarrja në kundërshtim me kërkesat e nenit 99, pika (iv) të Ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative*", i cili parashikon qartë se çdo akt administrativ i shkruar duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën mbështetet vendimmarrja. Kjo e bën aktin formalisht të paplotë dhe, në aspektin e sigurisë juridike, të kontestueshëm.

-Gjithashtu, mungesa e një relacioni teknik e ligjor që të shoqërojë këtë vendimmarrje, siç kërkohet nga "*Manuali për hartimin e legjislacionit*", Shtojca E, përbën shkelje të parimeve të transparencës dhe proporcionalitetit të përcaktuara në nenet 5 dhe 12 të "*Kodi i Procedurave Administrative*".

2-Nga auditimi konstatohet se VKA nr. 4, datë 09.07.2024, është miratuar jashtë afatit të parashikuar në nenin 4, pika 3 të Ligjit nr. 97/2023 "*Për buxhetin e vitit 2024*" (i ndryshuar), i cili citon se: "*Rezultati pozitiv në fund të vitit buxhetor derdhet në të ardhurat e buxhetit të shtetit të vitit pasardhës, pas miratimit të pasqyrave financiare, por jo më vonë se muaji prill 2024.*"

3- Nga auditimi konstatohet mospërputhje ndërmjet ligjit dhe statutit lidhur me Fondin Rezervë Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "*Për sigurimet shoqërore*", neni 70, përcakton që: "*Instituti i Sigurimeve Shoqërore krijon një fond rezervë që të mbulojë të paktën një muaj shpenzimet për pensione*". Ndërsa Statuti i ISSH-së (VKM nr. 161, datë 11.04.1994, i ndryshuar), neni 5, përcakton që: "*Fondi rezervë duhet të mbulojë të paktën 3 muaj shpenzime për pensione.*"

Kjo mospërputhje midis ligjit dhe statutit krijon paqartësi juridike. Meqenëse ligji ka fuqi më të lartë normative se statuti (sipas nenit 116 të Kushtetutës), dispozitat e statutit që bien ndesh me ligjin duhet të harmonizohen dhe përditësohen. Mungesa e këtij përditësimi çon në vendimmarrje të paqarta dhe potencialisht të gabuara.

4- Sipas Statutit të ISSH-së, miratuar me VKM nr. 161, datë 11.04.1994, i ndryshuar, ky institucion administron fondin e sigurimeve shoqërore në mënyrë të pavarur, duke synuar ruajtjen dhe rritjen e fondeve për përfitimet aktuale dhe të ardhshme. Një nga funksionet themelore të ISSH-së, sipas nenit 6 të Statutit, është investimi i fondit rezervë. Misioni dhe vizioni institucional nënvizojnë qëndrueshmërinë, menaxhimin efikas të kontributeve, rritjen e transparencës dhe përforsimin e besimit publik në skemën e sigurimeve shoqërore.

Nga auditimi i dokumentacionit të Vendimit të Këshillit Administrativ nr. 4, datë 09.07.2024, u konstatua se rezultati financiar pozitiv i vitit 2023, në vlerën 1,107,162,054.67 lekë është ndarë si vijon: 757,214,912.34 lekë për plotësimin e fondit rezervë dhe 349,947,142.33 lekë janë kaluar në llogaritë e rezultatit të mbartur, me destinacion për t'u përcaktuar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Ky veprim është kryer pa një bazë ligjore të qartë dhe në mospërputhje me misionin institucional të ISSH-së si një organ financiarisht i pavarur. Përdorimi i pjesshëm i rezultatit financiar jashtë skemës, dhe pa destinacion të përcaktuar për përfituesit e saj, përbën shmangie nga parimi i autonomisë financiare të skemës dhe objektivit të forcimit të fondit rezervë.

Situata e konstatuar sjell disa pasoja thelbësore për funksionimin e skemës së sigurimeve shoqërore. Së pari, ajo cenon parimin e vetëqëndrueshmërisë dhe karakterin e mbyllur të skemës, duke devijuar nga parimi se kontributet duhet të përdoren vetëm për qëllimet e skemës.

Së dyti, mungon transparenca dhe llogaridhënia në përdorimin e fondeve që rrjedhin nga kontributet, duke krijuar pasiguri mbi destinacionin e tyre përfundimtar.

Së treti, rritet rreziku për mungesë fondesh në të ardhmen për përmbushjen e detyrimeve të skemës, për shkak të moskthimit të rezultatit financiar pozitiv në fondin rezervë.

Së fundi, situata mund të ndikojë në zbehjen e besimit publik në menaxhimin e skemës së sigurimeve shoqërore si një mekanizëm i pavarur dhe i qëndrueshëm.

Në zbatim të nenit 52 të Kushtetutës, e drejta për sigurime shoqërore duhet të garantohet nga një sistem që ka në thelb pavarësinë financiare dhe ruajtjen e fondeve për përfituesit. Ndaj, kalimi i rezultateve pozitive financiare jashtë skemës, për qëllime të papërcaktuara, përbën risk për të drejtën e kontribuesve dhe për funksionin social të sistemit të sigurimeve shoqërore.

c) Mbi miratimin e VKA-së nr. 9, datë 12.09.2024

Me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 9, datë 12.09.2024 "Për miratimin e Projekt VKM-së "Për Indeksimin e Pensioneve", Këshilli Administrativ ka miratuar:

1. Miratimin dhe dërgimin për shqyrtim në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të Projekt VKM –së "Për Indeksimin e Pensioneve",
2. Për ndjekjen e procedurave administrative të dërgimit për shqyrtim në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të projekt VKM, ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i ISSH.

Sipas projektvendimit të paraqitur nga ISSH dhe të miratuar nga Këshilli i Ministrave për indeksimin e pensioneve për vitin 2024, parashikohet që nga ky ndryshim të përfitojnë gjithsej rreth 791,257 përfitues, të cilët përfshijnë:

- 721,705 përfitues nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore;
- 68,613 përfitues nga programe të veçanta të qeverisë.

Ky numër përfshin përfituesit aktualë dhe personat që parashikohet të hyjnë në skemë deri më 31 dhjetor 2024, të cilët do të përfitojnë pensionin në masën e indeksuar sipas përqindjes së përcaktuar në vendim.

Efkti financiar i zbatimit të vendimit

Kostoja totale për zbatimin e këtij vendimi është përllogaritur në shumën **1,693,000,000 lekë** (një miliard e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre milion lekë), e cila do të përballohet nga fondi për politikatat e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin vjetor të ISSH për vitin 2024. Kjo shumë shpërndahet si më poshtë:

- 1,657,000,000 lekë (një miliard e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë milion) për mbulimin e pagesave të përfitimeve të indeksuara;
- 36,000,000 lekë (tridhjetë e gjashtë milion) për shpenzimet e nevojshme teknike dhe administrative për zbatimin e vendimit, përfshirë komisionet e shërbimit për pagesën e pensioneve, të realizuara përmes Postës Shqiptare sh.a. dhe bankave të nivelit të dytë.

Nga auditimi konstatohet se, në relacionin shpjegues të projektvendimit të paraqitur për shqyrtim, qëllimi i indeksimit të pensioneve është mbajtja e vlerës reale të përfitimeve nga pensioni dhe të përfitimeve të tjera sociale, në përputhje me ndryshimet në indeksin e çmimeve të konsumit për shportën e mallrave që konsumojnë pensionistët. Institucioni përgjegjës për përllogaritjen dhe deklarimin e këtij indeksi është INSTAT, i cili raporton ndryshimet në çmimet e mallrave dhe shërbimeve që përfshihen në strukturën e konsumit të pensionistëve.

Bazuar në të dhënat e përllogaritura dhe të dërguara nga INSTAT pranë ISSH, ndryshimet mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, si për shportën e plotë të mallrave, ashtu edhe për shportën specifike të pensionistëve, janë paraqitur si më poshtë:

Tabela nr 3: Ndryshimet mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit për shportën e pensionistëve dhe shportën e plotë (sipas INSTAT)

Periodha	ICK	ICK/Pensionistë
Mesatare vjetore Janar 2024 (Shkurt 2023-Janar 2024)	4.4	5.7

Mesatare vjetore Shkurt 2024 (Mars 2023-Shkurt 2024)	4.1	5.1
Mesatare vjetore Mars 2024 (Prill 2023-Mars 2024)	3.8	4.8
Mesatare vjetore Prill 2024 (Maj 2023-Prill 2024)	3.6	4.6
Mesatare vjetore Maj 2024 (Qershor 2023-Maj 2024)	3.4	4.4
Mesatare vjetore Qershor 2024 (Korrik 2023-Qershor 2024)	3.2	4.3
Mesatare vjetore Korrik 2024 (Qershor 2023-Korrik 2024)	3.0	4.2
Mesatare vjetore Gusht 2024 (Shtator 2023-Gusht 2024)	3.0	4.1

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Referuar nenit 61 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet se pensionet (sociale, të pleqërisë, të invaliditetit, familjare, si dhe përfitimet nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale) duhet të indeksohen çdo vit, me qëllim kompensimin e ndryshimeve në nivelin e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve që përcaktojnë minimumin jetik të pensionistëve. Në këtë proces, Këshilli i Ministrave ngarkohet të miratojë listën e mallrave të përzgjedhura, metodologjinë e përllogaritjes së indeksit dhe datën e zbatimit të tij.

Në zbatim të këtij parashikimi, është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 131, datë 22.02.2017, “Për përcaktimin e listës së mallrave të zgjedhura dhe metodën e llogaritjes së indeksit”. Sipas pikës 2 të këtij vendimi, indeksi i pensioneve dhe trajtimeve të tjera financiare duhet të kryhet mbi bazën e ndryshimit mesatar vjetor të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përcaktuara. Ndërsa pika 3 parashikonte se indeksi llogaritej nga Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe i njoftohej Institutit të Sigurimeve Shoqërore **deri më datë 10 shkurt të çdo viti.**

Kjo dispozitë është ndryshuar me VKM nr. 11, datë 11.01.2023, e cila përcakton që indeksi i ndryshimit të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përzgjedhura llogaritet çdo muaj nga INSTAT dhe i dërgohet ISSH **çdo datë 10 të muajit pasardhës.**

Nga auditimi i dokumentacionit për indeksimin e pensioneve për vitin 2024, rezultoi se si referencë për përllogaritjen e indeksit është marrë mesatarja vjetore e muajit gusht 2024 (Shtator 2023 – Gusht 2024), që sipas INSTAT ka rezultuar **4.1%** për shportën e mallrave të pensionistëve. Nga analiza krahasuese e të dhënave mujore të INSTAT për periudhën janar – gusht 2024, vlera mesatare aritmetike e indeksit për këtë periudhë rezultoi rreth **4.6%**, pra rreth 12% më e lartë sesa ajo që u përdor realisht për indeksim. Përzgjedhja e muajit gusht si muaj referencë ka ndikuar kështu në uljen e përqindjes së indeksimit për përfituesit.

Ndryshimi i metodologjisë nga përllogaritja vjetore (sipas VKM nr. 131/2017) në përllogaritje e cila dërgohet çdo muaj nga INSTAT, (sipas VKM nr. 11/2023) ka sjellë një efekt real në masën e përfitimeve. Për vitin 2024, niveli i indeksimit rezultoi më i ulët krahasuar me përqindjet më të larta të muajve të parë të vitit (5.7% në janar dhe 5.1% në shkurt). Si rrjedhojë, ky mekanizëm nuk garanton plotësisht ruajtjen e fuqisë blerëse të pensionistëve, nenin 65, pika 10, të ligjit nr. 9442, datë 16.11.2005 Për Ratifikimin e Konventës nr. 102 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Për sigurimet shoqërore (Standardet minimale) që përcakton se: *“Masat e pagesave aktuale periodike për efekt pleqërie, dëmtimit në punë (përveç rastit të paaftësisë për punë), invaliditetit dhe vdekjes së mbajtësit të familjes, do të rishikohen në bazë të ndryshimeve të konsiderueshme në nivelin e përgjithshëm të të ardhurave, kur këto rezultojnë nga ndryshimet e konsiderueshme të kostos së jetesës”.*

Nga shqyrtimi mbi miratimet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për indeksimin e pensioneve përgjatë periudhës 2019–2024, rezultoi se për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 aktet përkatëse janë miratuar në muajin mars të çdo viti, konkretisht:

Tabela nr 4: VKM- të (2019-2024)

VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR INDEKSIMIN E PENSIONEVE (2019-2024)	
Viti	
2019	VKM nr. 167, datë 27.03.2019 "Për Indeksimin e Pensioneve"
2020	VKM nr. 263, datë 30.03.2020 "Për Indeksimin e Pensioneve"
2021	VKM nr. 196 datë 31.03.2021 "Për Indeksimin e Pensioneve"
2022	VKM nr. 188, datë 30.03.2022 "Për Indeksimin e Pensioneve"
2023	VKM nr. 553, datë 28.09.2023 "Për Indeksimin e Pensioneve"

Ky ndryshim në kohën e miratimit lidhet me ndryshimet e bëra në VKM nr. 131/2017, të reflektuara me VKM-në nr. 11, datë 11.01.2023, ku u ndryshua metodologjia e përlllogaritjes së indeksit, duke kaluar nga një përlllogaritje vjetore (me referencë janarin e çdo viti), në një përlllogaritje mujore, me të dhënat që INSTAT raporton çdo datë 10 të muajit pasardhës.

Për pasojë, indeksi i përdorur për vitin 2024 është bazuar në mesataren vjetore të muajit gusht 2024, e cila për shportën e pensionistëve ka rezultuar **4.1%**, ndërkohë që në muajt e mëparshëm të të njëjtit vit (si janar, shkurt apo mars), indeksat për këtë shportë ishin më të larta, përkatësisht **5.7%, 5.1% dhe 4.8%**.

Nëse praktika e miratimit të VKM-së në muajin mars do të ishte ndjekur edhe për vitin 2024, me indeks të bazuar në të dhënat e muajit janar apo shkurt, atëherë përqindja e indeksimit do të kishte qenë më e lartë. Kjo do të kishte garantuar një rritje më të ndjeshme të përfitimeve, veçanërisht në një periudhë kur kostot e jetesës janë rritur ndjeshëm për shkak të inflacionit të lartë dhe krizave të çmimeve të ushqimeve dhe energjisë.

Si konkluzion, ky ndryshim në kohën e miratimit të VKM-së dhe në mënyrën e përlllogaritjes së indeksit ka reflektuar **një nivel më të ulët indeksimi për vitin 2024**, në raport me mundësitë që ofronin të dhënat më të hershme të INSTAT. Për rrjedhojë, kjo ka ndikuar në mospërputhjen mes ritmit të rritjes së çmimeve dhe masës reale të përfitimeve të indeksuara, veçanërisht për kategoritë në nevojë si përfituesit e pensionit social.

Organizimi i Përgjithshëm i ISSH

Sipas vendimit të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), drejtimi i institucionit i është deleguar Drejtorit të Përgjithshëm, i cili zgjidhet nga vetë Këshilli Administrativ. Me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 5, datë 20.07.2010, është autorizuar Drejtori i Përgjithshëm të ndërmarrë ndryshime në organizimin e brendshëm të Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Drejtorive Rajonale, brenda kufirit të numrit total të punonjësve të miratuar. Struktura organizative e përgjithshme e ISSH-së përbëhet nga:

- Drejtoria e Përgjithshme e ISSH-së;
- Drejtoria e Arkivës Qendrore të ISSH-së;
- 1 Drejtori Rajonale e Sigurimeve Shoqërore në Tiranë;
- 11 Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, të cilat përfshijnë në varësi të tyre Agjenci Lokale të Sigurimeve Shoqërore të kategorisë I dhe II, nga të cilat 34 agjenci klasifikohen në kategorinë I;
- 2 Degë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, konkretisht në Tropojë dhe Sarandë.

6/2. Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH

Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) është e ndarë në njësi funksionale që mbulojnë fushat kyçe të administrimit dhe shërbimeve institucionale. Sipas të dhënave të vëna në dispozicion, numri total i punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme është 150, të shpërndarë në pozicione drejtues dhe drejtoritë përkatëse të paraqitura në tabelën si më poshtë:

Tabela nr 5: Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH

Nr.	EMËRTIMI I POZICIONIT	NR.PUNONJËSVE
I	DREJTOR I PËRGJITHSHËM	1
I.1	Zv. Drejtor i Përgjithshëm	1
I.2	Zv. Drejtor i Përgjithshëm	1
I.3	Zv. Drejtor i Përgjithshëm	1
II	Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm	5
III	Drejtoria e Burimeve të Informacionit	11
IV	Drejtoria e Financës	17
V	Drejtoria e Kontributeve	11
VI	Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm	26
VII	Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun	11
VIII	Drejtoria e Përfitimeve	21
IX	Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve	20
X	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm	8
XI	Drejtoria Juridike	9

XII	Drejtoria e Integrimit dhe Zbatimit të Marrëdhënieve me Jashtë	7
	TOTAL	150

Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i Auditimit


Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) është ndërtuar mbi parimin e ndarjes funksionale dhe linjës hierarkike të përgjegjësi. Në krye të strukturës qëndron Këshilli Administrativ, i cili ushtron kompetencat vendimmarrëse për çështje strategjike dhe emëron Drejtorin e Përgjithshëm.

Nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm funksionojnë:

- Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm – mbështet në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtarinë dhe komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit;
- Tre Zëvendësdrejtorë të Përgjithshëm – mbulojnë fusha të ndryshme të menaxhimit dhe koordinimit.

Në mënyrë të detajuar struktura paraqitet në grafikun e mëposhtëm :

Grafiku nr. 1; Skema e strukturës organizative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (150)



Burimi: ISSH, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion mbi strukturën organizative të Drejtorisë Qendrore të ISSH, rezultoi se për vitin 2024 janë miratuar gjithsej 150 pozicione pune. Sipas të dhënave të muajit dhjetor 2024, numri real i punonjësve të angazhuar është 141, çka tregon për një diferencë prej pesë (9) pozicioneve të paplotësuara.

Tabela nr.6: Struktura organizative (plan/fakt)

Viti 2024	Plan	Fakt	Vakanca
Struktura e Institutit të Sigurimeve Shoqërore	150	141	9

Burimi: Të dhëna të ISSH-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Tabela e mëposhtme paraqet pozicionet vakante në strukturën organizative të ISSH-së për vitin 2024, ku evidentohen gjithsej 9 vende të lira pune të shpërndara në njësi dhe drejtorë të ndryshme funksionale. Pozicionet përfshijnë role si Asistent i Drejtorit të Përgjithshëm, Specialistë në fusha të ndryshme si buxheti, rrjeti, auditimi dhe përfitimet, si edhe një pozicion drejtues. Vendet e lira janë të klasifikuara sipas kategorive të pagës, bazuar në përvojën në vite, duke përfshirë nivele nga klasa II.2 deri në III.2.

Tabela nr.7: Pozicionet vakante (Viti 2024)

Pozicioni në strukturën e ISSH	Kategoria e pagës	Nr. vakant i punonjësve
Asistent i Drejtorit të Përgjithshëm/Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm	Klasa II.2. (eksperiencë 0-6 vite punë) Klasa II.3. (eksperiencë 06-12 vite punë) Klasa II.4. (eksperiencë mbi 12 vite punë)	1
Specialist /Sektori i Administrimit dhe Mirëmbajtjes së Rrjetit /Drejtoria Burimeve të Informacionit	Klasa II.2. (eksperiencë 0-6 vite punë) Klasa II.3. (eksperiencë 06-12 vite punë) Klasa II.4. (eksperiencë mbi 12 vite punë)	1
Specialist i buxhetit faktik/ Sektori i Buxhetit të Përgjithshëm, Thesarit, Statistikës dhe Aktuaristikës/ Drejtoria e Financës	Klasa II.2. (eksperiencë 0-6 vite punë) Klasa II.3. (eksperiencë 06-12 vite punë) Klasa II.4. (eksperiencë mbi 12 vite punë)	1
Drejtor Drejtorie/ Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun	Klasa III.2	1
Specialist Mjek/ Sektori i Ekzaminimeve Mjekësore/ Drejtoria e Përfitimëve	Klasa II.2. (eksperiencë 0-6 vite punë) Klasa II.3. (eksperiencë 06-12 vite punë) Klasa II.4. (eksperiencë mbi 12 vite punë)	1

Specialist/ Sektori i Inspektimit të Përfitimeve të Pleqërisë/ Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve	Klasa II.2. (eksperiencë 0-6 vite punë) Klasa II.3. (eksperiencë 06-12 vite punë) Klasa II.4. (eksperiencë mbi 12 vite punë)	1
Përgjegjës Sektori/ Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Invaliditetit Familjar dhe Sociale/ Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve	Klasa II.5	1
Specialist/ Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare dhe Trajtimeve të Vecanta/ Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve	Klasa II.2. (eksperiencë 0-6 vite punë) Klasa II.3. (eksperiencë 06-12 vite punë) Klasa II.4. (eksperiencë mbi 12 vite punë)	1
Specialist/Auditues/ Drejtoria e Auditimit të Brendshëm	Klasa II.2. (eksperiencë 0-6 vite punë) Klasa II.3. (eksperiencë 06-12 vite punë) Klasa II.4. (eksperiencë mbi 12 vite punë)	1
TOTALI		9

Burimi: Të dhëna të ISSH-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Tabelat e mëposhtme pasqyrojnë gjendjen e pozicioneve të planifikuara dhe atyre të zëna në strukturën e ISSH, përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme dhe Drejtoritë Rajonale për vitin 2024. Referuar të dhënave të administruara, rezulton se në muajin janar 2024 janë evidentuar gjithsej 80 vende vakante, të krijuara gjatë vitit si dhe të mbartura nga viti 2023. Nga shqyrtimi i praktikës administrative është konstatuar se jo të gjitha këto pozicione janë publikuar për procedura rekrutimi, me arsyetimin se një pjesë e tyre ishin subjekt i proceseve të ristrukturimit apo suprimimit të pozicioneve përkatëse.

Tabela nr. 8: Pozicionet vakant në ISSH, DR

Janar 2024

Viti 2024	Plan	Fakt	Vakanca
Struktura e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, DP	158	144	14
Drejtoritë Rajonale të ISSH (DR)			
DR Berat	56	50	6
DR Dibër	61	58	3
DR Durrës	81	80	1
DR Elbasan	117	109	8
DR Fier	109	104	5
DR Gjirokastrë	53	48	5
DR Korçë	102	96	6
DR Kukës	59	53	6
DR Lezhë	60	58	2
DR Shkodër	73	70	3
DR Tiranë	184	173	11
DR Vlorë	100	96	4
Drejtoria e Arkivit Qëndror	116	110	6
Total	1329	1249	80

Burimi: Të dhëna të ISSH-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr. 8/1: Pozicionet vakant në ISSH, DR

Dhjetor 2024

Viti 2024	Plan	Fakt	Vakanca
Struktura e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, DP	150	141	9
Drejtoritë Rajonale të ISSH (DR)			
DR Berat	51	49	2
DR Dibër	58	56	2
DR Durrës	77	77	0
DR Elbasan	109	107	2
DR Fier	102	97	5
DR Gjirokastrë	48	45	3
DR Korçë	93	90	3
DR Kukës	54	51	3
DR Lezhë	55	54	1
DR Shkodër	70	70	0
DR Tiranë	187	184	3
DR Vlorë	95	92	3
Drejtoria e Arkivit Qëndror	116	110	6
Total	1265	1223	42

Burimi: Të dhëna të ISSH-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Si konkluzion, nga auditimi konstatohet se në ISSH, nga **1265 pozicione** pune të planifikuara në total, në dhjetor të vitit 2024, rezultojnë **42 vende të lira**, të shpërndara në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në shumicën e drejtorive rajonale, me përjashtim të Durrësit dhe Shkodrës, ku nuk ka vakanca. Kjo situatë tregon për një mungesë të vazhdueshme të burimeve njerëzore në

nivel qendror dhe rajonal e cila mund të ndikojë në mirëfunksionimin e punës si dhe në uljen e performancës së përgjithshme institucionale.

Mbi Procedurën e Krijimit dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit.

-Nga dokumentacioni pjesë e dosjeve të personelit, konstatohet se, në të gjitha dosjet personelit (gjithsej 25 punonjës) **“fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit”**, nuk është në përputhje me lidhjen nr. 2 të VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për Rregullat e Hollësishme për Përmbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit”.

-Nga dokumentacioni pjesë e dosjeve të personelit, konstatohet se, për punonjësit: në 25 dosje mungojnë certifikata personale dhe certifikata e gjendjes familjare; në 5 dosje nuk është përfshirë vlerësimi i performancës për vitin 2024; në 4 raste mungon kontrata e punës në tërësi, dhe në një rast kontrata është e pa nënshkruar nga palët përkatëse; Në 1 dosje mungonte diploma universitare, në 1 tjetër diploma e shkollës së mesme (dokument ky i kërkuar si kriter për pozicionin e punës) dhe në 2 raste diploma e masterit nuk është e shoqëruar me vërtetimin përkatës të notave.

Si konkluzion, mangësitë si dhe keqadministrimi i dosjeve të personelit, duke mos kryer përmirësimin dhe përditësimin e të gjitha elementeve përbërëse të tyre, ndikon negativisht në raportimin, zhvillimin dhe menaxhimin e proceseve të burimeve njerëzore.

Veprime këto në mospërputhje me: VKM nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/3 “Për Rregullat e Hollësishme për Përmbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit” sipas të cilës: *“Njësia e burimeve njerëzore në çdo institucion përgjigjet për mbajtjen, plotësimin, sistemimin dhe administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar”*, pika II/1 sipas të cilës: *“Dosja e personelit është individuale dhe përmban të dhëna të karakterit të përgjithshëm, profesional, akademik, masa disiplinore, të dhëna për vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe të dhëna të tjera, sipas lidhjeve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij”* dhe Lidhja nr. 1 e VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 *“Në dosjen e të punësuarit duhet të përfshihen: 1. Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur....3. Dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit e që vërtetojnë pohimin e bërë në fletën prezantuese janë, si më poshtë vijon... b) certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare; c) dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicioni i punës etj..”*

Në lidhje me Kontratën e Punës

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të **25 kontratave individuale** të punës duke përfshirë kontratat me afat dhe pa afat, rezulton se nuk janë përfshirë të gjithë elementët e nevojshëm referuar përcaktimeve ligjore dhe janë të nënshkruara nga të dy palët, punëmarrësi dhe punëdhënësi.

Nga auditimi konstatohet se, kontratat individuale të punës të lidhura me punonjësit nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Punës dhe në aktet nënligjore përkatëse. Konkretisht, kontratat nuk përmbajnë të gjitha elementet e detyrueshme të përcaktuara në nenin 21, pika 3 të Kodit të Punës, si afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës, kohëzgjatja e pushimeve të paguara dhe përfshirja e qartë e të drejtave dhe detyrimeve të palëve. Këto përbëjnë mangësi të rëndësishme që çenojnë standardin ligjor të marrëdhënies së punës.

Veprime këto në mospërputhje me: Kodi i Punës, i përditësuar, Kreu IV, Neni 11, 1 (e), sipas të cilit: *“Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës rregullohen në mënyrë përparësie nga “Kontrata individuale e punës”, Kreu V, Neni 12, sipas të cilit: “Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënësi, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim” dhe Neni 21, (3), sipas të cilit : “Kontrata e punës e lidhur me shkrim duhet të përmbajë sidomos.. c. përshkrimin e përgjithshëm të punës; f. kohëzgjatjen e pushimeve të paguara; g. afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës”.*

Gjithashtu, u konstatua se nuk është përditësuar neni i kontratës “Koha normale e punës dhe pushimeve” në përputhje me VKM nr. 746, datë 4.12.2024 Për disa ndryshime në Vendimin nr.

568 datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në Institucionet e Administratës Shtetërore, Institucionet e Pavarura dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *Në pikën 2, togfjalëshi “... 4 (katër) javë kalendarike ...” zëvendësohet me “... 22 (njëzet e dy) ditë pune ...”.* 2. *Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon: “3. I punësuar ka të drejtë të kërkojë kryerjen e pushimit vjetor të paguar edhe në periudha të ndryshme e të ndara”.*

Mos përfshirja e këtyre elementëve, si dhe mos përditësimi i kontratës sipas ndryshimeve të legjislacionit nënligjor në fuqi, krijon paqartësi dhe pasiguri në marrëdhëniet e punës ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit. Kjo cenon sigurinë juridike të palëve, rrit rrezikun për kontestime apo konflikte ligjore, si dhe pengon zbatimin korrekt të të drejtave që burojnë nga legjislacioni i punës, siç janë pushimet e paguara, kohëzgjatja e punës dhe procedurat e zgjidhjes së kontratës.

Në lidhje me rekrutimin (punësimin) e punonjësve pranë ISSH-së.

Organizimi dhe funksionimi për të gjithë stafin e ISSH-së është rregulluar, ndër të tjera, edhe me rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e ISSH-së” e ndryshuar.

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion, rezulton se gjatë vitit 2024, në Drejtorinë Qendrore të ISSH-së janë emëruar 9 punonjës të rinj, ndërkohë që 5 punonjës kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me kërkesë personale (dorëheqje). Po ashtu, 9 punonjës kanë dalë në pension, 1 punonjës është liruar nga detyra dhe 17 punonjës të tjerë kanë ndryshuar pozicionin e punës brenda strukturës. Gjatë periudhës së auditimit është evidentuar se ka 1 rast largimi nga detyra me masë disiplinore. Përveç këtyre, janë realizuar gjithashtu 3 komandime dhe 1 transferim, të paraqitura si më poshtë vijon:

Tabela nr. 9: Pasqyra e lëvizjeve të stafit për vitin 2024

Emërimet, Largimet dhe lëvizjet e brendshme të stafit	Numër punonjësish
Emërimet	9
Ndërprerje të marrëdhënieve të punës (dorëheqje)	5
Dalje në pension	9
Ndryshim pozicion pune	17
Largim nga puna me masë disiplinore	1
Lirim nga detyra	1
Komandim	3
Transferim	1

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Procedura e rekrutimit kryhet duke u mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në rregulloren për “Për personelin e ISSH”, ku përshkruhet mënyra e punësimit në ISSH, dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqitet pranë institucionit, si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët.

Sa më sipër, nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e rekrutimeve në ISSH, për vitin 2024 janë kryer 9 procedura punësimi, nga të cilat ka rezultuar me emërimin 1 Drejtor i Drejtorisë Juridike, dhe 6 emërimet në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH, të pasqyruara në tabelë si më poshtë:

Tabela nr. 10: Emërimet ISSH (2024)

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Nr. Urdhrit	Data e emërimit
1	Monika Shehaj	Drejtor i Drejtorisë Juridike	636/1	02.02.2024
2	Elda Caushaj	Specialist Mjek Sekori Ekzaminimeve Mjekësore, Dega Përfitimeve	4316/1	03.05.2024
3	Gazmend Duraj	Specialist Auditues/ DAB	5357	03.05.2024
4	Entela Ostrovica	Specialist/Sektori i Administrimit të Bazës së të Dhënave	3182/1	01.04.2024
5	Kristina Qirici	Specialist/Sektori i Administrimit të Bazës së të Dhënave	3183	01.04.2024
6	Oriolda Mehmeti	Specialist/ Sektori i Administrimit të Bazës së të Dhënave	3183/1	01.04.2024
7	Elisa Pura	Specialist për Informimin Publik, Sektori i Marrëdhënieve Publikun/DMP	3160/2	08.07.2024
8	Sosina Mecaj	Specialist i Sektorit të Zbatimit të Marrëveshjeve me Jashtë, DIZMJ	7374/1	26.08.2024
9	Arta Kurti	Specialist /Sektori i Administrimit dhe Mirëmbajtjes së Rrjetit/ DBI	8367	07.10.2024

Burimi: Të dhëna të ISSH, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka verifikuar respektimin e kuadrit ligjor nga ana e ISSH-së për rekrutimin (punësimin) e 5 punonjësve gjatë kësaj periudhe kohore, konkretisht:

1-Nga auditimi i dosjes së personelit të **znj. Oriolda Ahmeti**, e punësuar në pozicionin e specialistit në Sektorin e Administrimit të Bazës së të Dhënave, pranë Drejtorisë së Burimeve të Informacionit në ISSH, rezultoi se mungonte dokumentacioni që vërteton shpalljen e konkurrimit të hapur për këtë vend vakant. Me Urdhrin nr. 891, datë 04.03.2024, titullari i institucionit ka

emëruar znj. Ahmeti në pozicionin e ri, ndërkohë që ajo ishte më parë e punësuar në pozicionin Specialist Operatore në Sektorin e Numerizimit të të Dhënave Dokumentare, pranë Degës së IT në DAQ, me Urdhrin nr. 73, datë 07.03.2023. Ajo ka pasur kontratë me afat të datës 11.04.2023 dhe më pas kontratë pa afat, të datës 11.07.2023.

Nga auditimi u konstatua se emërimi i znj. Ahmeti në pozicionin e specialistit është bërë në mospërputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren *"Për Organizimin dhe Funkcionimin e ISSH-së"*, Kapitulli IV, pika 1.3.4 (b), e cila përcakton: *"Arsimi dhe eksperiencia: diplomë e nivelit të dytë (Master Profesional ose e barasvlefshme) në shkenca informatike/inxhinierike; përvojë pune prej të paktën dy vitesh në administratë publike ose sektor privat"*. Nga të dhënat e verifikuara rezultoi se në datën e emërimit, znj. Ahmeti nuk dispononte Diplomë të Nivelit (Master) dhe nuk përmbushte kriterin e përvojës dyvjeçare në profesion.

2-Nga auditimi i dosjes së personelit të znj. Kristina Qirici, e punësuar në pozicionin e specialistit në Sektorin e Administrimit të Bazës së të Dhënave, pranë Drejtorisë së Burimeve të Informacionit në ISSH, rezultoi se mungon dokumentacioni që vërteton shpalljen e konkurrit të hapur për këtë vend vakant. Me Urdhrin nr. 890, datë 04.03.2024, titullari i institucionit ka emëruar znj. Qirici në pozicionin e ri, ndërkohë që ajo ishte më parë e punësuar në pozicionin Specialiste e Administrimit të të Dhënave, pranë Degës së IT në DAQ, me Urdhrin nr. 4572 prot., datë 12.06.2020.

3-Nga auditimi i dosjes së personelit të znj. Entela Ostrovica, e punësuar në pozicionin e specialistit në Sektorin e Administrimit të Bazës së të Dhënave, pranë Drejtorisë së Burimeve të Informacionit në ISSH, rezultoi se mungon dokumentacioni që vërteton shpalljen e konkurrit të hapur për këtë vend vakant. Me Urdhrin nr. 892, datë 04.03.2024, titullari i institucionit ka emëruar znj. Ostrovica në pozicionin e ri, ndërkohë që ajo ishte më parë e punësuar në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit të Administrimit të të Dhënave, pranë Degës së IT në DAQ, me Urdhrin nr. 2406/1, datë 30.04.2021.

Si konkluzion:

Nga auditimi i dokumentacionit të personelit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, rezultoi se gjatë vitit 2024 janë realizuar 3 emërimet në pozicione specialistësh në Sektorin e Administrimit të Bazës së të Dhënave pranë Drejtorisë së Burimeve të Informacionit për tre punonjëse: znj. Orlinda Ahmeti, znj. Kristina Qirici dhe znj. Entela Ostrovica. Në të gjitha rastet, mungon dokumentacioni që vërteton zhvillimin e një procedure të hapur ose të brendshme konkurrimi për plotësimin e këtyre vendeve vakante, siç kërkohet nga aktet rregullatore të institucionit. Përveç kësaj, në rastin e znj. Ahmeti, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se në momentin e emërimit ajo nuk përmbushte kriteret e përcaktuara në Rregulloren *"Për Organizimin dhe Funkcionimin e ISSH-së"*, Kapitulli IV, pika 1.3.4 (b), lidhur me nivelin arsimor dhe përvojën profesionale. Konkretisht, mungonte diploma e nivelit të dytë (Master) dhe përvoja dyvjeçare në administratë publike apo sektor privat.

Mosrespektimi i procedurave të përcaktuara në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit ka cënuar transparencën, konkurrencën dhe barazinë në trajtim në procesin e rekrutimit, duke krijuar praktikë të mbyllura e të paauditueshme në administratën publike. Për më tepër, në kushtet kur dokumentacioni që justifikon procesin e përzgjedhjes mungon, dhe kur kriteret formale nuk janë përmbushur nga personat e emëruar.

Veprime në mospërputhje me:

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 107, pika 2, ku përcaktohet se: *"Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji"*; **Rregulloren e Personelit të ISSH-së, Kapitulli I "Rekrutimi dhe komandimi i përkohshëm në detyrë" pika 1 (a), (b)** sipas të cilës: *"Vendet e lira të punës, brenda sistemit të sigurimeve shoqërore plotësohen në varësi të kategorisë dhe natyrës së vendit të punës, nëpërmjet konkurimit të brendshëm nga personeli ekzistues, për lëvizjet paralele, ngritjes në detyrë; me rekrutimin e personelit nëpërmjet konkurimit të hapur"*;

Rregulloren e Personelit të ISSH-së, Pika 2. (1) “Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve” sipas të cilës: “Pranimi në administratën e sigurimeve shoqërore bazohet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale dhe mosdiskriminimit dhe kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë”;

Rregulloren e Personelit të ISSH-së, Pika 4 (1), (2), “Shpallja e konkurimit” sipas të cilës: “Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm iu komunikoi të gjitha zyrave të sistemit të sigurimeve shoqërore shpalljen e vendeve të lira, për procedurën e konkurimit të brendshëm nga personeli ekzistues, nëpërmjet postës elektronike (e-mail) dhe në stendat e informimit publik; 2 Publikimi elektronik i të gjithë informacionit që i përket rekrutimit të personelit nëpërmjet konkurimit të hapur, realizohet në faqen zyrtare të ISSH-së dhe në stendat e informimit publik”;

Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksonimin e ISSH-së”, Kapitulli IV, pika 1.3.4 (b)

4-Për punësimin e **z. Gazment Duraj**, në pozicionin e Specialist/Auditues në pranë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, nga verifikimi i dosjes së personelit rezultoi se: ISSH në datën 03.04.2024 ka kryer dhe dokumentuar shpalljen e konkurimit të hapur për vendin vakant; Për këtë pozicion shprehën interes, z. Ermal Taho, z. Florian Dyrmishi, z. Gazment Duraj. Në datën 03.04.2024 me urdhrin nr. 1008, titullari i institucionit ka ngritur komisionin për vlerësimin e kandidatëve; Në datën 25.04.2024 nga komisioni përkatës është kryer vlerësimi i kandidatëve dhe është shpallur fitues z. Gazment Duraj i cili është emëruar me Urdhrin (1018) Nr.5357 prot., datë 03.05.2024 dhe ka nënshkruar kontratën e punës pa nr. datë 09.05.2024.

Grupi i auditimit vlerëson se procedura e rekrutimit të z. Gazment Duraj është zhvilluar në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në njoftimin për vend të lirë pune, nr. 4175/1 datë 03.04.2024.

4-Për punësimin e **znj. Monika Shehaj**, në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Juridike nga verifikimi i dosjes së personelit rezultoi se: ISSH në datën 04.01.2024 ka kryer dhe dokumentuar shpalljen e konkurimit të hapur për vendin vakant; Për këtë pozicion shprehën interes, znj. Klopedia Bajraktari, Monika Shehaj, Matilda Çausi, Vangjush Rapi. Në datën 25.01.2024 nga komisioni përkatës është kryer vlerësimi i kandidatëve dhe është shpallur fitues z. Monika Shehaj e cila është emëruar me Urdhrin (31) Nr.636/1 prot., datë 02.02.2024 dhe ka nënshkruar kontratën e punës pa nr. datë 05.02.2024.

Grupi i auditimit vlerëson se procedura e rekrutimit të znj. Monika Shehaj është zhvilluar në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në njoftimin për vend të lirë pune, datë 04.01.2024.

Në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së punonjësve.

Gjatë vitit 2024, rezultoi se është ndërprerë marrëdhënia e punës për 16 punonjës gjithsej, nga të cilët 5 (pesë) janë larguar me dëshirë, 9 (nëntë) kanë dalë në pension, 1 (një) lirim nga detyra dhe (1) larguar me masë disiplinore.

Tabela nr. 11: Ndërprerja e marrëdhënieve të punës

Arsyeja e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës	Nr. i punonjësve
Larguar me dëshirë	5
Dalë në pension	9
Larguar me masë disiplinore	1
Lirim nga detyra	1
Totali	16

Burimi: Të dhëna të ISSH, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr. 12: Punonjësit e larguar (2024)

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Arsyeja e Largimit
1	Petrit Bregasi	Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm	12.02.2024 Dalje në pension
2	Belinda Hidi	Specialist/ Drejtoria e Integrimit dhe Zbatimit të Marrëveshjeve me Jashtë	29.02.2024 Transferim
3	Emil Pulla	Përgjegjës Sektori i Administratës e Prokurimeve/ DAP	13.03.2024 Dalje në pension
4	Anila Kika	Specialist statistike/ Sektori i Buxhetit Përgjithshëm	14.03.2024 Dalje në pension
5	Hatixhe Hyka	Specialist në Sektorin e Sigurimit Vullnetar/ Drejtoria e Kontributeve	12.02.2024 Dalje në pension
6	Lindita Titka	Specialist personeli/ Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve/ DAP	12.02.2024 Dalje në pension
7	Petrit Zeneli	Specialist i Arkivit administrativ/ DAP	12.02.2024 Dalje në pension
8	Vera Gjana	Specialist Auditues/ Sektori i raporteve dhe menaxhimit riskut/ DAB	12.02.2024 Dalje në pension
9	Gloria Hazizi	Specialist Sektori i Administrimit të Dhënave, DBI	15.01.2024 Dorëheqje

10	Merita Zenelaj	Përgjegjës Sektori/ Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun	12.06.2024	Dalje në pension
11	Xhon lena	Specialist/ Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare dhe Trajtimeve/ Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve	30.09.2024	Dorëheqje
12	Elona Bedalli	Drejtör i Drejtorisë së Marrëdhënieve me publikun	13.09.2024	Dorëheqje
13	Xhevair Laraku	Specialist Sektori i Ekzaminimeve Mjekësore/ Drejtoria e Përfitimeve	01.11.2024	Dalje në pension
14	Arsim Rama	Përgjegjës Sektori/ Sektori inspektimit përfitimeve invaliditetit dhe familjare/ Drejtoria Inspektimit të Përfitimeve	01.11.2024	Dorëheqje
15	Brunilda Mene	Zëvendës Drejtör i Përgjithshëm	01.11.2024	Dorëheqje
16	Vladimir Eski	Administrator godine	01.11.2024	Dalje në pension

Burimi: Të dhëna të ISSH-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në lidhje me komandimet dhe ndryshimet e marrëdhënieve të punës së punonjësve.

Referuar Rregullores “Për Personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, Kapitullin 1, Pikën I/11.1,2 “Komandimi i përkohshëm në detyrë” përcakton se: 11.1 Kur për nevoja operacionale, të dokumentuara, kërkohet, detyrimisht, plotësimi i menjëhershëm i një vendi të lirë pune apo i një vendi pune të sapokrijuar, atëherë mund të kryhen ngritje të përkohshme në kategori ose të kontraktohen punonjës jashtë administratës së sigurimeve shoqërore. “11.2 Komandimi si më sipër zgjat vetëm për një afat kohor, maksimumi tre muaj, gjatë të cilës administrata e sigurimeve shoqërore duhet të zbatojë procedurat përkatëse dhe aktet ligjore e nënligjore”

Në Drejtorinë Qendrore të ISSH-së, për vitin 2024, rezulton se për 3 pozicione pune janë nga punonjës të komanduar, të paraqitura në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 13: Punonjësit e komanduar (2024)

Nr.	Emër /Mbiemër	Pozicioni i punës	Data e Komandimit	Emëruar
1	Nertila Beshiku	Specialist/auditues i raporteve dhe menaxhimit riskut/ DAB	Nr..9924, 26.09.2024	Nr.10392/1, 06.01.2025
2	Ilda Poda	Specialist /Sektori i Zbatimit të Marrëveshjeve me Jashtë /Drejtoria e Integritetit dhe Zbatimit të Marrëveshjeve me Jashtë	Nr.10392, 11.10.2024	Nr.12714/1, 06.01.2025
3	Rakip Nexhi	Administrator godine/ Drejtoria Administrimit të Përgjithshëm	Nr.11117, 31.10.2024	Nr.11117/1, 31.01.2025

Burimi: Të dhëna të ISSH-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi u konstatua se znj.Nertila Beshiku është komanduar në pozicionin e specialistit/audituesit në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm me Urdhrin nr. 9924, datë 26.09.2024, dhe është emëruar në këtë pozicion me Urdhrin nr. 10392/1, datë 06.01.2025. Znj. Ilda Poda është komanduar në pozicionin e specialistit në Sektorin e Zbatimit të Marrëveshjeve me Jashtë më 11.10.2024 dhe është emëruar me Urdhrin nr. 12714/1, datë 06.01.2025. Po ashtu, z. Rakip Nexhi është komanduar në pozicionin e administratorit të godinës më 31.10.2024 dhe është emëruar me Urdhrin nr. 11117/1, datë 31.01.2025.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, u konstatua se periudha ndërmjet komandimit dhe emërimit të përhershëm nuk ka tejkaluar afatin maksimal të lejuar nga rregullorja e ISSH-së, çka tregon se procedurat janë ndjekur në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Mbi ndryshimet e pozicionit të punës, rezultoi se për 17 punonjës ka ndryshime të pozicionit të punës, të paraqitura në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr. 14: Ndryshimet e pozicionit të punës së punonjësve

Nr.	Emër /Mbiemër	Pozicioni i punës	Nr. Urdhrit	Data e emërimit
1	Evgjeni Mecani	Specialist, Sektori i Burimeve Njerëzore /Drejtoria Administrimit të Përgjithshëm	607/1	02.02.2024
2	Enkeleda Hysenbelli	Përgjegjëse Sektori/Sektori i Protokoll-arkivi/ Drejtoria Administrimit të Përgjithshëm	3107	04.03.2024
3	Mimoza Hoxha	Specialist-protokoll-arkivit/ Sektori Protokoll -arkivit/Drejtoria Administrimit të Përgjithshëm	3011	04.03.2024
4	Esmeralda Doci	Përgjegjës Sektori, Sektori Kontabilitetit/ Drejtoria e Financës	3022	04.03.2024
5	Donjeta Rodoni	Specialist /Sektori i Sigurimit Vullnetar /Drejtoria e Kontributeve	2990	04.03.2024
6	Ermal Taço	Specialist në Sektorin e Inspektimit të Përfitimeve /Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve	3185	04.03.2024
7	Lindita Bilibashi	Specialist për aktuaristike/ Sektori Buxhetit të Përgjithshëm Thesarit, Statistikës dhe Aktuaristikës/ Drejtoria e Financës	3018	04.03.2024
8	Beatrice Kazazi	Operator/ Skanues në Sektorin e Protokoll -Arkivit/ Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm	3014	04.03.2024

9	Vjosana Isufaj	Këshilltar për problemet organizative/Shef Kabineti/ Kabineti Drejtorit të Përgjithshëm	3487	08.03.2024
10	Ali Brahja	Specialist Auditues/ Drejtoria e Auditimit të Brendshëm	3092	11.03.2024
11	Dashnor Çauhillari	Specialist Auditues/ Drejtoria e Auditimit të Brendshëm	4635/1	03.05.2024
12	Gerti Bode	Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm	3486/2	20.05.2024
13	Manjola Cura	Specialist në Sektorin e Integritimit dhe Marrëveshjeve me Jashtë	3103/1	11.06.2024
14	Sonila Sinanaj	Specialist në Sektorin e Integritimit dhe Marrëveshjeve me Jashtë	3106/1	11.06.2024
15	Hortenca Resuli	Përgjegjëse e Sekt. Të Marrëdhënieve me Publikun/Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun	8403/1	14.08.2024
16	Flutura Gjoni	Përgjegjëse e Sektorit të buxhetit të përgjithshëm, thesarit, statistikës dhe akuaristikës, Drejtoria e Financës	3016/1	08.07.2024
17	Sonila Osmani	Zv. Dr i Përgjithshëm	8179/2	30.10.2024

Burimi: Të dhëna të ISSH, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në lidhje me procedurën e ndjekur për dhënien e masave disiplinore në ISSH

Rregullorja nr. 3/2, datë 26.02.2008 “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, në Kapitullin V, përcakton rregullat për trajtimin e shkeljeve disiplinore, masat që merren ndaj punonjësve dhe procedurat që ndiqen në rastet kur konstatohet një shkelje. Shkeljet disiplinore ndahen në tre kategori: shumë të rënda, të rënda dhe të lehta. Për secilën kategori përcaktohen sjelljet dhe veprimet që përbëjnë shkelje, si dhe pasojat që ato shkaktojnë në përmbushjen e detyrave funksionale. Për shkeljet e konstatuara, punonjësit mund t’i nënshtrohen një prej masave disiplinore të parashikuara, të cilat variojnë nga tërheqja e vëmendjes deri në largim nga puna, duke përfshirë gjithashtu masa si vërejtje me shkrim, pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, mbajtje page apo kalim në detyrë më të ulët. Afatet e vlefshmërisë dhe të shlyerjes së masave disiplinore përcaktohen sipas llojit të masës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me masat disiplinore të marra gjatë vitit 2024 nga ISSH dhe Drejtoritë Rajonale, rezultoi se janë dhënë gjithsej 92 masa disiplinore, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 15: Masa Disiplinore ISSH (2024)

Nr.	RAJONET	MASA DISIPLINORE						TOTAL
		VITI 2024						
		Tërheqje vëmendje	Vërejtje me shkrim	Vërejtje me paralajmërim	Pezullim ngritje detyrë	Ulje në kategori ose klase (ulje në detyrë)	Largim nga puna	
1	Berat	3	-	-	-	-	-	3
2	Dibër	-	-	-	-	-	1	1
3	Durrës	7	3	-	-	-	2	12
4	Elbasan	5	2	-	-	-	2	9
5	Fier	-	2	3	-	-	1	6
6	Gjirokastrë	2	-	-	1	-	-	3
7	Korçë	2	-	1	-	1	-	4
8	Kukës	3	1	-	-	-	-	4
9	Tropojë	-	-	-	-	-	-	-
10	Lezhë	6	-	-	-	-	-	6
11	Shkodër	8	3	-	-	-	-	11
12	Tiranë	21	1	-	-	-	1	23
13	Vlorë	-	1	-	-	-	-	1
14	Sarandë	1	3	1	-	1	-	6
15	DAQ	3	-	-	-	-	-	3
16	ISSH	-	-	-	-	-	-	-
	Total	61	16	5	1	2	7	92

Burimi: Të dhëna të ISSH, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në lidhje me trajnimet e punonjësve të ISSH-së

Mbështetur në prioritetet e përcaktuara nga Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm për zhvillimin e kapaciteteve institucionale të stafit, si dhe në analizën e nevojave për trajnim të paraqitura nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe drejtoritë përbërëse të ISSH-së, është vlerësuar e domosdoshme organizimi i një programi të strukturuar të trajnimeve. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve ka hartuar **Planin Vjetor të Detajuar të Trajnimeve për vitin 2024**, me qëllim përvetësimin e njohurive të reja dhe përmirësimin e aftësive profesionale të punonjësve në fushat përkatëse të punës. Programi përfshin trajnimet si më poshtë:

Nga auditimi rezulton se, për vitin 2024, janë paraqitur gjithsej 19 kërkesa për realizimin e aktiviteteve trajnuese nga të gjitha drejtoritë e ISSH-së dhe degët përkatëse në nivel rajonal. Nga këto, janë realizuar 13 aktivitete trajnuese në ambientet e institucionit, me pjesëmarrjen e punonjësve të përzgjedhur nga të gjitha Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH), në përputhje me temat dhe grupet e përcaktuara në programin vjetor të trajnimeve të planifikuara nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve.

Gjatë këtyre aktiviteteve janë trajnuar rreth 528 punonjës të planifikuar, përfshirë edhe punonjësit e rinj të punësuar në sistemin e Sigurimeve Shoqërore. Trajnimet janë realizuar në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga institucioni. Të dhënat e detajuara mbi temat, pjesëmarrësit dhe përmbajtjen e aktiviteteve trajnuese tabela e të cilave është paraqitur në *Aneksin nr. 1*.

Mbi pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzime për udhëtime dhe dieta

Për auditimin e saktësisë dhe rregullshmërisë së kryerjes së pagesave për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzime për udhëtime dhe dieta, si dhe shpenzime të tjera personeli, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Dosjet e punonjësve (akt emërimi/diploma); Listë pagesat; Listë prezencat; Urdhër shpenzimet; Borderotë; dhe çdo informacion justifikues/vërtetues që është gjykuar i nevojshëm gjatë auditimit, vënë në dispozicion nga struktura e Financës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua:

Marrëdhëniet e pagave të punonjësve së ISSH, rregullohen në përputhje me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe me Rregulloren “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, të miratuar me VKA nr. 3/2 datë 26.02.2008, i ndryshuar me VKA nr. 5, datë 14.08.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008, “Për personelin e ISSH”.

Në rregulloren “Për personelin e ISSH”, miratuar me vendimin nr. 3, datë 26.02.2008, të Këshillit Administrativ, është miratuar struktura organizative e ISSH, si dhe janë përcaktuar klasat e kategoritë e punës për personelin e Drejtorisë së Përgjithshme dhe për Drejtoritë Rajonale. Çdo punonjësi i është akorduar një klasë, e cila quhet klasa personale e punonjësit, shkallët e karrierës dhe koeficientët. Klasat e punonjësve janë paracaktuar në bazë të eksperiencës së punës, si dhe nivelit të arsimit, e cila i përcaktohet në kontratë ose në vendimin e emërimit të tij, të punës. Në bazë të kërkesave profesionale, kushteve të punës e përgjegjësisë së punës që punonjësi kryhen, përcaktohet edhe kategoria përkatëse. Shkallët e karrierës janë rezultat i vlerësimeve vjetore individuale që merr punonjësi dhe propozimet nga eprori i tij për rritje page.

Sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 74, “Kompetencat e Këshillit Administrativ”, pika 1 b/1, “Përcakton e miraton strukturën dhe numrin e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”.

Nga auditimi kontatohet se çdo punonjësi në ISSH i akordohet një klasë që quhet klasa personale e punonjësit. Ai kryen një detyrë/ punë që i përket një kategorie të caktuar të quajtur kategoria e punës. Klasat e personelit, që i jepen çdo punonjësi, janë si më poshtë vijon:

Tabela nr. 17: Klasat e personelit, ISSH (2024)

KLASAT E SHËRBIMIT TË PËRGJITHSHËM (Personeli Ndihmës ose KLASAT I)	
I.1	Fillestar i Klasës I; nuk ka kërkesa për arsimim
I.2	Punonjës i Klasës I; kërkohet eksperience në punë ose trajnim i ngjashëm i pranueshëm për punësim.
I.3	Nëpunës i Klasës I; kërkohet të ketë përfunduar shkollën e mesme (të ketë diplome pjekurie të gjimnazit ose ndonjë shkolle tjetër të krahasueshme me të).
I.4	Nëpunës i lartë i Klasës I; kërkohet përfundimi i arsimit të mesëm dhe të paktën 10 vjet praktikë ose një kurs kualifikimi, që dëshmon aftësitë profesionale.
KLASAT E SHËRBIMIT PROFESIONAL (Specialistët ose KLASAT II)	
II.1	Ndihmës (asistent) i Klasës II; kërkohet arsim universitar me deri në 1 vit në profesion.
II.2	Specialist i klasës II kërkohet arsim universitar dhe 1 deri 6 vjet eksperience në profesion.
II.3	Specialist i Klasës II; kërkohet arsim universitar dhe 6 deri 12 vjet eksperience në profesion.
II.4	Specialist i Klasës II kërkohet arsim universitar dhe mbi 12 vjet eksperiencë në profesion.
II.5	Shef i Klasës II; kërkohet arsim universitar, mbi 6 vjet në profesion.
KLASA E DREJTORËVE ose KLASAT III	
III.1	Drejtor i ri; kërkohet arsim universitar dhe me deri 2 vjet eksperiencë në drejtim.

III.2	Drejtor i Klasës III; kërkohej arsim universitar dhe mbi 2 vjet eksperience në drejtim, Këshilltar i Drejtorit të Përgjithshëm.
III.3	Zv/ Drejtor i Përgjithshëm.

Burimi: ISSH, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 5, datë 09.07.2024, "Për disa ndryshime në VKA-në nr. 2, datë 23.06.2023, për disa ndryshime në Rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008, të personelit të ISSH-së", janë miratuar ndryshime që lidhen me rritjen e pagave bazë, caktimin e klasave dhe shkallëve të karrierës, si dhe koeficientët përkatës sipas klasifikimit të pozicioneve. Konkretisht, janë bërë ndryshime në pagat bazë për pozicionet e specialistëve dhe drejtuesve (klasa II dhe III), si më poshtë:

- Për Drejtorinë Qendrore, paga bazë është rritur nga 36,044 lekë në 39,648 lekë, me një rritje prej 10%;
- Për Drejtorinë Rajonale Tiranë, nga 36,681 lekë në 42,183 lekë, me një rritje prej 15%;
- Për Arkivin Qendror, nga 36,681 lekë në 42,183 lekë, me një rritje prej 15%;
- Për drejtoritë e tjera rajonale, nga 35,275 lekë në 40,566 lekë, me një rritje prej 15%.

Shpenzimet e personelit për paga, për vitin 2024, janë planifikuar në vlerën 264,566,000 lekë dhe janë realizuar në vlerën 255,563,000 lekë, 97% e vlerës së planifikimit. Në krahasim me vitin paraardhës, është realizimi i shpenzimeve për paga, është 255,563,000 lekë nga 28,553,000 lekë në vitin 2023. Shpenzimet për kontributet shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2024 janë planifikuar në vlerën 41,771,000 lekë dhe janë realizuar në vlerën 38,832,000 lekë ose me një realizim në masën 93%. Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera janë planifikuar në masën 174,158,000 lekë dhe janë realizuar në vlerën 154,497,000 lekë, ose 89% realizim.

Shpenzimet për dieta brenda dhe jashtë vendit janë planifikuar në vlerën 24,053,000 lekë dhe 23,046,000 lekë, pra me një realizim 96% të vlerës së planifikuar. Përqindjen më të lartë të realizimit referuar dietave, e kanë dietat brenda vendit me 100% realizim krahasuar me planifikimin ndërkohë 67% e kanë dietat jashtë vendit.

Tabela nr. 18: Paga, Shpërbime e Shpenzime të tjera Personeli

Në mijë lekë

Llogari ekonomike	Shpenzimet	Planifikim	Realizim faktik	% e realizimit
600	Paga, Shpërblime e Shpenz. Tjera Personeli	264,566	255,563	97%
601	Kontribute të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore	41,771	38,832	93%
602	Mallra dhe Shërbime të tjera	174,158	154,497	89%
6024	Dieta	24,053	23,046	96%
6024100	Brenda vendit	21,018	21,017	100%
6024200	Jashtë vendit	3,035	2,028	67%
	TOTALI	480,495	448,893	93%

Burimi: ISSH, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr. 19: Pagat e muajve Janar-Dhjetor 2024

Viti 2024	Paga Bruto	Sig shoq.punëdhënës	Sig shëndet.punëdhënës
Janar	19,994,145	3,026,189.94	193,161.06
Shkurt	19,252,452	2,935,683.92	187,384.08
Mars	18,884,954	2,878,427.58	183,729.42
Prill	19,131,945	2,909,415.62	185,707.38
Maj	19,126,800	2,773,925	325,143
Qershor	19,104,984	2,765,681	324,785
Korrik	21,055,740	3,008,050.35	357,937.58
Gusht	21,227,057	3,037,046.65	360,858.42
Shtator	21,119,943	3,023,099	359,035
Tetor	21,309,406	3,040,955	362,257
Nëntor	20,626,416	2,951,058	350,649
Dhjetor	20,544,697	2,942,568	349,262
Total	241,378,539	35,292,100.06	3,539,908.94
BILANC	241,378,539	35,292,100.06	3,539,908.94
DIFERENCA (bilancë-paga faktike)	0	0	0

Burimi: ISSH, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Referuar dokumentacionit justifikues për pagat nga të cilat grupi i auditimit përzgjedhi muajt Janar, Mars, Shtator, Nëntor, në dosje gjendet bashkëlidhur dokumentacioni i listë pagesave sipas numrit të identifikimit të llogarisë personale për pagën neto, lista pagesa përmblendhëse e

nënshkruar nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore, Përgjegjësi i Sektorit të Buxhetit të Brendshëm, Drejtori i Financës, Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm si dhe Drejtori i Përgjithshëm. Gjithashtu, gjenden bashkëlidhur raportet mjekësore, Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm për komandimet në punë, për lëvizjet paralele, daljet në pension, ngritjet në detyrë, miratimi i lejeve, etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se pagesat janë kryer në përputhje me pagën e pozicionit të punës për çdo punonjës. Libri i pagave për çdo punonjës, i ruajtur edhe në format elektronik që përmban ditët e punës sipas muajve, të dhëna mbi sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pagën bruto, pagën neto, tatimi dhe ndalesa në telefon. Nga shqyrtimi i informacionit mbi të dhënat në librin e pagave dhe listë pagesë rezultoi se këto të dhëna përputhen, si dhe të dhënat mbi listë pagesat dhe transaksionet financiare nuk rezultojnë me diferenca.

Mbi dokumentacionin justifikues për dietat, grupi i auditimit përzgjedhi dosjet për shpenzimet e realizuar për muajt janar, shtator, nëntor 2024. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se dokumentet autorizues për kryerjen e veprimeve janë bashkëlidhur për secilën nga institucionet banka ku janë kryer veprimet si “Banka Kombëtare Tregtare”, “Credins” dhe “Tirana”.

Gjithashtu, bashkëlidhur gjenden dokumentet justifikues që vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve, veprime të cilat janë kryer në përputhje me VKM nr. 870 datë 14.11.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” si dhe me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

Në lidhje me derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të mbledhura nga punëmarrësi e punëdhënësi, si dhe tatimit mbi të ardhurat, është zbatuar ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Mbi Vendimet gjyqësore që ndiqen nga ISSH

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Juridike, lidhur me vendimet gjyqësore që lidhen me largimet nga puna, rezultoi se gjatë vitit 2024, janë në proces **30 çështje gjyqësore** me objekt “**Dëmshpërblim page**”. Këto çështje janë iniciuar nga ish-punonjës ose punonjës aktualë të strukturave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, përfshirë DRSSH-të, DAQ, si dhe strukturat qendrore të ISSH-së. Paditësit në këto procese kanë kërkuar kompensime në formën e pagave mujore, rikthim në vendin e punës, ose njohje të të drejtave që ata pretendojnë t’u jenë mohuar në mënyrë të padrejtë.

Në mënyrë të detajuar të dhënat përkatëse për secilin rast, përfshirë emrin e punonjësit, drejtorinë përkatëse, pozicionin e punës, numrin e pagave të pretenduara dhe të fituara, gjendjen aktuale të çështjes në gjykatat përkatëse, si dhe vlerën monetare të përfituar apo të pretenduar, së bashku me të dhënat identifikuese të vendimeve gjyqësore janë të paraqitura në *Aneksin nr. 1*.

Nga shqyrtimi i të dhënave të vëna në dispozicion, rezultoi se në pjesën më të madhe të rasteve, punonjësit kanë pretenduar një numër të konsiderueshëm pagash, që varion nga 12 deri në 33 paga. Megjithatë, vendimet e gjykatave kanë konfirmuar vetëm pjesërisht këto pretendime, duke miratuar shpesh një numër më të ulët pagash, ose në disa raste duke rrëzuar paditë në tërësi. Ka edhe raste kur çështjet janë ende në proces në gjykatat e apelit ose të larta, pa një vendim përfundimtar të formës së prerë. Në disa raste, vlerat financiare të përfituara janë të konsiderueshme dhe shoqërohen me kosto financiare shtesë për institucionin.

Si Konkluzion: Nga analiza e 30 çështjeve gjyqësore të evidentuara, rezultoi se 18 janë ende në proces, ndërsa 3 raste kanë përfunduar me lënie në fuqi të vendimit dhe 1 rast me ndryshim vendimi (rikthim në punë). Gjithashtu, 5 padi janë rrëzuar, 1 rast është pranuar pjesërisht, 1 rast mbetet pa zbardhur, dhe në 2 raste gjykata ka vendosur rikthim në punë së bashku me pagesën e prapambetur. Auditimi i këtyre rasteve tregon një nevojë për forcimin e ndjekjes ligjore të çështjeve, mbrojtjes së interesave të institucionit dhe shmangien e shkeljeve që çojnë në humbje gjyqësore apo kompensime të panevojshme. Për një pjesë të konsiderueshme të rasteve, çështjet janë ende në shqyrtim gjyqësor dhe mbeten pa një vendim të formës së prerë.

Vendimet të ekzekutuara për vitin 2024 (ISSH)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur, rezulton se për largimet nga puna (ISSH), në vitin 2024 janë ekzekutuar 2 vendime gjyqësore me objekt “Dëmshpërblim page”. Këto vendime kanë ngarkuar institucionin me detyrime për pagesën e pagave të prapambetura dhe/ose dëmshpërblime, si dhe me mbulimin e kostove procedurale përkatëse. Të dhënat e detajuara paraqiten në tabelën si më poshtë:

Tabela nr.21: Vendime gjyqësore të ekzekutuara për vitin 2024

Nr.	Pala paditëse	Ekzekutimi i vendimit	Nr. Pagave	Vlera sipas vendimit /Lekë	Tarifa e Sh. Përmbari mor	Shpenzime Gjyqësore	Totali i shpenzimeve	Likuiduar - lekë për Vitin 2024
1	Erisa Babameto	Vendimi nr. 553 datë, 10.02.2015	16,5 paga	814,853			814,853	372,504
2	Ada Ruci	Vendimi nr. 689, datë 09.02.2024	13 paga	903,385	59,623	3,000	966,008	966,008

Burimi: ISSH, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se gjatë vitit 2024 janë ekzekutuar vendime gjyqësore për dy raste, për të cilat ISSH ka likuiduar detyrimet përkatëse ndaj palëve paditëse në përputhje me vendimet e formës së prerë të gjykatës. Më konkretisht:

- **Rasti i znj. Ada Ruci:** Është ekzekutuar vendimi nr. 689, datë 09.02.2024, i cili ka përcaktuar kompensim në masën e 13 pagave mujore dhe 7 ditëve pune, në vlerën totale prej 966,008 lekësh. Kjo përfshin shumën kryesore prej 903,385 lekësh, tarifën përmbartimore prej 59,623 lekësh dhe shpenzime gjyqësore në vlerën 3,000 lekë. Vendimi është likuiduar në tërësi gjatë vitit 2024.
- **Rasti i znj. Erisa Babameto:** Është ekzekutuar vendimi nr. 553, datë 10.02.2015, i cili parashikonte dëmshpërblim në masën e 16.5 pagave mujore, me një vlerë totale të detyrimit prej 814,853 lekësh. Gjatë vitit 2024 është likuiduar shuma prej 372,504 lekësh, ndërsa pjesa e mbetur vijon të jetë e pa likuiduar.

Nga auditimi konstatohet se në rastin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor për paditësen Ada Ruci, është paguar një tarifë përmbartimore në vlerën **59,623 lekë**. Ky shpenzim përbën një kosto shtesë për institucionin dhe konsiderohet **shpenzim joefektiv**, pasi nuk është zbatuar në kohë të vendimi gjyqësor nga ana e institucionit..

Vendimet të ekzekutuara për vitin 2024 ISSH, DRSSH, DAQ

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur, rezulton se për largimet nga puna (ISSH, DRSSH, DAQ), në vitin 2024 janë ekzekutuar **13** vendime gjyqësore me objekt “Dëmshpërblim page”. Këto vendime kanë ngarkuar institucionin me detyrime për pagesën e pagave të prapambetura dhe/ose dëmshpërblime, si dhe me mbulimin e kostove procedurale përkatëse. Të dhënat e detajuara paraqiten në tabelën si më poshtë:

Tabela nr.21: Vendime gjyqësore të ekzekutuara total (ISSH, DRSSH, DAQ) për vitin 2024

Rajoni	N r.	Pala paditëse	Ekzekutimi i vendimit	Vlera sipas vendimit/Lekë	Tarifa e Sh. Përmbartimor	Shp enzi me Gjy qëso rë	Totali i shpenzimeve	Likuiduar - për Vitin 2024
Berat	1	Makbule Çeqo	Vendimi nr. 829, datë 16.05.2024	645,816	-	-	645,816	645,816
			BERAT					645,816
Dibër	1	Anduela Kryemadhi	Vendimi Nr. 293 datë 06.03.2024	993,580			993,580	993,580
	2	Ahmet Miha	Vendimi Nr. 986, datë 06.06.2024	438,598			438,598	438,598
			DIBER					1,432,178
Ës	1	Eda Plaku	Vendimi Nr. 116 date 30.01.2024	1,670,466.00	-	3 800	1,674,266	1,674,266
			FIER					1,674,266
Elbasan	1	Ekejda Kila	Vendimi Nr. 981, datë 06.12.2023	726,900			726,900	726,900
	2	Lulzim Meta	Vendimi Nr. 178, datë 22.02.2024	473,000			473,000	473,000
	3	Islam Muraci	Vendimi Nr.611, datë 19.04.2024	998,019			998,019	998,019
	4	Vjollca Hyseni	Vendimi Nr. 789, datë 27.10.2023			21,7 50	220,000	241,750
		Vjollca Hyseni	Vendimi Nr. 789, datë 27.10.2023	375,740	9,450		375,740	375,740
	5	Hysni Myrta	Vendimi Nr. 1391, datë 17.07.2024				319,000	319,000
		Hysni Myrta	Vendimi Nr. 1391, datë 17.07.2024		28,800		341,648	341,648
			ELBASAN					3,476,057

Kukës	1	Florije Halilaj	Vendimi Nr.161, datë 21.02.2024	1,089,482	-	-	1,089,482	1,089,482
			KUKËS					1,089,482
DAQ	1	Luljeta Drogu	Vendimi Nr. 719, datë 04.10.2023	1,668,492	-	-	1,668,492	1,668,492
			DAQ					1,668,492
ISSH	1	Ada Ruci	Vendimi Nr. 689, datë 09.02.2024	903,385	59,623	3,000	966,008	966,008
	2	Erisa Babameot	Vendimi Nr. 553, datë 10.02.2015	814,853			814,853	372,504
			ISSH					1,338,512
			TOTALI		97,873			11,324,803

Burimi: ISSH, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Tabela e mësipërme paraqet vendimet për të cilat janë kryer pagesa në rajonet Berat, Dibër, Ës, Elbasan, Kukës, DAQ dhe ISSH.

Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2024 janë ekzekutuar një sërë vendimesh gjyqësore me objekt “Dëmshpërblim page” për largim nga puna apo çështje të tjera të lidhura me marrëdhëniet e punës. Totali i vlerës së vendimeve të ekzekutuara për të gjithë rastet është **11,324,803 lekë**, përfshirë shpenzimet gjyqësore dhe tarifat përmbartimore në disa raste.

Rajonet me vlerën më të lartë të likuiduar për vitin 2024 janë **Elbasani** me mbi 3.4 milionë lekë dhe **DAQ** me rreth 1.67 milionë lekë. Në disa raste, si ai i ISSH-së dhe Elbasanit, janë përfshirë edhe shpenzime shtesë si tarifa përmbartimore dhe shpenzime gjyqësore.

Nga auditimi u konstatua se në rastin e ekzekutimit të 3 vendimeve gjyqësore, është paguar një tarifë përmbartimore në vlerën totale **97,873 lekë**. Totali i vlerës së vendimeve të ekzekutuara për të gjithë rastet është **11,324,803 lekë**, përbën një kosto shtesë për institucionin dhe konsiderohet **shpenzim joefektiv**, pasi nuk është zbatuar në kohë të vendimi gjyqësor nga ana e institucionit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Znj. Olta Manjani, në cilësinë e Kryetares së Këshillit Administrativ; znj. Dhurata Pashollari, në cilësinë e sekretares së Këshillit Administrativ; znj. Anila Minxhozi, në cilësinë e Drejtoreshës së Administrimit të Përgjithshëm në ISSH; znj. Lindita Gjinaj në cilësinë e Drejtoreshës së Financës në ISSH.

Pretendimi i subjektit:

Me shkresën nr429/2 prot., datë 28.07.2025 protokolluar në KLSH me nr. 4089/2 prot., datë 24.07.2025 ISSH ka përcjellë observacion në lidhje me konstatimin.

Në lidhje me pozicionet vakante, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore ka patur gjithmonë parasysh që ky menaxhim të jetë racional dhe eficient, për të plotësuar vendet vakante në përputhje me nevojat reale dhe jo detyrim për ti plotësuar formalisht duke ruajtur kështu dhe balancën buxhetore të pagave. Plotësimi i vendeve vakante është bërë kryesisht duke u mbështetur në kërkesat e Drejtorive të argumentuara nga ana tyre si të nevojshme për plotësim, bazuar në ngarkesën reale të punës në momentin që është krijuar vakanca dhe duke mos cenuar funksionalitetin e punës.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga DAP, sqarojmë sa më poshtë:

Grupi i auditimit nuk ka vlerësuar si të pajustificuar të gjitha vendet vakante, por ka evidentuar faktin se për pozicionet e miratuara në strukturën organizative dhe të mbetura vakant për një periudhë të gjatë, nuk janë paraqitur dokumente justifikuese që të dëshmojnë qartazi analizën e nevojës dhe arsyetimin për mosplotësimin e tyre.

Argumenti i mbajtjes së balancës buxhetore është i vlefshëm, por kjo nuk e përjashton detyrimin institucional për të dokumentuar mënyrën e menaxhimit të burimeve njerëzore në përputhje me parimet e eficiencës dhe përmbushjes së objektivave funksionale të njësive përkatëse.

Për rrjedhojë, gjetja mbi ekzistencën e pozicioneve të paplotësuara në strukturë qëndron, për sa kohë që mungon dokumentacioni përkatës për vlerësimin e ngarkesës së punës dhe vendimmarrjen mbi mosplotësimin e tyre.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me procedurën e krijimit dhe administrimit të dosjeve të personelit, lidhur me fletën prezantuese të dosjes së të punësuarit, në çdo dosje pasqyrohet fleta e inventarit dhe përmban listën e dokumenteve përbërës të dosjes. Fleta prezantuese e dosjes është e pasqyruar në sistemin elektronik të administrimit të burimeve njerëzore (HRMIS), një platformë zyrtare dixhitale dhe funksionale, ku çdo

veprim dhe dokument shtohet dhe përditësohet në kohë reale, Përmbajtja dhe administrimi i të dhënave në këtë platformë është në përputhje të plotë me VKM nr. 833, datë 28.1.2020. Për rastet e rastet e konstatuara me mungesë dokumentacioni po trajtohen përmes një procesi rishikimi dhe përditësimi të tyre.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga DAP, sqarojmë sa më poshtë:

Sipas përcaktimeve të VKM nr. 833, datë 28.1.2020, "Për dosjen personale të punonjësve të administratës shtetërore", administrimi i dosjes së personelit duhet të bëhet në formë fizike dhe elektronike, ku çdo dosje fizike përmban fletën prezantuese, fletën e inventarit, si dhe dokumentet përbërëse të listuara sipas përmbajtjes së përcaktuar në këtë akt nënligjor.

Edhe pse përdorimi i sistemit elektronik HRMIS është një praktikë funksionale dhe e dobishme për administrimin në kohë reale të të dhënave, kjo nuk përjashton detyrimin për të mbajtur dhe përditësuar dosjen fizike, në përputhje me përcaktimet e mësipërme. Gjatë auditimit u konstatua se në disa dosje mungonte fleta prezantuese dhe dokumente të tjera përbërëse në versionin fizik, duke përbërë një mospërputhje me kërkesat e VKM-së. Pohimi nga vetë subjekti i audituar se disa dokumente janë në proces rishikimi dhe përditësimi përforcon vlerësimin e grupit të auditimit se mangësitë ekzistojnë dhe gjetja mbetet e vlefshme.

Për rrjedhojë, observacioni i paraqitur nga Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm nuk merret në konsideratë, pasi nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore në fuqi dhe nuk është shoqëruar me asnjë provë apo dokumentacion shtesë që të vërtetojë pretendimet e ngritura.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me vlerësimin e performancës për 5 punonjësit sqarojmë se nuk është përfshirë në dosje pasi ata janë punësuar gjatë vitit 2024 dhe nuk kanë një vit pune kalendarike për tu kryer vlerësimi vjetor.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga DAP, sqarojmë sa më poshtë:

Auditimi është fokusuar në shqyrtimin e 25 dosjeve të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme nga punonjës me përvojë të gjatë në institucion, të cilët kanë përmbushur periudha të plota vjetore pune dhe për të cilët duhet të ishin zhvilluar vlerësimet vjetore të performancës në përputhje me rregulloren përkatëse.

Për rrjedhojë, argumenti i dhënë nga subjekti nuk lidhet me konstatimin e bërë dhe nuk e cënon vlefshmërinë e gjetjes mbi mungesën e dokumentacionit për vlerësimin e performancës në dosjet e punonjësve me periudhë të plotë pune.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me trajtimin e emërimeve në ISSH, për 3 punonjëset e transferuara në Drejtorinë Qendrore, Drejtoria e TI, sqarojmë se në rastet në fjalë nuk përbëjnë emërim të ri dhe nuk kërkon publikim të vendeve vakante. Ato janë pjesë e një procesi të ligjshëm ristrukturimi mbështetur në nevojat e institucionit dhe mbrojtjen e punonjësve gjatë riorganizimeve. Në bazë të rregullores së personelit, kapitulli VI, Transferimi, pezullimi dhe largimi nga puna, pika 2, Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, procesi është ristrukturim i brendshëm dhe lëvizje horizontale brenda sistemit, për arsye organizative. Punonjësit e prekur nga shkurtimi janë transferuar në pozicione të barasvlershëm me strukturën e re, pa ndërprerje të marrëdhënieve të punës dhe në përputhje me parimet e ristrukturimit të brendshëm.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga DAP, sqarojmë sa më poshtë:

Grupi i auditimit nuk ka kontestuar ligjshmërinë e procedurës së ristrukturimit dhe të transferimit të punonjësve në pozicione të barasvlershme. Megjithatë, theksojmë se, pavarësisht se ristrukturimi dhe lëvizjet horizontale përbëjnë një instrument të njohur në rregulloren e brendshme të institucionit, ky proces duhet të dokumentohet në mënyrë të plotë dhe të jetë i shoqëruar me një analizë të detajuar të ndryshimeve në strukturë, vendimeve përkatëse dhe arsyetimit për secilin transferim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se për rastet në fjalë mungonin dokumente të qarta dhe të verifikueshme që të justifikojnë plotësisht vendimmarrjen mbi transferimin e punonjësve konkretë, lidhjen e tyre me pozicionet ekzistuese dhe përputhjen me kriteret e transparencës dhe barazisë në trajtimin e burimeve njerëzore. Për këtë arsye, gjetja lidhur me mungesën e dokumentacionit mbështetës dhe mungesën e publikimit të pozicioneve, mbetet e vlefshme.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me konstatimin e znj. Orialda Ahmeti, sqarojmë se në Drejtorinë e Arkivit ku ka qenë e emëruar më parë, kriteri arsimor i kërkuar për atë pozicion pune ka qenë i përmbushur dhe transferimi i saj ka qenë në kuadër të një ristrukturimi organizativ dhe jo si emërim përmes një procedure të hapur konkurrimi, me qëllim ruajtjen e vendit të punës. Në procesin e ristrukturimit, punonjësja ka qenë në përfundim të ciklit të masterit shkencor e cila vërtetohet nga diploma e masterit që rezultoi në dosjen e punonjësës dhe është marrë në konsideratë përvoja dhe kapaciteti i punonjësës për të vijuar punën.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga DAP, sqarojmë sa më poshtë:

Risqarojmë se, grupi i auditimit nuk ka kontestuar procesin e ristrukturimit si formë organizative për ruajtjen e marrëdhënieve të punës së punonjësve ekzistues. Megjithatë, konstatimi i bërë lidhet me faktin se për pozicionin ku është transferuar punonjësja, nuk është dokumentuar në mënyrë të plotë përmbushja e kriterëve të përcaktuara në strukturën përkatëse të miratuar, në momentin e transferimit.

Në mungesë të një diplome të lëshuar dhe të dorëzuar në atë periudhë, dokumentacioni në dosje nuk provon plotësisht përmbushjen e menjëhershme të kriterit arsimor të kërkuar për pozicionin e ri.

Për rrjedhojë, gjetja e auditimit nuk i referohet paligjshmërisë së transferimit, por mospërputhjes së dokumentacionit në dosje me kërkesat e përcaktuara në strukturën organizative dhe mungesës së evidencave që të mbështesin vendimmarrjen në kohën e kryerjes së lëvizjes.

Pretendimi i subjektit:

Me shkresën nr429/2 prot., datë 28.07.2025 protokolluar në KLSH me nr. 4089/2 prot., datë 24.07.2025 ISSH ka përcjellë observacion në lidhje me konstatimin.

Lidhur me konstatimin se njoftimet për të gjitha mbledhjet e Këshillit Administrativ janë bërë në kundërshtim me afatin e përcaktuar në Statutin e ISSH-së dhe se asnjë nga njoftimet nuk është firmosur nga Kryetarja e Këshillit Administrativ, znj. Olta Manjani: të gjitha njoftimet për zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit Administrativ dërgohen me email, në të cilin bashkëlidhen materialet për njohje paraprake si dhe nëpërmjet mesazheve telefonike, me qëllim arritjen e kuorumit dhe prezantimin e axhendës të përcaktuar në rendin e ditës. Mbledhjet e Këshillit Administrativ njoftohen dhe zhvillohen në datat e përcaktuara nga Kryetari i Këshillit Administrativ ka lidhje me zhvillimet e sistemit të sigurimeve shoqërore dhe afatet e përcaktuara në statut, nuk mund të zbatohen në raste emergjencas. Sipas nenit 16 të statutit të ISSH-së, mbledhja e Këshillit Administrativ thirret nga kryetari, nga dy nën kryetarët dhe nga drejtori i përgjithshëm i ISSH-së. Ky i fundit ka të drejtë të mbledhë Këshillin Administrativ kur interesat e ISSH kërkojnë vendime të shpejta që nuk janë në kompetencë të tij.

Në asnjë rast anëtarët e Këshillit Administrativ nuk kanë patur vërejtje për afatet e njoftimit të mbledhjeve të KA, përndryshe këto vërejte do të pasqyroheshin në procesverbale.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga DAP, sqarojmë sa më poshtë:

Përdorimi i mjeteve elektronike si email-i dhe njoftimet telefonike për thirrjen e mbledhjeve të Këshillit Administrativ përfaqëson një praktikë funksionale në kushtet aktuale të komunikimit institucional. Megjithatë, kjo mënyrë e njoftimit nuk e përjashton detyrimin për të respektuar afatet dhe format e përcaktuara qartë në Statutin e ISSH-së.

Sipas nenit 17 të Statutit të ISSH-së, miratuar me VKM nr. 161, datë 11.04.2006, i ndryshuar, mbledhjet e Këshillit Administrativ duhet të njoftohen me shkrim të paktën 10 ditë përpara zhvillimit të tyre, duke përcaktuar rendin e ditës dhe me firmë të Kryetarit të Këshillit. Në të gjashta rastet e audituara për vitin 2024, njoftimet janë bërë më pak se 10 ditë përpara, dhe në asnjë rast nuk është konstatuar firma e Kryetares së Këshillit në dokumentacionin përkatës.

Argumenti për nevojën e mbledhjeve emergjente është i kuptueshëm në rrethana të veçanta, por përjashtimet nga afati i përcaktuar në statut nuk mund të aplikohen në mënyrë të përgjithshme

dhe pa dokumentacion mbështetës që të vërtetojë natyrën emergjente të çështjeve të trajtuara. Gjithashtu, mungesa e vërejtjeve nga anëtarët nuk përbën provë të respektimit të procedurës ligjore, pasi zbatimi i statutit nuk kushtëzohet nga reagimi i pjesëmarrësve, por nga përmbushja formale e kërkesave të tij.

Për rrjedhojë, gjetja mbi mosrespektimin e afatit dhe mungesën e firmës së Kryetares në njoftimet për mbledhjet e Këshillit Administrativ mbetet në fuqi, për sa kohë që nuk janë paraqitur prova që justifikojnë përjashtimet e pretenduara.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me konstatimin se në mbledhjen e datës 19.11.2024 nuk është miratuar rendi i ditës dhe procesverbali. Rendi i ditës së mbledhjes së datës 19.11.2024, është miratuar në fillim të mbledhjes dhe kjo është pasqyruar në proces verbalin e mbledhjes së kësaj date. Procesverbali i mbledhjes së datës 19.11.2024, është dakortësuar dhe miratuar nga Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Administrativ në mbledhjen pasardhëse të datës 30.12.2024 (Sipas rekomandimeve të mëhershme të KLSH, procesverbali i një mbledhjeje, miratohet në mbledhjen pasardhëse). Lidhur me konstatimin se, Vendimi nr. 4, datë 09.07.2024, nuk përmban bazën ligjore; Vendimi nr. 5 për disa ndryshime në rregullore për personelin e ISSH-së, përfshirë rritjen e pagave dhe përcaktimin e klasave e shkallëve të karrierës; dhe Vendimi nr. 6 për miratimin e rendit të ditës, procesverbali përkatës (pa nr. prot. datë 09.07.2024) dhe relacionet shpjeguese: Vendimi nr.4, datë 09.07.2024, i protokolluar me nr. 7552/1, prot., datë 09.07.2024 e ka patur bashkëlidhur relacionin shpjegues ku është shënuar dhe baza ligjore.; Vendimi nr.5, datë 09.07.2024, i protokolluar me nr. 7552/2, prot., datë 09.07.2024 e ka patur bashkëlidhur relacionin shpjegues ku është shënuar dhe baza ligjore; Vendimi nr.6, datë 09.07.2024, i protokolluar me nr. 7552/3, prot., datë 09.07.2024 e ka patur bashkëlidhur relacionin shpjegues ku është shënuar dhe baza ligjore. Bazuar në VKM nr. 161, datë 11.04.1994, dhe bazuar në rregulloren nr. 1 datë 30.04.1996, nuk specifikohet që procesverbali të jetë i protokolluar.

Lidhur me konstatimin se në mbledhjen e zhvilluar më datë 13.06.2024, me pjesëmarrjen e 10 anëtarëve, procesverbali është firmosur nga 9 anëtarë të Këshillit Administrativ: z. Luan Bregasi ka qenë prezent në mbledhjen e datës 13.03.2024, fakt që konfirmohet nga listë prezenca e formosur prej tij ditën e mbledhjes. Procesverbali i mbledhjes së datës 13.06.2024, është miratuar e kaluar për firmë mbledhjen pasardhëse të datës 09.07.2024, në të cilën ai nuk ka qenë prezent, konfirmuar dhe nga lista e asaj date.

Sa i përket konstatimit për mungesën e zëvendësimit të anëtarit përfaqësues znj. Vasilika Vjero, në detyrën e zv. Ministër nga Ministria e Financave: ISSH i është drejtuar Ministrisë të Financave z. Petrit Malaj, me shkresën nr. 12320 prot., datë 10.12.2024, lidhur me përfaqësuesin e kësaj ministrie në Këshillin Administrativ të ISSH-së. Ministria e Financave me shkresën nr. 12320/1 prot., datë 24.07.2025 ka konfirmuar si përfaqësues të kësaj ministrie Z. Andi Memeti, zv ministër i Financave.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga DAP, sqarojmë sa më poshtë:

Konstatimi i grupit të auditimit nuk lidhet me mungesën faktike të zhvillimit të mbledhjes apo me mungesën e diskutimeve mbi rendin e ditës dhe vendimet përkatëse, por me mospërfshirjen e një vendimi të dokumentuar dhe të miratuar formalisht, që të përmbajë miratimin e rendit të ditës, të procesverbalit dhe të projekt-vendimeve përkatëse të mbledhjes së datës 19.11.2024.

Në të gjitha mbledhjet e tjera të Këshillit Administrativ, është ndjekur një praktikë e konsoliduar, ku miratimi i rendit të ditës dhe i procesverbalit është bërë përmes një vendimi të veçantë të Këshillit, i cili është përfshirë në dokumentacionin zyrtar dhe është i protokolluar. Kjo praktikë garanton formalitetin, transparencën dhe vlefshmërinë e procesit vendimmarrës. Në rastin e mbledhjes së datës 19.11.2024, ky vendim i miratimit nuk figuron në dokumentacion, duke krijuar një mospërputhje me standardin e ndjekur në mbledhjet e tjera dhe me kërkesat e mirëadministrimit institucional.

Për rrjedhojë, gjetja e auditimit që lidhet me mungesën e dokumentimit zyrtar dhe të miratuar të rendit të ditës, të procesverbalit dhe të vendimeve përkatëse mbetet e vlefshme.

2.7. “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për punë, mallra dhe shërbime”.

Për auditimin e këtij drejtimi, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Regjistrat e planifikimit dhe realizimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024.
- Urdhrat për krijimin e komisionit për prokurimin me vlerë të vogël gjatë vitit kalendarik 2024;
- Procedurat e prokurimeve me zgjedhje për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024.
- Dokumentacion plotësues/justifikues si fatura, transaksione bankare, fletë-hyrje në magazinë etj.

Nga auditimi i evidencave dhe dokumentacionit të paraqitur ISSH, me shkresën nr.230 prot., datë 09.01.2024, ka miratuar Regjistrin e Parashikimeve të procedurave të prokurimit publik për vitin 2024, në të cilin janë parashikuar 23 procedura prokurimi me fond limit (pa TVSH) në shumën 79,000,000 lekë dhe sipas Regjistrave të Realizimit të Prokurimit Publik për vitin 2024,

Lidhur me parashikimin e procedurave të prokurimit publik, realizimin e tyre, hartimin e miratimit të Regjistrave të parashikimeve dhe realizimeve për vitin 2024 nga ISSH rezulton se Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm mbështetur në shkresën nr. 231 prot, datë 09.01.2024 mbi “Kërkesat, nevojat e institucionit për mallra, shërbime dhe investime” për vitin 2024 ka hartuar regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik për vitin 2024, sipas të cilit janë miratuar 23 procedura prokurimi me fond limit (pa TVSH) në shumën 79,000,000 lekë, nga të cilat janë realizuar 19 procedura prokurimi me fond limit (pa TVSH) në shumën 18,400,000 lekë.

Gjatë vitit 2024, bazuar në nenin 3, pika 7, nga Autoriteti Kontraktor janë kryer ndryshimet si më poshtë: -Me shkresën nr. 5173/1 prot, datë 30.04.2024 është miratuar ndryshimi; “Dizenjim/Prodhim Raporti vjetor dhe Libri i Statistikave dhe shtohet, Elementi i regjistrit me objekt: “Realizimi i Përmbledhjes të të dhënave statistikore 2019-2023”, me shkresën nr.2105/1 prot, datë 28.02.2024, është miratuar shtesë fondi: me objekt: “ F/V Tabela informuese me logon e ISSH-së, me gërma 3D,

-Me kërkesën nr. 10219 prot, datë 04.10.2024 kryerjen e procedurave të veçanta të Prokurimit Publik. me objekt: “Blerje automjete për ISSH-në” i kaloi për kryerjen e procedurës së prokurimit OBP-së, në vlerë 38,910,368 lekë pa tvsh.

Sa i përket elementit me objekt: “F/V sistemi fotovoltaiik për prodhim energjie për ISSH-në është parashikuar në bazë të kërkesës me nr. 231 prot, datë 09.01.2024, për nevojat e Autoritetit Kontraktor nga Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, në vlerë 20,000,000 lekë.Kjo procedure prokurimi nuk është realizuar pasi godina e ISSH-së, në vitin 2023 i është nënshtruar rikonstruksionit. Përgjatë vitit 2024 ka qënë nën garancinë e punimeve sipas kontratës nr.7534 prot, datë 19.09.2023 me objekt: “ Rikonstruksioni i godinës së ISSH-së”.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet:

Lidhur me parashikimet për procedurat e prokurimit në bazë të nevojave për punë, mallra ose shërbime në regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të procedurave të prokurimit për vitin 2024 me gjithë kërkesat dhe ndryshimet, konstatohet se nuk është bërë një planifikim i mirë i përdorimit të fondeve publike dhe planifikim i realizimit në kohë të procedurave të prokurimit public, nuk janë ndjekur përcaktimet e nenit 3 të VKM nr.285/2012“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Instituti i Sigurimeve Shoqërore(ISSH) ka realizuar 19 procedura prokurimi me Fond Limit pa TVSH në shumën 18,400,000 lekë, me vlerë kontrate të realizuar në shumën 13,054,286 lekë, nga 79,000,000 lekë të planifikuara.

Nga 19 procedurat e prokurimit të realizuara për vitin 2024 rezultojnë sipas llojit të procedurës : 1 procedurë e Hapur e thjeshtuar shërbime/sigurimi i aseteve të ISSH-së, 6 procedura blerje nën vlerën 100,000 lekë, 11 procedura prokurim me vlerë të vogël, 1 procedurë blerje biletash avioni sistem dinamike.

Nga ana e grupit të auditimit është kryer përzgjedhja e dosjeve të procedurave të prokurimit të realizuara, duke konsideruar si kriter për përzgjedhjen vlerën e fondit limit, llojin e procedurës, tipin e kontratës. Sipas objektit të kontratës janë përzgjedhur këto procedura:

- Mirëmbajtja e faqes zyrtare të ISSH-së;
- Blerje artikujsh kancelarie;
- Riparim / Shërbimi i automjeteve të ISSH-së;
- Blerje artikujsh me logon e ISSH-së;
- Sigurimi i Aseteve të ISSH-së;
- 2 Dosje Blerje nën vlerën 100,000 lekë,
- Mirëmbajtje godine blerje nën vlerën 100,000 lekë.

Nisur nga vlera e fondit limit dosjet e përzgjedhura përbëjnë 53% të fondit limit të 19 procedurave të realizuara gjatë 2024. Procedurat e përzgjedhura janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e publikimit
1	Mirëmbajtja e faqes zyrtare të ISSH-së	179,000.00	Procedurë me vlerë të vogël	150,000.00	17.04.2024 12:15 PM	MC NETWORKING SHPK	16.04.2024 12:15 PM
2	Blerje artikujsh kancelarie	651,000.00	Procedurë me vlerë të vogël	332,700.00	10.10.2024 11:00 AM	InfoSof Office	09.10.2024 11:00 AM
3	Blerje artikujsh me logon e ISSH-së	555,000.00	Procedurë me vlerë të vogël	380,000.00	18.12.2024 12:45 PM	Onufri	17.12.2024 12:35 PM
4	Riparim/shërbimi i automjeteve të ISSH-së	104,000.00	Procedurë me vlerë të vogël	90,000.00	11.10.2024 12:30 PM	Auto Manoku Servis	10.10.2024 12:25 PM
5	Sigurimi i aseteve të ISSH-së,DAQ Lunder, DRSSH-ve dhe ALSSH-ve përkatëse për periudhën një vjeçare	7,989,000.00	Procedurë e hapur e thjeshtuar	7,919,359.00	19.07.2024	INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP	09.07.2024 08:00 AM
6	Mirëmbajtje godine		Nën 100,000.00			PINA	
7	Mirëmbajtje godine		Nën 100,000.00			DSS HIDRO	

Tabela e procedurave të përzgjedhura për auditim

Nga procedurat e realizuara është përzgjedhur për auditimi procedura e prokurimi e llojit: Procedurë “E hapur e thjeshtuar” me Fondi limit 7,989,000 lekë pa tvsh, nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet:

1.Procedur prokurimi e Hapur e Thjeshtuar me objekt: **“Sigurimi i aseteve të ISSH-së, DAQ Lunder, DRSSH-ve dhe ALSSH-ve” përkatëse për periudhën një vjeçare**; Fondi limit 7,989,000 lekë pa tvsh, me Urdhër Prokurimi nr. 7471, datë 04.07.2024; është hartuar Njësia e prokurimit: me përbërje znj.Nevila Celiku, znj.Klaudia Duka, z.Besmir Durdija; Komisioni i vlerësimit të ofertave znj.Flutura Sharra, znj.Monika Shehaj dhe znj.Anila Minxhozi.

Të dhënat mbi procedurën:

Procedura e prokurimit me objekt: “Sigurimi i aseteve të ISSH”			
1.Urdhër Prokurimi nr. 7471,datë 04.07.2024	3.Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit,sipas UP nr.7471 datë 04.07.2024.	4.KVO,Urdhrinr.7471/,datë 05.07.2024	
2.Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar	Klaudia Duka, Nevila Celiku Anëtar Besmir Durdia,jurist Anëtar	Anila Minxhozi Anëtar Flutra Sharra Anëtar	
5.Fondi limit pa TVSH: 7,989,000 lekë.	6.Oferta fituese pa TVSH: 7,919,359 lekë	7.Diferenca me fondin limit pa TVSH: 69,641 lekë.	
8.Data e hapjes së procedurës: 26.06.2024	9.Burimi i financimit: Buxheti i ISSH për vitin 2024.	10.Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 1 (një) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE. c. S’kualifikuar:	
11.Ankimime: S’ka	12.Përgjigje ankesës nga AK:	13.Përgjigje ankesës nga APP/KPP:	
14.Lidhja e kontratës datë 02.08.2024	15.Vlera e kontratës:	16. Likuiduar brenda 30 ditëve	

“Sigurimi i aseteve të ISSH-së, DAQ Lundër, DRSSH-ve dhe ALSSH-ve, përkatëse për periudhën një vjeçare”, me fond limit 7,989,000 pa TVSH,

Përlllogaritja e nevojave: Nevoja për sigurimin e aseteve të ISSH cilësuar në dokumentin “sigurimin e aseteve për një periudhë 1 (një vjeçare). Termat e referencës kanë për qëllim përcaktimin e kërkesave dhe kriterëve që shoqëria përcakton për subjektet që do të konkurrojnë”. Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm me kërkesën nr.5757/1prot, datë 26.06.2024 ka kërkuar fillimin e procedurave për realizimin e prokurimit me objekt “Për sigurimin e aseteve”

Perlllogaritja e fondit limi. Me Proces verbalin e datës 02.07.2024 njësia e prokurimit ka përcaktuar vlerën limit të kontratës, bazuar në termat e referencës përgatitur nga komisioni i ngritur me urdhërin nr.5757, datë 14.05.2024, njësia e prokurimit për testimin e tregut ka dërguar në adresat përkatëse në rrugë elektronike ftesë për paraqitje të ofertës ekonomike 4 shoqërive të sigurimit (të mëposhtme) që operojnë në territorin e Shqipërisë, për sa më sipër kanë paraqitur ofertat e tyre ekonomike 3 shoqëri sigurimesh: shoqëria e sigurimeve “INTERSIG”SHA me vlerë 7,989,000 lekë, shoqëria e sigurimeve “ANSIG”SHA me vlerë 8,105,000 lekë, shoqëria e sigurimeve “ATLANTIK”SHA me vlerë 8,145,627 lekë. Shoqëria e sigurimeve “ALBSIG”SHA nuk ka paraqitur ofertë.

Me Urdhër Prokurimi nr.7471prot., datë 04.07.2024 është urdhëruar të kryhet prokurimi i fondit limit 7,989,000lekë pa TVSH, nga fondet e ISSH-së Lloji i prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me mjete elektronike, ku për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet njësia e prokurimit znj.Klaudia Duka, znj.Nevila Celiku dhe z.Besmir Durdia.

Me Urdhërin nr.7471 /1prot., datë 05.07.2024 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje znj.Monika Shehaj Kryetar, znj.Anila Minxhozi dhe znj.Flutura Sharra Anëtare.

Duke marrë aparasysh ofertat paraprake të ofruara nga shoqëritë e sigurimit njësia e prokurimit ka përcaktuar si fond limit për procedurën e prokurimit ofertën më të ulët me vlerë 7,989,000 lekë pa TVSH.

Vlerësimi i ofertave: Në datë 19.07.2024 nga njësia e prokurimit është bërë verifikimi i listës së ofertave të dorëzuara, ku ishte paraqitur vetëm një operator ekonomik ,OE “Intersig Insurance Group”SHA oferta ekonomike 7,919,359 lekë pa TVSH. Për sa më sipër bazuar në dispozitat ligjore të prokurimit publik si dhe në kërkesat ligjore administrative dhe kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e tenderit KVO-ja ka kryer verifikimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur. Në datë 24.07.2024 anëtarët e KVO kanë përfunduar në sistemin elektronik vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga OE “Intersig Viena Insurance Group”SHA. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertës, përpara publikimit të njoftimit të fituesit, KVO ka dërguar OE nëpërmjet (SPE) të dorëzojë dokumentat provues për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, në datë 26.07.2024 KVO pasi ka kontrolluar dhe verifikuar dokumentacionin e paraqitur ka arritur në konkluzionin se dokumentacioni i OE “Intersig Viena Insurance Group”SHA me NUIS K12201002T ishte konform kriterëve dhe dispozitave të legjislacionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër KVO e ka vlerësuar të suksesshme ofertën e OE “Intersig Viena Insurance Group”SHA. Me shkresë nr.7471/2prot., datë 31.07.2024 është miratuar raporti përmbledhës dhe është dhënë urdhër komisionit për ekzekutimin e kontratës për vazhdimin me njoftimin e fituesit dhe lidhjen e kontratës. Kontrata e lidhur me operatorin fitues nr.8424prot., datë 02.08.2024.

Nga auditimi I vlerësimit të ofertave nga ana e KVO-së, u konstatua se ky vlerësim është bërë conform legjislacionit për Prokurimin Publik.

Zbatimi i kontratës: Me Urdhëri nr.8424/1prot., datë 02.08.2024 për krijimin e komisionit lidhur me çështjet për ndjekjen e kontratës (z.K Nuredini, z.E Hysenbelliu, z.V Eski). Plani i zbatimit të kontratës Nr.8424/2Prot.,datë 02.08.2024. Polica e sigurimit të pasurisë datë 02.08.2024, siguruesi OE “Intersig Viena Insurance Group”SHA, i siguruari ISSH. Fatura tatimore 400/2024, datë 06.08.2024, pagesa Urdhër Transferte BKT datë 02.09.2024. Kontratë sigurimi nr.8424, datë 02.08.2024. Procedura është kryer në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

Procedurat e prokurimit Blerje me vlera të vogla

Në fillim të vitit Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhërin nr.560, datë 16.01.2024 për Krijimin e komisionit të prokurimit me “Vlerë të vogël” ka emëruar komisionin me përbërje, z.Emil Pulla Kryetar, znj.Nevila Celiku Anëtare dhe z.Besmir Durdia Anëtare.

-Me urdhrin nr.560/1, datë 19.03.2024 Drejtori i Përgjithshëm ka urdhëruar shfuqizimin e urdhërit

-Me urdhrin nr.560/2, datë 19.11.2024, Drejtori i Përgjithshëm ka urdhëruar shfuqizimin e urdhrin me nr.560/1, me një ndryshim të një anëtar i cili ka dale në pension dhe ka zëvendësuar me Enkelejda Dedja Anëtare, znj.Nevila Celiku Kryetar, dhe z.Besmir Durdija Anëtar.

1.Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje kancelarie” për nevojat e ISSH Me Fond limit 651,000 lekë, me urdhri e prokurimin nr. 10030/1 datë 10.01.2024 komisioni i prokurimit i përbërë nga znj.Klaudia Durdia(kryetar i komisionit), znj.Nevila Celiku dhe z. Besmir Durdia (anëtarë), në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit.

Përlllogaritje e fondit limit

Sipas procesverbalit të mbajtur datë 02.10.2024 komisioni ka marrë për bazë përlllogaritjen e fondit limit shpallur fitues të një viti më parë sipas listës së ardhur nga magazina duke i shtuar 1.9% të inflacionit të marrë sipas INSTAT.Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 10.10.2024 në klasifikimin përfundimtar është kualifikuar i pari operatori ekonomik “InfoSoft Office”SHPK me NUIS J62426002Q; me shumën 327,700 pa TVSH. Sipas procesverbalit për shpalljen fitues datës 14.10.2024, komisioni e ka klasifikuar të suksesshme ofertën ekonomike duke e shpallur fitues operatorin ekonomik të klasifikuar në vendin e parë. Me procesverbalin datë 17.10.2024 është marrë në dorëzim mallin sipas emërtimeve, OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr.15965/2024, datë 17.10.2024 në shumën 399,240 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë më datë 30.10.2024. Procedura është kryer në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

2. Procedura e prokurimit me objekt: “Riparim / Shërbimi i automjeteve të ISSH-së”, për mjetet me targa AA593PM, AA592PM, AA165VX dhe AA166VX, me Fond Limit 104,000 lekë, Bazuar në Urdhrin e Prokurimit nr. 9854/1, datë 10.10.2024, komisioni i përbërë nga znj.Klaudia Durdia (Kryetar i komisionit), znj. Nevila Çeliku dhe z.Besmir Durdia (Anëtarë), është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit. Sipas proces verbalit të mbajtur datë 09.10.2024, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të vogël ka kryer përlllogaritjen e fondit limit bazuar në mesataren e cmimeve të marra nga tregu dhe ka përcaktuar Fondin limit 104,000 lekë. Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 10.11.2024, ka marrë pjesë një operatorë ekonomik “AutoManoku Servis”SHPK është klasifikuar i pari me vlerën e ofruar 90,000 lekë. Sipas proces verbalit datë 17.10.2024 operatori ekonomik i klasifikuar në vendin e parë i cili është shpallur si ofertë e sukseshme. Proces verbalet e kryerjes së shërbimit datë 25.10.2024 për mjetet me targa AA 166 VX, AA 165 VX, AA 592PM, AA 593 PM së bashku me deklarata e garancisë. OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore nr.1241/2024 datë 25.10.2024 në shumën totale 90,000 lekë. Procedura është kryer në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

3.Procedura e prokurimit me objekt:“Blerje artikujsh me logon e ISSH-së”, me fond limit 555,000 lekë. Bazuar në Urdhrin e Prokurimit nr.12523, datë 17.12.2024, komisioni i përbërë nga znj.Nevila Celiku, z.Besmir Durdija, znj.Enkeleda Dedja, ka nënshkruar deklaraten e konfliktit të interesit. Sipas procesverbalit të mbajtur datë 17.12.2024, mbi përlllogaritjen e fondit limit njësia ka kryer mesataren e tre ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik (procedurë e zhvilluar datë 17.12.2024, nga autoriteti kontraktor). Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 18.12.2024, operatori ekonomik “ONUFRI”SHPK është renditur i pari në klasifikim me shumën 380,000 lekë pa TVSH. Me Proces verbalin e datës 23.12.2024 është shpallur fitues ky operator i cili është klasifikuar në vendin e parë pas njoftimit të kryer nëpërmjet sistemit elektronik. Procesverbal i marrjes në dorëzim është mbajtur në datë 30.12.2024. OE ka lëshuar

faturën nr.274/2024, datë 30.12.2024 e cila është paguar datë 24.01.2025. Procedura është kryer në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

4-Procedura e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtja e faqes zyrtare të ISSH-së” me fond limit 179,000 lekë. Bazuar në Urdhrin e Prokurimit nr. 4487/2 data 4/16/2024; datë 15.04.2024 komisioni i prokurimit i përbërë nga znj.Klaudia Durdia(Kryetar i komisionit), znj.Nevila Celiku dhe z. Besmir Durdia(anëtarë ka nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit. Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka mbajtur në datë 15.04.2024 proces verbalin mbi përlllogaritjen e fondit limit. Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, në përlllogaritjen e fondit limit përlllogariti fondin limit bazuar në vlerën e kontratës së vitit 2023, vlera e përafërt e fondit limit duke shtuar dhe inflacionin është 179,000 Lekë pa TVSH. Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 17.04.2024 klasifikimi përfundimtar janë klasifikuar të parët dy operatorë ekonomikë “Future Block Group”SHPK dhe “MC NETËORKING”SHPK me vlerë të ofruar 150,000 lekë. Sipas proces verbalit për kalimin të operatorit ekonomik i radhës i mbajtur në datë 18.04.2024 nga komisioni mbi përcaktimin e fituesit, komisioni ndoqi parashikimet ligjore për hedhjen e shortit ndërmjet dy operatorëve ekonomik të cilët rezultuan me vlerë ekonomike të njëjtë. Në mbështetje të njoftimit të bërë në sitemin elektronik për hedhjen e shortit në datë 18.04.2024, fitues rezultoi operatori ekonomik “MC NETËORKING”SHPK me NUIS K722230070 me vlerë 150,000 lekë pa TVSH. Sipas proces verbalit për shpalljen fitues datës 22.04.2024 , operatori ekonomik i klasifikuar në vendin e parë pas hedhjes së shortit, pas njoftimit të kryer nëpërmjet sistemit elektronik u paraqit duke dorëzuar dokumentacionin pranë ISSH duke marrë përsipër realizimin e kësaj procedure sipas ftesës për ofertë.

Në datë 29.04.2024 është lidhur kontrata me nr.4487/3prot., datë 29.04.2024 me object *Mirëmbajtja e faqes zyrtare të ISHSH* , me afat një vit dhe fillim në datën kur kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktues nënshkruajnë atë.

Për këtë procedurë konstatojmë kryerjen në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

Lidhur me ndjekjen e realizimit të shërbimit konstatojmë :

Nga auditimi u konstatuan mangësi në ndjekjen e realizimit të shërbimit, mangësi në administrimin e protokollimin e proces verbaleve mujore për realizimin e shërbimit të kryer, si dhe mungesën e një procesverbali për realizimin e shërbimit të kryer për muajin maj 2024 me vlerë 15,000 lekë. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021 “ Për përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar të APP-së. me nenin 2 Dokumentimi i procesit të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”.

Për këto mangësi mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të hartimit të proces verbaleve për realizimin e shërbimeve të kryera , Hortena Deliallisi Përgjegjëse në Drejtorinë e Mardhënieve me Publikun, Fatjona Dosku Specialiste e Sektorit të Programimit të Softëare-it, Ervisa Shkrepa, Specialiste e Sektorit të Programimit të Softëare-it.

- Auditimi i blerjeve me vlerë nën 100, 000 lekë.

1. Blerje me vlerë nën 100,000 lekë “Mirëmbajtje godine”

Dokumentacioni dhe përshkrimi i procedures.

Me aktkonstatimin e mbajtur nga Administratorit i godinës në datë 02.12.2024, janë konstatuar defekte në godinë, në datë 04.12.2024, me nr. Prot. 12201, është miratuar kërkesa e Sektorit të administratës nga Titullari i Institucionit, për kryerjen e shërbimit për ndërrimin sistemit të tubacioneve të difektuara. Në datë 15.12.2024 është mbajtur Proces-verbali për realizimin e shërbimit të kryer. Komisioni me përbërje z.Rakip Nexhi, znj.Enkeleda Dedja dhe z.Uran Hoxha; -FaturaTatimore,1/2024,datë18.12.2024,subjekti“DSSHidro”SHPK me NUIS M21425022A.

2.Blerje me vlerë nën 100,000 lekë: Mirëmbajtje godine.

Nga adminsitatori i godinës është hartuar një kërkesë sektorit të administratës për blerje 4 artikuj, nga auditimi rezultoi se kërkesa është pa nr., datë protokoll. Është miratuar kërkesa e sektorit të Administratës me nr. Prot. 9866 datë 24.09.2024, për nevojat e institucionit kërkohet të blihen 4 artikuj; Me datë 30.09.2024 është mbajtur proces verbali për marrjen në dorëzim të mallit nga

Komisioni i Blerjeve të Vogla pa nr. datë protokolli. Komisioni është i përbërë nga znj. Ervisa Shkrepa, znj. Alketa Shimaj dhe znj. Mimoza Zeqaj. -Fatura Tatimore 215/2024 datë 25.09.2024 subjekti "PINA" shpk me NUIS J61826115R; -Fletë hyrje nr.8/1, datë 30.09.2024.

Për këto dy procedura konstatojmë:

Mangësi në administrimin e dokumentacionit, mungesën e numerizimit dhe arshivimit të dokumentacionit për të dy procedurat blerje me vlerë nën 100,000 lekë. Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të painventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit.

Veprime në kundërshtim me nenet 1,2,9 të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", i përditësuar dhe nenet 1, 2, 21 të "Norma Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë" të DPA-së.

Përgjegjës për këto mangësi: z. Rakip Nexhi, z. V Eski, znj. Enkeleda Dedja, z. Uran Hoxha. Zj. Mimoza Zeqaj Kryetar, znj. Ervisa Shkrepa anëtare dhe znj. Alketa Shimaj anëtare.

Si konkluzion konstatojmë:

1. Nga auditimi për dy blerjet nën 100,000 lekë

-mangësi në administrimin e dokumentacionit: si numerizimit dhe arshivimit të dokumentacionit.
-mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të painventarizuara që mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit. Veprime në kundërshtim me Nenet 1,2,9 të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", i përditësuar dhe nenet 1, 2, 21 të "Norma Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë" të DPA-së.

2. Lidhur me procedurat e ndjekura për përcaktimin e fondit limit nga auditimi i katër procedurave blerje me "vlerë të vogël", në dy procedura (50%), përcaktimi i fondit limit është bërë bazuar vetëm në një çmim referues në vlerën e kontratës të vitit të mëparshëm dhe jo në mënyra të tjera të përlllogaritjes së fondit limit, duke mos qenë kështu koherent me çmimet reale të tregut dhe duke mos iu krijuar mundësi pjesëmarrje me shumë OE. Në kundërshtim me nenet nr. 13, 56 dhe 76 të VKM nr.285 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", datë 09.06.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

3. Në procedurën e prokurimit me objekt: "Mirëmbajtja e faqes zyrtare të ISSH-së" konstatojmë mangësi në ndjekjen e realizimit të shërbimit, mangësi në administrimin e protokollimit e proces verbaleve mujore për realizimin e shërbimit të kryer dhe mungesën e një proces verbal për realizimin e shërbimit të kryer për muajin maj 2024 me vlerë 15,000 lekë. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021 "Për përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar të APP-së, Neni 2 Dokumentimi i procesit të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

4. Lidhur me parashikimet për procedurat e prokurimit në bazë të nevojave për punë, mallra ose shërbime në regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të procedurave të prokurimit për vitin 2024 me gjithë kërkesat dhe ndryshimet nuk është bërë një planifikim i mirë i përdorimit të fondeve publike, nuk janë ndjekur përcaktimet e nenit 3 të VKM nr.285/2012 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Anëtarët e komisionit të hartimit të proces verbaleve për realizimin e shërbimeve të kryera, znj. Hortena Deliallisi, znj. Fatjona Dosku, znj. Ervisa Shkrepa si dhe z. Rakip Nexhi, z. V Eski, me detyrë administrator godine, znj. Enkeleda Dedja, z. Uran Hoxha, znj. Mimoza Zeqaj, znj. Ervisa Shkrepa, znj. Alketa Shimaj, znj. Hortena Deliallisi, znj. Fatjona Dosku, anëtarë të komisionit për blerjet e vogla.

Me shkresën hyrëse nr.429/2prot., datë 28.07.2025, ISSH ka përcjell informacion në lidhje me konstatimet.

Pretendimi i subjektit: Observacion sqarues lidhur me akt konstatimin nr. 7 "Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik".

Pika 2. Mbi procedurat e ndjekura për përcaktimin e fondit limit argumentojmë sa më poshtë:

Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit public, Autoriteti Kontraktor është mbështetur në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit public", nenin 56 "Procedura e prokurimit me vlerë të vogël" sipas të cilës AK të kryejë përllogaritjen e fondit limit në përputhje me nenin 76 të këtyre rregullave. Sa më sipër AK ka zhvilluar me korrektesë nenin 76 "Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit".

Si përfundim konstatimi nr.2 mbi fondin limit nuk qëndron pasi AK ka zbatuar pikën c) cmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo autoritetet e tjera kontraktore.

-Pika 4 mbi parashikimet për procedurat e prokurimit public ju sqarojmë se:

AK bazuar në nenin 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit public" mbështetur në nevojat për punë, mallra ose shërbime, të Drejtorive të ISSH-së, në buxhetin e brendshëm të miratuar nga titullari i ISSH –së ka hartuar regjistrin vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit public, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së. Regjistri i parashikimeve është përgatitur bazuar në një planifikim të mirë të përdorimit të fondeve të miratuara. Gjatë vitit kalendarik ka lindur nevoja e ndryshimit në regjistrin e parashikimeve publike mbështetur kjo në kërkesat e bëra nga drejtoritë përkatëse, si dhe në pikën 7 të nenit 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, sipas të cilit AK ka të drejtë të bëjë ndryshimet në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste kur këto ndryshime vijnë për arsye që nuk kanë qenë të mundura të parashikohen në kohën e hartimit të regjistrit.

Në lidhje me parashikimin për investime që kapin vlera të konsiderueshme AK është mbështetur në objektivat e Qeverisë mbi efikasitetin ekonomik të investimeve publike ku vlen të përmendim investimin mbi panelet fotovoltaike e cile sjell përfitime të tilla si: përfitimet mjedisore: panelet fotovoltaike prodhojnë energji të pastër, të rinovueshme, e cila mund të ndihmojë në reduktimin e emetimeve të gazrave serrë dhe në luftimin e ndryshimeve klimatike. Kursimet e kostos: prodhimi i energjisë elektrike nga panelet diellore PV mund të çojë në kursime të kostos në faturat e energjisë elektrike, veçanërisht në afat të gjatë.

Sa më sipër mendojmë që Autoriteti Kontraktor ka vepruar conform rregullave të Prokurimit Publik mbi planifikimin sa më efektiv të fondeve për plotësimin e nevojave të ISSH-së.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me pikën 2. Mbi procedurat e ndjekura për përcaktimin e fondit limit: Sqarojmë se në konstatim theksohet se: "në dy procedura (nga 4 procedura prokurimi "blerje me vlerë të vogël" të audituara) përcaktimi i fondit limit është bërë bazuar vetëm në një çmim referues në vlerën e kontratës të vitit të mëparshëm dhe jo në mënyra të tjera të përllogaritjes së fondit limit, duke mos qenë kështu koherent me çmimet reale të tregut dhe duke mos iu krijuar mundësi pjesëmarrje me shumë OE, kjo në kundërshtim me nenet nr. 13, 56 dhe 76 të VKM nr.285 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", datë 09.06.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pra ka të bëjë me fokusimin në këtë metodë përcaktimi dhe mos zbatimin e procedurave përpara se të nisë një procedurë prokurimi lidhur me studimin paraprak të tregut dhe referimin e më shumë alternativave në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me pikën 1 të nenit 13 Studimi paraprak i tregut dhe me pikën 1 të nenit 76 Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit. Autoriteti Kontraktor ISSH ka zbatuar pikën c) cmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo autoritetet e tjera kontraktore, por në lidhje me referimin në më shumë alternative në përllogaritjen e fondit limit me qëllim që vlera e kontratës të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë observacioni nuk merret në konsideratë.

Lidhur me pikën 4. Mbi parashikimet për procedurat e prokurimit publik: Sqarojmë se në informacionin tuaj datë 18.07.2025, mbi parashikimet për procedurat e prokurimit public citohet: "Sa i përket elementit me objekt: "F/V sistemi fotovoltaike për prodhim energjie për ISSH-në" është parashikuar në bazë të kërkesës me nr. 231 prot, datë 09.01.2024 për nevojat e Autoritetit Kontraktor nga Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm. Kjo procedure prokurimi nuk është realizuar pasi godina e ISSH-së, në vitin 2023 i është nënshtruar rikonstruksionit. Për vitin 2024 ka qenë nën garancinë e punimeve sipas kontratës nr.7534 prot, datë 19.09.2023 me objekt: " Rikonstruksioni i godinës së ISSH-së", pra Autoriteti Kontraktor ka patur dijeni dhe mundësi të analizojë më mirë këtë kërkesë dhe nuk ka bërë " planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimit në kohë të procedurave të prokurimit public" sipas pikës 2 të nenit Neni 3 Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit public të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit public". Për këtë pikë observacioni juaj nuk merret në konsideratë .

8. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin e brendshëm.

1. Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga stafi i ISSH-së, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe kuadrit ligjor në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor, u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në ISSH. Nga auditimi u konstatua se strukturat përgjegjëse (Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Njësia e Zbatimit) kanë njohuri mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës në këtë fushë.

Institucioni ka hartuar projektbuxhetin afatmesëm për periudhën 2024–2026, në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, dhe ia ka përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 10757 prot., datë 22.12.2023. Gjithashtu, me Vendimin nr. 12, datë 28.12.2023, është miratuar detajimi i treguesve buxhetorë për çdo drejtori rajonale, për Arkivin Qendror dhe buxhetin e brendshëm.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, me shkresën nr. 12516/1 prot., datë 08.01.2025, Drejtori i Përgjithshëm ka dërguar në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Raportin vjetor të funksionimit të Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2024” dhe “Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm”, së bashku me pyetësorin e vetëvlerësimit për vitin 2024.

Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se Raporti Vjetor mbi cilësinë e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm nuk është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Udhëzimit nr. 2, datë 26.01.2024 “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike”.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i ISSH-së në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Referuar të dhënave të plotësuar nga koordinatori i MFK-së, në pyetësorin e vetëvlerësimit rezultoi se ISSH operon mbi bazën e “*Rregullores së Brendshme për Personelin*”, miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 5, datë 14.08.2020, e ndryshuar.

Në përbërje të kësaj rregulloreje është edhe Aneksi nr. 2, i titulluar “*Kodi Etik i Institutit të Sigurimeve Shoqërore*”, i cili përcakton qartë vlerat, parimet dhe rregullat e etikës profesionale, si dhe normat e sjelljes që duhet të respektojnë të gjithë punonjësit e institucionit. Kreu II i këtij Aneksi, me titull “*Konflikti i Interesit*”, bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike*”, të ndryshuar, si

dhe në Kodit të Procedurave Administrative, parashikon rastet që përbëjnë konflikt interesi për personelin e ISSH, si dhe masat administrative dhe procedurat që duhet të ndiqen për shmangien dhe menaxhimin e këtyre situatave.

Rregullorja e Brendshme dhe Kodi Etik, të cilat janë të publikuara edhe në faqen zyrtare të ISSH-së, u bëhen të njohura të gjithë punonjësve të institucionit që në momentin e nënshkrimit të kontratës së punës. ISSH ka hartuar dhe miratuar Udhëzues nr. 6804 prot., datë 26.09.2018 "*Për sjelljen dhe etikën në ofrimin e shërbimeve*", i cili është shpërndarë për zbatim nga të gjithë punonjësit e institucionit.

Gjithashtu, në Kapitullin IV të rregullores së ISSH-së, me titull "*Shkeljet, masat disiplinore dhe procedimi disiplinor*", janë të përcaktuara procedurat për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore nga punonjësit si dhe funksionimi i Komisionit Disiplinor, i cili është ngritur si strukturë e posaçme për të garantuar zbatimin e rregullave dhe procedurave disiplinore.

Nga auditimi i dokumentacioni konstatohet se, gjatë vitit 2024 janë marrë 14 masa disiplinore:

14 "vërejtje" për shkelje të rregullave të etikës;

Temat që lidhen me integritetin dhe etikën janë të përfshira në programin vjetor të trajnimeve që zhvillohen nga Departamenti i Administratës Publike (DAP). Në trajnimin e zhvilluar më datë 19.12.2024, me pjesëmarrjen e 30 punonjësve të ISSH-së, është trajtuar edhe çështja e integritetit, duke u diskutuar mbi parimet bazë të sjelljes profesionale që duhet të udhëheqin punonjësit gjatë ushtrimit të detyrës.

Bazuar në Ligjin 60/216 për "*Sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*", në ISSH me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.533 date 19.01.2017, është ngritur struktura e njësisë përgjegjëse të sinjalizimit e cila shqyrton ankesat për korrupsion ose abuzime. Gjatë vitit njësia merr në shqyrtim çdo rast ankese, bazuar në procedurat ligjore dhe rregulloren e saj miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Në fund të vitit kjo njësi harton raportin përmbledhës të veprimtarisë të njësisë dhe ia dërgon atë Inspektoriatit të lartë të deklarimit të pasurisë.

Bazuar në Rregulloren "Për personelin e ISSH", Aneksi nr. 2 "*Kodi etik për punonjësit e ISSH*", Zyra Qendrore e Burimeve Njerëzore, në fillim të çdo viti, mbledh nga eprorët përkatës Formularët e Vlerësimit të Performancës së punonjësve, të hartuar sipas formatit tip të miratuar me Udhëzimin nr. 01, datë 07.02.2023.

Parimi 2 -Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë, mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi rezultoi se ISSH është e organizuar në 13 njësi shpenzuese dhe dy degë, të cilat kryejnë raportime mbi realizimin e buxhetit dhe performancën operacionale. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm realizon misione kontrolli bazuar në planin vjetor, për të cilat harton raporte, identifikon shkeljet dhe përgatit plane veprimi për përmirësimin e situatave të konstatuara. Për vitin 2024 janë realizuar 14 misione auditimi dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse.

Gjithashtu, titullari i ISSH merr opinione të vazhdueshme për performancën e sistemit të Sigurimeve Shoqërore nga menaxherët e njësisë, auditimi i brendshëm, si dhe nga institucione të jashtme si Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe KLSH.

Mbikëqyrja e përgjithshme e institucionit ushtrohet nga Këshilli Administrativ, i cili miraton dokumentet kryesore financiare dhe analizon realizimin e objektivave të institucionit, në përputhje me kërkesat ligjore për funksionimin e tij.

Nga auditimi u konstatua se ISSH nuk ka miratuar një Plan Veprimi të posaçëm për sistemin e kontrollit të brendshëm, si pasojë mungojnë edhe raportimet periodike të monitorimit mbi zbatimin e këtij plani. Gjithashtu, objektivat dhe Plani i Punës, i miratuar nga titullari i institucionit për vitin 2024, nuk janë të hartuara në përputhje me formatin dhe përmbajtjen e parashikuar në Aneksin nr. 1 të Manualit të MFK-së i ndryshuar.

Po ashtu, u konstatua se titullari i ISSH-së nuk ka miratuar një plan të veçantë për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë, në mospërputhje me kërkesat e përcaktuara në Aneksin nr. 5 të po këtij Manuali.

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organi gramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiave funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

ISSH ka përfshirë njësitë vartëse në procesin e hartimit të treguesve buxhetorë vjetorë dhe afatmesëm përmes takimeve dhe udhëzimeve të detajuara. Struktura organizative është miratuar me VKA nr. 13, datë 28.12.2023, dhe është rishikuar rregullorja për funksionimin e institucionit e cila nuk është harmonizuar me kërkesat e përcaktuara në Aneksin nr. 8 të Manualit të MFK-së, i ndryshuar. Në rregullore janë përcaktuar përgjegjësitë e menaxherëve, por procedurat e delegimit të detyrave mbeten të paplota, veçanërisht në rastet e mungesës së përgjegjësve. Institucionet vartëse dhe dokumentacioni përkatës janë të aksesueshme publikisht në faqen zyrtare të ISSH-së.

Nga auditimi u konstatua se ISSH nuk disponon një dokument strategjik të miratuar, i cili të përcaktojë objektivat afatmesme dhe afatgjata, prioritetet zhvillimore dhe drejtimet kryesore të institucionit, në përputhje me kërkesat e nenit 8 (a) të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, të ndryshuar, si dhe të pikës 2.3 të Manualit të MFK-së i ndryshuar. Mungesa e një strategjie të miratuar cenon procesin e planifikimit strategjik dhe monitorimit të performancës institucionale, duke ndikuar negativisht në përcaktimin, ndjekjen dhe matjen e objektivave të qarta dhe të matshme për përmirësimin e eficiencës dhe efektivitetit të ISSH-së.

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësive.

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2024, në strukturën e ISSH-së janë miratuar gjithsej 1,265 pozicione pune, nga të cilat janë mbuluar realisht 1,223, duke lënë 42 pozicione vakante. Në Drejtorinë Qendrore janë evidentuar 9 vakanca, në Drejtorinë Rajonale 27 vakanca dhe në Drejtorinë e Arkivit Qendror 6 vakanca. Kjo situatë paraqet risk në mirëfunksionimin dhe efikasitetin e veprimtarisë institucionale.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar 9 emërimet të reja, ndërkohë që janë regjistruar 5 dorëheqje, 9 dalje në pension, 1 lirim nga detyra dhe 17 lëvizje të brendshme.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të personelit u konstatuan mangësi në dosjet e punonjësve, përkatësisht: mungesë e certifikatave personale dhe të gjendjes familjare në 25 raste, mungesë e vlerësimit të performancës për vitin 2024 në 5 raste, mungesë ose mungesë nënshkrimi të kontratës së punës në 5 raste, si dhe dokumentacion arsimor jo i plotë në 4 raste.

ISSH ka zbatuar një program vjetor trajnimesh të miratuar me Urdhrin nr. 561, datë 16.01.2024, duke përfshirë 13 aktivitete me pjesëmarrjen e 528 punonjës nga 556 të planifikuar. Megjithatë, për menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK) janë trajnuar vetëm 50 punonjës, çka konsiderohet e pamjaftueshme për të siguruar përhapjen efektive të njohurive dhe zbatimin e standardeve të MFK-së në të gjitha nivelet e institucionit.

Gjithashtu, ndonëse ISSH nuk është i detyruar të krijojë një Komitet të Auditimit të Brendshëm, pasi mbikëqyrja realizohet nga Komiteti pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, rezultoi se gjatë vitit 2024 ISSH nuk ka dërguar raportime periodike në këtë komitet, duke mos respektuar detyrimin për raportim të përcaktuar në nenin 13 të ligjit nr. 114/2015 dhe VKM nr. 160/2016.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësiave dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm. Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2024 në ISSH ka funksionuar praktika e delegimit të detyrave sipas varësisë, megjithatë mungojnë rregulla të qarta të brendshme për mënyrën e delegimit në rastet e mungesës ose zëvendësimit të personave përgjegjës.

Po ashtu, Institucioni vijon të përdorë Rregulloren nr. 3739/12 prot., datë 05.12.2012 për funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS), pa një urdhër të përditësuar për vitin 2024, në mospërputhje me kërkesat e nenit 27, pika 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, si dhe të Manualit të MFK-së, miratuar me urdhrin nr. 4, datë 26.01.2024.

Ndryshimet në strukturën organizative ndër vite nuk janë reflektuar në rregulloren ekzistuese, ndërsa për vitin 2024 mungojnë procesverbalet që dokumentojnë mbledhjet, diskutimet dhe vendimmarrjet e GMS-së. Kjo tregon mangësi në dokumentimin dhe funksionimin e strukturuar të GMS-së, duke cenuar transparencën, qartësinë institucionale dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2024, ISSH ka hartuar dhe miratuar programe afatmesme trevjeçare dhe programe vjetore për të gjitha njësitë shpenzuese, në përputhje me kërkesat ligjore dhe në bashkëpunim me njësitë vartëse. Treguesit buxhetorë janë miratuar me ligj dhe objektivat janë publikuar. Hartimi i buxhetit është mbështetur në dokumente strategjike të politikave të programit dhe është shoqëruar me plan-veprime vjetore operationale, me afate dhe përgjegjësi të përcaktuara, të miratuara nga titullari i institucionit.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

Nga auditimi u konstatua se, ndonëse ISSH ka ndërmarrë hapa për ngritjen dhe funksionimin e strukturave për menaxhimin e riskut dhe ka emëruar Koordinatorin e Riskut me urdhër të posaçëm, nuk është nxjerrë një urdhër i veçantë për ngritjen formale të Grupit të Menaxhimit të Riskut (GMR), në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër nr. 4, datë 26.01.2024, Kapitulli III, pika 3.2.

Gjithashtu, gjatë auditimit nuk janë vënë në dispozicion dokumente justifikuese për funksionimin e GMR-së, si procesverbalet e mbledhjeve, planet konkrete të menaxhimit të risqeve dhe raportet e monitorimit. Po ashtu, nuk është përditësuar Regjistri i Riskut dhe mungojnë plane të miratuara masash për menaxhimin e risqeve, që të përcaktojnë qartësisht strukturat përgjegjëse (pronarët e riskut), trajtimin e risqeve në të gjitha nivelet, si dhe mekanizmat e matjes dhe vlerësimit. Kjo përbën mospërputhje me kërkesat e anekseve 4, 5, 6 dhe 7 të Manualit të MFK-së dhe cenon efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit

të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

Nga auditimi rezultoi se, ndonëse ISSH ka deklaruar se vlerësimi i riskut të mashtrimit është pjesë e procesit të menaxhimit të riskut dhe janë raportuar masa parandaluese për minimizimin e tij, nuk janë vënë në dispozicion dokumente që vërtetojnë përfshirjen konkrete dhe të dokumentuar të këtij vlerësimi në procesin formal të analizës së riskut për vitin 2024. Po ashtu, mungon një sistem i strukturuar për raportimin dhe trajtimin e rasteve të mundshme të mashtrimit apo shkeljeve të rregullave në fuqi. Kjo tregon një boshllëk në funksionimin praktik të mekanizmave të parandalimit dhe identifikimit të riskut të mashtrimit brenda institucionit.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

Referuar të dhënave të vetëvlerësimit, rezultoi se gjatë vitit 2024 ISSH nuk ka ndërmarrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për përditësimin e regjistrit e riskut dhe hartimin e objektivave strategjike të institucionit edhe pse janë kryer disa ndryshime organizative në strukturën e njësisë së inspektimit të përfitimeve afatgjata dhe afatshkurtra, me qëllim rritjen e efektivitetit të monitorimit dhe mbikëqyrjes mbi zbatimin e legjislacionit në fushën e përfitimeve.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

Nga auditimi rezultoi se ISSH dhe njësitë vartëse kanë zbatuar parimet bazë të kontrollit të brendshëm, përfshirë ndarjen e detyrave, sistemin e dy firmave për transaksionet financiare, procedurat e prokurimit, menaxhimin e aktiveve dhe administrimin e dokumentacionit arkivor. Janë respektuar rregullat për ngritjen e komisioneve të prokurimit dhe është përditësuar Regjistri Vjetor i Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit.

Megjithatë, u konstatua se mungojnë manualët e punës për proceset kyçe të institucionit, të cilat janë të domosdoshme për të garantuar standardizimin e procedurave, ndarjen e qartë të detyrave dhe përgjegjësi, si dhe për të dokumentuar aktivitetet e kontrollit të integruara në proceset operacionale. Kjo situatë përbën mospërputhje me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (pika 3.3.2 dhe Aneksi 2), çka ndikon në qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm institucional.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

Nga auditimi rezultoi se ISSH ka në funksion sisteme të komunikimit të brendshëm dhe përdor platforma të integruara financiare dhe operative si FMS, PCAMS, CMIS dhe DMAIS. Janë ndërmarrë masa bazë për mbrojtjen e të dhënave dhe aktiveve kundër aksesit të paautorizuar, përmes fireëall-it, menaxhimit të fjalëkalimeve dhe kufizimit të aksesit sipas roleve të përdoruesve.

Megjithatë, Drejtoria e Burimeve të Informacionit nuk disponon një rregullore të dedikuar që të përcaktojë qartë përgjegjësitë për administrimin dhe funksionimin e sistemeve IT. Përgjegjësitë aktuale mbështeten vetëm në përshkrimet e pozicioneve të punës, duke krijuar paqartësi në ndarjen funksionale të roleve dhe detyrave.

Gjithashtu, ISSH nuk ka vendosur procedura të dokumentuara për të garantuar vazhdimësinë e veprimtarive operacionale në rast rreziku të jashtëm si zjarri, përmbytjet apo fatkeqësitë natyrore. Edhe pse është në funksion sistemi i ruajtjes së të dhënave (back-up), mungon një BCC, çka rrit rrezikun për ndërprerje të zgjatur ose humbje të pakthyeshme të të dhënave në rast incidentesh madhore.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave. Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2024 ISSH ka përcaktuar përgjegjësitë për kontrollin financiar në përputhje me ndarjen funksionale të roleve, duke shmangur përfshirjen e të njëjtit person në më shumë se një fazë të të njëjtit transaksion. Janë zbatuar procedura kontrolli për integritetin, sigurinë dhe rakordimin e të dhënave financiare, si dhe për ruajtjen e pasqyrave financiare, të cilat nënshkruhen nga strukturat përgjegjëse në qendër dhe në degë.

Megjithatë, u konstatua se ISSH nuk ka përditësuar në mënyrë të vazhdueshme gjurmët e auditimit për proceset financiare dhe jo financiare. Kjo situatë kufizon mundësinë e ndjekjes së ecures së veprimeve dhe dokumentimit të hapave të një procesi të plotë, duke krijuar mospërputhje me kërkesat e Aneksit nr. 3 të Manualit të MFK-së në lidhje me transparencën, verifikueshmërinë dhe dokumentimin sistematik të procedurave.

IV. Komponenti: "Informimi dhe komunikimi"

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Referuar të dhënave të vetëvlerësimit, u konstatua se gjatë vitit 2024 në ISSH ekziston një sistem raportimi mbi realizimin e buxhetit dhe ecurinë e shpenzimeve krahasuar me planifikimet, në total dhe sipas programeve. Titullari i institucionit dhe drejtuesit e programeve informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi këto të dhëna. Institucioni shkëmben të dhëna përmes rrjetit gov.net me DPGJC, QKR, MF dhe DPT.

Evidencat e raportimit të buxhetit janë të përmuajshme dhe dorëzohen rregullisht nga të gjitha njësitë vartëse në Drejtorinë Qendrore. ISSH ndjek gjithashtu në baza ditore treguesit e të ardhurave nga kontributet dhe shpenzimet për pagesat e pensione.

Raportimet financiare në SIFQ kryhen nga një përdorues i vetëm i autorizuar, ndërkohë që në institucion është implementuar sistemi financiar ORACLE, i cili aktualisht nuk është i ndërfaqësuar me sistemin ORACLE të Ministrisë së Financave.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2024, në ISSH janë zbatuar procedura dhe praktika të përcaktuara për informimin e punonjësve mbi ndryshimet ligjore, udhëzimet e reja dhe Vendimet e Këshillit Administrativ, në përputhje me fushën e tyre të përgjegjësisë. ISSH përgatit raporte dhe publikime vjetore mbi performancën e tij lidhur me shërbimet publike të ofruara qytetarëve, të cilat publikohen rregullisht në faqen zyrtare të internetit të ISSH-së. Për çdo lëvizje ose alokim të buxhetit, realizohet informimi në formë shkresore ndaj drejtuesve të programeve dhe njësive vartëse përkatëse.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2024 të gjithë punonjësit e ISSH-së janë pajisur me adresa personale zyrtare të e-mailit dhe përdorin komunikimin elektronik për shkëmbimin e informacionit dhe çështjeve të lidhura me punën.

ISSH ka ndërtuar një sistem komunikimi me qytetarët dhe bizneset, si përmes faqes zyrtare të internetit, ashtu edhe nëpërmjet platformës qeveritare E-Albania, në funksion që prej datës 1 maj 2022.

Në institucion funksionojnë struktura të posaçme që monitorojnë dhe analizojnë reagimet dhe kërkesat e qytetarëve, përmes komunikimeve verbale dhe shkresore, të administruara nga punonjësit në njësitë përkatëse territoriale.

Në faqen zyrtare të internetit të ISSH-së janë publikuar raportime statistikore financiare, baza ligjore mbi të cilën funksionon sistemi i sigurimeve shoqërore, si dhe materiale informuese dhe broshura sensibilizuese për publikun.

V. Komponenti: "Monitorimi"

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2024, ISSH ka realizuar procesin e vetëvlerësimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si në Drejtorinë Qendrore ashtu edhe në njësitë vartëse, në përputhje me kërkesat ligjore për menaxhimin buxhetor dhe financiar. Njësia e Auditimit të Brendshëm është funksionale, me strukturë të miratuar dhe ka hartuar dokumentet përkatëse vjetore dhe strategjike të auditimit.

Megjithatë, u konstatua se ISSH nuk ka hartuar një dokument të posaçëm për monitorimin e zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe mungon një Plan Veprimi i MFK-së për ndjekjen e progresit, matjen e rezultateve dhe analizën e shkaqeve të dështimeve në realizimin e objektivave. Kjo situatë përbën mospërputhje me kërkesat e Manualit të MFK-së dhe të ligjit nr. 10296/2010, duke cenuar efektivitetin e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm dhe të vetë-monitorimit institucional.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.

Gjatë vitit 2024, ISSH ka reflektuar në raportin e menaxhimit financiar të dhënat mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm, duke dokumentuar rezultatet e arritura dhe masat e ndërmarra për përmirësim. Pas analizës së çdo raporti auditimi të brendshëm, është hartuar një plan veprimi me masa konkrete për zbatimin e rekomandimeve, i cili është ndjekur dhe monitoruar nga titullari i institucionit.

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm mban një regjistër të rekomandimeve për çdo subjekt të audituar dhe e përditëson rregullisht statusin e zbatimit në bazë të informacionit të marrë nga njësitë përkatëse. Për rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), ISSH ka ndërmarrë masa korrigjuese përmes planeve të veprimit dhe ka organizuar ndjekjen me programe të dedikuara, duke dëshmuar një angazhim të qëndrueshëm në përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit institucional.

Për sa më sipër, arrihet në konkluzionin se:

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm funksionojnë pjesërisht, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

- ISSH nuk ka miratuar një Plan Veprimi të posaçëm për sistemin e kontrollit të brendshëm, si pasojë mungojnë edhe raportimet periodike të monitorimit mbi zbatimin e këtij plani.
- Objektivat dhe Plani i Punës nuk janë hartuar në përputhje me formatin dhe përmbajtjen e përcaktuar në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- ISSH nuk ka miratuar një plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë, në mospërputhje me kërkesat e Manualit të MFK-së.
- Institucioni nuk disponon një dokument strategjik të miratuar që të përcaktojë objektivat afatmesme dhe afatgjata, prioritetet zhvillimore dhe drejtimit kryesore të veprimtarisë së ISSH-së.
- Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e ISSH-së nuk është rishikuar dhe harmonizuar me kërkesat e Manualit të MFK-së, të miratuar me Urdhër nr. 4, datë 26.01.2024.
- ISSH nuk ka përcjellë raporte periodike pranë Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi për auditimin e brendshëm në sektorin publik.
- Nuk është nxjerrë urdhër për përbërjen dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) për vitin 2024, në përputhje me Manualin e MFK-së.
- Mungojnë procesverbalet e mbledhjeve të GMS-së që të dokumentojnë diskutimet, analizat dhe vendimmarrjet lidhur me realizimin e detyrave të këtij grupi.
- Mungesat e burimeve njerëzore në strukturën organizative të ISSH-së mund të ndikojnë negativisht në funksionimin efikas të proceseve dhe në uljen e performancës së përgjithshme institucionale.

Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

- Koordinator i Riskut nuk ka përditësuar Regjistrin e Riskut dhe nuk ka hartuar plane të masave për menaxhimin e risqeve, të cilat duhet të përcaktojnë qartë strukturat përgjegjëse (pronarët e risqeve), trajtimin e risqeve në nivel strategjik, programi dhe aktiviteti, si dhe mekanizmat për monitorimin, vlerësimin dhe matjen e risqeve, në përputhje me kërkesat e Manualit të MFK-së.
- Vlerësimi i riskut të mashtimit nuk është i integruar si pjesë përbërëse e procesit të rregullt të vlerësimit të riskut. Gjithashtu, mungon një sistem formal raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo për rastet e mundshme të mashtimit.

Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

- Në ISSH mungojnë manualët e punës për proceset kyçe, të cilat do të garantonin uniformitetin në kryerjen e aktiviteteve, identifikimin e qartë të detyrave, përgjegjësi dhe afateve për realizimin e tyre, si dhe pasqyrimin e veprimtarive të kontrollit të integruara në çdo proces pune.

- Konstatohet mungesa e një BCC, duke rritur rrezikun për mosrikuperimin e funksioneve kritike në rast të ndërprerjeve madhore të veprimtarisë institucionale.

- ISSH nuk ka përditësuar gjurmët e auditimit në mënyrë të vazhdueshme, për të siguruar pasqyrimin e qartë të ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban çdo proces, në mospërputhje me kërkesat e Aneksit nr. 3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

- ISSH disponon një sistem komunikimi si brenda ashtu edhe jashtë institucionit, por ky sistem nuk siguron informacion të strukturuar dhe të rregullt për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave strategjike dhe operacionale, si në nivel institucioni ashtu edhe në nivel njësisht vartëse.

- Nuk rezulton të ketë raportime periodike dhe të dokumentuara nga drejtoritë përkatëse mbi realizimin e objektivave të tyre.

Komponenti: “Monitorimi”

- ISSH nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për monitorimin e zbatimit të Planit të Kontrollit të Brendshëm.

- Nuk është miratuar një Plan Veprimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për ndjekjen e progresit në arritjen e objektivave dhe për analizën e shkaqeve të dështimeve të mundshme.

Organizimi, përbërja dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm

I. Organizimi dhe funksionimi i DAB.

Në përputhje me nenin 10, pika 1 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore është krijuar dhe funksionon Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB). Kjo strukturë ushtron veprimtarinë e saj në varësi funksionale nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së, duke respektuar parimin e pavarësisë së funksionit të auditimit të brendshëm, në përputhje me kërkesat e standardit nr. 1100 të Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm (IIA). Varësia funksionale e DAB është e përcaktuar edhe në nenin 12 të VKM nr. 1022, datë 09.07.2008, që ndryshon VKM nr. 161, datë 11.04.1994 “Për miratimin e Statutit të ISSH-së”.

Misioni i Auditit të Brendshëm në ISSH, mbështetur në nenin 5, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, është të japë siguri të arsyeshme për Titullarin e Institucionit, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.

Objektivat e DAB janë: Siguridhënia objektive ndaj Titullarit të ISSH-së, zbatimi i proceseve të punës kryhet me efikasitet, efikasitet dhe ekonomikitet, në përmbushje të objektivave të përcaktuara; zhvillimi i një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit; shtimi i vlerës dhe përmirësimi i veprimtarisë së ISSH-së; kryerja e auditimeve të vazhdueshme, duke siguruar që çdo DRSSH dhe Degë të mos mbetet pa u kontrolluar për një periudhë më shumë se dy vjet, me qëllim shmangien e risqeve që mund të kërcënojnë skemën e sigurimeve shoqërore, aktivitetin e njësisht vartëse të ISSH-së, si dhe vetë aktivitetin e ISSH-së në tërësi.

II. Analiza dhe vlerësimi i burimeve njerëzore të DAB.

Për vitin 2024, veprimtaria e DAB është mbështetur në ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, Kapitulli III “Planifikimi i veprimtarive të Auditimit të Brendshëm”, Kapitulli IV “Kryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit. Përveç këtyre akteve, në punën audituese, ka shërbyer edhe legjislacioni në fuqi, sipas fushave objekt auditimi.

DAB e realizon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në:

- ✓ Drejtorinë e Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore;
- ✓ 12 Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore;
- ✓ 2 Drejtori Qarku;

✓ Drejtorinë e Arkivit Qendror të ISSH.

Organika e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm është miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 13, datë 29.12.2023, "Për miratimin e strukturës organizative të ISSH-së dhe miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të ISSH-së". Sipas këtij vendimi, struktura e DAB është e përbërë nga gjithsej **8 punonjës**, nga të cilët **1 Drejtor, dhe 7 Specialistë Auditues**. Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, z. Petrit Bregasi, është larguar nga detyra për shkak të daljes në pension. Pas këtij zhvillimi, drejtimi i drejtorisë është marrë nga z. Gerti Bode, i cili më parë ushtronte funksionin e specialistit të auditimit brenda së njëjtës njësi.

Po ashtu, u konstatua se znj. Vera Mena, një nga auditueset e DAB-së, ka dalë në pension më datë 12.02.2024. Si pasojë, gjatë periudhës janar-qershor 2024, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar me 4 pozicione vakante. Dy prej tyre janë plotësuar: një me punësimin e z. Gazment Duraj (Urdhri nr. 5357, datë 03.05.2024) dhe një tjetër me komandimin e znj. Nevila Beshiku (Urdhri nr. 9924, datë 26.09.2024). Një pozicion vijon të mbetet i paplotësuar përgjatë gjithë periudhës objekt auditimi.

Si konkluzion, gjatë vitit 2024, DAB ka funksionuar me një strukturë jo të plotë, ku dy pozicione janë plotësuar përgjatë vitit, një pozicion ka mbetur vakant dhe një tjetër është mbuluar përkohësisht nëpërmjet komandimit. Gjithashtu, vërehet se të gjithë audituesit e emëruar ose të komanduar gjatë këtij viti janë të profilin ekonomik, ndërkohë që nuk është siguruar diversitet në profilet e audituesve, pavarësisht përcaktimeve të nenit 11 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i cili parashikon që audituesit të kenë diplomë të arsimit të lartë në shkencat ekonomike, juridike ose në disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet. Kjo situatë kufizon kapacitetin profesional dhe shumëdimensional të funksionit të auditimit të brendshëm, duke reduktuar mundësinë për të adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjet që kërkojnë njohuri përtej fushës ekonomike dhe duke rritur riskun për mangësi në vlerësimin e aspekteve ligjore, procedurale apo të natyrës ndërdisiplinore.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, në zbatim të pikave nr. 1, 2 dhe 6, të VKM nr. 816, datë 16.11.2016 "Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Drejtori i Përgjithshëm i ISSH me urdhrin nr. 01 prot., datë 27.03.2024, ka ngritur strukturën e Njesisë Përgjegjëse të Sinjalizimit. Punonjësit e Njesisë Përgjegjëse të Sinjalizimit janë, Drejtori i DAB, z. Gerti Bode dhe një prej audituesve z. Ali Brahaj.

III. Trajnimet e NjAB dhe certifikimet

Audituesit e brendshëm duhet të zgjerojnë njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përgjegjësia për trajnimin nuk është vetëm e drejtuesit të auditimit të brendshëm ose struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit, por çdo auditues duhet të përditësojë individualisht njohuritë dhe aftësitë e veta mbi zhvillimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi teknikat dhe praktikatat e reja të auditimit.

Me shkresën nr. 7353 prot., datë 23.05.2024, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave i ka dërguar njoftim për pjesëmarrje në trajnimin e vazhdueshëm profesional audituesve të brendshëm në sektorin publik për vitin 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, u konstatua se punonjësit e DAB kanë kryer trajnimet e vijueshme të detyrueshme, 40 orë në vit dhe kanë marrë pjesë në të gjitha trajnimet që ka organizuar Njësia Qendrore e Auditit të Brendshëm (NJQAB).

IV. Komiteti i Auditit të Brendshëm.

ISSH nuk ka krijuar Komitet të Auditimit të Brendshëm, pasi për ISSH këtë rol e luan Komiteti i Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës, Inovacionit i cili është organ epror për këtë institucion, bazuar në pikë nr. 2, neni 13, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", si dhe në VKM nr. 160 datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike", i cili përcakton në Kreun II, pika nr. 2: "Njësitë publike, të cilat kanë varësi funksionale

nga një organ epror dhe kanë në strukturën e tyre organizative njësi të auditimit të brendshëm nuk krijojnë komitet, por mbikëqyren nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm i organit epror”.

V. Karta e Auditimit.

Karta e Auditimit përbën një akt administrativ të miratuar me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë së auditimit të brendshëm, si dhe përcakton qëllimin, misionin, objektivat, përgjegjësitë dhe detyrat e kësaj njësie.

Në zbatim të pikës (c), të nenit 12 të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e Kartës së Auditimit, dhe në përputhje me pikën (a), të nenit 14 të po këtij ligji, ku përcaktohet se “drejtuesi i NJAB është përgjegjës për organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, hartimin e Kartës së Auditimit sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me nenin 8”, NJAB ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” për ISSH-në, e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr. 7671 prot., datë 12.11.2019.

Nga auditimi rezultoi se, Karta e Auditimit nuk është përditësuar në përputhje me ndryshimet e parashikuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar. Sipas tij, në objektin e Kartës së Auditimit, sikurse parashikohet edhe nga ligji për auditimin e brendshëm, duhet të përfshihen qartë shërbimet e sigurimit dhe shërbimet e këshillimit që ofrohen nga NJAB për njësinë publike. Gjithashtu, në rastet kur këto shërbime u ofrohen edhe palëve të jashtme të njësisë publike, duhet të përcaktohet qartë në Kartë edhe lloji i këtyre shërbimeve. Mungesa e këtij përditësimi përbën një mospërputhje me kërkesat metodologjike dhe standardet profesionale në fuqi për auditimin e brendshëm.

VI. Përgatitja e Planit Strategjik 2024-2026 dhe të Vitit 2024.

Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publike edhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm.

Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE Nr.100, datë 25.10.2016, përcaktohet se:

“Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitet e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën 10 Tetor të çdo viti. Planet pas dhënies së mendimit të KAB-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data 20 Tetor e çdo viti, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.....”

Për periudhën objekt auditimi, DAB në ISSH ka hartuar planin strategjik dhe vjetor për vitet 2024-2026. Me shkresën nr. 7662/1 prot., datë 16.10.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH janë dërguar në Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (NJQH/AB). Nga auditimi u konstatua se, planet janë dërguar brenda afatit (20 Tetor), të përcaktuara në pikën 3.2 “Plani vjetor i auditit të brendshëm” dhe pikën 3.3 “Afati i përgatitjes dhe dërgimit të planit vjetor dhe strategjik të auditit të brendshëm”, në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Plani strategjik i auditimit të brendshëm për periudhën 2024–2026, i hartuar nga NJAB në përputhje me metodologjinë e miratuar dhe me standardet profesionale, parashikon auditimin e njësive të sistemit të sigurimeve shoqërore, së bashku me identifikimin e fushave prioritare, funksioneve dhe sistemeve të rrezikut.

NJAB ka identifikuar subjektet që do të përfshihen në procesin e auditimit, si dhe sistemet, funksionet dhe fushat prioritare ku do të fokusohet veprimtaria auditues. Për secilin prej sistemeve të parashikuara për auditim, NJAB ka përcaktuar opinionin dhe vlerësimin që synon të realizojë, duke iu referuar objektivave të funksionit të auditimit të brendshëm dhe parimeve të menaxhimit të riskut. Universi i auditimit është ndërtuar mbi bazën e strukturës organizative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe përfshin të gjitha njësitë shpenzuese të sistemit të sigurimeve shoqërore, përkatësisht Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së, dymbëdhjetë drejtoritë rajonale të

organizuara sipas ndarjes administrative në nivel qarku, dy degët e veçanta DSSH Sarandë dhe DSSH Tropojë, si dhe Drejtorinë Qendrore të Arkivës së ISSH-së. Kjo përzgjedhje synon të sigurojë një mbulim të plotë dhe të strukturuar të sistemit institucional të ISSH-së, duke krijuar bazën për auditime efektive që kontribuojnë në përmirësimin e menaxhimit të burimeve publike dhe garantimin e integritetit të proceseve administrative.

Mbështetur në Standardin Ndërkombëtar të Auditimit të Brendshëm nr. 2060, si dhe në Manualin e Auditimit të Brendshëm, ku përcaktohet se *"Drejtpuesi i auditimit të brendshëm duhet t'i raportojë periodikisht menaxhimit të lartë dhe bordit mbi qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe rezultatin e aktivitetit të auditimit të brendshëm në raport me planin e tij"*, nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) nuk ka përcjellë gjatë vitit 2024 raportime periodike pranë Këshillit Administrativ lidhur me realizimin e planit të auditimit apo përmbledhje të rezultateve të tij.

Megjithatë DAB ka përgatitur raportin vjetor për periudhën janar–dhjetor 2024 dhe e ka përcjellë atë vetëm te Drejtori i Përgjithshëm, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokument që të vërtetojë dërgimin e ndonjë informacioni pranë Këshillit Administrativ gjatë vitit 2024. Mungesa e këtij raportimi bie në kundërshtim me kërkesat standarde për transparencë dhe përgjegjshmëri në raport me organin mbikëqyrës.

VII. Identifikimi i sistemeve dhe fushat me risk për auditim.

DAB në bazë të vlerësimit të riskut dhe në funksion të zbatimit dhe përmbushjes së objektivave strategjikë të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ka vlerësuar dhe përzgjedhur sistemet dhe funksionet prioritare që do të përfshihen në angazhimet e auditimit, të cilat paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 3: Sistemet prioritare të parashikuara për auditim gjatë vitit 2024

Nr.	Vlerësimi i Sistemeve	Vlerësimi i Funksioneve	Vlerësimi i Veprimtarisë së Drejtorive në Drejtorinë e Përgjithshme
1	PCAMS- Sistemi i Llogaritjes dhe Menaxhimit të Pensioneve;	Funksioni i degës së përfitimeve	Drejtoria e Përfitimeve
2	CMIS- Sistemi i Menaxhimit të Kontributeve;	Funksioni i degës së përfitimeve	Drejtoria e Financës
3	FMS (ORACLE)- Sistemi i Menaxhimit Financiar;	Funksioni i degës së administrimit	Drejtoria e Kontributeve
4	HRMSI- Integrimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	Funksioni i degës së (TI)	Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm
5	APP- Agjencia e Prokurimit Publik	Funksioni i degës juridike	Drejtoria Juridike
6	E-Albania- Portali unik qeveritar shumë funksional.	Funksioni i degës së arkivës	Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit
7		Funksioni i ankimit në dy shkallë	Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun
8		Funksioni i ekspertizës mjekësore	Drejtoria e Inspektimit të përfitimeve

Burimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, në ISSH.

Nga auditimi konstatohet se, në kuadër të procesit të vlerësimit të riskut për përzgjedhjen e subjekteve dhe fushave për auditim gjatë vitit 2024, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) ka përfshirë edhe komponentët e teknologjisë së informacionit (TI) si pjesë të misionëve të auditimit. Kjo qasje përputhet me natyrën komplekse dhe të automatizuar të proceseve institucionale të ISSH-së, veçanërisht në sistemet që lidhen me përfitimet dhe të ardhurat. Megjithatë, evidentohet se në strukturën aktuale të NJAB mungon një auditues i brendshëm me profil dhe ekspertizë specifike në fushën e TI-së.

Ndërkohë që niveli i riskut në Drejtorinë e Përgjithshme është vlerësuar si i mesëm, në 15 drejtoritë rajonale janë identifikuar risqe të larta në fushat që lidhen me pagesat, përfitimet dhe të ardhurat. Në këtë kontekst, mungesa e kapaciteteve profesionale në auditimin e sistemeve TI përbën një mangësi që ndikon në thellësinë, cilësinë dhe efektivitetin e vlerësimit të risqeve teknologjike.

VII. Realizimi i programeve të DAB-së për vitin 2024.

Programi vjetor i auditimit për vitin 2024 është hartuar mbi bazën e Planit Strategjik të Auditimeve, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr. 7662/1 prot., datë 16.10.2023.

Nga auditimi rezultoi se, gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithsej **14 misione auditimi**, të shpërndara sipas kategorive si më poshtë:

-10 misione auditimi përputhshmërie dhe financiare, të cilat janë zhvilluar pranë njësive të ndryshme të sistemit të sigurimeve shoqërore. Në këto misione është audituar veprimtaria organizative dhe funksionale në të gjitha fushat dhe sistemet përkatëse, me fokus në vlerësimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare;

-1 mision auditimi financiar, i cili është zhvilluar në Drejtorinë Qendrore të ISSH-së;

-1 mision auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit, i zhvilluar po ashtu në Drejtorinë Qendrore të ISSH-së, me qëllim vlerësimin e proceseve dhe menaxhimit të sistemeve IT;

-1 mision auditimi për ndjekjen e rekomandimeve, i cili kishte për qëllim vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera gjatë vitit 2023 në të gjitha subjektet përkatëse.

- 1 mision auditimi tematik i zhvilluar në DRSSH Sarandë, i cili është zhvilluar me kërkesë të Titullarit me qëllim verifikimin e pagesave shtesë të përfituara nga inspektorët e kontributeve për personat e vetëpunësuar në bujqësi, të akorduara si formë shpërblimi (bonus) mbi bazën e rezultateve të arritura dhe të ardhurave të realizuara në territorin që ata mbulojnë. Realizimi i misioneve audituese për vitin 2024, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 4: Realizimi i misioneve të auditimit për vitin 2024,

Realizimi i angazhimeve të auditimit											
Nr	Subjekte të audituara nga DAB	Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjithsëj	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime kërkesë titullari	Angazh. të përfunduara	Angazh në proces
			Përfutsh	Perform.	Financë	IT	Të kombinuara				
1	DRSSH VLORE	1					1			1	
2	DSSH SARANDË	1					1			1	
3	DRSSH ELBASAN	1					1			1	
4	ZB. I REKOMANDIMEVE	1	1							1	
5	DRSSH KUKËS	1					1			2	
6	DSSH TROPOJË	1					1			1	
7	DSSH SARANDË	1							1	1	
8	ISSH Drejtoria e Financës	2	1		1					1	
9	ISSH Drejtoria e Burimeve Informacionit	1				1				1	
10	DRSSH FIER	1					1			1	
11	DRSSH SHKODËR	1					1			1	
12	DRSSH GJIROKASTËR	1					1			1	
13	DRSSH ËS	1					1			1	
Totali		14	2	0	1	1	9	0	1	14	0

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Gjithashtu, mbështetur në Kapitullin VII, pika 7.1.1. “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë Njësia e Auditimit të Brendshëm”, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar; me shkresën nr. 574/1 prot., datë 14.02.2025, është dërguar nga ISSH, Aneksi 3 “Pyetësori i Vetëvlerësimit të DAB”, të DHAB në MFE. Pyetësori përmban në total 40 pyetje dhe të gjitha përgjigjet janë dhënë nga DAB: “përputhshmëri e plotë”.

VIII. Gjetjet/Rekomandimet.

Bazuar në fushat e gjetjeve, sipas auditimeve të kryera nga DAB, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 janë evidentuar 103 gjetje, si dhe shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në vlerën 6,893,6 mijë lekë.

Gjetjet kryesore nga auditimet lidhen kryesisht me:

✓ *Sistemin e proceseve organizative. Menaxhimi i burimeve njerëzore.*

- Në disa raste rezultojnë të mos jetë i plotë dokumentacioni për vlerësime dhe shkallëzim vjetor të punonjësve;

- Është konstatuar se nuk zbatohet Rregullore nr. 3/2 datë 26.02.2008 “Për personelin e ISSH-së”, për shtesat mbi pagë dhe vlerësimi në mënyrë periodike, shkallë pas shkalle dhe vit pas viti për punonjësit me të cilët bëhet rritja në detyrë dhe shkallë pagese;

- Është konstatuar se në rregulloret e brendshme të DRSSH-ve, nuk janë të përcaktuara qartë detyrat konkrete për çdo punonjës brenda degëve të kësaj drejtorie, në lidhje me funksionet që duhet të ushtrojnë konform dispozitave ligjore.

✓ *Sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit.*

- Buxheti i shpenzimeve të DRSSH-ve gjatë vitit ushtrimor ka ndryshime të shpeshta;

-Ka rritje të debitorëve që vinë nga llogaritjet e gabuara të përfitimeve apo rezultuar debitorë për përfitime të padrejta për shkak të punësimeve që ndalohen me ligj.

✓ *Sistemin e programimit dhe realizimit të të ardhurave.*

-Nuk mbahen dosje për kontribuesit e vetëpunësuar në bujqësi sipas udhëzimeve përkatëse.

- Vonesa në hedhjen e të dhënave në programin CMIS si dhe transferimi i kontribuesve të vetpunësuar në bujqësi, në historikun kontributiv.

-Struktura e Degës së Financës në bashkëpunim me Degën e Postës Shqiptare, nuk kanë marrë masa për respektimin e afateve të përcaktuara në Marrëveshjen me Postën Shqiptare nr. 4537/1932, datë 21.08.2008, midis ISSH-së dhe Postës Shqiptare për derdhjen e të ardhurave në llogarinë e DRSSH-së

✓ *Sistemin e caktimit të pagesave të përfitimeve afatgjata dhe afatshkurtra.*

-Tejkalim të afateve të përcaktuara të lidhjes së pensioneve të reja, të rishqyrtimeve kryesisht afatet e lidhjes së pensioneve të invaliditetit.

-Është konstatuar një numër i lartë kërkesash për rishqyrtime, për shkak të: Mosnjohjes së vjetërsisë në punë; Mungesës së listëpagesave për periudhat kontributive pas vitit 1994; Problemeve me fondin arkivor të sigurimeve; Mungesës së informacionit dhe transparencës ndaj qytetarëve.

-Janë identifikuar raste ku specialistët nuk plotësojnë të gjitha rubrikat e programit të pensioneve gjatë përpunimit të të dhënave dhe caktimit të masës së përfitimit.

-Për përfitimet afatshkurtra janë evidentuar raste të përfitimeve të dhëna në kundërshtim me ligjin, kryesisht për raportet e barrë lindjes.

-Janë konstatuar raste të dhënies së shtesave kreditore për rishqyrtime të përfitimeve afatgjata në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi.

-Ka pasur diferenca debitore dhe kreditore në llogaritjen e pagesave të pensioneve pas vdekjes.

-Dosjet e përfitimeve afatshkurtra nuk janë dorëzuar në arkiv, duke mos respektuar rregullat e administrimit të dokumentacionit financiar.

-Programi elektronik për përfitimet afatshkurtra paraqet dobësi në: Automatizimin e plotë të proceseve; Shmangien e dublimeve; Gjenerimin e raporteve përmbledhëse.

-Mungon një kontroll i plotë për kategori të caktuara përfitimesh, ku nuk lejohet njëkohësisht përfitimi nga sigurimet shoqërore dhe punësimi aktiv (p.sh., përfitimet suplementare dhe trajtimet e veçanta).

-Janë konstatuar shkelje të marrëveshjeve me postën dhe bankat, si: Mosshpërndarje në kohë dhe mënyrë të saktë e detyrimeve të lindura; Mungesë e kontrollit mbi qarkullimin e dokumentacionit me filialet e postës; Pagesa të pensioneve pas vdekjes në kundërshtim me marrëveshjet dypalëshe dhe mosarkëtim i plotë i diferencave; Mosrespektim i afateve të pagesave nga postat, përtej kufizimeve të përcaktuara në akt-marrëveshje.

✓ *Sistemin e menaxhimit të aktiveve.*

- Janë konstatuar raste të pronave të RDSSH-së të paregjistruara në Zyrat e Regjistrimit të Pronave.

- Janë konstatuar raste ku në zërin pakësime në inventar ekonomik nuk ka dalje jashtë përdorimit për një vit ushtrimor.

✓ *Sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të institucionit.*

- Mospërmbushje e detyrimeve ligjore në proceset gjyqësore.

- Mungesë e treguesve kyç të performancës.

-Mungesë në Menaxhimin dhe Strategjinë e Riskut.

-Mungesë monitorimi nga drejtuesit e DRSSH-ve mbi respektimin e afatit të shërbimeve dhe treguesit e transparencës ndaj qytetarëve.

-Mungesë e funksionit të kontrollit të pagesave të përfitimeve.

-Mungesë e politikave dhe procedurave për sigurinë e informacionit në DRSSH.

Sipas të dhënave të tabelës së mëposhtme, vihet re se, numrin më të madh në masat e lëna, e zë auditimi i kryer në DRSSH Fier, me 17 rekomandime.

Tabela nr. 5: Përmbledhëse e gjetjeve / rekomandimeve për vitin 2024

Nr	Subjektet e Audituara	Gjetje në numër	Gjetje në vlerë (000 lekë)	Rekomandime për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm	Rekomandime të karakterit masa organizative	Rekomandime për arkëtim të vlerave monetare	Rekomandime të tjera
1	DRSSH VLORË	6			6		
2	DRSSH SARANDË	7			7		
3	DRSSH ELBASAN	8			8		
4	ZB I REKOMANDIMEVE	0			-		-
5	DRSSH KUKËS	7			7		
6	DRSSH TROPOJË	3			3		
7	DRSSH SARANDË (Tit)	2			2		-
8	ISSH DF	7			4	3	
9	ISSH DBI	3			3		
10	DRSSH FIER	17		1	11	3	2
11	DRSSH SHKODËR	11		1	7	3	
12	DRSSH GJIRKASTËR	16		1	13	2	
13	DRSSH ËS	16			10	5	1
	GJITHSEJ	103		3	81	16	3

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga auditimi rezultoi se në vitin 2024, DAB në rekomandimet që ka lënë ka dhënë: 103 rekomandime në total, nga të cilat 3 rekomandime për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, 81 rekomandime për masa organizative, 16 rekomandime për arkëtim të vlerave monetare, dhe 3 rekomandime të tjera.

IX. Zbatimi i rekomandimeve të lëna.

Në vlerësim të përputhshmërisë me këtë pikë, nga auditimi u konstatua se, në Planin Vjetor të vitit 2024, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH, me shkresën nr. 3639 prot, datë 13.03.2024, në periudhën 15.03.2024-28.03.2024 është planifikuar një mision auditimi për të gjithë subjektet e audituara gjatë vitit 2023, si dhe vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për periudhën e vitit 2023:

Tabela nr. 6: Shkalla e zbatimit të rekomandimeve për vitin 2023

Periudha	Rekomandime gjithsej	Rekomandime të pranuar	Rekomandime të zbatuara plotësisht	Rekomandime në proces zbatimi	Realizimi %
Viti 2023	70	68	42	21	60%

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Siç paraqitet në tabelë, nga 70 rekomandime të dhëna nga auditimi për vitin 2023, janë pranuar për zbatim 68 rekomandime. Nga këto, 42 janë zbatuar plotësisht, ndërsa 21 rekomandime janë në proces zbatimi. Nga auditimi i dokumentacionit dhe vlerësimi i shkallës së zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme në njësitë përbërëse të ISSH-së, rezultojnë si më poshtë:

- ✚ Drejtoria Rajonale Shkodër, nga gjithsej 5 rekomandime të dhëna, ka pranuar për zbatim 3 prej tyre, të cilat janë zbatuar plotësisht, ndërsa 2 rekomandime nuk janë pranuar dhe për rrjedhojë nuk janë zbatuar;
- ✚ Drejtoria Rajonale Elbasan, nga 14 rekomandime të dhëna, ka pranuar të gjitha rekomandimet, prej të cilave 12 janë zbatuar plotësisht dhe 2 janë në proces zbatimi;
- ✚ Drejtoria Rajonale Fier, nga 9 rekomandime të dhëna, ka pranuar të gjitha, prej të cilave 6 janë zbatuar dhe 3 janë në proces zbatimi;
- ✚ Drejtoria Rajonale Dibër, nga 8 rekomandime të dhëna, ka pranuar të gjitha, prej të cilave 6 janë zbatuar dhe 2 janë në proces zbatimi;

- ✚ Drejtoria Rajonale Ës, nga 8 rekomandime të dhëna, ka pranuar të gjitha, prej të cilave 7 janë zbatuar dhe 1 është në proces zbatimi;
- ✚ Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, nga 17 rekomandime të dhëna, ka pranuar të gjitha, prej të cilave 4 janë zbatuar, 9 janë në proces zbatimi dhe 4 nuk janë zbatuar;
- ✚ Drejtoria Rajonale Lushnjë, nga 7 rekomandime të dhëna, ka pranuar të gjitha, prej të cilave 3 janë zbatuar, 2 janë në proces zbatimi dhe 2 nuk janë zbatuar;
- ✚ Drejtoria e Financës në ISSH, nga 1 rekomandim i dhënë, e ka pranuar dhe është në proces zbatimi;
- ✚ Drejtoria e Kontributeve në ISSH, nga 1 rekomandim i dhënë, e ka pranuar dhe është në proces zbatimi.

Këto të dhëna pasqyrojnë një shkallë të ndryshme të angazhimit dhe progresit në zbatimin e rekomandimeve midis njësive përbërëse të institucionit, ku në disa raste evidentohen vonesa ose mospërmbyllje të rekomandimeve të pranuar, duke sugjeruar nevojën për forcim të monitorimit të brendshëm dhe ndjekjes së masave deri në përmbylljen e plotë të tyre.

XI. Zbatimi i procedurave dhe evadimi i materialeve të auditimit, ruajtja dhe arkivimi i tyre.

a) Nga auditimi me zgjedhje rastësore të dosjeve, rezultoi se:

Nga shqyrtimi i dosjeve të auditimit, rezultoi se grupet e auditimit kanë mbledhur informacionin e nevojshëm për përgatitjen e raporteve përkatëse të auditimit. Audituesit kanë analizuar informacionet e grumbulluara duke përdorur metoda dhe teknika të auditimit të konsideruara si më të përshtatshme dhe të besueshme për natyrën dhe specifikat e subjekteve të audituara.

Në dosjet e auditimit janë të administruara letrat e punës, evidencat mbështetëse dhe pyetësorët e përdorur gjatë procesit të auditimit, të cilat dokumentojnë gjurmët e auditimit dhe dëshmojnë mbi ndjekjen e procedurave të parashikuara në programin e auditimit të miratuar.

Megjithatë, nga dosjet e përzgjedhura për verifikim nga grupi i auditimit të KLSH, u evidentuan edhe mangësi në dokumentacionin e administruar, konkretisht:

-Në të gjitha dosjet e audituara u konstatua se shkresa e inventarit të dosjes, e cila sipas Kapitullit VI të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar, duhet të hartohet në përputhje me Formatin Standard nr. 1, nuk është e plotësuar sipas kërkesave përkatëse. Konkretisht, mungojnë elementë të detyrueshëm si numri i protokollit për çdo shkresë, data dhe numri i faqeve përkatëse të dokumenteve, si dhe në disa raste mungon nënshkrimi i audituesit dhe i drejtuesit të DAB-së mbi këtë shkresë.

Gjithashtu, nga verifikimi rezulton se dosjet e auditimit nuk janë marrë në dorëzim nga arkiva institucionale dhe nuk janë numerizuar, siç kërkohet në përfundim të procesit të auditimit dhe në përputhje me rregullat e administrimit të dokumentacionit zyrtar.

-Në dosjen e auditimit të zhvilluar pranë **DRSSH Durrës** u konstatua se vlerësimi i nivelit të riskut nuk është kryer në përputhje me kërkesat e parashikuara në Kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, pasi mungon plotësimi i Formave IV dhe V për identifikimin dhe vlerësimin e riskut. Gjithashtu, në dokumentacionin e administruar nuk rezulton të jetë përfshirë reagimi (feedback) i subjektit të audituar lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit, siç kërkohet në fazën përmbyllëse të procesit. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së analizës mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, rezulton se vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm nuk përfshin të pesë komponentët bazë të tij, siç përcaktohet në kuadrin metodologjik të miratuar për vlerësimin e funksionimit të sistemit të brendshëm të kontrollit.

-Në dosjen e auditimit të zhvilluar pranë **DRSSH Elbasan** u konstatua se vlerësimi i nivelit të riskut nuk është kryer në përputhje me kërkesat e parashikuara në Kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, pasi mungon plotësimi i Formave IV dhe V për identifikimin dhe vlerësimin e riskut. Gjithashtu, konstatohet se mungon dokumenti i takimeve të angazhimit të auditimit ballafaques ose përmbyllës dhe plani i veprimit të dërguar nga subjekti i audituar. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së analizës mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, rezulton se vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm nuk përfshin të pesë komponentët bazë të tij, siç përcaktohet në kuadrin metodologjik të miratuar për vlerësimin e

funksionimit të sistemit të brendshëm të kontrollit. Gjithashtu konstatohet se dërgimi i Raportit Përfundimtar në tejkalim të afatit ligjor.

-Në dosjen e auditimit të zhvilluar pranë **DRSSH Shkodër** u konstatua se vlerësimi i nivelit të riskut nuk është kryer në përputhje me kërkesat e parashikuara në Kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, pasi mungon plotësimi i Formateve IV dhe V për identifikimin dhe vlerësimin e riskut. Gjithashtu, konstatohet se mungon dokumenti i takimit fillestar me subjektin, dokumenti i takimeve të angazhimit të auditimit ballafaques ose përmbyllës dhe plani i veprimit të dërguar nga subjekti i audituar.

-Në dosjen e auditimit të zhvilluar pranë **DRSSH Gjirokastrë** u konstatua se vlerësimi i nivelit të riskut nuk është kryer në përputhje me kërkesat e parashikuara në Kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, pasi mungon plotësimi i Formateve IV dhe V për identifikimin dhe vlerësimin e riskut.

-Në dosjen e auditimit të zhvilluar pranë **DRSSH Fier** u konstatua se vlerësimi i nivelit të riskut nuk është kryer në përputhje me kërkesat e parashikuara në Kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, pasi mungon plotësimi i Formateve IV dhe V për identifikimin dhe vlerësimin e riskut. Gjithashtu, në dokumentacionin e administruar nuk rezulton të jetë përfshirë reagimi (feedback) i subjektit të audituar lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit, siç kërkohet në fazën përmbyllëse të procesit dhe plani i veprimit të dërguar nga subjekti i audituar.

-Në dosjen e auditimit të zhvilluar pranë **DBI në ISSH**, konstatohet se qëllimi kryesor i auditimit për vlerësimin e ekzistencës së kontrolleve dhe mekanizmave për menaxhimin, zhvillimin dhe sigurinë e burimeve të teknologjisë së informacionit nuk është realizuar. Audituesit nuk kanë arritur të japin një opinion të qartë mbi efektivitetin e përdorimit të teknologjisë së informacionit për ruajtjen e integritetit të të dhënave, mbrojtjen e asetëve dhe arritjen e objektivave të institucionit.

Auditimi është zhvilluar në disa drejtime të rëndësishme si funksionimi i DBI-së, strategjia dhe rregulloret, siguria e informacionit, identifikimi i risqeve, menaxhimi i përdoruesve dhe sistemet e informacionit. Megjithatë, audituesit janë kufizuar në përshkrime të përgjithshme dhe nuk kanë ndjekur metodologjinë specifike për auditimin e IT-së.

Nuk është përdorur Aneksi i i Manualit të Auditimit të Brendshëm, që përmban metodikën dhe kërkesat për auditimin e teknologjisë së informacionit, dhe nuk janë plotësuar matricat teknike të përcaktuara në këtë aneks. Gjithashtu, të gjithë anëtarët e grupit të auditimit kanë qenë me profil ekonomik dhe nuk kanë pasur njohuri të specializuara në fushën e teknologjisë së informacionit, duke ndikuar në pamundësinë për të kryer një auditim të mirëfilltë në këtë fushë. Referuar Manualit të Auditimit të Brendshëm të ISSH-së, Aneksi I përcakton qartë strukturën, elementët dhe teknikat për zhvillimin e auditimit të teknologjisë së informacionit. Roli i auditimit të IT-së është të sigurojë që ekzistojnë kontrole të përshtatshme për menaxhimin e risqeve dhe për të vlerësuar mjedisin, proceset dhe sistemet që mbështesin funksionet institucionale. Mungesa e zhvillimit të një auditimi të strukturuar dhe metodik në fushën e IT-së sjell:

- mungesë sigurie mbi ekzistencën dhe funksionimin efektiv të kontrolleve në sistemet dhe proceset teknologjike të ISSH-së;
- rrezik për identifikim të pamjaftueshëm të risqeve që lidhen me sigurinë, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave;
- mungesë të evidencave të mjaftueshme për të mbështetur opinionin e auditimit;
- dobësim të funksionit të auditimit të brendshëm në mbikëqyrjen e një fushe kritike për institucionin.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhëna të detajuara, të subjekteve të audituara gjatë vitit 2024, numrat e programeve të tyre, afatet e kryerjes së angazhimit në terren. Afatet e dorëzimit të projekt raporteve, konfirmimet e tyre nga subjektet e audituara, si dhe afatet e dorëzimit të raporteve përfundimtare. Gjithashtu, komente të grupit të auditimit të KLSH.

Tabela nr. 7: Të dhëna mbi numrin e programeve dhe zbatimin e afateve të auditimeve për vitin 2024.

Nr	Subjekti	Programi i auditit		Afati i kryerjes së angazhimit	Projekt raporti		Konfirmimi i Projekt raportit		Raporti Përfundimtar		Komente të KLSH
		Nr.	Data		Nr.	Data	Nr	Data	Nr.	Data	
1	DRSSH EŠ	11887/1	26.11.2024	03.12.2024-27.12.2024	11877/2	15.01.2024	18149	31.01.2024	11887/4	07.02.2024	
2	DRSSH ELBASAN	3589/1	12.03.2024	13.03.2024-12.04.2024	3589/2	29.04.2024	3589/3	17.05.2024	3589/4	27.05.2024	Dërgimi i Raportit Përfundimtar në tejkalim të afatit ligjor.
3	DRSSH SHKODËR	8364/1	01.08.2024	26.08.2024-27.09.2024	8364/2	11.10.2024	8364/3	01.04.2024	8364/4	08.11.2024	
4	DRSSH GJIRKASTËR	9729/1	27.09.2024	03.10.2024-01.11.2024	9729/3	15.11.2024	2729/11	10.12.2024	9729/5	11.12.2024	
5	DRSSH FIER	7102	26.06.2024	01.07.2024-26.07.2024	7102/1	07.08.2024	7102/2/	28.08.2024	7102/3	08.09.2024	
6	DBI ISSH/TI	6167/1	28.05.2024	03.06.2024-21.06.2024	6167/2	16.07.2024	6167/3	25.07.2024	6167/4	01.08.2024	Dërgimi i Projekt Raportit në tejkalim të afatit ligjor.

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

b) Ruajtja dhe arkivimi i tyre.

Nga auditimi u konstatua se, inventarizimi i dokumentacionit që përmbajnë dosjet, janë kryer me inventar personal nga secili anëtar i grupit të auditimit dhe nuk i janë përmbajtur Formatit Standard nr. 1, në Kapitullin VI, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar.

Në zbatim të kërkesave të parashikuara në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, një kopje e dokumenteve të dosjeve të auditimeve (shkresa dhe/ose dokumente që lidhen me të), duhet të dorëzoheshin në arkivën e ISSH. Nga auditimi u konstatua se, dosjet e auditimit për vitin 2024 janë ende të pa arkivuara.

XII. Dosja e përhershme

Audituesit e Brendshëm duhet të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operacionale dhe sistemin financiar me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësisë që auditohet.

Nga auditimi konstatohet se DAB, mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.

Sa më sipër, arrihet në konkluzionet se:

Gjatë vitit 2024, funksionimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në ISSH është zhvilluar në kushte të paplota organizative dhe në mospërputhje me kërkesat e akteve të brendshme rregullatore dhe standardeve profesionale të auditimit të brendshëm.

Auditimet e kryera gjatë vitit evidentojnë disa mangësi në përgatitjen dhe dokumentimin e dosjeve të auditimit, si mungesa e inventarit të dosjes sipas formatit standard, mosvlerësimi i riskut në përputhje me formatet përkatëse, mungesa e dokumenteve të takimeve ballafaqese dhe planit të veprimit të subjekteve të audituara. Mospërfshirja e reagimit të subjekteve dhe vlerësimi jo i plotë i komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm dëshmojnë për dobësi metodologjike në zbatimin e standardeve të auditimit.

Për më tepër, auditimi i zhvilluar në fushën e teknologjisë së informacionit ka rezultuar joadekuat, pasi nuk janë ndjekur udhëzimet e Aneksit përkatës të Manualit të Auditimit të Brendshëm, nuk janë përdorur matricat teknike dhe grupi auditues nuk ka pasur profil të përshtatshëm profesional për këtë lloj auditimi, çka ka cënuar qëllimin e auditimit dhe ka pamundësuar dhënien e një opinionit të besueshëm mbi mjedisin dhe kontrollet në sistemet IT të ISSH-së.

Në tërësi, situata e konstatuar tregon për nevojën e rishikimit të kapaciteteve njerëzore, përmirësimit të metodologjisë së punës dhe forcimit të funksionit mbikëqyrës të DAB në përputhje me standardet e auditimit të brendshëm dhe misionin institucional të ISSH-së.

Pretendimi i subjektit:

Me shkresën nr. 429/2 prot., datë 28.07.2025 protokolluar në KLSH me nr. 4089/2, prot., datë 24.07.2025 ISSH ka përcjellë observacion në lidhje me konstatiminse;

Çështja 1. "Në lidhje me strukturën ju sqarojmë se struktura e DAB (7+1) ka funksionuar me staf të reduktuar (4 pozicione vakante) deri në muajin Qershor 2024, dhe kjo vakancë ashtu si është shpjeguar dhe në auditimin e kaluar të KLSH, ka ardhur si pasojë e daljes në pension të disa audituesve (ndërsa 2 auditues të larguar në muajin Shkurt 2024). Në muajin qershor 2024 struktura është plotësuar me dy auditues të rinj, në muajin tetor është plotësuar me një auditues i cili është emëruar në Janar 2025.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga DAB, sqarojmë sa më poshtë:

Pretendimi i paraqitur nga DAB nuk e vë në diskutim gjetjen e auditimit në lidhje me ekzistencën e vakancave në strukturën e DAB gjatë vitit 2024. Nga të dhënat e përcjella prej vetë institucionit, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, rezulton se vetëm dy pozicione janë plotësuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024, një pozicion është mbuluar përkohësisht përmes komandimit, ndërsa emërimi i realizuar në janar 2025 nuk i përket periudhës objekt auditimi. Një tjetër pozicion ka mbetur vakant deri në fund të vitit 2024. Për rrjedhojë, vlerësimi mbi funksionimin me staf të reduktuar mbetet i vlefshëm.

Për rrjedhojë, observacioni i paraqitur nga DAB nuk merret në konsideratë, pasi nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore në fuqi dhe nuk është shoqëruar me asnjë provë apo dokumentacion shtesë që të vërtetojë pretendimet e ngritura.

Pretendimi i subjektit:

Çështja 2: Shpreheni se. në mospërputhshmëri me Standardin 2060 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, Drejtori i DAB nuk ka përcjellë te Këshilli Administrativ informacione dhe realizimet e planeve të auditimit për periudha të ndryshme të vitit. DAB ka përcjellë informacione mbi veprimtarinë e DAB te Drejtori i Përgjithshëm i ISSH. Në lidhje me këtë ju sqarojmë se DAB e ka përmbushur detyrën e vetë pasi në përfundim të çdo auditimi nëpërmjet Memo-s respektive ka raportuar te menaxhimi i lartë, Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së, rezultatet e auditimit , gjithashtu dhe në përfundim të vitit ka përgatitur periodikisht raport përmbledhës informues për menaxhimin e lartë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me pretendimin e paraqitur nga DAB, sqarojmë se gjatë procesit të auditimit nuk është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion justifikues që të dëshmojë se, krahas informimit të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH-së, janë përcjellë informacione edhe pranë Këshillit Administrativ, në përputhje me kërkesat e Standardit 2060 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Raportimi ndaj menaxhimit të lartë përmes memove apo raporteve vjetore nuk e zëvendëson detyrimin për të informuar edhe organin më të lartë drejtues të institucionit – Këshillin Administrativ – për realizimin e planeve të auditimit dhe gjetjet përkatëse, siç përcaktohet në standardin e sipërpërmendur.

Për rrjedhojë, observacioni i paraqitur nga DAB nuk merret në konsideratë, pasi nuk mbështetet në dispozitat ligjore në fuqi, nuk është shoqëruar me asnjë provë ose dokumentacion sqarues që të mbështesë pretendimin.

Pretendimi i subjektit:

Shpreheni se në disa dosje të audituar, vlerësimi i riskut nuk është kryer në përputhje me kërkesat e parashikuara sipas formateve standarde IV dhe V të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Në lidhje me këtë ju sqarojmë se nga ana jonë janë hartuar formatet për vlerësimin e riskut, përpara fillimit të çdo auditimi por ashtu si dhe çitohet në Manualin e Auditimit të Brendshëm, në kuadër të formateve orientuese DAB ka modifikuar formatin për vlerësimin e riskut të subjektit të audituar.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me pretendimin e paraqitur nga DAB, sqarojmë se, sipas pikës 4.1.2 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, audituesit kanë detyrimin të plotësojnë formatin e vlerësimit të riskut për sistemin apo fushën që do të auditohet, si pjesë e fazës së planifikimit të auditimit. Ky vlerësim përfshin përllogaritjen e koeficientit të riskut dhe realizohet përmes përdorimit të formateve standarde IV dhe V, të përfshira në fund të kapitullit IV të manualit. Në dosjet e audituara është konstatuar se formatet e përdorura nga DAB nuk reflektojnë në mënyrë të plotë elementët thelbësorë të përcaktuar në formatet standarde të manualit, duke bërë që vlerësimi i riskut të mos jetë në përputhje të plotë me kërkesat metodologjike të përcaktuara në dokumentin bazë.

Për rrjedhojë, observacioni i paraqitur nga DAB nuk merret në konsideratë, pasi nuk mbështetet në dispozitat ligjore në fuqi, nuk është shoqëruar me asnjë provë ose dokumentacion sqarues që të mbështesë pretendimin e subjektit të audituar.

Pretendimi i subjektit:

Çështja 4: Në lidhje me përfundimin tuaj, mbi auditimin e IT ju bëjmë me dije se ashtu si edhe ju citoni se të gjithë antarët e grupit kanë qenë me profil ekonomik dhe nuk kanë pasur njohuri të specializuara në fushën e teknologjisë së informacionit, duke ndikuar në pamundësinë për të kryer një auditim të mirëfilltë në këtë fushë, në zbatim të rekomandimit të KLSH në auditimin e kaluar, DAB, planifikoi një auditim TI, ku pavarësisht fokusit të specializuar dhe të thelluar në fushën e TI-së, e realizoi me sukses këtë auditim duke nxjerrë në pah disa hallka të dobta siç ishin mungesa e rregullores së miratuar për sigurinë e informacionit, procedurat e dokumentuara të dhënies/heqjes së aksesit në sistemet e ISSH-së të punonjësve etj. Gjithashtu ju bëjmë me dije se në çdo rast audituesit i janë referuar Manualit të Auditimit të Brendshëm të ISSH-së, Aneksi I, Metodika e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, me aq sa njohuri kanë në fushën e TI-së. Në lidhje me këtë fushë do të kërkonim dhe ndihmën tuaj si institucion i lartë kontrollues në përbërjen e të cilit keni dhe një departament të dedikuar me ekspertë të fushës për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit, për të planifikuar auditim TI pranë ISSH.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimin e paraqitur nga DAB për çështjen e auditimit në fushën e teknologjisë së informacionit (TI), sqarojmë se, pavarësisht përpjekjes për të adresuar rekomandimin e lënë nga KLSH në auditimin e mëparshëm dhe angazhimit të strukturës për zhvillimin e një auditimi në këtë fushë, nuk janë përmbushur kërkesat metodologjike dhe teknike të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm të ISSH-së. Raportimi i disa problematikave si mungesa e rregullores për sigurinë e informacionit apo procedurave për menaxhimin e aksesit vlerësohet si i dobishëm, por nuk e plotëson funksionin e auditimit sipas qëllimit të parashikuar në metodologji – që është vlerësimi i sistemeve, risqeve dhe kontrolleve në mjedisin IT në mënyrë të strukturuar, të pavarur dhe profesionale. Për këtë arsye, gjetja mbi mosrealizimin e një auditimi të plotë në fushën e teknologjisë së informacionit qëndron.

Për rrjedhojë, observacioni i paraqitur nga DAB nuk merret në konsideratë, pasi nuk mbështetet në dispozitat ligjore në fuqi, nuk është shoqëruar me asnjë provë ose dokumentacion sqarues që të mbështesë pretendimin e subjektit të audituar.

Pretendimi i subjektit:

Çështja 5: Shprehni se mospërfshirja e reagimit të subjekteve dhe vlerësimi jo i plotë i MFK-së dëshmojnë dobësi metodologjike në zbatim të standardeve të auditimit. Lidhur me këtë konkluzion tuajin nuk jemi dakord për arsye se formulari i reagimit nga subjekti i audituar nuk është në kompetencën tonë si njësi, por në diskrecionin e vetë subjektit e për më tepër vlera e të cilit nuk dëshmon cilësinë tonë audituese. Ai formular reagimi, do na shërbejë në punën tonë audituese për të ardhmen për të parë mangësi nëse kemi patur gjatë angazhimit në subjekt që mund të kenë qenë në kuadrin e komunikimit, sjelljes etike, profesionale etj, për të cilat duhet të reflektojmë për tu përmirësuar.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pretendimi i paraqitur nga DAB nuk e përjashton detyrimin metodologjik për përfshirjen dhe analizimin e reagimit të subjektit të audituar. Këto elementë përbëjnë pjesë përbërëse të procesit të auditimit, në përputhje me standardet profesionale, dhe ndihmojnë në rritjen e transparencës, dialogut dhe përmirësimit të cilësisë së auditimit. Mungesa e tyre në disa dosje evidentohet si mangësi në dokumentimin dhe përmbylljen e plotë të ciklit të auditimit. Për rrjedhojë, observacioni i paraqitur nga DAB nuk merret në konsideratë, pasi nuk mbështetet në dispozitat ligjore në fuqi, nuk është shoqëruar me asnjë provë ose dokumentacion sqarues që të mbështesë pretendimin e subjektit të audituar.

IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë e raportimit të planit të të ardhurave nga kontributet për skemën e sigurimeve shoqërore dhe financimi nga buxheti i shtetit për ISSH rezultoi se:

Plani fillestar i të ardhurave është miratuar me Ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2024”, në shumën totale 185,825 milionë lekë. Gjatë vitit 2024, janë bërë disa ndryshime me AN nr. 3, datë 29.08.2024 dhe nr. 5, datë 19.12.2024 të Këshillit të Ministrave, të cilat në raport me planin fillestar kanë patur efekt në rritjen e planit të të ardhurave nga kontributet me 1,128 milionë lekë dhe nga bonusi i pensionistëve me 6,224 milionë lekë, si dhe uljes së transfertës për indeksimin e pensioneve me 2,444 milionë lekë dhe së transfertës nga buxheti i shtetit me 1,908 milionë lekë.

Rritja në planifikim të ardhurave në Skemën e Sigurimit të Detyrueshëm për vitin 2024, pasqyron përmirësim të pritshëm ekonomik. Ndërsa rritja e shpenzimeve tregon se ka nevojë për fonde shtesë për të përballuar detyrimet ndaj pensionistëve dhe përfituesve të tjerë të sistemit.

-ISSH ka planifikuar të ardhura nga kontributet, në shumën 400,000 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 959,692 mijë lekë. Pra, 559,692 mijë lekë më shumë se plani, ose në masën 240% nga plani i parashikuar. Nga auditimi konstatohet se ISSH nuk ka kërkuar ulje të financimit nga buxheti i shtetit, rishikimin e Transfertës në vlerën 51,457,822 mijë lekë, pavarësisht realizimit të të ardhurave mbi pritshmërie edhe që projeksionet kanë qenë më të ulëta.

-Financimi nga buxheti i shtetit përfshin grantet për mbulimin e disa skemave të pensioneve, si dhe fondet për mbulimin e deficitit të skemës së pensioneve. Llogaria 720 “Grant nga buxheti për pagesa të posaçme” paraqitet në realizimin faktik të vitit 2024, për 17,656,588 mijë lekë, me një rritje prej 1,601,074 mijë lekë, ose në masën 10% më shumë, në krahasim me faktin 2023. Rritja lidhet kryesisht me shtimin e bonusit të pensionistëve, për pensionistët në 2024 (nga 3,650 milionë lekë në mbi 9,800 milionë lekë). Kjo vjen në dukje si një angazhim më i madh social i shtetit për të përballuar efektet e inflacionit dhe për të mbështetur kategoritë në nevojë. Por gjatë vitit 2024, transferata nga buxheti i shtetit për indeksimin e pensioneve u ul nga 4,137 milionë lekë, në 1,693 lekë (me -2.444 milionë lekë diferencë). Pra, rritja e bonusit të pensioneve ka kompensuar uljen e vlerës së indeksimit të pensioneve.

-Në vitin 2024 financimi nga buxheti i shtetit është rritur për shumën 4,730,587 mijë lekë ose në masën 10% më shumë, në krahasim me vitin 2023. Por, nevoja për përdorimin e këtij financimi ka qenë në shumën 49,189,349 mijë lekë, për shkak të rezultatit fiskal pozitiv ose 2,268,473 mijë lekë më pak, se financimi i tërhequr. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3.1 dhe 2.3.2 faqe 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masat për të përmirësuar në vijimësi procesin e planifikimit të të ardhurave sipas një parashikimi mbi nevojat reale për transfertë buxhetore, duke u mbështetur në ecurinë e të ardhurave dhe shpenzimeve faktike vjetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se kontributet e skemës së qytetit për vitin 2024, sipas degëve (sëmundje, barrë lindje, pensione, aksidente dhe papunësi) rezultuan me 139,381,098 mijë lekë ose në masën 11.8% më shumë, krahasuar me vitin 2023.

Gjithashtu edhe shpenzimet, sipas këtyre degëve kanë shënuar rritje, të cilat rezultuan në vlerën 148,756,034 mijë lekë në vitin 2024, ose në masën 11% më shumë, krahasuar me vitin 2023. Në nivel degësh: shpenzimet për sëmundje janë rritur në 778,479 mijë lekë në 2024, ose në masën 11.5% më shumë krahasuar me vitin 2023; shpenzimet për barrë lindje janë rritur në 5,427,621

mijë lekë në 2024, duke shënuar një rritje prej 20%, nga 4,521,217 mijë lekë në 2023; shpenzimet për pensione kanë shënuar rritje në vlerën 142,516,736 mijë lekë ose në masën 11% në 2024, nga vlera 128,375,821 mijë lekë në 2023; shpenzimet për aksidente kanë pësuar rritjen më të madhe në përqindjeje, prej rreth 41%, nga 23,513 mijë lekë në 2023 në 33,197 mijë lekë në 2024.

Sa më sipër, në lidhje me skemën e qytetit, deficitit rezultoi në shumën 14,054 milionë lekë, nga 13,086 milionë lekë që ishte në vitin 2023, pra është rritur me 0.04% ndaj PBB. Duke krahasuar ritmet e rritjes së të ardhurave me ato të shpenzimeve me vitin 2023, rezultoi që të ardhurat janë rritur më pak se shpenzimet, për rrjedhojë kemi një rritje të deficitit të qytetit në shumën 968,064 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024, kontributet për skemën e fshatit për të dyja degët përkatëse barrë lindje dhe pensione u rritën me 22% krahasuar me 2023, duke arritur në 9,810,916 mijë lekë. Ndërsa shpenzimet për fshatin u rritën lehtë me 1.5% krahasuar me vitin 2023, duke arritur në 13,480,761 mijë lekë. Kjo rritje reflekton ndryshime të kundërta brenda dy degëve kryesore: shpenzimet për pensione në fshat u rritën me 2.8%, nga 12,823,220 mijë lekë në 2023, në 13,178,876 mijë lekë në 2024, duke ruajtur trendin e rritjes së qëndrueshme. Ndërsa, shpenzimet për barrë lindje në fshat ranë ndjeshëm me 35%, nga 463,319 mijë lekë në 2023, në 301,885 mijë lekë në 2024, e cila lidhet kryesisht me rënien e numrit të përfituesve, e cila është pasojë e disa faktorëve si, rënia e lindshmërisë në zonat rurale, emigrimi i vazhdueshëm i popullsisë në moshë riprodhuese, si dhe zhvendosja e popullsisë drejt zonave urbane.

Në lidhje me skemën e fshatit, deficitit rezultoi në shumën 3,670 milionë lekë nga 5,272 milionë lekë që ishte në vitin 2023, pra është ulur në shumën 1,602 milionë lekë. Ndër vite deficitit i skemës së pensioneve të fshatit ka ardhur duke u ulur dhe se për vitin 2024, kjo ulje rezulton me 0.06% ndaj PBB. Për sa më sipër, u konstatua se të ardhurat nga kontributet nuk kanë qenë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të skemës së pensioneve qytet dhe fshat, duke pasur deficit të vazhdueshëm. Gjatë vitit 2024, deficitit financiar i sistemit ka zbritur në -17,724 milionë lekë ose -0.71% i PBB, krahasuar me **-18,358 miliardë lekë** në vitin 2023, **me një përmirësim prej 634.1 milionë lekë ose 0,03% të PBB**. Përmirësimi i deficitit për vitin 2024, ka qenë kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave për shkak të rritjes së pagave mesatare dhe i rritjes së numrit të kontribuesve. Me gjithë përmirësimet në rezultatin e vitit 2024, skema rezulton me deficit. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3.1 dhe 2.3.2 faqe 46-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e një strategjie afatmesme për rritjen e të ardhurave nga kontributet, duke kryer zgjerim të bazës së kontribuesve; përmirësim në administrimin dhe mbledhjen e kontributeve, monitorim dhe kontroll më efektiv të shpenzimeve, me fokus në efikasitetin dhe targetimin e përfituesve realë, për të ndihmuar, reduktimin më tej të deficitit dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare të skemës.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2024, rezultoi se:

Planifikimi i të ardhurave dërgohet në ISSH nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Ky planifikim nuk është i detajuar sipas kategorive të biznesit (buxhetor, jo buxhetor, biznes i madh, biznes i vogël, sigurime suplementare), pasi të dhënat për programimin buxhetor përgatiten dhe dërgohen në këtë format nga Ministria e Financave.

a. Kontributet e sigurimeve shoqërore, të derdhura nga subjektet fizike dhe juridike, publike e private, kontribuesit në sektorin e bujqësisë dhe ata vullnetarë, së bashku me të ardhura të tjera jo tatimore, si dhe derdhur në llogari të sigurimeve, kanë arritur në shumën **139,437,131 mijë lekë**, për vitin 2024 të përbërë nga:

-Vlera prej 134,295,143 mijë lekë të mbledhura nga DPT, përbëhen nga të ardhura nga derdhja e kontributeve (të ardhura tatimore) në shumën 133,655,493 mijë lekë dhe të ardhura të tjera (jo nga kontribute për sigurime shoqërore), nga gjoba dhe kamatëvonesa në shumën 639,650 mijë lekë, sipas rakordimit të ISSH me MF.

Nga të ardhurat e mbledhura nga DPT, për kontributet e sigurimeve suplimentare në shumën 2,296,035 mijë lekë, rezultuan me mosrealizim ndaj planifikimit **në shumën 1,011,965 mijë lekë ose në masën 31%, më pak.**

-Vlera prej 5,141,988 mijë lekë të mbledhura nga ISSH, përbëhen nga të ardhura: kontribute vullnetarë, të vetëpunësuar në bujqësi, të ardhura të tjera (jo tatimore), si dhe derdhur në llogari të sigurimeve (tatimore). Nga të ardhurat e mbledhura nga ISSH, për kontributet vullnetare në shumën 718,480 mijë lekë, **rezultuan me mosrealizim në vlerën 31,520 mijë lekë ose 4% më pak** në krahasim me planifikimin e bërë në 2024; si dhe kontributet nga të vetëpunësuar në bujqësi rezultuan me mosrealizim në **vlerën 26,184 mijë lekë ose 1% më pak** në krahasim me planifikimin e bërë.

Nga auditimi u konstatua një tejkalim i të ardhurave të realizuara prej 501,988 mijë lekë ose në masën 111% të planit, krahasuar me vlerën 4,640,000 mijë lekë të planifikuara, pasi nga ana e ISSH-së, në realizimin e të ardhurave janë përfshirë edhe “të ardhura të tjera”, të cilat sipas klasifikimit buxhetor, janë të ardhura jo nga kontributet ose “Të tjera DPT dhe ISSH”, gjithsej në shumën 1,852,974 mijë lekë, nga të cilat DPT: në vlerë 639,650 mijë lekë dhe ISSH: në vlerën 1,213,324 mijë lekë e përbërë nga (penalitetet 254,525 mijë lekë + të ardhura të tjera jo tatimore 958,799 mijë lekë).

Nga auditimi rezultoi se të ardhurat tatimore të realizuara, janë **137,584,157 mijë lekë**. ISSH nuk ka kryer një ndarje të drejtë të planit të të ardhurave duke përfshirë në realizimin faktik edhe të ardhurat jo tatimore. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” dhe Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, Të ardhura tatimore/ Të ardhura nga fondet speciale/ Të ardhura ISSH.

b. Nga analiza e të dhënave për realizimin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore në vitin 2024, rezultoi se janë realizuar në vlerën 188,626,480 mijë lekë, duke shënuar një rritje prej 18,388,306 mijë lekë ose 10.8% në krahasim me vitin 2023. Gjithashtu u konstatua tejkalim të shpenzimeve krahasuar me planifikimet fillestare për disa programe buxhetore, si: Programi “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” në vlerën 227,962 mijë lekë, ose 12% më shumë se fondi i miratuar dhe Programi “Shpenzime për përfitime” në vlerën 303,766 mijë lekë, ose 19% më shumë se fondi i miratuar. Ky tejkalim lidhet kryesisht me **rritjen e numrit të përfituesve dhe nivelit të përfitimeve**, për shkak të faktorëve si, rritja e pagave, rritja e pensioneve si dhe faktorë socialë, plakja e popullsisë dhe rritja e barrës së mbështetjes për familjet në nevojë.

Ndërsa, disa programe të tjera kanë rezultuar me mosrealizim të fondit të planifikuar konkretisht: Programi “Shpenzime për programe të veçanta shtetërore” me një mosrealizim prej 75,725 mijë lekë, ose 0.5% më pak se fondi i planifikuar dhe Programi “Shpenzime administrative” me mosrealizim në vlerën 426,867 mijë lekë ose 11% të fondit të parashikuar.

Mosrealizimi i fondit të planifikuar për këto programe lidhet kryesisht me **planifikim jo të saktë të nevojave reale** gjatë fazës së hartimit të buxhetit, të cilat mund të sjellin **vonesë në ofrimin e shërbimeve, akumulimin e fondeve dhe efikasitet të ulët buxhetor**, duke ndikuar negativisht në arritjen e objektivave të programit dhe në besueshmërinë e planifikimit financiar. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3.3, faqe 29-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet Drejtorisë së Financës të marrin masa që në procesin e detajimit dhe raportimit të planit të të ardhurave nga kontributet dhe të realizimit të tyre, të mos përfshihen të ardhurat jo tatimore (kategori “Të tjera DPT dhe ISSH”); Të marrin masa që të zbatohet në mënyrë të saktë klasifikimi funksional dhe ekonomik i të ardhurave, në përputhje me strukturën e Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, pjesë e ligjit vjetor të buxhetit dhe akteve përkatëse normative, me qëllim sigurimin e transparencës dhe krahasueshmërisë së të dhënave buxhetore.

3.2. Rekomandimi: Drejtorja e Financës në ISSH të marrë masa që procesi i parashikimeve buxhetore për shpenzimet të shoqërohet me një analizë të plotë dhe të thelluar, duke u bazuar në të dhëna reale dhe tendenca historike, me qëllim minimizimin e tejkalimeve ose mosrealizimeve dhe garantimin e një përdorimi sa më eficient, të qëndrueshëm dhe transparent të fondeve publike.

4. Gjetje nga auditimi: Nga krahasimi i të ardhurave të realizuara nga ISSH (kontributet/të ardhura tatimore) dhe të dhënave të Tabelës së Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit (Kapitulli II.3 "Të ardhurat nga fondet speciale") rezultoi se fakti i të ardhurave nuk është i rakorduar. Sipas të dhënave të MF, fakti i të ardhurave nga fondet speciale "Sigurimet Shoqërore", paraqiten në vlerën prej 139,404 milionë lekë, ndërsa nga ISSH janë deklaruar 134,295 milionë lekë, ku përfshihen të ardhurat tatimore në shumën 133,655 milionë lekë dhe të ardhura jo tatimore (jo nga kontribute për sigurime shoqërore), në shumën 640 milionë lekë duke krijuar një diferencë prej rreth 5 milionë lekësh.

Kjo diferencë është krijuar nga trajtimi i ndryshëm i të ardhurave ndërmjet institucioneve, si dhe nga vonesat kohore në pasqyrimin e arkëtimeve të pranura në sistemin e Thesarit dhe atij të ISSH, si: Momenti i regjistrimit të të ardhurave, ku MF evidenton të ardhurat sipas arkëtimeve faktike të raportuara nga Thesari, ndërsa ISSH mbështetet në deklaratimet dhe evidencat e kontributeve të administruara nga organet tatimore; klasifikimi i ndryshëm i të ardhurave, pasi ISSH, përveç të ardhurave nga kontributet (133,655 milionë lekë), përfshin edhe të ardhura jo tatimore në shumën 640 milionë lekë; efektet e riklasifikimeve dhe penaliteteve.

- Me Akt rakordimin nr. 1273/1, datë 27.01.2025 Ministria e Financave (MF) dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) kanë rakorduar realizimin e të ardhurave të raportuar në sistemin Oracle, në vlerën 134,295,143,017 lekë. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) kanë raportuar në MF, të ardhura në vlerën 134,295,636,937 lekë. Krahasimi midis këtyre dy burimeve ka nxjerrë diferencë negative në vlerën 493,920 lekë, që janë rimbursime të skemës së sigurimeve shoqërore, të cilat lidhen me raportime të ndryshme të sistemit Oracle në MF. Kjo diferencë shkaktohet kryesisht nga vonesa kohore në pasqyrim, lidhen me afrime teknike në regjistrimin e gjobave e kamatëvonesave ndërmjet sistemeve. korrigjimeve të deklaratimeve apo riklasifikimeve të pagesave të cilat MF i pasqyron si arkëtime. *Trajtuar më hollësisht në pikën 3.2.3, faqe 32-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Titullari i ISSH dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të shqyrtojnë mospërfuturit me Treguesit e Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, për sa i përket fondeve për ISSH, të raportuara në Kapitullin II "Të ardhurave tatimore"; II.3.1 "Të ardhura nga Fondet Speciale" (ISSH) dhe në Kapitullin I "Shpenzimet korrente", pika 5 "Shpenzimet për fondet speciale" (ISSH), për të garantuar një paraqitje të saktë dhe të unifikuar mes këtyre institucioneve, për të njëjtat zëra.

Menjëherë e në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se me Ligjin nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024" të ndryshuar, në nenin 4, pika 3, është përcaktuar se "Rezultati pozitiv në fund të vitit buxhetor derdhet në të ardhurat e buxhetit të shtetit të vitit pasardhës, pas miratimit të pasqyrave financiare, por jo më vonë se muaji prill 2024" dhe kjo është reflektuar në zërin "Rezultati financiar i ISSH" në grupin e të ardhurave tatimore në shumën 7,900 milionë lekë në tabelën 4 të ligjit, Treguesit Fiskalë sipas Buxhetit të Konsoliduar, realizuar në shumën 7,916 milionë lekë. Realizimi i këtij treguesi buxhetor është kryer në vijim të shkresës nr. 4776/1 prot. datë 25.04.2024 të ISSH "Kërkesë për transferim të likuiditeteve të krijuara nga rezultati financiar pozitiv i ISSH", ku është kërkuar transferimi më datë 25.04.2024 të shumës 7,916,259,945 lekë të gjendjes së likuiditetit të krijuar në Llogarinë Speciale të ISSH, në llogarinë me përfitues Ministria e Financave. Nga auditimi konstatohet se referuar Kapitullit V "Fondi i Sigurimit Shoqëror", të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, nuk është përcaktuar në asnjë nen transferimi i rezultatit të vitit, në Buxhetin e Shtetit pas krijimit të gjendjes së fondit rezervë në nivelin e një muaji të shpenzimeve të skemës. Gjithashtu, u konstatua se nuk përmbushen kushtet për t'u klasifikuar si e ardhur buxhetore, referuar nenit 3, pika 18 të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, i ndryshuar, pasi nuk kemi një rritje të pasurisë neto, por vetëm një lëvizje nga llogaria në llogari.

Nga auditimi u konstatua se megjithëse është kërkuar përdorimi i rezultatit të akumuluar financiar, me ligj është miratuar vetëm rezultati financiar pozitiv në fund të vitit buxhetor, dhe jo rezultati i akumuluar ndër vite. Nga MF me shkresën nr. 5158 prot., datë 17.04.2024 i është kërkuar ISSH-së **derdhja e rezultatit financiar të vitit 2023**, duke përcaktuar derdhjen në buxhetin e shtetit të fitimit të rezultuar nga viti 2023. Në përgjigje të kësaj shkrese, ISSH ka bërë kërkesë për transferim të likuiditeteve të krijuara nga rezultati financiar pozitiv i ISSH. Sipas VKA të ISSH nr. 4 datë 09.07.2024 “Për miratimin e rezultatit financiar të sigurimeve shoqërore për vitin 2023” është miratuar rezultati financiar pozitiv për vitin 2023 në shumën 1,107,162,055 lekë, duke destinuar 757,214,912 lekë për shtesën e fondit rezervë (nga 13,301,863,461 lekë në 14,059,078,373 lekë) dhe pjesën tjetër prej 349,947,142 lekë për kalim në rezultat të mbartur. Sa më sipër konstatohet se, në kundërshtim me parashikimet ligjore për transferimin e rezultatit vjetor, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) nuk ka transferuar në buxhetin e shtetit rezultatin e realizuar për vitin 2024, por është transferuar rezultati i mbartur nga vitet e mëparshme, konkretisht: 3,502,042,169 lekë nga viti 2021 dhe 4,414,217,785 lekë nga viti 2022, sipas të dhënave dhe llogaritjeve të paraqitura nga vetë ISSH.

Këto të ardhura nuk janë përdorur as për rritjen e fondit rezervë të ISSH-së, as për financimin e drejtpërdrejtë të skemës së sigurimeve shoqërore, e cila gjatë vitit ka rezultuar me deficit dhe është mbështetur nga transfertat të konsiderueshme nga buxheti i shtetit. Ky veprim ka çuar në mbivlerësimin e treguesve të të ardhurave dhe nuk reflekton realisht situatën financiare të skemës. (Trajtuar më hollësisht në pikën 3.2.3, faqe 41-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Këshilli Administrativ i ISSH të marrë masa për analizimin e situatës dhe të përcaktojë destinacionin e rezultatit të mbartur, si dhe të kryejnë detajimin e fondeve në financimin e nevojave të skemës së sigurimeve shoqërore në kushtet kur skema e sigurimeve shoqërore paraqitet me deficit dhe mbështetet me transfertat nga buxheti i shtetit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi problematikën në lidhje me rritjen e numrit të subjekteve me detyrime të prapambetura të kontributeve të sigurimeve shoqërore rezultoi se: Me anë të shkresës nr. 9189 prot., datë 03.09.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe për dijeni Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në lidhje me rritjen e detyrimeve të prapambetura të kontributeve të sigurimeve shoqërore, ku për shkak të këtyre detyrimeve, ISSH nuk mund të administrojë listëpagesat mujore përkatëse dhe për rrjedhojë një numër i konsiderueshëm individësh të punësuar në këto subjekte, nuk mund të përfitojnë shërbime nga skema e sigurimeve shoqërore.

a. Gjendja e debitorëve që ndiqen nga DPT në vitin 2024 e krahasuar me vitin 2023, ka pasur ndryshime të dukshme në sektorët publik dhe privat. Nga auditimi u konstatua rritje e numrit total të subjekteve debitorë me 10,705 (sektori publik dhe privat), si dhe e vlerës së debisë me 1,769,534 mijë lekë. Në sektorin publik, numri i debitorëve buxhetorë është reduktuar me 72, por vlera e tyre është rritur me 69,978 mijë lekë në vitin 2024. Kjo tregon një rritje të detyrimeve financiare të sektorit publik, që mund të pasqyrojë një problem më të madh në menaxhimin e borxheve.

Nga të dhënat e analizuara për sektorin privat, u konstatua një rritje e konsiderueshme e numrit të debitorëve dhe e vlerës së detyrimeve të papaguara. Konkretisht, në kategorinë e biznesit të madh është regjistruar një rritje me 2,877 subjekte debitore, ndërsa vlera e detyrimeve është shtuar me 422,880 mijë lekë. Në bizneset e vogla, megjithëse rritja numerike e debitorëve është më e lartë – me 7,729 subjekte – rezultoi gjithashtu dhe një rritje më e madhe në vlerë, me 877,614 mijë lekë. Ky trend pasqyron një përkeqësim të situatës së arkëtimeve nga kontributet dhe përbën një indikator të vështirësive financiare që po përballen sidomos bizneset e vogla në përmbushjen e detyrimeve të tyre ndaj skemës së sigurimeve shoqërore.

Nga detyrimet e sigurimeve shoqërore të papaguara, pjesën më të madhe të borxhit e përbëjnë subjektet juridike (54.9%) dhe biznesi i vogël (38.9%), ndërsa subjektet buxhetore dhe jo buxhetore përbëjnë një pjesë shumë më të vogël me 2.4% dhe 3.9%. Totali i detyrimeve arrin në

mbi **20,226 milionë lekë**, duke përfshirë detyrimin, gjrobat dhe interesat. Detyrimet e papaguara nga subjektet nën përgjegjësi të DPT-së, janë progresive dhe dërgohen në ISSH çdo 3 muaj, sipas akt marrëveshjes midis dy institucioneve. Subjektet **aktive** debitore rezultojnë në numër 51,653 ose rreth 42.8% të numrit total të subjekteve debitore dhe në vlerën 9,352 milionë lekë ose 46% të të gjithë shumës të detyrimit, ku vetëm subjektet me formë ligjore SHPK, përbëjnë një pjesë të madhe të borxhit, të cilët rezultojnë në numër 12,277 dhe në vlerën mbi **4,603 milionë lekë**.

Detyrimet e papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore nga subjektet **pasive**, të ndara sipas kategorive: biznesi i madh privat ka borxhin më të lartë, me 67.6% të totalit, ndjekur nga biznesi i vogël me 29.7%. Subjektet buxhetore dhe jo buxhetore kanë detyrime përkatësisht 1.8% dhe 0.9%. Në total, borxhi i papaguar është mbi **9,763 milionë lekë**. Subjekte debitorë me formë ligjore SHPK rezultojnë në numër 14,570 dhe në vlerën mbi **5,610 milionë lekë**.

b. Debitorët e mbetur në organet e sigurimeve shoqërore të ISSH-së janë rritur nga viti në vit, sepse shtesat e borxhit janë më të mëdha se pakësimet, e cila tregon një tendencë negative në mbledhjen e detyrimeve për sigurimet shoqërore. Nga auditimi rezultoi se në vitin 2024, pati një rritje të debitorëve për kontribute, në vlerën **295,121,094 lekë** krahasuar me vitin 2023.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 3.2.3 faqe 51-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të ISSH dhe DPT të intensifikojnë masat për forcimin e kontrolleve, monitorimin periodik dhe ndjekjen efektive të debitorëve, duke aplikuar mekanizma parandaluese dhe ndëshkues për shmangien e akumulimit të mëtejshëm të detyrimeve të papaguara për sigurimet shoqërore. Gjithashtu, të përforcohen politikat e menaxhimit të borxhit, veçanërisht ndaj bizneseve të vogla dhe subjekteve me formë ligjore SHPK, për të siguruar një bazë më të shëndetshme financiare dhe përmirësimin e nivelit të mbledhjes së të ardhurave nga kontributet.

Menjëherë e në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave mbi listëpagesat e sigurimeve shoqërore të munguara, u konstatuan mangësi në drejtim të bashkëpunimit ndërmjet ISSH dhe DPT.

Nga ana e ISSH janë evidentuar problematika në transmetimin e listëpagesave në formatin elektronik si: Vendosje e pasaktë e Numrit Personal të punëmarrësve në dokumentacionin elektronik; Problematika të mbartura nga vitet 2013–2014 për subjektet e varësisë së Drejtorive Arsimore Rajonale Elbasan, Durrës dhe Fier, të cilat vijnë të mbeten të pazgjidhura; Në sistemin CMIS, mungojnë listëpagesat për periudhat përkatëse të personave gjyqftues, për shkak se DPT nuk lejon gjenerimin e listëpagesave individuale për këta persona, duke penguar pasqyrimin e kontributeve përkatëse në bazën e të dhënave të ISSH; si dhe në rastet kur subjektet kryejnë pagesa të pjesshme për punëmarrës të veçantë, të dhënat për kontributet e paguara nuk pasqyrohen në sistemin CMIS. Për sa më sipër, rezulton se për periudhën 2012 – 2024, DPT ka dërguar në ISSH gjithsej 16,705,303 listëpagesa të formatit elektronik. Gjatë vitit 2024 janë plotësuar gjithsej 209,260 listëpagesa më shumë e krahasuar me vitin 2023.

-Në vitin 2024, u konstatua një ulje e lehtë e numrit të listëpagesave të munguara të formatit letër për periudhën 2006-2012. Numri i listëpagesave të munguara u reduktua nga 1,483,347 në fund të vitit 2023, në 1,475,773 në fund të vitit 2024, duke shënuar një ulje prej 7,574 listëpagesash në total ose në masën 0.5%, por për një numër të konsiderueshëm DRSSH-sh, problematika mbetet pothuajse e pandryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 3.2.3, faqe 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të intensifikojnë bashkëpunimin institucional për eliminimin e mangësive në transmetimin e listëpagesave elektronike dhe reduktimin e listëpagesave të munguara, duke ngritur një mekanizëm të përhershëm koordinimi dhe shkëmbimi të dhënash, me qëllim sigurimin e integritetit të plotë të informacionit në sistemet CMIS dhe arkivat përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të ISSH për vitin 2024, rezultoi se nga Ministria e Financave janë dërguar për njohje dhe zbatim tavanet përgatitore të PBA 2024-2026, ku janë përcaktuar shpenzimet e programit “Sigurime Shoqërore ku paraqitet një rritje e shpenzimeve të ISSH-së të programuara, kundrejt tavanit të shpenzimeve sipas MF-së për vitet 2024-2026. Konkretisht, për vitin 2025 kërkohet një shtesë prej 1,348 milionë lekë dhe për vitin 2026 një shtesë prej 2,477 milion lekë, duke marrë parasysh edhe ndikimin afatgjatë të rritjes së pensioneve për çdo vit në nivelet e inflacionit të vendosura nga qeveria nga data 1 prill për secilin vit, si për qytetin ashtu edhe për fshatin. Nga auditimi rezultoi se parashikimi i fondit në planin fillestar për zërin “AQ të patrupëzuara (230)”, është bërë i bazuar në shkresën e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) nr. 4372 prot, datë 25.08.2023 “Ri inxhinierizimi dhe rregullimi i shërbimeve publike dhe proceseve të punës”, drejtuar ISSH-së për “Digjitalizimin e Arkivës fizike të ISSH-së”, në të cilën kërkohet alokimi i fondeve buxhetore. Mosrealizimi për këtë zë ka ardhur si rezultat i mospërfundimit të procedurave nga ana e AKSHI-t. Shpenzime për rritjen e AQ të patrupëzuara (230), rezultoi me mosrealizim në shumën 177,920 mijë lekë ose në masën 11%, kundrejt planit fillestar. Në vitin 2024, plani i “Shpenzimeve administrative” të ISSH është rritur në 3,700,000 mijë lekë, pra 402,617 mijë lekë më shumë krahasuar me 2023. Megjithatë, realizimi i shpenzimeve ishte 12% më i ulët se plani përfundimtar, me një diferencë prej 426,867 mijë lekë, duke treguar mangësitë e planifikimit për vitin 2024. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 3.2.3 , faqe 57-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Titullari i ISSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrë masa për forcimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit buxhetor, përmes një analize më të thelluar të nevojave reale dhe kapaciteteve zbatuese të institucionit. Gjithashtu, të sigurohet që parashikimi i fondeve për zëra specifikë si, “Aktive të patrupëzuara” dhe “Shpenzime administrative”, të jetë sa më i saktë dhe i harmonizuar me tavanet e përcaktuara nga Ministria e Financave, si dhe të përforcohet koordinimi ndërinstitutional me AKSHI-n për zbatimin e angazhimeve brenda afateve të përcaktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve (DIP), gjatë vitit 2024 nuk ka planifikuar inspektime pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH), Tiranë, Fier, Lezhë dhe Berat, pavarësisht faktit se këto DRSSH-të, kanë një numër të konsiderueshëm përfituesish nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore, përfshirë pensionet afatgjata, përfitimet e invaliditetit, familjare dhe sociale. Mungesa e inspektimeve ka krijuar mangësi në ushtrimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së rregullt të veprimtarisë së këtyre strukturave, duke rritur ekspozimin ndaj riskut për dhënie përfitimesh të parregullta apo për vonesa në rikuperimin e shumave të paguara në mënyrë të pasaktë, veprime të cilat bien në kundërshtim me parashikimet e nenit 62, pika 3 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqe 64-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve të marrë masa të sigurojë përfshirjen sistematike të të gjitha Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në planin vjetor të inspektimeve, duke filluar nga plani i ardhshëm, ku të përfshihen në mënyrë të detyrueshme DRSSH Tiranë, Fier, Lezhë dhe Berat, me qëllim forcimin e mbikëqyrjes, respektimin e afateve ligjore dhe sigurimin e ligjshmërisë së përfitimeve të administruara.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve (DIP) nuk ka inspektuar të gjitha dosjet e paraqitura për kontroll, duke devijuar nga plani i miratuar vjetor si dhe nga detyrimet ligjore në fuqi, mos realizimit në kohë të planeve të inspektimit është në kundërshtim me parashikimet e nenit 62, pika 3 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, afati për rikuperimin e shumave të konstatuara si të përfituara në mënyrë të padrejtë nga përfituesit e pensioneve është 3 vjet.

Grupi i auditimit konstatoi mungesë në angazhimin e duhur nga strukturat përgjegjëse për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), duke ndikuar negativisht në respektimin e parimeve të ligjshmërisë dhe në garantimin e mbrojtjes së fondeve publike. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4, faqe 67-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Titullari i ISSH si dhe Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve pranë ISSH të të marra masa të zbatojë me përpikëri planin vjetor të inspektimeve dhe detyrimet ligjore në fuqi, duke garantuar kontrollin e plotë të dosjeve dhe ndërmarrjen në kohë të masave për rikuperimin e përfitimeve të përfituara padrejtësisht, brenda afateve të parashikuara nga legjislacioni. Gjithashtu, të forcohet angazhimi institucional dhe përgjegjshmëria e strukturave përkatëse, me qëllim parandalimin e përsëritjes së mangësive që çenojnë ligjshmërinë e skemës dhe mbrojtjen e fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për në 128 raste të ndara në 125 raste të çertifikuara nga Drejtoria e Inspektimit (DIP) dhe 3 raste të konstatuara në DRSSH Berat, masa e ndalesës së përfitimtë mujor është arkëtuar në disa këste mujore të zgjatura në kohë dhe jo sa 50% e vlerës së përfitimtë/mujor veprimet në kundërshtim me nenin 62, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, duke shkaktuar vonesa në kthimin e shumave të përfituara padrejtësisht. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4 faqe 75-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: ISSH dhe DRSSH-të të marrin masa për rishikimin e ndalesës së pensioneve për rastet e shpallura debitor në nivelin prej 50%, duke e aplikuar proporcionalisht me indeksimin (rritjen) e pensionit dhe duke bërë përjashtim vetëm për kështin e fundit, me qëllim rikuperimin në kohë të shumave të përfituara padrejtësisht.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e afateve nga përfundimi i inspektimit në terren deri në mbajtjen e Raportit Paraprak dhe të Raportit Përfundimtar, rezultoi se nga ana Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve (DIP) nuk janë të njëjta dhe variojnë deri në 60 ditë vonesë, ky veprim bie në kundërshtim me përcaktimet e Rregullores së miratuar të DIP në kreun VI të saj.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve (DIP) të ndërmarrë masa konkrete për standardizimin dhe respektimin e afateve të përcaktuara sipas Rregullores, nga momenti i përfundimit të inspektimit në terren deri në hartimin dhe miratimin e Raportit Paraprak dhe atij Përfundimtar.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura për zbatimin e afateve nga paraqitja e kërkesës deri në caktimin e pensionit në DRSSH Berat, u konstatuan parregullsi në 7 dosje përfitimtë, si pasojë e mosrespektimit të procedurave të përcaktuara në Rregulloren Nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, duke shkaktuar vonesa në marrjen e shërbimit nga qytetarët. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2). 4 faqe 86-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: DRSSH Berat të marrë masa për të siguruar zbatimin e afateve ligjore në të gjithë procesin nga paraqitja e kërkesës nga përfituesi deri te caktimi i pensionit, duke përmirësuar koordinimin dhe kontrollin në mënyrë që qytetarët të marrin shërbimin e pensionit në kohë dhe sipas parashikimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer mbi hedhjen e kartelave për vitin 2024 në sistemet PAMC dhe CMIS, pas krahasimit ndërmjet dy sistemeve informatike, u konstatuan një numër i konsiderueshëm rastesh të trashëguara të pa sistemuara. Këto parregullsi janë shkaktuar nga

mospërputhjet e krijuara gjatë hedhjes manuale të të dhënave në sistem, si dhe nga mosidentifikimi në kohë të rasteve të dyfishta të punësimit pas certifikimit të pensioneve, duke sjellë pasaktësi në të dhënat e pensioneve dhe rrezik për saktësinë dhe afatet e pagesave. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2).5, faqe 83-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1. Rekomandim: ISSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për të minimizuar riskun e përfitimeve të padrejta, të marrin masa për krijimin e një sistemi të integruar të përbashkët, i cili të mundësojë verifikimin në kohë reale të statusit të punësimit për çdo aplikant, të sigurojë përputhshmërinë e të dhënave midis dy palëve dhe të rrisë efikasitetin në menaxhimin e sistemeve të përfitimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik “Blerje me vlerë të vogël” të zhvillura nga ISSH për vitin 2024, u konstatua se:

- Në administrimin e dokumentacionit komisioni i prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, për procedurën “Mirëmbajtja e faqes zyrtare të ISSH-së” kishte mangësi në ndjekjen e realizimit të shërbimit konkretisht;protokollimin e procesverbaleve mujore.

Në dy procedurat me vlerë nën 100 mijë lekë u konstatua mangësi në dokumentacion, veprime në kundërshtim me Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, i përditësuar, si dhe të Udhëzimit nr.5, datë 25.06.2021 “Për përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën nr.2.7, faqe 112-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1.Rekomandimi: ISSH, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, të marrë masa për ndjekjen dhe realizimin e shërbimeve të kryera duke protokolluar procesverbalet e realizimit të shërbimit, si dhe për procedurat e prokurimit me vlerë nën 100 mijë lekë, të bëhet plotësimi i dokumentacionit sipas udhëzimeve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të mbledhjeve të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2024, u konstatua se procedurat e njoftimit për mbledhjet nuk janë respektuar në përputhje me afatet dhe kërkesat e përcaktuara në Statutin e ISSH-së. Konkretisht, në të gjashtë rastet e zhvillimit të mbledhjeve gjatë vitit, njoftimet përkatëse janë dërguar nga një deri në tre ditë përpara mbledhjeve, në kundërshtim me afatin minimal 10-ditor të përcaktuara në Statutin e ISSH-së. Po ashtu, asnjë nga këto njoftime nuk është firmosur nga Kryetarja e Këshillit Administrativ, siç kërkohet nga po i njëjti nen. Gjithashtu, në mbledhjen e datës 19.11.2024, nuk është zbardhur me vendim miratimi i rendit të ditës dhe i procesverbalit të mbledhjes, në kundërshtim me praktikën e ndjekur në mbledhjet e tjera të vitit. Mungesa e këtij formalizmi cenon transparencën dhe dokumentimin e plotë të procesit vendimmarrës të organit drejtues. Veprime këto në kundërshtim me nenin 17 të Statutit të ISSH-së, miratuar me VKM nr. 161, datë 11.04.2006, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 28, faqe 90-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandim: Sekretariati i Këshillit Administrativ të marrë masa që njoftimet për mbledhjet të dërgohen brenda afatit minimal 10-ditor dhe të jenë të firmosura nga Kryetarja e Këshillit, në përputhje me kërkesat procedurale. Gjithashtu, të garantohet që në çdo mbledhje të formalizohet me vendim miratimi i rendit të ditës dhe i procesverbalit përkatës, me qëllim forcimin e transparencës, dokumentimit të plotë dhe respektimit të procedurave të vendimmarrjes.

Menjëherë

17.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i VKA-së nr. 4, datë 09.07.2024, u konstatuan disa mospërputhje me parimet ligjore dhe institucionale që rregullojnë funksionimin e skemës së sigurimeve shoqërore.

-Së pari, vendimi nuk përmban bazën ligjore mbi të cilën mbështetet vendimmarrja, duke cënuar kërkesat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative për formën dhe sigurinë juridike

të akteve. Gjithashtu, mungon relacioni teknik dhe ligjor shoqërues, duke cënuar transparencën dhe proporcionalitetin e vendimit.

-Së dyti, vendimi është miratuar pas afatit ligjor të përcaktuar në ligjin vjetor të buxhetit, i cili parashikon miratimin e pasqyrave financiare dhe kalimin e rezultatit financiar pozitiv në buxhetin e shtetit jo më vonë se muaji prill 2024. Miratimi në korrik bie ndesh me këtë afat.

-Së treti, u konstatua mospërputhje ndërmjet ligjit dhe statutit të ISSH-së mbi nivelin e fondit rezervë – ligji kërkon të mbulojë të paktën 1 muaj pensione, ndërsa statuti 3 muaj.

-Së katërti, pjesa e mbetur e rezultatit financiar pozitiv për vitin 2023, në vlerën 349,947,142.33 lekë, është kaluar në llogaritë e rezultatit të mbartur me destinacion të papërcaktuar dhe jashtë skemës së sigurimeve shoqërore, pa një bazë ligjore të qartë. Kjo bie në kundërshtim me misionin e ISSH-së për të garantuar pavarësi financiare dhe përdorimin e fondeve në funksion të përfituesve të skemës. Në zbatim të nenit 52 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën për sigurime shoqërore për çdo individ në pleqëri apo në raste paaftësie, administrimi i rezultateve financiare të skemës duhet të bazohet në ligjshmëri, transparencë dhe në forcimin e kapaciteteve të saj financiare. Kalimi i fondeve jashtë skemës, pa destinacion të qartë dhe pa mbështetje të plotë ligjore, bie ndesh me këto parime kushtetuese dhe rrezikon të cënojë funksionin social të sistemit të sigurimeve shoqërore. Këto mangësi përbëjnë devijim nga parimi i vete qëndrueshmërisë dhe karakterit të mbyllur të skemës, duke dëmtuar transparencën dhe llogaridhënien në përdorimin e kontributeve dhe duke rritur rrezikun për cenimin e qëndrueshmërisë së saj financiare në të ardhmen.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me, nenin 99, pika (iv) të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, “Manuali për hartimin e legjislacionit” (Shtojca E), Neni 4, pika 3 të Ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” (i ndryshuar), Nenin 71, pika 2, nenin 65, nenin 70 të Ligjit nr. 7703/1993, Nenet 3, 6 të Statutit të ISSH-së, miratuar me VKM nr. 161, datë 11.04.1994, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8. faqe 91-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandim: Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Këshilli Administrativ të marrë masa që vendimmarrjet mbi përdorimin e rezultateve financiare të jenë të mbështetura në një bazë të qartë ligjore dhe në përputhje me misionin institucional të garantimit të autonomisë financiare të skemës. Përkatësisht, çdo tepriçë financiare duhet të destinohet në mënyrë të plotë për forcimin e fondit rezervë dhe për përfitimet e kontribuesve, duke shmangur kalimin e saj jashtë skemës pa një qëllim të përcaktuar ligjorisht. Gjithashtu, të rishikohen dhe harmonizohen dispozitat e statutit me ligjin për të shmangur paqartësitë normative që mund të çojnë në vendimmarrje të kontestueshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i VKA-së nr. 9, datë 12.09.2024, dhe procesit pasues të indeksimit të pensioneve për vitin 2024, u konstatua se përzgjedhja e muajit gusht 2024 si bazë për përlllogaritjen e indeksit ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e përqindjes së indeksimit për përfituesit e skemës. Konkretisht, vlera 4.1% e aplikuar është më e ulët se mesatarja aritmetike e thjeshtë e indekseve mujore të raportuara nga INSTAT për periudhën janar–gusht 2024, e cila arrinte në rreth 4.6%. Ky nivel më i ulët i indeksimit rezulton si pasojë e ndryshimeve të bëra me VKM nr. 11, datë 11.01.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 131, datë 22.02.2017 të Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e listës së mallrave të zgjedhura dhe metodën e llogaritjes së indeksit” që e zëvendësoi metodologjinë e mëparshme të përlllogaritjes vjetore, duke mundësuar përdorimin e muajve me inflacion më të ulët si referencë. Ndryshe nga praktika e ndjekur në vitet 2019–2022, kur vendimet për indeksimin miratoheshin në muajin mars mbi bazën e indekseve të janarit/shkurtit kur inflacioni ishte zakonisht më i lartë, për vitin 2024 u aplikua një afat më i vonuar (shtator), duke përdorur si referencë muajin me vlerë më të ulët të indeksit të çmimeve. Nga analiza krahasuese e të dhënave të muajve të parë të vitit rezultoi se, në janar 2024 indeksi për shportën e pensionistëve ishte 5.7%.

Nëse do të ishte ndjekur praktika e viteve paraardhëse, ku indeksimi bazohej në të dhënat e muajit janar të vitit përkatës, përqindja e indeksimit për vitin 2024 do të kishte qenë 5.7% në vend të 4.1%. Ky ndryshim ka ndikuar negativisht në masën reale të rritjes së pensioneve, duke rezultuar në një nivel indeksimi më të moderuar që nuk reflekton plotësisht tendencën e rritjes së kostos së jetesës për pensionistët.

Për më tepër, ndryshimi i mekanizmit të përlogaritjes, ka sjellë efekt indirekt në zbehjen e funksionit kompensues të indeksimit, duke rrezikuar që pensionistët të mos përfitojnë në kohë reale nga ndikimi i inflacionit.

Veprime e mësipërme janë në mospërputhje me nenin 65, pika 10, të Ligjit nr.9442, datë 16.11.2005 "Për Ratifikimin e Konventës nr. 102 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Për sigurimet shoqërore (Standardet minimale". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 93-93 të të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandim: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, si dhe INSTAT, të marrë masa të analizojë ndikimin e ndryshimit të metodologjisë së përlogaritjes së indeksit të pensioneve dhe të propozojë, nëse është e nevojshme, rishikimin e saj me qëllim që mekanizmi i indeksimit të sigurojë një mbrojtje më efektive të fuqisë blerëse të pensionistëve. Gjithashtu, të shqyrtohet rikthimi i praktikës së miratimit të vendimeve për indeksim në muajin mars, duke përdorur si referencë periudhën me inflacion më të lartë, për të garantuar një reflektim më të drejtë të kostove reale të jetesës në përfitimet e indeksuara.

Brenda datës 31.3.2026

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në dhjetor 2024, në strukturën organizative të ISSH-së, e cila përbëhej nga gjithsej 1265 pozicione, ishin të plotësuar 1223 vende pune, ndërsa 42 pozicione rezultuan vakante, nga të cilat 33 pozicione në drejtoritë rajonale, dhe 9 pozicione në Drejtorinë e Përgjithshme. Mungesa e burimeve njerëzore ka ndikuar negativisht në mirëfunksionimin e njësive përkatëse, duke rritur ngarkesën e stafit ekzistues dhe duke krijuar rrezik për uljen e performancës dhe cilësisë së shërbimeve publike.

Paralelisht, gjatë vitit 2024, janë evidentuar parregullsi në procedurat e rekrutimit të realizuara nga institucioni. Konkretisht, janë realizuar emërimë në 3 pozicione specialistësh në Sektorin e Administrimit të Bazës së të Dhënave në mungesë të dokumentacionit që vërteton zhvillimin e një procedure të hapur apo të brendshme konkurrimi. Në një rast, punonjësi i emëruar nuk plotësonte kriteret e kërkuara për nivelin arsimor dhe përvojën profesionale. Mosrespektimi i procedurave të rekrutimit dhe mungesa e transparencës në përzgjedhje cenojnë zbatimin e parimit të meritës dhe barazisë në trajtim, si dhe rrisin riskun për kontestime administrative dhe ligjore. Veprime këto në kundërshtim me Rregulloren nr. 3/2, datë 20.02.2008 "Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore", e ndryshuar me VKA nr. 5, datë 14.08.2020, Kapitulli I, pika 1.1 dhe 1.2; Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 107, pika 2; Rregulloren e Personelit të ISSH-së, Kapitulli I, pika 1 (a), (b); Rregulloren e Personelit të ISSH-së, pika 2. 1 pika 4 (1), (2), Rregulloren "Për Organizimin dhe Funksionimin e ISSH-së", Kapitulli IV, pika 1.3.4 (b). (Më hollësisht trajtuar në pikën).8, faqe 97-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1.Rekomandim: Titullari i ISSH, në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Përgjithshëm, të marrë masa konkrete për plotësimin e pozicioneve vakante të miratuara në strukturë, duke garantuar shpalljen e tyre brenda afateve të arsyeshme dhe në përputhje me rregulloren e brendshme për personelin. Gjithashtu, të sigurohet që çdo rekrutim të zhvillohet përmes një procedure konkurrimi që është transparente dhe e dokumentuar, me qëllim plotësimin e burimeve njerëzore dhe garantimin e funksionimit efikas të njësive organizative.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 25 dosjeve të personelit, u konstatua se në të gjitha rastet mungon fleta prezantuese standarde e dosjes së të punësuarit, certifikata personale dhe certifikata e gjendjes familjare. Në 5 raste nuk është përfshirë vlerësimi vjetor i performancës për vitin 2024. Në 4 raste mungon kontrata individuale e punës, ndërsa në një rast kontrata rezulton e

panënshkruar nga palët përkatëse. Gjithashtu, në një dosje mungon diploma universitare, në një tjetër diploma e shkollës së mesme, ndërsa në dy raste diploma e ciklit master nuk shoqërohet me vërtetimin përkatës të notave. Kjo situatë mund të sjellë pasaktësi në trajtimin e çështjeve që lidhen me menaxhimin e personelit dhe të ndikojë në transparencën dhe gjurmueshmërinë e të dhënave në rast auditimi apo procesesh administrative.

Këto mangësi, janë në mospërputhje me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrimit Qendror të Personelit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 97-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandim: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm pranë ISSH të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit të konstatuara me mungesa, duke siguruar përfshirjen e të gjithë dokumentacionit të detyrueshëm për çdo punonjës, me qëllim garantimin e administrimit korrekt dhe funksional të burimeve njerëzore.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 25 kontratave individuale të punës u konstatua se, megjithëse të nënshkruara nga të dyja palët, dokumentet nuk përmbanin të gjitha elementet e detyrueshme të përcaktuara në Kodin i Punës, i përditësuar, Kreu IV, nenet 11, 1 (e), 12, 21, (3). Konkretisht, mungojnë informacionet për afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës, kohëzgjatjen e pushimeve të paguara dhe përshkrimi i qartë i të drejtave dhe detyrimeve të palëve. Po ashtu, në asnjë kontratë nuk është reflektuar ndryshimi i fundit lidhur me kohëzgjatjen e pushimit vjetor, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 746, datë 04.12.2024, për disa ndryshime në VKM-në nr. 568, datë 06.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në Institucionet e Administratës Shtetërore, Institucionet e Pavarura dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore" (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 97-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandim: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në ISSH, të rishikojë dhe përditësojë kontratat e punës, duke siguruar përfshirjen e të gjithë elementeve të detyrueshme ligjore dhe zbatimin e akteve nënligjore në fuqi, në mënyrë që të reflektohen qartë të drejtat, detyrimet dhe procedurat përkatëse për të dyja palët.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISSH, gjatë vitit 2024, nuk ka siguruar funksionim të plotë dhe të integruar të komponentëve kryesorë të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në komponentin "Mjedisi i Kontrollit", mungon një Plan i Veprimit i miratuar për kontrollin e brendshëm, nuk janë hartuar objektiva dhe plane pune sipas formatit të kërkuar, si dhe mungon një dokument strategjik për objektivat afatgjata të institucionit. Po ashtu, nuk janë raportuar periodikisht informacionet pranë Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe nuk është funksionalizuar GMS sipas kërkesave ligjore. Në komponentin "Menaxhimi i Riskut", mungon përditësimi i regjistrit të riskut, planet e masave për risqet me prioritet, dhe integrimi i vlerësimit të riskut të mashtrimit në procesin e përgjithshëm të menaxhimit të riskut. Në komponentin "Aktivitetet e Kontrollit", mungojnë manuale pune për proceset kyçe, si dhe gjurmët e përditësuara të auditimit. Në komponentin "Informimi dhe Komunikimi", edhe pse ekziston një sistem komunikimi elektronik, mungon raportimi i strukturuar dhe periodik mbi realizimin e objektivave në nivel qendror dhe vartësie. Në komponentin "Monitorimi", mungon një dokument i mirëfilltë për monitorimin e zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe nuk është miratuar një Plan Veprimi i MFK-së për ndjekjen e progresit dhe analizën e devijimeve nga objektivat). Kjo situatë rrit rrezikun e cenimit të integritetit financiar, vonesës në arritjen e objektivave institucionale dhe përdorimit joefektiv të fondeve publike, për shkak të ekspozimit ndaj risqeve të brendshme dhe të jashtme.

Për sa më sipër evidentohet se nga ana e ISSH-së nuk janë marrë masa për ngritjen e një sistemi funksional dhe efektiv për kontrollin e brendshëm.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”; Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK-së, i ndryshuar.(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8x, faqe 121-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.1.Rekomandim: Strukturat përgjegjëse të ISSH-së, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara, si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, me qëllim rritjen e efektivitetit në funksionimin e institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

23.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm pranë ISSH përgjatë vitit 2024, u konstatuan:

- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në ISSH ka funksionuar me një strukturë jo të plotë. Nga katër pozicione vakante të konstatuara në fillim të vitit, tre u plotësuan gjatë vitit (dy me punësim dhe një me komandim), ndërsa një pozicion mbeti vakant deri në fund të periudhës së auditimit. Gjithashtu, të gjithë audituesit (7 në total) janë diplomuar vetëm në fusha ekonomike, duke krijuar një strukturë homogjene dhe në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në osektorin publik”. Mungesa e diversitetit profesional dhe funksionimi me strukturë jo të plotë kufizon kapacitetin shumëdisiplinor të auditimit dhe rrit riskun për mosadresimin e plotë të aspekteve ligjore, teknike dhe procedurale, duke ndikuar negativisht në cilësinë e vlerësimeve mbi sistemet e kontrollit të brendshëm.

- Mangësi në dokumentimin e dosjeve të auditimit. Në disa raste mungonin inventarët sipas formatit, vlerësimi i riskut, dokumentet e takimeve ballafaqese, planet e veprimit dhe përgjigjet e subjekteve të audituara. Po ashtu, në auditimin e teknologjisë së informacionit nuk janë përdorur matricat teknike dhe ka munguar ekspertiza profesionale e nevojshme. Këto mangësi kanë cënuar standardizimin dhe cilësinë e auditimit, duke mos garantuar një opinion të plotë e të besueshëm mbi funksionimin e kontrolleve të brendshme, veçanërisht në sistemet komplekse të TI-së. Gjithashtu, Karta e Auditimit nuk është përditësuar sipas manualit përkatës.

Veprime këto në mospërputhje me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar dhe Manualit e Auditimit të Brendshëm, të ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 136-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1.Rekomandimi: Të merren masa për plotësimin e menjëhershëm të pozicionit vakant në strukturën e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe për sigurimin e diversitetit të nevojshëm profesional të audituesve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe nevojat e institucionit, me qëllim forcimin e kapaciteteve të njësisë dhe garantimin e një qasjeje shumëdisiplinore në auditim.

23.2.Rekomandimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të ISSH të marrë masa për standardizimin e dokumentimit të dosjeve të auditimit sipas manualit përkatës, përfshirë vlerësimin e riskut, dokumentimin e takimeve ballafaqese dhe përgjigjet e subjekteve të audituara si dhe të përditësojë Kartën e Auditimit. Gjithashtu, të sigurohet përfshirja në grupet e auditimit të audituesve me kapacitetet e duhura profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit, duke zbatuar udhëzimet teknike të parashikuara në manual.

Menjëherë dhe në vijimësi

